Ruajtja e sekretit është një çështje shumë e rëndësishme për respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, që parashikohet edhe në Kushtetutë, sipas të cilës garantohet mosndërhyrja jashtë ligjit në jetën private të njeriut (neni 35) (Elezi, 2002).

Në Kodin Penal Shqiptar janë paraqitur disa nene që dënojnë përhapjen e sekreteve vetjake (neni 122) ndërhyrjen e padrejtë në jetën private (neni 121), pengimin ose shkeljen e fshehtësisë së korrespondencës (neni 123) etj. (K.Penal i Republikës së Shqipërisë, 1995).

Ky parim është shumë i rëndësishëm edhe në mjekësi, i parashikuar edhe në Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore të Shqipërisë. Aq më tepër sot, që rreziku i shkeljes së tij është bërë më i madh nga zhvillimi i mediave elektronike, kompjuterave, fakseve, mesazheve zanore etj.

Në këto kushte, ka filluar që në shumë vende të përpunohet një legjislacion i ri mjekësor, për këto çështje. Por fusha e sekretit mjekësor pas vdekjes, nuk është e njohur aq sa duhet. Aspektet e ndryshme të tij është e rëndësishme të njihen edhe në vendin tonë, sepse kohët e fundit ka pasur te ne mjaft botime, të shoqëruara me diskutime dhe kritika sidomos në lidhje me sëmundjet dhe vdekjet e disa personave publikë.

Në këtë prezantim analizohen përveç të tjerave edhe disa të dhëna të karakterit etik, filozofik dhe juridik mbi këtë çështje që kanë të bëjnë kryesisht me interesat e personit të vdekur, kohën që ka kaluar nga vdekja, ndikimin negativ nga mosruajtja e të dhënave mjekësore në kujtim të tij, të pasuara me paraqitjen e disa rasteve të njohura etj.

2.Njohuri të përgjithshme mbi sekretin mjekësor.

A është e lejueshme të botohet gjithçka mbi studimet mjekësore që kryhen në trupin e njeriut? A mund të shpallen të gjitha të dhënat mjekësore mbi sëmundjet dhe shkakun e vdekjes nga ana e mjekëve? A duhen bërë përpjekje për zbulimin pas vdekjes e të dhënave mbi trupin e njeriut, si pasoja të veprimeve kriminale apo dyshimeve të kryerjes së tyre? A ka mundësi që zbatimi i parimeve të etikës mjekësore: konfidencialitetit, konsentit, respektit të trupit të njeriut pas vdekjes të kushtëzohen nga periudha kohore që ka kaluar? (Charlier,2014).

Kohët e fundit këto pyetje kanë filluar të bëhen edhe në vendin tonë sidomos në lidhje me të dhënat mjekësore dhe vdekjen e personave publikë të regjimit të mëparshëm, si p.sh. të Enver Hoxhës, Mehmet Shehut, Nako Spirut etj.,apo atyre të persekutuar dhe të vrarë në atë periudhë.

Për t'i kuptuar ato duhet analizuar në fillim parimi i rëndësishëm i konfidencialitetit mjekësor, i cili nga një detyrim moral u transformua në një detyrim ligjor dhe në fund si një nga të drejtat fondamentale të njeriut (Çipi,2015).

Sipas këtij parimi, në mbrojtje të interesave të pacientit, informatat që doktori merr prej tij gjatë ushtrimit të praktikës së tij mjekësore, nuk duhet t'ja u tregojë personave të tjerë, ose t'i përhapë ato. Në mungesë të garancisë që sekreti i tij do të ruhet nga mjeku, pacienti mund të mbajë të fshehur të dhëna të rëndësishme që mund të ndikojnë negativisht në mjekimin e tij, apo të personave të tjerë (Çipi, 2005).

Në fakt, koncepti i sekretit mjekësor, në shumë vende, sidomos ato perëndimore, ka një lidhje të ngushtë me atë të privilegjit të marrëdhënies mjek-pacient, një koncept ky më i ngushtë se konfidencialiteti mbi të drejtat e pacientit. Sipas tij, mjeku kurues, të dhënat që merr nga pacienti, nuk duhet t'ja zbulojë një pale tjetër dhe nuk duhet t'i përdorë kundër pacientit në gjykatë apo procese të tjera juridike (Robitcher,1968; DeWitt, 1959).

Kohët e fundit çështjeve të sekretit mjekësor po u kushtohet një vëmendje gjithnjë e më e madhe në lidhje me aspektet e tyre etike dhe juridike.

Zhvillimi i madh i mediave elektronike, arritjet në fushat e gjenetikës mjekësore kanë ndryshuar kuptimin e transmetimit tradicional të informacionit mjekësor.

Përdorimi i telefonave celularë dhe aparaturave të sotme elektronike: kompjuterave, fakseve etj., kanë krijuar mundësinë që të ndodhin shkelje të paqëllimshme të sekretit mjekësor. Mesazhet zanore të dërguara në mënyrë elektronike mund të dëgjohen edhe nga persona të tjerë përveç pacientëve. Po kështu

kompjuterizimi i të dhënave mjekësore, që ka shumë avantazhe, rrezikon në shkeljen e konfidencialitetit të tyre (Berg, 2001).

Për këtë në shumë vende është përpunuar një legjislacion i ri mjekësor për mbrojtjen e konfidencialitetit në rrethana të ndryshme (Guidance and adivece, confidentiality and disclosing information after death, 2021).

3.Sekreti mjekësor pas vdekjes.

Sekreti mjekësor pas vdekjes së pacientitdhe ai për personat publikë përbën një fushë të veçantë, jo shumë tëstudiuar.

Në këtë studimjanë analizuar nga literatura e huaj disa nga aspektet kryesore të kësaj çështjeje që kanë të bëjnë me konceptin e ruajtjes apo mosruajtjes të sekretit mjekësor pas vdekjes, argumentet filozofike dhe etike të këtyre qëndrimeve, rrethanave në të cilat ky sekret nuk ruhet, ndikimine kohës që ka kaluar nga vdekja, kush do ta ketë të drejtën për ta ruajtur ose jo sekretin mjekësor pas vdekjes etj.

Ruajtja e konfidencialitetit mjekësor pas vdekjes është e domosdoshme për të mbrojtur individin, qoftë për jetën private apo pozitën e tij shoqërore, për shkak të dëmit që mund t'i shkaktohet pacientit kryesisht moral, në rast se këto të dhëna mjekësore do të zbuloheshin (Berg,2001).

Shqetësimet e sotme mbi konfidencialitetin kanë të bëjnë kryesisht me çështjen kur mjeku zbulon një sëmundje veneriane (seksualisht të transmetueshme), ose që personi ka qenë i alkoolizuar ose të dhëna të tjera që mund të jenë përbuzëse për publikun, apo nëse zbulimi është kryer për t'u mbrojtur nga një veprim shpifës ndaj pacientit.

Po kështu grupet e gjakut në vetvete mund të mos jenë informata që duhen mbajtur sekret, por në rastet e çështjeve të përcaktimit të atësisë së bashku me ato të ADN-së, ato mund të jenë shumë të rëndësishme.

P.sh. në rastet e identifikimit të kufomave të masakrës së Srebrenicës, të kryer nga serbët në Bosnjë, nëpërmjet të ekzaminimit krahasues të të dhënave të ADN-së me ato të prindërve të tyre të gjallë, rezultoi që në disa raste babai i një viktime nuk ishte babai i vërtetë biologjik. Ky konstatim ishte e domosdoshme që të mbahej sekret për të shmagur konflikte të rënda familjare të mëvonshme.

Ose në rastet e personave të prekur nga HIV/AIDS, kjo sëmundje duhet mbajtur sekret edhe pas vdekjes së tyre Berg, 2001).

Mosruajtja e konfidencialitetit mjekësor pas vdekjes mund të ndodhë për shkak se mjekët nuk i kanë bërë ndonjë premtim pacientit të tyre për t'i ruajtur të dhënat mjekësore pas vdekjes së tij.

Në të vërtetë, pavarësisht se kjo parashikohet në kodet etike, pak mjekë e kanë shfaqur detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit të pacientëve të veçantë, dhe akoma më pak për sekretin mjekësor pas vdekjes.

Sipas literaturës mjekësore të huaj, mbrojtja e konfidencialitetit mjekësor pas vdekjes është në vartësi të interesave që ka pasur i ndjeri para vdekjes, për ta ruajtur atë.

Pra, nëse mosruajtja e konfidencialitetit mjekësor post mortem do të jetë në favor të personit të vdekur, kjo mund të mos kundërshtohet (Berg,2001).

Pikëpamjet filozofike në lidhje me interesat pas vdekjes së personit *(Berg,2001).*

Interesi i njeriut të vdekur është që t'i ruhen informacionet, në qoftë se shpallja e tyre pas vdekjes do ta dëmtonte atë, p.sh. nga mosmbajtja e premtimit për ruajtjen e sekretit mjekësor që mund të prekë kujtimin e njeriut kur ka qenë gjallë, apo nga shpifjet që mund t'i shkaktojnë atij një dëm moral.

Në të vërtetë njeriu i vdekur, ndërgjegjia e të cilit është zhdukur, nuk ka pse të ketë interesa. Por, ai kur ka qenë gjallë ka pasur interesa që duhet të vazhdojnë të ruhen edhe pas vdekjes së tij.

Edhe të afërmit e të vdekurit kanë interesa, që përcaktohen nga fakti se i vdekuri jeton në memorien e tyre. Kështu dëmtimi i memories së të vdekurit nga mosruajtja e të fshehtës mjekësore prej mjekëve, do të dëmtojë interesat e njerëzve të gjallë për të ruajtur në mendjet e tyre virtutet e personit të vdekur.

Mund të ndodhë që për një njeri që gjatë jetës së tij ka qenë shumë korrekt, nxjerrja e të dhënave mjekësore konfidenciale, të ndryshojë opinionin e gjithë të njohurve të tij që ata të kuptojnë tani, që ai ka qenë një njeri me të meta, i shtirë.

Nga pikëpamja filozofike dhe etike, ka dy qëndrime ndaj ruajtjes së konfidencialietit pas vdekjes (Berg, 2001):

-qëndrimi i parë, sipas të cilit, ruajtja e konfidencialitetit pas vdekjes duhet të jetë shumë më e fuqishme, të ketë një karakter absolut, në krahasim me sekretin mjekësor para vdekjes. Kjo, sepse personi që ka vdekur, tani nuk ka më mundësi që ta miratojë këtë mosruajtje të konfidencialitetit, ose të mbrojë reputacionin apo identitetin e tij.

-qëndrimi i dytë, sipas të cilit, interesi i personit të vdekur për të ruajtur konfidencialitetin e tij do të jetë më i vogël se ai, kur ky person ka qenë gjallë. Kjo, për arsyen se personi që ka vdekur nuk mund të dëmtohet, në kuptimin që ai nuk e ndjen më dhimbjen, lumturinë ose emocione të tjera. Ndërsa te personi i gjallë, mosruajtja e konfidencialitetit, p.sh. atij mjekësor do ta dëmtojë dhe do ta bëjë të vuajë nga ky veprim,për pasojat nga kjo mospërfillje për dëshirat e tij.

Disa situata të tjera të mosruajtjes të konfidencialiteti mjekësor pas vdekjes *(Guidance and advice etc, 2021)**:***

-rastet e denoncimeve për ndjekjen mjekësore të personit para vdekjes,

-në rastet e kundërshtimit të testamenteve,

-kur kërkohen dokumentet mjekësore të shoqërive të sigurimeve, nga ana e të afërmve, të nevojshme këto për përfitime financiare, që përcaktohen nga shkaku mjekësor i vdekjes të njeriut të tyre që ka qenë i siguruar në këto shoqëri,

-nevoja e të afërmve për t'u njohur me diagnozat e sëmundjeve të trashëguara të personit të vdekur, me qëllim që ata të marrin masa mjekësore për parandalimin e tyre,

-interesi i studimit të ecurisë dhe shpërndarjes të sëmundjeve të ndryshme (mosruajta e konfidencialitetit është vetëm për studiuesin dhe jo për personat e tjerë),

-interesi i publikimit p.sh. për ngjarje me vdekje të shumta nga sëmundje të veçanta, ose kur personi i vdekur është një person publik,

-rastet e informatave mjekësore që kërkohen nga media, bibliografët për interesa të përgjithshme, zbulimin e ngjarjeve kriminale etj.

Ndikimi i kohës që ka kaluar nga vdekja në ruajtjen ose jo të sekretit mjekësor *(Berg, 2001; Charlier, 2014).*

Me kalimin e kohës, kujtimi për të vdekurin, që ruhet në mendjen e një të gjalli fillon dhe dobësohet.

Po kështu edhe interesi i anëtarëve të familjes së të vdekurit, me kalimin e viteve, do të vijë duke u ulur.

Me këtë rast, nuk duhet harruar që memoria e njerëzve që e kanë njohur të vdekurin është shumë më e rëndësishme se ajo që ka mbetur në gjeneratat e mëpasme.

Pra mbrojtja e konfidencialitetit mjekësor pas vdekjes do të pakësohet me kalimin e kohës, deri në zhdukjen e plotë të saj.

Në literaturën e huaj, ka një pikëpamje, sipas të cilës, nuk duhet ruajtur më konfidencialiteti, kur ka kaluar një kohë që i korrespondon një ose dy gjeneratave pas vdekjes së personit.

Në legjislacionin francez kjo kohë ka qenë 150 vjet; më pas është pakësuar në 120 vjet dhe është tendenca që kjo kohë të pakësohet edhe më shumë. Por theksohet që edhe me kalimin e kohës së nevojshme, kjo nuk do të thotë që informacioni të bëhet publik (Charlier, 2014).

Kjo vështirësi për ta ruajtur ose jo këtë sekret mund të ndodhë edhe për shkak se mjekët e këtij rasti mund të kene vdekur me kalimin e kohës, apo se dokumentet mjekësore të këtij rasti janë asgjësuar.

Në praktikë ndeshen raste të studimit nga ana jonë të aspekteve mjekësore apo mjekoligjore të kufomave apo mbetjeve skeletike të mëparshme. Ato nuk kanë qenë "pacientë", sipas kuptimit të mirëfilltë të këtij termi. Në legjislacionin mjekësor në përgjithësi, ruajtja e sekretit mjekësor si për së gjalli ashtu dhe pas vdekjes i takon zakonisht mjekut kurues të pacientit.

Pra, në këto raste, këta do të konsiderohen si "persona të vdekur", pa jetë, por që dhe ato duhet të respektohen (Charlier, 2014).

Prandaj, në botimete ekzaminimeve të këtyre rasteve, duhet të ruhet të paktën anonimati i tyre (Charlier, 2014).

Kush e ka detyrimin për ta ruajtur ose jo sekretin mjekësor pas vdekjes?

Ky detyrim i takon në radhë të parëmjekut kurues të pacientit që ka vdekur; porky mund të jetë edhe për mjekun që ka kryer autopsinë e personit të vdekur, apo personelit tjetër mjekësor (Berg, 2001).

Kërkesa për mosruajtjen e sekretit mjekësor mund të bëhet nga të afërmit e personit që ka vdekur, apo nga vetë personi para se ai të vdiste.

Zbulimi i sekretit mjekësor mund të kryhet edhe nga mjeku në rrethanat e përmendura më parë, si p.sh në rastet e informatave mjekësore që kërkohen nga media, bibliografët për interesa të përgjithshme, sqarimin e ngjarjeve kriminale etj.

4.Raste nga literatura.

Në vitin 1965, miku dhe mjeku personal i Churcillit, Lordi Moran (Charles McMoran Wilson) botoi menjëherë pas vdekjes së Churcillit, librin:"The struggle for survival 1940 – 1965", një biografi e jetës së Churcillit, në bazë të ditareve që Morani kishte mbajtur gjatë gjithë periudhës nga viti 1940 deri në vitin 1965 të vdekjes së Churchillit (Robitscher, 1968).

Libri mbështetej në ditaret e Moranit gjatë gjithë kësaj kohe dhe përmbante dy lloje argumentesh(Robitscher, 1968):

-ngjarjet e radhitura në mënyrë kronologjike për ato që Churcilli kishte bërë dhe shprehur në takimet e tij me Ruzveltin dhe Stalinin, vërejtjet e tij mbi luftën, kundërshtarët e tij në Parlament etj. Kjo, sepse Lordi Moran, si mjeku personal i Churcillit, kishte qenë i pranishëm në të gjitha këto konfidenca, jo në rolin e mjekut, por në atë të mikut të besuar.

-argumentet mbi gjendjen shëndetësore të Churcillit, të cilat po të bëheshin publike që në gjallje të tij, ai nuk do të shpresonte që të vazhdonte detyrën e tij edhe dy vjet të tjera si kryeministër.

Botimi i këtij libri, u shoqërua me kritika të rrepta në shtypin britanik të asaj kohe (Robitscher, 1968).

Sipas tyre: Doktor Morani duhet të kishte heshtur për aq sa kishte parë.

Në revistën e njohur Lancet, me rastin e daljes së këtij libri theksohej se, "Besimi i publikut në profesionin e mjekësisë rrjedh kryesisht nga bindja se ajo që ndodh midis pacientit dhe mjekut nuk duhet të përhapet" dhe se, "Në qoftë se konfidencialiteti ruhet për së gjalli, ai duhet të respektohet dyfish për të vdekurin".

"Duke shkruarpublikisht për gjendjen shëndetësore të një personi të identifikueshëm, Lordi Moran ka krijuar një precedent, i cili nuk duhet bërë përsëri".

Ndërsa teShoqata e njohur britanike mjekësore(British Medical Association), në takimin e saj vjetor pas këtij botimi, organi i saj përfaqësues, i përbërë nga 560 anëtarë, mori vendimin, me vetëm tri vota kundër, në të cilinnuk përmendej Lordi Moran, ku theksohej: "Vdekja e një pacienti nuk e çliron mjekun nga detyrimi për ruajtjen e sekretit".

Pavarësisht nga këto qëndrime kundërshtuese për këtë libër, në diskutimet dhe shtypin e kohës u dhanë edhe shumë mendime dhe argumente në favor të të tij (Robitscher, 1968).

Sipas tyre, "dëshmitë e Lordit Moran janë shumë të çmuara, sepse nëpërmjet tyre janë zbuluar aspektet e munguara të jetës së Churcillit, në radhë të parë, nëpërmjet bërjes publike të dëshmive mjekësore".

"Një figurë si Churcilli nuk mund të ketë asnjë privaci. Ai i përket të gjithë botës, i gjallë apo i vdekur dhe gjithçka që ka të bëjë me të, sidomos problemet shëndetësore, kanë një interes universal"(Robitscher, 1968).

"Ne jetojmë në një kohë, kur figurat publike, të gjallë apo të vdekur, bëhen subjekte të biografëve, sekretarëve, asistentëve, apo familjarëve. Kur të gjithë lejohen të shkruajnë për këto raste, atëherë, përse mjekëve u ndalohet kjo gjë?"(Robitscher, 1968).

I njëjti arsyetim mund të bëhet edhe në rastin e Lordit Moran, i cili e botoi këtë libër pas vdekjes së pacientit, kryesisht për mjekimin e Churcillit, pa e diskredituar të ndjerin (Robitscher, 1968).

Në literaturën mjekësore shëmbuj të tillë janë të panumërt (Robitscher 1968; Piédelièvre, 1966):

-rasti Maratit, një nga udhëheqësit e revolucioni francez të viti 1789 që u vra duke bërë banjo, por që nga mjeku i tij rezultoi se ai vuante nga dermatiti (infeksion i lëkurës) së skrotumit dhe perineumt. Banja e qetësonte atë nga sëmundja prej së cilës vuante.Kjo e bëri më të lehtë atentatin ndaj tij.

-rasti i mjekut, që kishte përpiluar raportet mjekësore mbi përparimin e sëmundjes dhe sjelljen e Napoleonit para se të vdiste.

-rastet e sëmundjeve dhe vdekjeve të shumë presidentëve të ShBA etj.

5.Sekreti mjekësor në Shqipëri.

Çështja e sekretiti mjekësor në vendin tonë, paraqitet në KodineEtikës dhe Deontologjisë Mjekësore, i cili përmban nenin 22 (ruajtja e sekretit mjekësor) dhe nenin 23 (zbulimi i sekretit mjekësor).

Pra, sipas këtyre neneve, sekreti mjekësor i mjekut, përbën një parim shumë të rëndësishëm, por jo me karakter absolut, sepse mund të zbulohet kur rrezikohet jeta e pacientit ose e kërkon ligji.

Kështu mosruajtja e sekretit mjekësor, nga kërkesa e ligjit, është dhe ai i parashikuar në Kodin e Procedurës Penale të vendit tonë. Sipas nenit 282 (kallzim nga personeli mjekësor), personeli mjekësor për një mjekim që ai kryen dhe dyshon se lidhet me një vepër kriminale, është i detyruar ta denoncojë atë në organet e prokurorisë (Kodi iProcedures Penale të Republikës së Shqipërisë, 1995).

Para disa kohësh, në zbatim të këtij neni të procedures penale, u arrestuan dy mjekë dhe një infermier në Fier me akuzat penale "moskallzim i krimit" dhe "veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës" (Top Channel, 2022). Kjo për arsye, se ata kishin mjekuar një person që kërkohej nga drejtësia, pas përplasjes së tij me armë zjarri në një fshat të Elbasanit. Pra në këtë rast, ata nuk kishin zbatuar nenin 282 të Kodit të Procedures Penale, sipas të cilit ata ishin të detyruar të kallëzonin mjekimin që i kishin kryer këtij personi në organet e drejtësisë.

6.Sekreti mjekësor pas vdekjes i personave publikë.

Çështja e sekretit mjekësor pas vdekjes përmendet në Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore (viti 2012) të vendit tonë vetëm në paragrafin e dytë të nenit 22 (ruajtja e sekretit): "……..Madje edhe pas vdekjes të të sëmurit, me përjashtim të rasteve kur ajo (e fshehta mjekësor) përbën rrezik për shëndetin dhe jetën e të tjerëve, mjeku duhet të mos zbulojë sekretin profesional".
Siç shihet, kjo çështje trajtohet shumë pak në legjislacionin mjekësor Shqiptar.
Prandaj për këto raste, sidomos për personat publikë, që kanë filluar të analizohen edhe te ne, duhen zbatuar rregullat e rekomanduara nga literatura e huaj, një pjesë e të cilave u paraqitën më parë në këtë studim.

Nga ana ime unë kam pjesë në disa raste vdekjesh mjekoligjore, rezultatet e të cilave i kam shpallur dhe botuar në shtyp, duke mos ruajturkështu sekretin mjekësor, por pa shkelur rregullat e veçorive të këtyre rasteve (Çipi, 2018).

-Kështu në disa botime për vdekjet e Mehmet Shehut, Nako Spirut, që përfshihen në grupin e vdekjeve kriminale dhe si të tilla ato do të konsiderohen si raste kur sekreti pas vdekjes nuk ruhet. Sidoqoftë përpara botimit, unë kam marrë edhe lejen e familjarëve të tyre (Çipi B., Çipi S. 2015; Çipi, 2018, 2020;).

-Çështja e viktimave të bombës në ambasadën sovjetike në Tiranë në vitin 1951, përbën edhe ajo një rast kriminal, ku nuk ka qenë nevoja e ruajtjes së sekretit mjekësor; edhe për këtë çështje është marrë prej meje leja e familjarëve të viktimave, të cilët kanë ndihmuar edhe në zbulimin dhe ekzaminimin e tyre.

-Në rastin ezhvarrimit të Enver Hoxhës në vitin 1992, të drejtuar prej meje, botimi i tij në vitet 2000, u bë për të përgënjeshtruar shpifjen e publikuar në atë kohë, sipas të cilës gjatë ekzumimit(nxjerrjes nga varri), kufoma u godit në kokë dhe u dëmtua nga kavoja e vinçit që po e nxirrte. Për këtë botim unë pata mbështetjen edhe nga një prej njerëzve të rrethit familjar tëEnver Hoxhës.
Në lidhje me të dhënat e ndjekjes mjekësore së Enver Hoxhës, mund të përmenden këto publikime:
-Shënimet mbi ndjekjen mjekësore të Enver Hoxhës, të lëna nga Prof. Dr.Fejzi Hoxha (të botuara pas vdekjes së tij nga Prof.Dr.Lluka Heqimi, në vitin 2003): bashkëmoshatar, nga Gjirokastra dhe ai, që e kishte

njohur Enver Hoxhënqë në fëmijëri dhe e kishte kuruar, pavarësisht nga vështirësitë e këtij mjekimi, për një kohë shumë të gjatë.(Heqimi, 2003).Botimi i këtyre shënimeve, pas vdekjes së autorit të tyre, përbën një nga ato raste kur sekreti mjekësor mund të mos ruhet për personat publikë shumë të njohur.

Në të vërtetë, në 10 vitet e fundit të jetës së tij, Enver Hoxha ka qenë nën kujdesin shëndetësor të një ekipi mjekësor të përzgjedhur, në të cilin bënin pjesë edhe Prof. Dr. Isuf Kalo dhe Prof.Dr.Ahmet Kamberi.

-Vitet e fundit janë botuar dy libra me detaje të hollësishme nga ana e këtyre dy mjekëve që e kanë kuruar Enver Hoxhën:

"Blloku" i Prof.Dr.Isuf Kalo, viti 2019 (Kalo, 2019).

"Pacienti ynë i veçantë" i Prof.Dr. Ahmet Kamberi, viti 2020 (Kamberi, 2020).

Të dy librat në lidhje me ruajtjen ose jo të sekretit mjekësor pas vdekjes, janë të justifikuara, sepse kanë të bëjnë me udhëheqësin kryesor të diktaturës komuniste 40 – vjeçare; prandaj problemet mjekësore të tij, do të ishin të nevojshme të njiheshin në radhë të parë nga publiku i gjerë i vendit tonë. Nga ana tjetër është marrë dhe leja e të vesë së Enver Hoxhës, për botimin e librit "Pacienti ynë i veçantë" të Prof.Dr.Ahmet Kamberi.

Në këto libra janë ruajtur dhe respektuar në përgjithësi interesat e pacientit.

Kështu në librin "Blloku", Prof.Dr.Isuf Kalo shkruan midis të tjerave: "Kam mendimin se nëse Enver Hoxha nuk do të jetonte në atë kohë, nuk do të ishte bërë diktator, por do të ishte bërë një mësues shumë sharmant, sepse ishte shumë simpatik si njeri; në një farë mënyre pozita e mori në qafë atë…. U bë një pacient bashkëpunues që ia lehtëson punën mjekut. ….Ai nuk ka dashur që ne ta diktojmë as sëmundja ta diktojë, porka pasur inteligjencën edhe mundësinë që të bashkëpunonte në lidhje me mjekimi e tij".

Ndërsa në librin "Pacienti ynë i veçantë", Prof. Dr.Ahmet Kamberi, duke u mbështetur kryesisht në marrëdhënien mjek-pacient, thekson se: "në marrëdhëniet me mjekët Pacienti ishte i përzemërt. Nuk ka ndodhur kurrë që ai të shprehte pakënaqësi me fjalë ndaj ndonjërit prej nesh, madje edhe atëherë kur ai nuk ishte i kënaqur me këshillat tona. Pakënaqësinë ai e shprehtethjesht me ngrysjen e fytyrës, me mungesëne dëshirës për ta zgjatur diskutimin dhe me mosbindje….".

Por në librin e parë "Blloku" të Isuf Kalos, jepen disa të dhëna dhe mendime mbi jetën intime, që unë kam mendimin që Pacienti vetë dhe bashkëshortja e tij, nuk do të ishin dakord që ato të shpalleshin pas vdekjes së Pacientit.

Po kështu në librin "Blloku"jepen mendime dhe argumente kryesisht të karakterit psikologjik nga ana e autorit të librit, për ngjarje të ndryshme të asaj kohe, mendime këto të cilat nuk i ka shprehur Pacienti dhe me të cilat vetë Pacienti kur ishte gjallë, besoj se nuk do të ishte dakord.

Këto mund të kenë qenë disa nga arsyet që për botimin e librit: "Blloku", nuk është marrë miratimii familjes së Enver Hoxhës.

Në lidhje me këto dy botime, unë kam këto vërejtje dhe sugjerime:

-Botimi i këtyre librave, të dy mjekëve të njohur: Prof. Dr.Isuf Kalo dhe Prof.Dr.Ahmet Kamberi, do të ishte mirë që të shoqërohej edhe me publikimin e plotë të raportit të autopsisë, sikurse është vepruar me udhëheqësit e B.S., Leninit dhe Stalinit. Kjo më shumë për të vërtetuar ose hedhur poshtë hipotezën që ai mund të jetë eliminuar.

-Do të ishte më e përshtatshme që libra të tillë, të botoheshin në një kohë më të vonë, sikurse rekomandohet nga literaturapërkatëse, sipas të cilës kujtesa e njerëzve që e kanë njohur të vdekurin është shumë më e rëndësishme se ajo që ka mbetur në gjeneratat e mëpasme,prandaj mbrojtja e konfidencialitetit mjekësor pas vdekjes do të pakësohet me kalimin e kohës, deri në zhdukjen e plotë të tij.Kjo, për arsye se botimi i këtyre dy librave sidomos i librit "Blloku" u shoqërua, përveç lavdërimeve të shumta, edhe me një reagim të rreptë kundërshtues ndaj paraqitjes simpatike të Enver Hoxhës në marrëdhëniet me mjekët që e kuronin atë, ndërkohë që në mendjet e njerëzve si atyre të moshuar por edhe atyre më të rinj janë ende të freskëta dëshmitë shumë negative të jetës së Enver Hoxhës, një pjesë nga ato të publikuara nga ata që e kanë njohur që në rininë e tij, si dhe ato të krimeve monstruoze të urdhëruara prej tij, shumë prej tyre ende të pazbuluara etj.

7.Përfundime.

-Parimi i rëndësishëm i konfidencialitetit mjekësor, i cili nga një detyrim moral është kthyer në një detyrim ligjor dhe në fund si një nga të drejtat fondamentale të njeriut, përmban edhe të fshehtën mjekësore pas vdekjes, të njohur jo aq sa duhet.

-Kjo e fundit përmban aspekte të ndryshme që i përkasin argumenteve kryesisht filozofike, interesave të personit të vdekur, rrethanave kur kjo e fshehtë nuk ruhet, kohës që ka kaluar nga vdekja, personave që kanë detyrimin për ruajtjen ose jo të saj, rasteve të ruajtjes ose jo të saj për personat e njohur etj.

-Kjo lloj e fshehte mjekësore, sidomos ajo e një personi publik për vendin tonë, përbën një çështje shumë delikate që kërkon një kujdes shumë të madh në rastet e shpalljes së saj.

Bibliografia:

1.Berg J. (2001). Grave Secret: Legal and Ethical Analysis of Postmortem Confidentiality, Connecticut law review, Vol 34: 81, pp. 81-122.
2.Charlier Ph. (2014). Quand la science explore l'histoire, Editions Tallandier, Paris 2014, pp. 240-248.
3.Çipi B. (2005). Bioetika në një këndvështrim mjekoligjor, Shtëpia e botimeve Naim Frashëri, Tiranë, pp.48-60.
4. Çipi B. (2015). Ethical, juridical and historical issues of medical confidentiality, Journal JAHR, Rijeka, Vol 3, nr.5, pp.139-146.
5. Çipi B. Çipi S.(2015). Manual i Mjekësisë Ligjore, KLEAN Shpk, Tiranë, p.95.
6. Çipi B. (2018). Tranzicioni Shqiptar në lupën e Mjekësisë Ligjore, Shtëpia botuese Flamuri, Tiranë, pp. 34-50, 73-90, 269-274.
7. Çipi B. (2020). Përse vdekja e Mehmet Shehut, sipas mjekësisë ligjore kriminalistike, duhet të ketë qenë vrasje dhe jo vetëvrasje? Gazeta "Telegraf", Tiranë, 14.12.2020.
8.DeWittC. (1959). Privileged communications between physician and Patient, Case Western Reserve Law Review. http://scholarlycommonos.law.case.edu/caselrev
9.Elezi I. (2002). Edrejta Penale, Shtëpia botuese e librit universitar, Tiarnë 2002, pp. 134-137.
10.Guidance and advice (2021). Confidentiality and disclosing information after death, pp. 1-9.
http://themdu.com/guidance-and-advice/guides/disclosure-after-death
11.Heqimi Ll. (2003). Profesor Fejzi Hoxha, mjeku, humanisti, pedagogu, shkencëtari; shtëpia botuese PEG, Tiranë.
12.Kalo I. (2019). Blloku, UET Press, Tiranë.
13.Kamberi A. (2020). Pacienti ynë i veçantë, Edlon, Tiranë.
14.Kodi i Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore (2012). Urdhri i Mjekut të Shqipërisë, Këshilli Kombëtar, Botime "Vllamasi", Tiranë, 2012.
15.Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë (1995), Kuvendi Popullor i Republikës së Shqipërisë.
16.Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë (1995), Kuvendi Popullor i Republikës së Shqipërisë, Tiranë 21.03.1995.
17. Piédelièvre R. (1966). Souvenir d'un médecin légiste, Flammarion, Paris, pp. 5 -12.
18.Robitscher J.B. (1968). Doctors' privileged communication, public life and history's rights, Cleveland State University Law Journals, pp.199-212.
https://engagedscholarship.csuoio.edu/clevstlrev/vol17/iss2/3
19.TopChannel (2022), Emrat/ mjekuan N.D., arestohen dy mjekë dhe një infremier në Fier, për çfarë akuzohen?, 31.3.2022.
https://top-channel.tv/2022/03/31/emrat-mjekuan-nuredin-dumanin-arrestohen-dy-mjeke-dhe-nje-infermier-ne-fier-per-cfare-akuzohen/

THE STRATEGY FOR THE INTERNATIONALIZATION OF HIGHER EDUCATION IN ALBANIA

Dr. Majlinda Liçi Koçi
University "Eqrem Çabej"
Faculty of Education and Social Sciences
maj.li@yahoo.it

Abstract

The internationalization is a process of change, which has been adapted to meet the needs and interests of each institution of Higher Education. For several decades it has developed intensively
iIncreasing its importance and the level it has reached. In reality the internationalization has profoundly changed the whole world of Higher Education.

Every university needs to be modernized through the internationalization that can be considered as a key factor for increasing the institutional quality and achieving a positive assessment of its functioning.

The purpose of this paper is to highlight in summary how the internationalization has become a necessity because the success of each university is closely linked to the internationalization strategy that it pursues and how it implements the quality management in Higher Education.

In this paper we will also highlight the problems and challenges faced by this process in our country.

Of course, in this paper will not be left without analyzing the advantages and disadvantages of the internationalization of Higher Education, the priorities set by universities in building their internationalization strategy such as increasing the mobility of academic staff and students, participation in programs Higher Education and research and especially the building partnerships and collaborations with universities in other countries. The internationalization is considered by the Higher Education institutions not only as a process that contributes to the improvement of Higher Education, but also as a process that brings positive improvement to society.

The method of descriptive and comparative analysis has been used for the realization of this work. The qualitative data were reviewed and interpreted to highlight the issues and problems related to the internationalization of Higher Education using studies and articles of Albanian and foreign scholars as well as through the observation instrument.

Keywords: Strategy, internationalization of Higher Education, mobility, international partnership, challenges.

Abstrakt

Ndërkombëtarizimi është një proces ndryshimi, i cili është përshtatur për të plotësuar nevojat dhe innteresat e secilit institucion të arsimit të lartë prej disa dhjetëvjecarësh ai është zhvilluar në mënyrë intensive duke u zgjeruar për nga rëndësia që ka marrë dhe për nga niveli që ka arritur. Në mënyrë reale ndërkomtarizimi e ka ndryshuar thellësisht gjithë botën e arsimit tëlartë.

Cdo universitet ka ndjerë nevojën e modernizimit përmes ndërkombëtarizimit duke e parë këtë të fundit si një factor kyc për rritjen e cilësisë institucionale dhe arrijen e një vlerësimi pozitiv të funksionimit të tij.

Qëllimi i këtij punimi është të evidentojë në mënyrë të përmbledhur, se si ndërkombëtarizimi është kthyer në domosdoshmëri, pasi suksesi i cdo universiteti është lidhur ngushtë strategjisë e ndërkombëtarizimit që ai ndjekë dhe më mënyrën se si ai realizon menaxhimin e cilësisë në arsimin e lartë

Në këtë punim do të evidentojmë gjithashtu problemet dhe sfidat me të cilat përballet ky proces në vendin tonë.

Natyrisht që në këtë punim nuk do të lihet pa u analizuar edhe avantazhet dhe disavantazhet e ndërkombëtarizimit të arsimit të lartë, prioritetet që kanë vendosur universitetet në ndërtimin e strategjisë së tyre të ndërkombëtaizimit sic është rritja e mobilitetit të stafit akademik dhe studentëve, pjesëmarrja në programet ndërkombëtare të arsimit të lartë dhe kërkimet shkencore dhe vecanërisht ndërtimi i marrëdhënieve të partneritetit dhe bashkëpunimit me universitete të vendeve të tjera. Institucionet e arsimit të lartë po e shohin ndërkombëtarizimin jo vetëm si një proces q ë kontribuon në përmirësimin e arsimit të lartë, por edhe si një process që sjell përmirësim pozitiv të shoqërisë.

Për realizimin e këtij punimi është përdorur metoda e analizës, deskriptive dhe krahasuese. Duke përdorur teknikën e shfrytëzimit të studimeve dhe artikujve të studiuesve shqiptarë dhe të huaj si dhe përmes instrumentit të vëzhgimit janë shqyrtuar dhe interpretuar të dhënat cilësore për të nënvizuar çështjet dhe problematikat e lidhura me ndërkombëtarizimin e arsimit të lartë

***Fjalë kyçe**: Strategji, ndërkombëtarizim i arsimit të lartë, mobilitet, partneritet ndëkombëtar, sfida.*

HYRJE

Në epokën moderne të arsimit, njerëzit janë më të lidhur globalisht se kurrë më parë, duke bërë që të diskutohet mbi ndërkombëtarizimin. I përdorur zakonisht brenda qarqeve ekonomike, ndërkombëtarizimi lidhet me përfshirjen në rritje të një kompanie ose institucioni arsimor në tregjet ndërkombëtare, të ngjashme me globalizimin.

Ndërkombëtarizimi është një proces ndryshimi, i cili është përshtatur për të përmbushur nevojat dhe interesat individuale të çdo subjekti të arsimit të lartë. Ndërkombëtarizimi i arsimit të lartë lidhet me tema të ndjeshme me interes publik. Ndërkombëtarizimi arsimor është vlerësuar si aftësia e mësimdhënies dhe të nxënit për t'u përfshirë gjithnjë e më shumë me kulturat ndërkombëtare në mënyrë që të përmirësohet mësimi i globalizuar.

Koncepti i ndërkombëtarizimit u përcaktua sipas një përkufizimi të pranuar përgjithësisht të Jane Knight. Sipas këtij përkufizimi ndërkombëtarizimi i arsimit të lartë është procesi i integrimit të një dimensioni ndërkombëtar, ndërkulturor ose global në qëllimin, funksionet dhe ofrimin e arsimit pas të mesëm.[4]

[4] Knight, J., & De Wit, H. 1995. *Strategies for internationalisation of higher education: historical and conceptual perspectives.* In de Wit, H. (Editor). 1995. Strategies for Internationalisation of Higher Education, A Comparative

Një studiues tjetër, Jonas Stier u referohet tre ideologjive të ndërkombëtarizimit brenda arsimit të lartë:

1. Idealizmi
   - Krijon një botë më demokratike, më të drejtë dhe të barabartë.
   - Synimi ose ambicia për të krijuar një 'rend botëror' në shkallë globale.
   - Rrit ndërgjegjësimin për kushtet globale të jetës dhe padrejtësitë sociale.
   - Nxisin tolerancën, respektin, vlerat demokratike dhe një angazhim personal për të ndihmuar njerëzit më pak me fat.
   - Wshtw më i përhapur mes mësuesve sesa administratorëve.

2.Instrumentalizmi
   - Synime të qenësishme pragmatike dhe ekonomike: Qëllimi është krijimi i një fuqie punëtore dhe konkurrueshmërie më fleksibël.
   - Thekson vlerën e të mësuarit gjatë gjithë jetës, arsimit gjithëpërfshirës, kompetencave sociale, të menduarit kritik dhe mirëkuptimit ndërkulturor.
   - Ndërkombëtarizimi i arsimit të lartë do të përmbushë kërkesat e botës kapitaliste, globale dhe multikulturore.

3.Edukativizmi
   - Ka një vështrim më të gjerë dhe më të thellë mbi arsimin.
   - Qëllimet shtrihen përtej aspiratave thjesht idealiste dhe profesionale të politikëbërësve.
   - Ekspozimi dhe nevoja për t'u përshtatur me një mjedis akademik të panjohur, pasuron përvojat e përgjithshme akademike të studentëve dhe stafit mësimdhënës.
   - Nxit ekspozimin ndaj ekspozimeve të reja.[5]

Ndërkombëtarizimi u bë një agjent kyç ndryshimi në arsimin e lartë, në botën e zhvilluar, por edhe në demokracitë në tranzicion dhe shoqëritë në zhvillim, të cilat përdorën gjithashtu tendencat ndërkombëtare për të justifikuar reformat jopopullore. [6]

Qeveritë kombëtare e shohin gjithnjë e më shumë ndërkombëtarizimin e arsimit të lartë si një faktor të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik kombëtar, tregtinë dhe reputacionin. Në dritën e mobilitetit të zgjeruar të studentëve dhe stafit, pranisë së shtuar të kampuseve të degëve dhe ofruesve ndërkombëtarë, dhe konkurrencës në rritje për talentet ndërkombëtare, institucionet e arsimit terciar dhe qeveritë kombëtare po mobilizohen për të nxitur dhe drejtuar ndërkombëtarizimin. Strategjitë dhe planet kombëtare të ndërkombëtarizimit të arsimit të lartë përfaqësojnë përpjekjet më të prekshme dhe më të drejtpërdrejta të qeverive për të luajtur një rol aktiv dhe vendimtar në ndërkombëtarizimin e marrëdhënieve, por ka dallime thelbësore në qasjet, arsyetimet dhe prioritetet e tyre.

Në vitin 2018, një nismë e madhe e Bashkimit Evropian ishte thirrja për propozime dhe miratimi rrjedhimisht i rrjeteve pilot për Iniciativën e Universiteteve Evropiane (EUI). Kjo skemë ndoqi shtysën politike të presidentit francez Macron për të krijuar një lloj të ri të skemës së bashkëpunimit universitar që do të nxisë inovacionin arsimor dhe kërkimin e përsosmërisë në të gjithë Evropën. Edhe pse është ende herët për të dalë në konkluzione për këtë nismë, për të cilën sapo u hap thirrja e dytë, Andrew Gunn në kontributin e tij e vendos iniciativën në një kontekst të formimit të aleancave dhe një mjet për të çuar më tej ndërkombëtarizimin e arsimit të lartë. Ndërkombëtarizimi përbën prioritet në axhendat e universiteteve në mbarë globin dhe në këtë drejtim janë due u orienuar edhe universitete në Shqipëri si ato publike ashtu dhe ato private.

Study of Australia, Canada, Europe and the United States of America. EAIE (in cooperation ëith IMHE/OECD and AIEA), Amsterdam. Marrë nga: https://books.google.al/

[5] Stier, J. (2004). *Taking a critical stance toward internationalization ideologies in higher education: idealism, instrumentalism, educationalism*. Globalisation, Societies and Education, 2*(1), 1-28*. Marrë nga: https://doi.org/10.1080/1476772042000177069

[6] De Wit, H., & Altbach, Ph. G. (2020). *Time to cut international education's carbon footprint.* University World News, 11 January 2020, issue 580, Marrë nga: https://books.google.al/

Edhe në Shqipëri ka filluar të punohet shumë në këtë aspekt nga ana e institucioneve të arsimit të lartë. Ndërkombëtarizimi i arsimit të larte në Shqipëri është kthyer në një nevoje për zhvillimin dhe modernizimin e mëtejshëm të universiteteve shqiptare duke u lidhur edhe me domosdoshmërinë e përshtatjes edhe me standartet që ndjekin universitetet e tjera europiane në kuadrin e integrimit të Shqipëri në Bashkimin Europian. Në strategjinë kombëtare të arsimit 2021-2026 ndërkombëtarizimi i arsimit të lartë në Shqipëri është një nga objektivat kryesore të politikës që synohet të ndiqet për arsimin e lartë.[7]

Universitetet që kanë pjesë të prioriteteve çështjet e ndërkombëtarizimit janë më të preferuar nga maturantët që zgjedhin të ndjekin për herë të parë studimet në ciklin e lartë, por edhe të gjithë individët e tjerë të cilët kanë vendosur të bëhen pjesë e një universiteti në ciklet e ndryshme të studimit. Kjo ndodhë për shkak të mundësive të shumta për një edukim cilësor që të tilla universitete ofrojnë.

Sipas Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë në kuadër të ndërkombëtarizimit të universiteteve, deri tani janë arritur rreth 27 marrëveshje bashkëpunim dhe janë në proces 30 të tjera. Universitetet publike kanë qenë shumë aktive në këtë proces dhe bashkëpunimet janë kryesisht me universitete italiane, austriake, franceze, gjermane, dhe greke. Në të njëjtën kohë janë realizuar dhe po zhvillohen negociata dhe me universitete hungareze, çeke, turke, bullgare, Gjithashtu është rënë dakord deri tani hapja e rreth 7-8 programeve të përbashkëta dhe të dyfishta, si dhe janë në proces diskutimi nga 40-50 programe të tjera të përbashkëta.[8]

Një faktor i rëndësishëm në mënyrën se si funksionon ndërkombëtarizimi brenda arsimit është ndikimi i praktikave të mësimdhënies në një mjedis të ndryshëm. Hulumtimet tregojnë se praktikat efektive të mësimdhënies së bashku me preferencat ndaj stileve të ndryshme të të nxënit dhanë një efekt pozitiv në perceptimet e të nxënit (Smith, Zhou, Potter,& Ëang, 2019). [9]

Lidhja e marrëveshjeve për ndërkombëtarizimin është element shumë i rëndësishëm brenda arsimit të lartë. Synimet e marrëveshjeve janë të sigurojnë përgatitje për mësuesit, të ofrojnë programe dhe kërkime dhe të rrisë lëvizshmërinë ndërkombëtare për shkak të globalizimit të shpejtë të arsimit të lartë. Marrëveshja përshkruan një konceptualizim të ndërkombëtarizimit arsimor përmes disa proceseve:

- Përvoja ndërkombëtare e lëvizshmërisë;
- Partneritetet ndërkombëtare të mësimdhënies;
- Partneritetet kërkimore ndërkombëtare;
- Ndërkombëtarizimi i kurrikulës;
- Përgatitja e edukatorëve dhe drejtuesve për shkollat dhe sistemet arsimore.[10]

Universitetet kanë pasur gjithmonë dimensione ndërkombëtare në kërkimin, mësimdhënien dhe shërbimin e tyre ndaj shoqërisë, por ato dimensione, në përgjithësi, ishin më shumë ad hoc, të fragmentuara dhe të nënkuptuara, sesa të qarta.[11]

Strategjitë gjithëpërfshirëse janë një zhvillim mjaft i fundit i tre dekadave të fundit. Në dekadën e fundit të shekullit të kaluar, globalizimi dhe rajonalizimi në rritje i ekonomive dhe shoqërive, i kombinuar me

[7] STRATEGJIA KOMBËTARE E ARSIMIT 2021-2026 Tiranë, prill 2021 Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, UNICEF

[8] Xhajanka, E. Ndërkombëtarizimi i universiteteve, Kushi: 27 marrëveshje bashkëpunimi 14/12/2021 http://ata.gov.al/2021/12/14/nderkombetarizimi-i-universiteteve-kushi-27-marreveshje-bashkepunimi/

[9] Smith C., Zhou, G., Potter, M., Wang, D., Pecoraro, M., & Paulino, R. (2019). *Variability by individual student characteristics of student satisfaction ëith promising international student teaching practices*. Literacy Information and Computer Education Journal, 10*(3)*, *3160-3169*. Marrë nga: https://infonomics-society.org/wp-content/uploads/Variability-by-Individual-Student-Characteristics-of-Student-Satisfaction.pdf

[10] Magnusson, K. (2016). *Accord on the internationalization of education.* Association of Canadian Deans of Education, Marrë nga: https://csse-scee.ca/acde/wp-content/uploads/sites/7/2017/08/Accord-on-the-Internationalization-of-Education.pdf

[11] De Wit, H., & Merkx, G. (2012). *The history of internationalization of higher education*. In Deardorff, de Wit, Heyl & Adams, (Eds.), The SAGE Handbook on International Higher Education. Pp. 43–60. Sage Publications, Thousand Oaks, USA, Marrë nga: https://books.google.al/

kërkesat e ekonomisë së dijes dhe përfundimit të Luftës së Ftohtë, krijuan një kontekst për një qasje më strategjike ndaj ndërkombëtarizimit në arsimin e lartë. [12]

Lëvizshmëria e studentëve, studiuesve dhe programeve; reputacioni dhe marka (e manifestuar nga renditjet globale dhe rajonale) dhe një zhvendosje e paradigmës nga bashkëpunimi në konkurrencë ishin manifestimet kryesore të agjendës së ndërkombëtarizimit në arsimin e lartë gjatë 30 viteve të fundit. Arsimi ndërkombëtar u bë një industri, një burim të ardhurash dhe një mjet për rritjen e reputacionit dhe fuqisë së butë.

Disa nga tendencat kryesore të ndërkombëtarizimit në 30 vitet e fundit kanë qenë:

- Më shumë i fokusuar në ndërkombëtarizimin jashtë vendit sesa në ndërkombëtarizimin brenda vendit;
- Më shumë ad hoc, e fragmentuar dhe margjinale sesa strategjike, gjithëpërfshirëse dhe qendrore në politika;
- Më shumë në interes të një nëngrupi të vogël elitar studentësh dhe pedagogësh sesa të fokusuar në rezultatet globale dhe ndërkulturore për të gjithë, kaq pak ose aspak gjithëpërfshirje dhe barazi;
- Drejtuar nga një gamë vazhdimisht në ndryshim të arsyeve politike, ekonomike, sociale/kulturore dhe arsimore, me fokus në rritje në motivimet ekonomike;
- Drejtuar gjithnjë e më shumë nga renditjet kombëtare, rajonale dhe globale;
- Përafrim i vogël ndërmjet dimensioneve ndërkombëtare të tre funksioneve kryesore të arsimit të lartë: arsimi, kërkimi dhe shërbimi ndaj shoqërisë;
- Kryesisht një zgjedhje strategjike dhe fokus i institucioneve të arsimit të lartë, por gjithnjë e më shumë një prioritet i qeverive kombëtare (fuqia e butë, reputacioni dhe/ose e drejtuar nga të ardhurat) dhe rajonet (Bashkimi Evropian, vendet nënshkruese të Bolonjës, ASEAN);
- Duke ndjekur modele tashmë të vendosura mirë—kryesisht të promovuara nga "lojtarë të mëdhenj" me ndikim të mjaftueshëm ekonomik dhe traditë në promovimin e arsimit të lartë: MB, SHBA, Franca, Gjermania etj.[13]

Aspektet pozitive të ndërkombëtarizimit të arsimit të lartë në Shqipëri përfshijnë përmirësimin e cilësisë akademike, studentët dhe stafin e orientuar ndërkombëtarisht.

Ndërkombëtarizimi i arsimit të lartë në Shqipëri ka nxitur aktivitete ndërkombëtare në arsimin e lartësi shkëmbimin dhe bashkëpunimin, paqen dhe mirëkuptimin e ndërsjellë, zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe solidaritetin. Por nuk duhet lënë mënjanë edhe faktin se strategjia e ndërkombëtarizimit i bën universitetet më konkurrente, duke i mundësuar atyre sigurim të ardhurash dhe një reputacion të mirë.

Duke punuar së bashku me studentë ndërkombëtarë, zhvillohen aftësi që janë të rëndësishme në karrierën e ardhshme të studentëve. Kjo sepse jo vetëm arsimi, por edhe tregu i punës bëhet më i orientuar ndërkombëtarisht. Prandaj, nëse në universitete shqiptare mësohet se të punojnë së bashku me njerëz nga kombësi të ndryshme janë një hap përpara. Në këtë mënyrë universitetet nxisin aftësitë ndërkulturore dhe bëhen më me përvojë në bashkëveprim me njerëz me prejardhje të ndryshme kulturore.

Duke takuar studentë, profesorë dhe mësues nga vende të ndryshme dhe universitete të ndryshme, universitetet shqiptare bëjnë përpjekje për të ndërtuar një rrjet ndërkombëtar. Ndërtimi i një rrjeti të tillë sjell përfitime për studentët dhe stafin akademik, veçanërisht kur ata aspirojnë të punojnë jashtë vendit.

Si Komisioni Evropian ashtu edhe Parlamenti Evropian janë në mbështetje të rritjes së financimit dhe mobilitetit të studentëve dhe mësuesve në programin kryesor Erasmus+. Në kuadrin e ndërkombëtarizimit të arsimit të lartë në Shqipëri ka ndihmuar mjaft program Erasmus+, i cili mbështet shkëmbimet ndërkombëtare të studentëve, stafeve akademike dhe administrative, qarkullimin e praktikave të

[12]Knight, J. (2008). *Higher education in turmoil: The changing world of internationalization.* Rotterdam, The Netherlands: Sense Publishers. Marrë nga: https://books.google.al/

[13]De Wit, H., & Altbach, Ph. G. (2020). *Time to cut international education's carbon footprint.* University World News, 11 January 2020, issue 580, Marrë nga: https://books.google.al/

mira midis institucioneve të arsimit të lartë dhe forcimin e lidhjeve midis arsimit dhe tregut të punës.[14] Në vetvete, kjo është pozitive dhe ky program ka qënë i suksesshëm dhe ka sjellë përfitimet e tij të matshme.

Ndonëse mobiliteti është një nga aspektet më të njohura të ndërkombëtarizimit, universitetet përshtaten me trendet e kohës dhe me ritmet e shpejta të ndryshimit si në sferën sociale, ekonomike ashtu edhe atë teknologjike. Këto ndryshime të shpejta kërkojnë nga universitetet që strategjinë e ndërkombëtarizimit ta zgjerojnë edhe më tej, në bashkëpunime me universitete kombëtare, ndërkombëtare por edhe interkontinetale edhe në fusha të tilla sidiplomat e përbashkëta, mbështetja për ndërtimin e kapaciteteve, programet e përbashkëta të kërkimit, mundësitë për të studiuar në distancë etj.

Ka arsye të ndryshme që ka një qeveri kur vendos të dërgojë disa studentë jashtë vendit për studime të mëtejshme. Shumica e qeverive kanë gjithmonë synim të përmirësojnë cilësinë e arsimit që marrin studentët e tyre dhe në shumicën e rasteve shumica e studentëve të jashtëzakonshëm që tregojnë aftësi të jashtëzakonshme në studime dërgohen jashtë vendit për të marrë arsim. Destinacionet ku studentët marrin arsim varen drejtpërdrejt nga përparimi që vendi i destinacionit ka bërë si në aspektin arsimor ashtu edhe në atë ekonomik.

Studimi jashtë vendit është një mënyrë që studentët të fitojnë përvojë ndërkombëtare dhe të zhvillohen si personalisht ashtu edhe profesionalisht, për shembull, duke njohur kultura të ndryshme, duke përmirësuar aftësitë gjuhësore dhe duke zhvilluar një identitet më kozmopolit. Përveç kësaj, ajo mund të jetë një strategji për të përmirësuar perspektivat e dikujt për karrierë, veçanërisht nëse njohuritë dhe aftësitë e kërkuara nuk mund të merren në vendin e origjinës së studentit. Klasat ndërkombëtare çojnë në rezultate të përmirësuara të të nxënit, nxisin aftësi ndërkulturore dhe krijojnë rrjete ndërkombëtare që përgatitin studentët ndërkombëtarë dhe vendas për të jetuar dhe punuar në një botë të globalizuar.

Institucionet e Arsimit të Lartë mund të përfitojnë si financiarisht ashtu edhe akademikisht. Në kuadrin e rënies së kontributeve financiare të qeverive, studentët ndërkombëtarë (nga jashtë BE-së) janë një mundësi shtesë financimi. Për më tepër, ndërkombëtarizimi mund të përmirësojë reputacionin e IAL-ve dhe cilësinë e programeve arsimore për shkak të rritjes së konkurrencës ndërkombëtare për studentët dhe akademikët më të mirë. Për më tepër, tërheqja e studentëve ndërkombëtarë është jetike për shumë IAL për të mbijetuar, veçanërisht në vendet ku popullsia e të rinjve në moshë madhore pritet të bjerë në mënyrë drastike në dekadat e ardhshme.

Ka vende ku institucionet arsimore janë përmirësuar shumë dhe prania e studentëve që dërgohen jashtë mund të rrisë cilësinë e arsimit që ofrojnë këto institucione. Është analizuar niveli i ndikimit që kjo ka në ekonomi dhe vendosen masat e mundshme.

Pavarësisht nga përfitimet endëerkombëtarizimit të arsimit të lartë në Shqipëri, shumë sfida mbeten. Ekzistojnë gjithashtu disa pengesa që mund të hasni gjatë studimit në një mjedis ndërkombëtar. Gjuha është një prej tyre. Sidomos kur ka vështirësi me shkrimin dhe leximin në anglisht, bëhet më e vështirë të performohet mirë gjatë periudhës të studimit. Literatura shpesh paraqitet në anglisht dhe është e detyrueshme të shkruhen ose të përkthehen dokumentet në anglisht.

KONKLUZIONE

Gjithashtu, studentët ndërkombëtarë përballen me shumë sfida pas mbërritjes në vendin pritës, duke përfshirë çështjet e përshtatjes, integrimit, diskriminimit, kostove financiare, aksesit të kufizuar në tregun e punës dhe pengesave të tjera administrative dhe ligjore. Nëse këto mund të trajtohen, përfitimet për të gjithë palët e interesuara do të rriten edhe më shumë. Sfidat me EUI janë disa, në veçanti: a është e mundur që universitetet të punojnë në mënyrë gjithëpërfshirëse së bashku dhe a do të jenë rrjetet më shumë kompromise politike dhe gjeografike apo aleanca institucionale reale? Duhet parë nëse kjo përpjekje do të jetë më e suksesshme se nismat e mëparshme për të krijuar universitete të vërteta evropiane.[15]

[14] Erasmus+ për arsimin e lartë dhe studentët https://arsimi.gov.al/ëp-content/uploads/2017/09/Brochure-12-october.pdf.

[15] Orr, E., Unangst, L., & De Wit, H. (2019). *The long, problematic road towards a European University*. University World News, 7 April 2019, issue 546. Marrë nga: https://books.google.al/

Institucionet e arsimit te larte po e shohin ndërkombëtarizimin e arsimit të lartë jo vetëm si një proces që kontribuon në përmirësimin e cilësisë së arsimit, por edhe si një process që sjell një kontribut pozitiv në shoqëri.

Bashkëpunimi dhe shkëmbimi ndërkombëtar janë mekanizma thelbësorë për mbajtjen e komunikimit të hapur dhe dialogun aktiv. Edukimi ndërkombëtar është i rëndësishëm për vendin tonë sepse siguron një sërë përfitimesh pavarësisht vështirësive që mund të haste gjatë rrugës. Ndërkombëtarizimi i arsimit do të ndihmojë venditn tonë të diversifikojë fuqinë e tij të punës;duke mundësuar që nga shkëmbimet e univeristeteve tona me ato të huaja të përfitohet nga aftësitë dhe përvoja e këtyre universiteteve. Në të vërtetë kur realizohen bashkëpunime dhe shkëmbime midis këtyre universiteteve shkëmbehen më shumë sesa ide-ato po bëjnë një shkëmbim kulturor që inkurajon një mirëkuptim më të thellë kulturor.

Bibliografia

- British Council (2017). *The Shape of Global Higher Education: International Mobility of Students, Research and Education Provision*, Marrë nga: www.britishcouncil.org/education/ihe
- Deca, L. (2016). *Understanding the internationalization of higher education as a policy process: the case of Romania*, PhD thesis, University of Luxembourg, Marrë nga: http://orbilu.uni.lu/handle/10993/31206
- De Wit, H. (2019). *Internationalization in Higher Education: A critical review. Pp. 9–17. Special Issue: Internationalization of higher Education*. SFU Educational Review, *12* (3), Marrë nga: https://journals.lib.sfu.ca/index.php/sfuer/article/view/1036
- De Wit, H., Deca, L. (2020). *Internationalization of Higher Education, Challenges and Opportunities for the Next Decade*. In: Curaj, A., Deca, L., Pricopie, R. (eds) European Higher Education Area: Challenges for a New Decade. Springer, Cham. https://doi.org/10.1007/978-3-030-56316-5_1.
- De Wit, H., & Altbach, Ph. G. (2020). *Time to cut international education's carbon footprint.* University World News, 11 January 2020, issue 580, Marrë nga: https://books.google.al/
- De Wit, H., & Merkx, G. (2012). *The history of internationalization of higher education*. In Deardorff, de Wit, Heyl & Adams, (Eds.), The SAGE Handbook on International Higher Education. Pp. 43–60. Sage Publications, Thousand Oaks, USA, Marrë nga: https://books.google.al/
- De Wit, H., Hunter, F., Egron-Polak, E., & Howard, L. (Eds). 2015. *Internationalisation of Higher Education.* A study for the European Parliament, Brussels, Marrë nga: https://books.google.al/
- De Wit, H., Gacel-Avila, J., Jones, E., & Jooste, N. (Eds.). 2017. *The Globalization of Internationalization: Emerging Voices and Perspectives.* Internationalization in Higher Education Series, Routledge, Marrë nga: https://books.google.al/
- Ergin, H., De Wit, H., & Leask, B. (2019). *Forced Internationalization: An Emerging Phenomenon.* International Higher Education, no. 97, Spring 2019, pp. 9–10, Marrë nga: https://books.google.al/
- Jones, E., & De Wit, H. (2014). *Globalized Internationalization: Implications for Policy and Practice*. In IIEnetworker, Spring 2014, pp. 28–29. IIE, New York, Marrë nga: https://books.google.al/
- Knight, J. (2008). *Higher education in turmoil: The changing world of internationalization.* Rotterdam, The Netherlands: Sense Publishers. Marrë nga: https://books.google.al/

- Knight, J., & De Wit, H. 1995. *Strategies for internationalisation of higher education: historical and conceptual perspectives*. In de Wit, H. (Editor). 1995. Strategies for Internationalisation of Higher Education, A Comparative Study of Australia, Canada, Europe and the United States of America. EAIE (in cooperation with IMHE/OECD and AIEA), Amsterdam. Marrë nga: https://books.google.al/
- Magnusson, K. (2016). *Accord on the internationalization of education.* Association of Canadian Deans of Education, Marrë nga: https://csse-scee.ca/acde/wp-content/uploads/sites/7/2017/08/Accord-on-the-Internationalization-of-Education.pdf
- Orr, E., Unangst, L., & De Wit, H. (2019). *The long, problematic road toëards a European University*. University World News, 7 April 2019, issue 546. Marrë nga: https://books.google.al/
- Stier, J. (2004). *Taking a critical stance toward internationalization ideologies in higher education: idealism, instrumentalism, educationalism*. Globalisation, Societies and Education, 2*(1), 1-28*. Marrë nga: https://doi.org/10.1080/1476772042000177069
- Reinold, J.*The Benefits of the Internationalisation of Higher Education*, 4 June 2018 Marrënga:https://www.maastrichtuniversity.nl/blog/2018/06/itembenefitsinternationalisationhigher-education
- Smith, C., Zhou, G., Potter, M., & Wang, D. (2019). *Connecting best practices for teaching linguistically and culturally diverse international students with international student satisfaction and student perceptions of student learning*. Marrë nga: https://scholar.uwindsor.ca/educationpub/24/
- Smith C., Zhou, G., Potter, M., Wang, D., Pecoraro, M., & Paulino, R. (2019). *Variability by individual student characteristics of student satisfaction with promising international student teaching practices*. Literacy Information and Computer Education Journal, 10*(3), 3160-3169*. Marrë nga: https://infonomics-society.org/wp-content/uploads/Variability-by-Individual-Student-Characteristics-of-Student-Satisfaction.pdf

ANALIZIMI, STUDIMI DHE GJENERIMI I KODEVE QR.

Dr. Blerta Leka (Moçka)[1]

[1] Univesiteti Bujqësor i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit, Departameti i Matematikë dhe Informatikë

bmocka@ubt.edu.al

Dr. Jona Mulliri[2]

[2] Univesiteti Bujqësor i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit, Departameti i Matematikë dhe Informatikë

jmullir@kub.edu.al

Abstrakti

Fiskalizimi që nga viti 2020 është i detyrueshëm për çdo tatimpagues që lëshon faturë,si: organet publike, banka, institucionet financiare jobankare dhe subjekte të tjera, që ofrojnë shërbime pagesash të faturave elektronike. Në procesin e fiskalizimit me anë të numrit identifikues të faturës NIVF, të gjitha transaksionet raportohen në kohë reale në Administratën Tatimore. Numri identifikues i faturësështë unik dhe ai shoqërohet me kodin e vet QR.

Kodet QR janë një mënyrë efikase për të hyrë në një lidhje web ose përmbajtje mediatike duke skanuar një kod në ekranin e pajisjes tuaj.Kodet QR tani përdoren në një kontekst shumë më të gjerë.Ato përdoren në aplikacionet e gjurmimit komercial, aplikacionet e telefonave celularë, për të shfaqur tekstin tek përdoruesi, për të hapur një faqe në internet në pajisjen e përdoruesit, për të shtuar një kontaktnë pajisjen e përdoruesit, për të hapur një Identifikues Uniform të Burimeve (URI), për t'u lidhur me një rrjet me valë ose për të hartuar një e-mail ose mesazh me tekst.Gjenerimi i kodve QR ofrohet nga shumë kompani. Për të krijuar kode të tilla nevojitet të përdorim softwere të besueshëm dhe të sigurt si gjenerues të kodeve QR me ndjekjen e aktivitetit të skanimit, kodet dinamike dhe më shumë veçori.

Përdorimi i kodeve QR është rritur shumë në fillimin e izolimit nga pandemia e Covid-19 dhe shtimit të kërsesë për porositjen e produkteve. Në këtë artikull do të studiohet funksioni, përdorimi dhe krijimi i kodeve QR.

Fjalët kyçe: Kodi QR, Fiskalizimi, Krijimi i kodeve QR

Kodet QR

Kodet QR (Quick Response) janë bërë një nga format më të përhapura në vitet e fundit që bizneset dhe kompanitë po përdorin për t'u lidhur me klientët e tyre. Përfshirja e kodeve QR në paketën e promocioneve po shtohet gjithmonë e më tepër. Kodet QR janë matrica 2-dimensionale, barkodet katrore që u shpikën nga korporata japoneze Denso Wave në 1994 (Mainchin, 2021). Në vitin 2012 kur Kodet QR filluan të përdoreshin më tepër ato ende nuk ishin një mënyrë tërheqëse për klientët, shumica e tyre nuk i njihnin, nuk kishin një program të përshtatshëm për skanimin e kodit QR ose e shikonin të panevojshëm leximin e më tepër informacionin (Onak, 2013; Heikkinen, 2012). Në vitin 2017 dy kompani kryesore si iOS 11 i Apple dhe Google me anë të aplikacioneve koresponduese të leximit të kodeve në telefona celular, QR Code Reader, e rritën më shumë përdorimin e këtyre kodeve.
Marketingu me telefona celularëështë nga më të përdorurit në ditët tona. Sille telefonin me vete ose BYOD (Bring Your Own Device) është motoja e viteve të fundit (Chouffani dhe Wigmore). Punonjës, drejtus, klient me anë të telefonit në çdo kohë mund të bashkveprojnë me punët, kompanitë që drejtojnë ose shëbimet e tjera me anë të telefonit, duke i aksesuar shërbimet në distancë, pa pasur nëvojë të jenë prezent.
Përdorimi i telefonave inteligjentë dhe aksesit në internet me shpejtësi të lartë celularishkoi nga 10% në 2014 në 36% në 2018. Kjo ndikoi edhe në rritjen e përdorimit të kodeve QR, e cila nga 48.8% që ishte në vitin 2014 shkoi në 61.2% në 2018. Kodet QR u bënë një pamje e zakonshme (Mall, 2020).

Llojet e kodeve QR

Kodet QR ndryshojnë në dizajn dhe funksion.Dy kadegoritë më kryesore të kodeve janë: Kodet statik QR dhe Kodet dinamik QR. (Figura. 1)

Figura 1Kodet Statik përkundrejt kodeve Dinamik

Kodet statik janë ideale për ruajtjen e informacioneve fikse ose të ndjeshme, si: kodet e faturave, fjalëkalimet e Wi-Fin numrat ID të punonjësve ose kodet e aksesit. Nëse bëhet ndonjë gabim shtypi, do t'ju duhet të ribëni një kod të ri.

Kodet dinamik QR na lejojnë të ndryshojmë informacionin sa herë të dëshirojmë, informacioni nuk është i bashkangjitur në vetë kodin, informacioni ridrejton përdoruesit në një URL specifike që mund të ndryshohet në çdo kohë.

Kodet QR mund të përfaqësojnë informacion dixhital, të kenë opsione për korrigjimin e gabimeve dhe mund të lexohen në mënyrë efektive nëpërmjet teknikave të përpunimit të imazhit. Përparësitë kryesore janë (Wang et al., 2015):

- Kapaciteti i lartë i të dhënave
- Lexim me shpejtësi të lartë
- Regjistrim me densitet të lartë
- Korrigjim i lartë gabimi (7% ~ 30%)
- Madhësia e vogël e printimit
- Versione të ndryshme të disponueshme (1-40, Figura 2)

Ka një sërë opsionesh konfigurimi për kodet QR. Informacioni i koduar me një kod QR mund të përbëhet nga katër lloje standarde të të dhënave: numerike, alfanumerik, bajt/binar, Kanji (shkronja në gjuhën Japoneze).



Figura 2 Versionet e kodeve QR (qrcode.com)

Kërkesa për numrin e kodeve të nevojshme për t'u gjeneruar ndikon edhe në përzgjedhjen e versionit të përshtatshëm të kodit QR

Përdorimet e kodeve QR

Kodet QR gjejnë mjaft përdorime. Pasi një kod QR skanohet, modelet horizontale dhe vertikale të matricës deshifrohen nga programi në telefonin tonë inteligjent dhe konvertohen në një varg karakteresh. Në varësi të komandës së atyre karaktereve, në telefonin tonë mund të drejtohemi në: një faqe interneti, të konfirmojë informacionin e pagesës, të verifikojë vendndodhjen gjeografike, të hapim profilet e mediave socialeose të na shfaqen ofertat e uljeve të fundit.
Një nga përdorimet e tjera krysore në rastin e Shqipërisëështëpërfshirja e tyre si pjesë e faturave tatimore. Fiskalizimi që nga viti 2020 është i detyrueshëm për çdo tatimpagues që lëshon faturë, si: organet publike, banka, institucionet financiare jobankare dhe subjekte të tjera, që ofrojnë shërbime pagesash të faturave elektronike (DPT, 2020).

Në procesin e fiskalizimit me anë të numrit identifikues të faturës NIVF, të gjitha transaksionet raportohen në kohë reale në Administratën Tatimore. Numri identifikues i faturës është unik dhe ai shoqërohet me kodin e vetë QR.

Kodet QR si një strategji e mirë marketing

Kodet QR janë një mënyrë shumë efikase për marketing. Përdorimi i tyre gjatë pandemisë, por edhe pas saj, u rrit me ritme shumë të larta, si një mënyrë efikase për të ruajtur distancat.

Disa nga avantazhet e përdorimt të kodeve QR për marketing janë (Rodrigue):

- Kodet QR mund t'ju ndihmojnë të diferencoheni nga konkurrentët tuaj.

- Kodet QR ju lejojnë të synoni konsumatorët në lëvizje.
- Kodet QR e bëjnë jetën reale interaktive në Web dhe bizneset mund të kenë më shumë informacion për klientët e tyre.
- Kodet QR janë falas dhe të lehta për t'u konfiguruar.
- Kodet QR ndihmojnë shumë në marketing dhe nëse po mendoni t'i shtoni ato në strategjinë tuaj, praktika më e mirë është:
    - Sigurohuni që çdo kod të çon në një burim vlerë - të tillë si një kupon ose promovim dhe kërkon sa më pak klikime të jetë e mundur.
    -

Një mënyrë tjerër e përdorimit të kodeve QR është ajo në largësi ose distancë. Shefi i Produketeve të PayNearMe, John Minor, jep disa nga funkionalitetet qe orfron kjo mënyrë (Minor, 2021):

- Ruajtja e informacionit
    - Kodet QR mbajnë 100 herë më shumë informacion sesa barkodet tradicionale.
    - Duke dhënë një kod që është unik për çdo klient, kodi QR i drejton ata menjëherë në ekranin e tyre të pagesës pa kërkuar informacion shtesë.
- Shpejtësia
    - Kodet QR funksionojnë shpejt krahasohuar me kohën që i duhet një klienti për të: shtypur një URL, një fjalëkalim dhe informacion shtesë të sigurisë.
- Vetëshërbimi
    - Një nga kërkesat kundër COVID-19 ishte respektimi i distancës. Imazhet ScanMe u bënë mjaft të përdorshme. Ne po shohim adoptim edhe më të madh të kodeveQR për shkak të kërkesës për opsione pagese në distance. Ne mund të skanojmë një kod dhe kalojm check-in për të marrë avionin, skanojmë një kod dhelexojmë menunë në një telefon ose thjesht skanonjme kodin QR në faturë për të bërë një pagesë në internet.
- Kursejnë kohë dhe reduktojnë kostot
    - Opsionet pa kontakt dhe në distancë paraqesin një mundësi për bizneset që të thjeshtojnë veprimet
- Shkathtësia
    - Më tepër mundësi për të promovuar markën e një kompanie dhe për të përmirësuar përvojën e klientit.
    - Kodet QR mund të dizajnohen për të përfshirë një:logo, ngjyrë,mesazh ose pamje vizuale të sfondit në një kod QR.

Figura 3 Kode QR të personifikuar Burimi: https://www.unitag.io/qrcode

Krijimi i kodeve QR

Ekzistojnë shumë gjenerues të kodeve QR. Disa prej tyre janë falas dhe të tjerët ofrohen përkundrejt një pagese. Përfshirja e kodeve QR është bërë mjaft e lehtë, por efektshmëria e tyre varet nga ndjekja e njëprocesi të përshtatshëm. Nesë ne duam t'i përdorim si një strategji marketingu duhet të kemi parasysh katër faza kryesore si në figurën e mësposhtme.

Figura 4 Hapat për të krijuar një kod QR

1. Gjeneruesit e kodeve QR

Sfida për përzgjedhjen e gjeneruesit të kodeve QR është të gjejmë të duhurin sipas nevojave tona. Hubspot sygjeron disa këshilla për të zgjedhur gjeneruesin e përshtatshëm (Wainwright, 2022):

- A mund të gjurmoni dhe analizoni performancën,
- A ju lejon të hartoni njëkod që është unik për markën tuaj dhe
- A është i pajtueshëm me lexues të zakonshëm të kodit QR.

Në rastin e gjenerimit të kodeve QR për Fiskalizimin në Shqipëri(DPT,2020); Çdo faturë shoqëruese duhet të përmbajë kodin QR, i cili ka brenda një URL. URL-ja dërgon në një aplikacion web "Kontroll fature" dhe shfaq informacionin rreth faturës shoqëruese nëse fatura shoqëruese është regjistruar në mëyrë të suksesshme. Kodi QR përmban një URL me një varg parametrash të veçantë që identifikon faturën shoqëruese. Pjesa e parë e URL-së është fikse dhe përmban protokollin, emrin e hostit dhe rrugën (path-in) e ndjekur nga parametrat.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatim Taksave në Shqipëri ju vjen në ndihmë bizneseve me listën e të 41 kompanive të zhvillimit të programeve për fiskalizimin (Tabela 1).

Kjo listë ndryshohet sa herë që një subjekt bëhet pjesë e saj ose ka ndryshime të ndonjë shërbimi. Një pjesë e kompanive më parë kanë qenë distributorë kryesor të kasave fiskale dhe tani e kanë të përfshirë dhe gjenerimin e faturave me kodet QR. Kjo edhe për t'ju ardhur në ndihmë bizneseve të cilët i kanë pasur klient.

2. Krijimi, Dizenjimi dhe Lidhja

Krijimi dhe dizenjimi i Kodeve QR tani lejon më shumë personalizim, duke shtuar ngjyra dhe logo(Figura 3). Pasi e dizenjojmë atë, qëllimi përfudmtar është cfarë duam të arrijme kur dikush eka skanuar kodin tonë QR.
Nëse po vendosim një kod për të shpërndarë informacionin tonë të kontaktit, mund ta bëjmë atë pjesë të kartëvizitës. Nëse biznesi juaj po bën oferta ose ulje mund t'i intrigoni klientët me to duke e lidhur me linkun e hapësirës së ofertave. Kodet argëtuese QR rezultojnë më të suksesshme dhe japin rezultate për qëllimin e përdorimit në nivele më të larta se kodet e thjeshta (Ales, 2019).

Tabela 1. Lista e subjekteve të certifikuara

Nr	Subjekti	Me dhe pa para në dorë	Pa para në dorë E-invoice	Faturë shoqëruese	Pagesave pa para në dorë të faturave elektronike
1	AED DISTRIBUTION	✓	✓	✓	
2	ASSECO SEE	✓	✓	✓	✓
3	Bilanc	✓	✓	✓	
4	BNT Electronics	✓	✓	✓	✓
5	Communication Progress	✓	✓	✓	✓
6	DAISY & ETM	✓	✓	✓	
7	Infosoft Softëare Developer	✓	✓	✓	
8	IMB	✓	✓	✓	
9	IVA ELEKTRONIK	✓	✓	✓	✓
10	SOFT & SOLUTION	✓	✓	✓	
11	S-SYSTEMS	✓	✓	✓	✓
12	TETRA SOLUTIONS	✓	✓	✓	
13	VODAFON ALBANIA	✓	✓	✓	
14	ONE Telecommunications	✓	✓	✓	
…					
41	NDP	✓	✓	✓	

Tabela 2Lista e subjekteve të certifikuara (https://www.tatime.gov.al/c/424/494/lista-e-subjekteve-te-certifikuara

3. Kodimi i kodit QR

Pas gjenerimit kontrolloni për të parë nëse kodi QR "lexon" saktë. Duhet të sigurohemi që të provojmë më shumë se një lexues. Ekzistojnë shumë aplikacione falas të cilat mund t'i përdormi për të testua kodet QR si: Google Lens, QR Code Reader ose aplikacionin e kamerës së telefonin për iPhone ose Android.

4. Gjurmimi dhe Analizimi i të dhënave

Gjurmimi dhe analizimi i të dhënave me anë të kodeve dinamike, është shumë i rëndësishmë për marketigun. Të dhënat statistikore që gjenerohen mund të na ndihmojnë të kuptojmë me mire klienët pasi e kanë skanuar. Nëse përformaca është e dobët duhet të rishikojmë dhe një herë kodin tonë QR a funskion në rregull, a është informacioni i përshtatshëm ai që kemi vendosur si destinacion.



Figura 5 Kod dinamik QR [QR Triger]

Siguria e përdorimit të kodeve QR

Një nga pyetjet qe shqetëson cdo përdorues i cili skanon një kod QR është: A gjurmohen të dhënat tona? Shumica e përdoruesve janë kureshtarë të eksplorojnë se ku të çon një kod i çuditshëm QR, duke harruar se kjo sjellje mund të dëmtojë ato, ndërsa përdoruesit dyshues ngurojnë të vizitojnë një URL të panjohur dhe të paqartë (Kapsalis, 2013). Ashtu si hapja e një faqe web, ose një email-i në inbox edhe kur skanojmë kodet QR duhet të sigurohemi që nuk po cënojmë sigurinë tonë. Software-i që gjeneron kodin QR nuk mbledh informacion personal të identifikueshëm. Të dhënat që mbledh, të cilat janë të dukshme për krijuesit e kodit, përfshijnë: vendndodhjen, numrin e herëve që kodi është skanuar dhe në çfarë kohe, plus sistemin operativ të pajisjes që skanoi kodin.

Përdorimi i kodeve QR për të dhëna sensitive kërkon përfshirjen e elementeve shtesë të sigurisë. CryptoPaper është një nga sistemet e ofruara, i cili zëvendëson informacionin e ndjeshëm me kode QR 2-dimensionale që mund të lexohen vetëm nga përdoruesit e autorizuar (Wang et al., 2015).

Kokluzione

Kodet QR po bëhen gjithmonë e më shumë të përdorshëm. Skanimi i kodeve QR nuk është më i varuar nga pajisjet specifike. Telefonat celular, gjeneratat e tyre, shpejtësia dhe shtrirja e internetit e kanë bërë më të lehtë dhe shpejtë skanimin e kodeve QR.

Aplikacionet e kodit QR, të cilët konsiderohen si një nga elementët më të fuqishëm në përshpejtimin e shkëmbimit të të dhënave në botën dixhitale, përdoren shpesh sot për të ngjallur kuriozitet tek konsumatorët dhe për t'u futur në proceset e informacionit dhe blerjes duke përdorur këto aplikacione.

Kodet QR mund të përdoren si një strategji e mirë marketingu duke pasur prasysh ndjekjen e katër hapave për përfshirjen e tyre në biznes, si:

- Përzgjedhja e një gjeneruesi të përshtatshëm të kodit QR;
- Krijimi, Dizenjimi dhe Lidhja me informacionin e duhur;
- Testimi i kodit;
- Gjurmimi dhe analizimi i të dhënave që mund të gjenerohen nga kodet dinamike.

Gjithmonë duhet t'i kushtojmë rëndësi sigurisë në përdorimin dhe gjenerimin e kodeve QR. Si biznes duhet të kujdesemi për klientët tanë që e aksesojnë dhe si individ të sigurohemi për kodin QR që po skanojmë.

Referncat

[I]. Ales, F. (2019) "QR Codes on Packaging: A Technology Acceptance Model approach comparing informative and entertaining content." Bocconi University, https://repositorio.ucp.pt/bitstream/10400.14/29090/1/152117312_AlesFrancesca_DPDFA.pdf

[II]. Chouffani, R., Wigmore, I. "BYOD (bring your own device)" https://www.techtarget.com/whatis/definition/BYOD-bring-your-own-device

[III]. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (2020) UDHËZIM Nr. 16, datë 3.4. 2020 "PËR FATURËN DHE SISTEMIN E MONITORIMIT TË QARKULLIMIT", https://www.tatime.gov.al/c/424/431/njihuni-me-ligjin-dhe-draft-aktet-nenligjore

[IV]. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve "Lista web e kompanive" https://www.tatime.gov.al/c/424/494/lista-e-subjekteve-te-certifikuara

[V]. Heikkinen, N (2012) "QR code as a channel tool"

[VI]. John Minor, J. (2021) "QR Codes regain the spotlight for remote bill pay and more" https://www.atmmarketplace.com/blogs/qr-codes-regain-the-spotlight-for-remote-bill-pay-and-more/

[VII]. Kapsalis, I. (2013) "Security of QR Codes", Norwegian University of Science and Technology, https://ntnuopen.ntnu.no/ntnu-xmlui/bitstream/handle/11250/262814/644988_FULLTEXT01.pdf?sequence=2

[VIII]. Mainichi Daily News Japan (2021), "From Japanese auto parts to ubiquity: A look at the history of QR codes", https://mainichi.jp/english/articles/20211109/p2a/00m/0bu/024000c

[IX]. Mall, SH. (2020) "List of smartphones and apps with inbuilt QR Code reader", https://scanova.io/blog/blog/2016/03/11/inbuilt-qr-code-reader/

[X]. Oonk, L. (2013) "Qr Codes, Quick Response or Quick Rejection?"

[XI]. QR Code,"History of QR Code",https://www.qrcode.com/en/history/

[XII]. QR Tiger, (2021) "How to set-up QR code tracking in real-time: A step-by-step guide in 2022!", https://www.qrcode-tiger.com/qr-code-tracking

[XIII]. Wang, P., Chen, Sh., Duggisetty, P., Guo, Sh. and Wolf, T. (2015) "Cryptopaper: digital information security for physical documents", https://dl.acm.org/doi/10.1145/2695664.2695727

[XIV]. Wainwright, C. (2022) "How to Make a QR Code in 5 Easy Steps" https://blog.hubspot.com/blog/tabid/6307/bid/29449/how-to-create-a-qr-code-in-4-quick-steps.aspx

LEGJISLACIONI DHE RREGULLATIVA BANKARE NË KOSOVË, ROLI I SAJ NË MBROJTJEN EKONSUMATORIT NË SEKTORIN BANKAR.

Msc. Fitim Gashi[1]

fitimigashi@mail.com

Universiteti i Prishtinës, Kosovë

Abstrakti.

Kosova sot ka një treg bankar ku aktivitetin e tyre e zhvillojnë 10 banka komerciale nga të cilat 80% janë banka të huaja. Nëse flasim për një storie suksesi në Kosovë atëherë në mesin e tyre padyshim bënë pjesë tregu bankar. Për këtë sukses ende ka debate në mesin e bankierve dhe industrisë bankare se cili është më meritori, Banka Qendrore e Kosovës si institucion rregullativdhe mbikëqyrës i këtij tregu apo vetë institucionet bankare ku shumica e këtyre institucioneve vijnë nga tregu i jashtëm me një përvojë të gjatë në tregun bankar të cilat kanë sjellur me vete edhe një traditë në ushtirmin e "zanatit të bankave".

Për zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve bankare poashtu mund të flasim gjatë dhe mundtë të konkludojmë se janë bankat ato të cilat kanë shfrytëzuar teknologjinë më së miri për të përshtatur produktet dhe shërbimet bankare konform benefiteve që sjellë teknologjia e fundi. Mirëpo dilemat janë tek konsumatori bankar, niveli i tij dhe si qëndron gjendja e tij karshi bankave,a ka rregullativë dhe legjislacion të mjaftueshëm i cili ofron një mbrojtje të nevojshme për konsumatorin bankar. Në këtë punim do të njifemi me legjislacionin dhe rregullativen aktuale në Kosovë dhe impaktin e kësaj infrastrukute ligjore në mbrojtjen e konsumatorit bankar.

Fjalët kyce: *bankat, legjislacioni, rregullativa, mbrojtja e konsumatorit.*

[1] Ph.D. Cand. në Fakultetin Juridik, drejtimi: Juridik-Financiar, Universiteti i Prishtinës, Republika e Kosovës, Adresa: Rr.Agim Ramadani.p.n 1000, Prishtinë, Kosovë – Autor, e-mail: fitimigashi@mail.com

Zhvillimi i sistemit bankar të Kosovës nga aspekti i legjislacionit bankar.

Pas konsolidimit të sistemit bankar pas luftës dhe themelimit të bankave komerciale me qëllim të funksionimit të një tregu stabil janë nxjerrë shumë akte juridike në funksion të rregullimit të sistemit bankar. Karakteristikë e akteve juridike të sistemit bankar në Kosovë ka qenë vetë situata politike dhe statusi i vendit pas përfundimit të luftës andaj edhe në sistemin bankar është filluar me nxerrjen e Rregulloreve të UNMIK-ut për të vazhduar më pas me Ligjet më të avancuara krahas avancimit të statusit politik të vendit.

Instrumenti i parë Ligjor i pasluftës në sektorin bankar është Rregullorja e UNMIK -ut për përdorimin e valutës në Kosovë[2] e cila ka luajtur një rol domethënës për kohën sepse pas luftës kishte një numër të madh të valutave në përdorim në Kosovë, andaj kjo Rregullore ndihmoi në përcaktimin e valutës siç ishte marka gjermane dhe pati ndikim domethënës edhe në politikën monetare dhe stabilitetin e çmimeve duke pas parasysh përdorimin dhe fuqinë që kishte valuta gjermane. Ndërsa me hyrjen në qarkullim të euros në vitin 2002 gjithashtu u pranua si valutë nëpërdorim zyrtar në Kosovë dhe në këtë formë vendi u bë pjesë e eurozimit.

Sa i përket rëndësisë juridike, Rregullorja e UNMIK-ut për Autoritetin Bankar dhe të Pagesave në Kosovë[3] , është dokument bazik me të cilin themelohet ABPK-ja si paraardhëse e Bankës Qendrore të Kosovës. Me këtë Rregullore përcaktoheshin detyrat dhe përgjegjësitë e autoritetit, qeverisja dhe kompetencat ligjore.

Në periudhën e pasluftës kishte kërkesë për hyrjen në treg të bankave komerciale, andaj miratimi i Rregullores për Licencim, Mbikqyrje dhe Rregullim në vitin 1999[4] pati efekin e saj juridik me të cilën parashiheshin kushtet ligjore për futjen në tregun e ri bankar të Kosovës.

Bazuar në këtë Rregullore, bankat organizohen si shoqëri aksionare (SHA) me përgjegjësi të kufizuar sipas Ligjit në zbatim, me të gjitha aksionet e regjistruara në emër të pronarëve të tyre të vërtetë. Çdo bankë duhet të ketë autonomi të plotë ligjore, operacionale, financiare dhe administrative nga çdo person tjetër, duke përfshirë edhe BPK-në.

Çdo bankë do të ketë statusin Ligjor, duke përfshirë të drejtën për të kontraktuar, poseduar dhe shpronësuar pasurinë e tundshme dhe të patundshme dhe mund të jetë palë në procedurat gjyqësore. Duhet të ceket se çdo bankë do të administrohet nga bordi drejtues, i cili do të ketë së paku pesë anëtarë, dy prej të cilëve do të jenë jofunksionarë. Duhet të ketë Komisionin revizor, Komisionin për menaxhimin e riskut kreditor, si dhe Komisionin për menaxhimin e aktivit dhe pasivit.

[2] Rregullore Nr.1999/4 për Valutën e Lejuar për Përdorim në Kosovë, 2 shtator 1999

[3] Rregullore Nr.1999/20 për Autoritetin Bankar dhe të Pagesave në Kosovë, 15 nëntor 1999

[4] Rregullore Nr.1999/21 për Licencimin, Mbikëqyrjen dhe Rregullimin e Bankave

Këto ishin dokumentet juridike bazike me të cilat filloi një rregullim i ri Ligjor në sistemin bankarndërsa në vazhdim këto Rregullore pësuan ndyrshime duke u munduar t'i përshtaten rrethanave të reja ekonomike dhe shoqërore. Moment historik dhe juridik në sistemin bankar shënon miratimi i Ligjit për BQK-në[5]. Ky Ligj ka rëndësinë e vet sepse rregullon funksionimin e autoritetit superlativ financiar në vend dhe një konstruksion i normave juridike në këtë Ligj i japin BQK-së autoritetin e saj në dimensione të rëndësishme rregullative, mbikqyrëse, licencuesedhe detyra e përgjegjësi në sigurimin e funksionimit të tregut bankar stabil dhe stabiliteti të çmimeve. Për më tepër, ky Ligj i jep prerogativa bankës qendrore në funksion të rritjesekonomike, hartimit të politikës monetare dhe mbledhjen e shpalosjen e statistikave financiare jo vetëm për tregun bankar.

Tregu bankar ka vazhduar të mbetet mjaft atraktiv për investitorët e shumtë, kryesisht të jashtëmndërsa në anën tjetër rritja ekonmike, zhvillimi i tregut bankar solli nevojën e rregullimit më të avancuar juridik të akterëve të sistemit bankar dhe për këtë qëllim u aprovua Ligji për Bankat, Institucionet Mikrofinanicare dhe Institucionet Financiare Jobankare[6]. Nxjerrja e këtij Ligji ishte nevojë shumë e madhe e tregut finanicar dhe bankar të vendit, meqë kërkesa vinte nga zhvillimii tregut bankar por edhe atij financiar, meqë u themeluan një numër i madh i institucioneve mikrofinanciare dhe institucione financiare jobankare, andaj ky Ligj ishte nevojë imediate për rregullimin e veprimtarisë së tyre.

Me ndryshimet e fundit ky Ligj ka bërë progres në lidhje me përmirësimin e kapitalit dhe likuiditetin e bankave. Një risi është qeverisja korporative e cila praktikë ka dëshmuar më shumë se me një strukturë qeverisëse të mirëkonsoliduar, transparencë, llogaridhënie dhe ndërtimin e marrëdhënieve të shëndosha me klientë , me ç'rast mund të arrihetnjë sistem bankar stabil.

Po ashtu, miratimi i Ligjit për Sistemin e Pagesave[7] ka ndikuar jashtë mase në lehtësimin e qarkullimit të pagesave dhe ka ndikuar në ekoniminë e vendit, ngase qarkullimi i pagesave është i rëndësishëm për të gjitha sistemet financiare kudo, por shto kësaj numrin e remitencave që ka vendi ynë[8], mendoj që ky Ligj ka rregulluar shumë aspekte dhe ka ndikuar në funksionalizimin dhe rritjen e qarkullimit të pagesave edhe në sistemin ndërkombëtar të pagesave.

[5] Ligji Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, 11 maj 2012

[6] Ligji Nr.04/L- 093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, 11 maj 2012

[7] Ligji Nr.04/L-155 për Sistemin e Pagesave, 2 maj 2013

Një instrument Ligjor po ashtu me rëndësi është aprovimi i Ligjit për Sigurimin e Depozitave[9] me të cilat garantohet shuma e depozitave të deponuara në bankat komerciale. Vlen të theksohet obligimi Ligjor që kanë bankat komerciale të bëhen anëtare të Fondit për Sigurimin e Depoziave[10] e cila është një garanci për klientët e bankave të licencuara që duke parë interesin etyre të zgjedhin edhe institucionin bankar që është më i leverdishëm për deponimin apo kursimin e mjeteve. Ky Ligj ka tentuar të marr praktikat më të mira të vendeve evropiane por një udhërrëfyes i këtij Ligji ka qenë Direktiva Evropiane për Garantimin e Depozitave ndërsa shumamaksimale e siguruar është pesë mijë (5,000) euro[11]. Përveç depozitave edhe kredia është aktivitet themelor i bankave komerciale. Ndërsa bizneset vazhdimisht e kanë shprehur si pengesë në zhvillimin e tyre qasjen në financa. Për të lehtësuar këtë proces është themeluar Fondi Kosovarpër Garanci Kreditore ndërsa baza ligjore është pikërisht Ligji për themelimin e këtij fondi[12].

Miratimi i Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit[13] dhe krijimi i Njësisëpër Intelegjencë Financiare[14](NJIF) i dha një drejtim të ri tregut bankar të Kosovës.

[8] Remitencat e pranuara në Kosovë, që njëherësh paraqesin edhe kategorinë më të madhe në kuadër të llogarisë së të ardhurave dytësore, shënuan vlerën prej 851.7 milionë euro. Remitencat në Kosovë vijnë kryesisht nga Gjermania dheZvicra, vende këto nga të cilat dërgohen 40.7 % përkatësisht 20.2 % të gjithsej remitencave të pranuara në Kosovë, burimi: Raporti vjetëor 2019 (BQK,2020) fq.35, Prishtinë.

[9] Ligji Nr.03/L-216 për Themelimin e Sistemit për Sigurimin e Depozitave në Institucionet Finanicare në Kosovë 25nëntor 2011(dhe më pas ndryshimet ligjore që u bënë me Ligjin Nr.04/L-133 për ndryshimin dhe plotësimin e LigjitNr.03/L-216, 21 janar 2013)

[10] Shih më gjerësisht nenin.2 të Ligjit Nr.04/L-133

[11] Po aty neni.3, par.1

[12] Ligji Nr.05/L-057 për Thmelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, 14 dhjetor 2015

[13] Ligji Nr.05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit ,Gazeta Zyrtaree Republikës së Kosovës Nr.18/ 15 qershor 2016, Prishtinë

[14] Njësia për Inteligjencë Financiare e Kosovës është institucion qendror i pavarur kombëtar përgjegjës për kërkimin, marrjen, analizimin dhe shpërndarjen tek autoritet kompetente dhe bërjen publike të informacionit në lidhje me pastrimin potencial të parave dhe financimin e terrorizmit, kompetencat, roli dhe funksionet janë të rregulluara me Ligjin Nr.05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit.

Një peshë të madhe në tregun bankar të Kosovës kishte miratimi i Ligjit Për Procedurën Përmbarimore[15], i cili shpejtoi procedurën e ekzekutimit të borxheve dhe kolateralit ndaj debitorëve. BQK duke qenë rregullator dhe si lehtësuese në procesin e procedurës përmbarimoremiratoi Udhëzimin për zbatimin e aktvendimeve për përmbarim duke debituar llogaritë bankaretë klientëve.
Njëri ndër ligjiet me ndikim në funksionimin e institucioneve bankare dhe mbrojtjen e konsumatorit në sektorin bankar është Ligji për Mbrojtjen e Konsumatorit të cilin nga aspeki I mbrojtjes së konsumatorit do ta trajtojmë në temën vijuese.

Ligji për mbrojtjen e konsumatorit dhe ndikimi i tij në mbrojtjen e konsumatorit në sektorin bankar në Kosovë.

Në Kosovë Ligj specifik për mbrojtjen e konsumatorit ishte Ligji Nr.2004/17 Për mbrojtjen e Konsumatorëve i datës 19.10.2004, Ligji Nr.03/L-131 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.2004/17 i datës 03.04.2009 (i shfuqizuar), Ligji Nr.04/L-121 Për Mbrojtjen e Konsumatorit i datës 19.10.2012 (i shfuqizuar) dhe aktualisht Ligji bazik për mbrojtjen e konsumatorit është LigjiNr.06/L-034 Për Mbrojtjen e Konsumatorit i datës 17.05.2018

Ligji parashikon në pjesën e XIV" Mbrojtja juridike dhe administrative e konsumatorëve":

"Nëse një tregtar nuk i përgjigjet ankesës së klientit, i njejti mund të paraqesë ankesë për mbrojtjetë së drejtës së tij pranë organit administrativ apo rregullator në dikasterin përkatës. Ta zëmë nësenjë klient i sektorit bankar nuk merr përgjigje nga ana e bankës lidhur me ankesën e parashtruar, klienti ka të drejtë që ankesën lidhur me këtë rast ta dërgoj në Divizionin për Shqyrtimin e Ankesave[16] (DSHA) në kuadër të BQK-së.
Por siç specifikohet tutje në këtë kapitull asnjëherë Ligji nuk e ndalon që konsumatorit të vazhdoj edhe me forma tjera në zgjidhjen e ankesave dhe mosmarrëveshjeve qofshin ato administrative apo gjyqësore[17]. Ankesa e klientit mund të drejtohetdirekt edhe në DSHA pranë BQK-së apo në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorit në MTImirëpo gjithnjë preferohet që konsumatori ti drejtohet fillimisht bankës ku ka marr produktin aposhërbimin e caktuar.

Ndërsa në pjesën e XV të këtij Ligji parashihet "Mbrojtja gjyqësore e interesave të konsumatorëve". Ligji po ashtu e njeh padinë kolektive si mjet për mbrojtjen e konsumatorit që mund të inicohet nga një tregtar apo shumë sosh varësisht nga shkelja e pretenduar si dhe personat e autorizuar18 që mund ta inicojnë padinë koletive.

[15] Ligji Nr.04/L-139 për Procedurën Përmarimore, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.3/ 31 janar 2013,Prishtinë

[16] Divizioni për Shqyrtimin e Ankesave dhe Funksionet e tij,info BQK-dhe-ankesat-tetor-14.pdf (bqk-kos.org)

Shoqata e Bankave të Kosovës në bashkëpunim me Bankën Qendrore të Kosovës kanë marrë disa iniciativa që të sensibilizojnë publikun e gjerë në lidhje me mbrojtjen e konsumatorit dhe edukiminfinanciar i cili është tejet i rëndësishëm në procesin e mbrojtjes së klientit në sektorin bankar të Kosovës, megjithatë mbetet për të intensifikuar edhe më shumë këto aktivitete informuese dhe edukuese për klientët e sektorit bankar, e në këtë drejtim edhe bankat komerciale duhet ta bëjnë punën e tyre sidomos në informimin e drejtë të konsumatorit lidhur me produktet dhe shërbimet bankare, të cilat konsumatori i merr në bankën e caktuar.

Sigurisht që detyra e bankave, përveç shitjes së vrullshme të produkteve e shërbimeve, që çon në rritjen e fitimeve të shpejta, duhet të jetë edhe edukimi i klientëve të tyre, dhënia sa më e saktë e në mënyrë të kuptueshme e informacionit të duhur.

Sa më mirë të jenë të informuar klientët e tyre, aq më pak ankesa ata do tëkenë, aq më të aftë do të jenë të marrin vendimet e duhura, e madje aq më të aftë do të jenë të zgjedhin produktin e duhur në bankën e duhur. Kështu me një informim të drejtë e të saktë të klientëve të tyre, bankat kanë mundësinë të sigurojnë një grup të besueshëm klientele që i çon drejtfitimeve afatgjata e të sigurta.

Ligji i ri gjithashtu parashikon edhe ndalimin e praktikave tregtare të padrejta ose çorientuese. Kështu Neni 7 par.2) shkruan: *"Praktikat e padrejta tregtare shtrembërojnë sjelljen ekonomike ndaj një grupi të konsumatorëve qartë të identifikueshëm të cilët konsiderohen veçanërisht të pambrojtur ndaj praktikave apo ndaj produktit të caktuar për shkak të sëmundjeve mendore apo fizike, moshës apo naivitetit karshi atyre aspekteve të cilat tregtari mundet në mënyrë të arsyeshme ti parashikojë, duhet të vlerësohen nga perspektiva e anëtareve të atij grupi. Kjo nuk cenon praktikat e zakonshme dhe legjitime të reklamimit të bërjes së deklaratave të ekzagjeruara apo deklaratave të cilat nuk janë paramenduar në kuptim të plotë".*

[17] Neni 117 i LMK-së

[18] Neni 119 i LMK-së – Personat e autorizuar për të inicuar procedurat. Padia kolektive mund të iniciohet nga:

1. Organizatat e konsumatorëve të parapara në paragrafin 1 të nenit 134 të këtij ligji;
2. Odat dhe asociacionet e interesave ekonomike nga fusha përkatëse e biznesit;
3. Autoritetet Rregullative brenda fushave të tyre specifike;
4. individi në emër të interesit kolektiv

Ligji më me rëndësi në kuadër të mbrojtjes së klientit bankar është padyshim Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve[19] ku pothuajse të gjitha marrëdhëniet mes klientit dhe bankës krijohenmbi baza kontraktuale, andaj si në çdo marrëdhënie juridike-civile, edhe në sektorin bankar Ligji mbi marrëdhëniet e detyrimeve ka peshë të madhe. Kushtet për lidhjen e kontratës, nulitieti i kontratave, kontratat standarde dhe kufizimet tjera janë vetëm disa prej dispozitave ligjore që i japin klientit në sektorin bankar siguri dhe mbrojtje ligjore.

Konkurenca e drejtë është objektivë e një vendi demokratik e po ashtu edhe një vendi që aspiron të jetë demokratik e zhvillimor, andaj kjo objektivë është kanalizuar edhe me legjislacion. I tillë është Ligji për mbrojtjen e konkurrencës[20] i cili duke mbrojtur konkurencën mbron edhe konsumatorin. Pra, BQK-ja ka nxjerr mjaftë instrumentë rregullativë të cilët direkt ose indirekt ndikojnë në avancimin e mbrojtjes së klientit në sektorin bankar të cilat do i kemi trajtuar apo do t'i trajtojmë në vartësi të prizmit dhe analizës së mbrojtjes së klientit bankar në Kosovë.

Rregullativa ligjore bankare në Kosovë dhe mbrojtja e konsumatorit bankar.

Në nivel të hierarkisë juridike Rregulloret e BQK-së konsiderohen akte më të ulëta juridike mirëpo për nga pesha dhe rëndësia janë kruciale për një sistem bankar të qëndrueshëm dhe cilësor. Sipas autorizimeve të saj, BQK vazhdimisht nxjerr Rregullore në funksion të ofrimit të një rregullative që mundëson zhvillimin e një sistemi bankar modern dhe të sigurt. Në numër janë të shumta (mbi katërdhjetë Rregullore në fushën e bankave) por që nga efekti juridik janë shumë të rëndësishme si Rregullorja për raportimin e bankave[21] me të cilën obligohen bankat që të raportojnë lidhur me aktivitetin dhe operacionet bankare të tyre.

[19] Ligji Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.16, 19 qershor 2012

[20] Ligji Nr.03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës 25 nëntor 2011 dhe Ligji Nr. 04/L-226 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.17, 10 mars 2014

[21] Rregullore për Raportimin e Bankave, 31 mars 2016

Ndërsa një tjetër Rregullore me rëndësi edhe në fushën e mbrojtjes së klientit bankar është Rregullorja për shpalosjen e normës efektive të interesit[22] me të cilën obligohen të gjitha bankat komerciale por edhe insitucionet tjera finanicare që ta bëjnë transparent çmimin e kredisë dhe ta informojnë klientin lidhur me shpenzimet administrative lidhur me një kredi, por edhe normën e saktë të interesit nëdepozita si dhe shpalosjen e informatave tjera lidhur me koston e produkteve dhe shërbimeve bankare.

Informacioni asimetrik si njëri ndër risqet e institucioneve bankare është amortizuar me sistemin e regjistrit të kredive. Sipas Rregullores për regjistrin e kredive të gjitha institucionet finanicare që veprojnë në Kosovë dhe që kanë aktivitet kredidhënës obligohen që të raportojnë në Regjistrine Kredive ndërsa BQK ka miratuar Rregullore të veçantë me të cilën rregullohet në detaje procedura e raportimit[23].

Është me rëndësi të përmenden edhe Rregulloret për licencim të bankave[24], auditim të jashtëm[25] dhe auditim të brendshëm[26] me të cilat përmbyllet një kornizë juridike që siguron infrastrukturë ligjore të qartë për të gjitha institucionet bankare që veprojnë në Kosovë. Dinamika e sistemit bankar është e madhe andaj BQK vazhdimisht nxjerrë instrumentë rregullativ duke ju përshtatur rrethanave të reja financiare e teknologjike.

Përmbledhje rregulloresh të BQK-së në funksion të mbrojtjes së konsumatorit.

Banka Qendrore e Kosovës është pasardhëse e Autoritetit Qendror Bankar dhe e themeluar me Ligjin nr.03/L209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Themelimi i saj parashihet edhe me Kushtetutë27 ndërsa po në Kushtetutë në nenin 140, paragrafin 1 dhe 2 konfirmohet pavarësia institucionale dhe karakteri i institucionit kushtetues të saj101. Për ta kuptuar më mirë rolin e saj, fillimisht të shohim se cilat janë objektivat e BQK-së të parapara me Ligj28:

1. Objektivi parësor i Bankës Qendrore sipas nenit 7 është të nxisë dhe të mbajë një sistem financiar stabil, duke përfshirë një sistem të sigurt, të qëndrueshëm dhe efikas të pagesave.

1. Objektiv shtesë i Bankës Qendrore i cili i nënshtrohet objektivit parësor të saj, është të kontribuojë në arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve vendore.
2. Pa paragjykuar arritjen e këtyre objektivave, Banka Qendrore mbështet politikat e përgjithshme ekonomike të Qeverisë, dhe
3. Banka Qendrore vepron në pajtim me parimin e ekonomisë së tregu të hapur me konkurrencë të lirë, duke favorizuar shpërndarjen efikase të resurseve.

[22] Rrellore për Normën Efektive të Interesit dhe kërkesat për Shpalosje, 29 nëntor 2012

[23] Rregullore për Regjistrin e Kredive, 16 gusht 2010

[24] Rregullore për Licencimin e Bankave dhe Degëve të Huaja, 9 nëntor 2012

[25] Rregullore për Auditim të Jashtëm të Bankave, 9 nëntor 2012

[26] Rregullore për Kontrollet e Brendshme dhe Auditimin e Brendshëm,9 nëntor 2012

Po ashtu, në të njëjtin Ligj[29] janë listuar edhe detyrat e saj si:

a) përcaktimin dhe zbatimin e politikave të një sistemi financiar stabil duke përfshirë mbikëqyrjen e një skeme të sigurimit të depozitave, kryerjen e operacioneve të tregut, si dhe ofrimin e likuiditetit emergjent;
b) rregullimin, licencimin, regjistrimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare ashtu si specifikohet më tej në këtë Ligj apo ndonjë Ligj tjetër;
c) promovimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të sigurta, të qëndrueshme dhe efikase të pagesave, të kliringut dhe të shlyerjes së letrave me vlerë;
d) sigurimin e një furnizimi të duhur të kartëmonedhave dhe monedhave në Kosovë;
e) mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave ndërkombëtare;
f) mbledhjen dhe publikimin e statistikave;
g) kontribuon në arritjen dhe mbajtjen e stabilitetit të çmimeve vendore;
h) informimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Qeverisë dhe publikut të gjerë rreth politikave, detyrave dhe operacioneve të saj ashtu siç përcaktohet më tej në këtë Ligj;
i) veprimin si bankier, këshilltar financiar dhe agjent fiskal për Qeverinë dhe çdo organpublik dhe organizatë publike të Kosovës;
j) bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen në këshillat dhe organizatat ndërkombëtare përkitazi me çështje brenda fushës së saj të kompetencave, dhe
k) realizimin e çdo aktiviteti ndihmës që rrjedhë nga ushtrimi i detyrave të saj sipas këtij Ligji apo ndonjë Ligji tjetër.

Pra, BQK duke qenë rregullator i tërë sistemit financiar të Kosovës, ka nxjerrë një numër të konsideruar të rregulloreve, por edhe akte tjera (rregulla e udhëzime) në funksion të mbikëqyrjes sa më efektive të sistemit financiar në përgjithësi. Mirëpo për qëllime të këtij punimi ne do të fokusohemi në një fushë më të ngushtë financiare, siç është ajo bankare.

[27] Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni.11, par.2

[28] Ligji Nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, neni 7, 22 korrik 2010

[29] Ligji Nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, neni 8, 22 korrik 2010

Me kalimin e viteve, me zhvillimet e gjithëmbarshme shoqërore e juridike ndryshojnë edhe rregullat ligjore. BQK pas pavarësisë së Kosovës dhe aprovimit të Ligjit mbi BQK, merr kompetencat e Bankës Qendrore e cila ka autorizime juridike për nxjerrjen e rregullave në kuadërtë tregut financiar. Në kuadër të tregut bankar BQK vazhdimisht nxjerrë rregullore të cilat kanëpër qëllim që të rregullojnë aspekte të ndryshme të operacioneve bankare. Sot, BQK ka krijuar një sistem të konsoliduar të rregulloreve të cilat janë obligative për të gjitha bankat që operojnënë vend.

Sikur edhe në bankat tjera qendrore pothuajse në gjithë botën, edhe në BQK "prodhimtaria" rregullative lulëzon pas krizës financiare të vitit 2008, ku u pa nevoja për masa shtesë në mbikëqyrjen e sistemit bankar. Nga ky portofol i rregullativës së tregut bankar ajo që shihet është jo vetëm aprovimi i rregulloreve të reja, por edhe ndryshimi i atyre ekzistuese konformpraktikave më të mira të mbikëqyrjes bankare. Tregu bankar është specifik për faktin se lënda eparë është paraja nga e cila rrjedhin shumë konglomeratë financiar andaj edhe është tregu më i rregulluar.

Në vijim po paraqesim një tërësi të rregulloreve[30] që janë të aplikueshme për tregun bankar dhebankat komerciale janë të detyruara që t'i zbatojnë:

1. Rregullore për licencimin e bankave dhe degëve të bankave të huaja, 30 prill 2020
2. Rregullore për huadhënie brenda ditore dhe njëditore, 30 prill 2020
3. Rregullore për teknologji të informacionit për banka , 26 mars 2020
4. Rregullore për transaksionet me personat e ndërlidhur me bankën dhe punëtorët e bankës , 29 gusht 2019
5. Rregullore për qeverisjen korporative të bankave, 29 gusht 2019
6. Rregullore për riblerje të letrave me vlerë me Bankën Qendrore të Kosovës, 25 prill 2019;
7. Rregullore për ekspozimet joperformuese dhe ristrukturimet, 28 mars 2019;
8. Rregullore për aplikimin e standardit ndërkombëtar të raportimit financiar, 28 mars 2019;
9. Rregullore për menaxhimin e rrezikut kreditor, 28 mars 2019;
10. Rregullore për adekuatshmërinë e kapitalit të bankave, 29 nëntor 2018;
11. Rregullore për procesin e vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit, 29nëntor 2018;
12. Rregullore për treguesin e leverazhit, 29 nëntor 2018;
13. Rregullore për lëshimin e çertifikatave të licencimit apo regjistrimit të institucioneve financiare, 31 gusht 2017;
14. Rregullore për ekspozimet e mëdha, 29 shtator 2016;
15. Rregullore për letërkredinë dhe garancionin bankar, 31 gusht 2017;

16. Rregullore për instrumentet dhe marrëveshjet e garantimit në mes të institucioneve të licencuara financiare dhe Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, 28 prill 2016;
17. Rregullore për menaxhimin e rrezikut të normës së interesit në librin e bankës, 28 prill2016;
18. Rregullore për përdorimin e vlerësimeve të jashtme kreditore për qëllim të llogaritjes së kapitalit rregullativ, 28 janar 2016;
19. Rregullore për kreditë hipotekare dhe rezidenciale, 22 dhjetor 2015;
20. Rregullore për shpërndarjen e mjeteve të kredisë për bankat, 22 dhejtor 2015;
21. Rregullore për mbështetje emergjente për likuiditet, 30 shtator 2015;
22. Rregullore për kërkesat minimale të sigurisë, 26 mars 2015;
23. Rregullore për kasafortën, 30 prill 2015;
24. Rregullore për procesin e brendshëm të trajtimit të ankesave, 25 shtator 2014;
25. Rregullore për depozitën ekuivalente me kapitalin për degët e bankave të huaja, 31 tetor2013;
26. Rregullore për mbikëqyrjen e konsoliduar të grupeve bankare, 26 prill 2013;
27. Rregullore për auditimin e jashtëm të bankave, 9 nëntor 2012;
28. Rregullore për bashkimet dhe përvetësimet bankare, 9 nëntor 2012;
29. Rregullore për hapjen dhe mbylljen brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës të degëvedhe subjekteve të varura të bankave, 9 nëntor 2012;
30. Rregullore për hapjen e zyrave përfaqësuese brenda dhe jashtë Kosovës, 9 nëntor 2012;
31. Rregullore për kontrollet e brendshme dhe auditimin e brendshëm, 9 nëntor 2012;
32. Rregullore për kufizimet në mbajtjen e pasurisë së paluajtshme dhe të luajtshme, 29nëntor 2012;
33. Rregullore mbi menaxhimin e rrezikut operacional, 29 nëntor 2012;
34. Rregullore mbi menaxhimin e rrezikut likuiditetit, 29 nëntor 2012;

[30] https://bqk-kos.org/?id=213

35. Rregullore për ndryshimet në llogaritë e kapitalit, 29 nëntor 2012;

36. Rregullore për normën efektive të interesit dhe kërkesat për shpalosje, 29 nëntor 2012;

Partia në pushtet në programin e saj qeverisës 2021 deri më 2025[106] për arsimin e lartë prezantoi disa hapa të cilat do ta conin arsimin në një nivel tjetër nga paraardhësit politik duke u fokusuar tek ndryshimi i skemës së financimit të arsimit të lartë, duke rritur financimet që shkojnë drejt sistemit dhe cilësinë që ai ofron. Po kështu hapa të tjerë ishin asistencë universiteteve publike në ngritjen dhe fuqizimin e Qendrave të Këshillimit për Karrierën. Politika arsimore që i mundësojnë çdo të riu deri në moshën 26 vjeç diplomim në universitet, formim në një profesion ose mundësi sistemimi në një punë. Përmirësim i kushteve të mësimdhënies dhe pagave të personelit akademik, drejt ngushtimit të hendekut me pagat në universitet private.Sigurim i autonomisë së universiteteve deri në njësitë bazë, shoqëruar me rritjen e kapaciteteve menaxhuese të njësive. Sigurim i kualifikimit korrekt dhe transparent të personelit akademik. Efektifizim i programeve të mobilitetit për studentët e cikleve Bachelor dhe Master, si dhe bashkëpunim në zhvillimin e doktoraturave.

[105]Ligji Nr. 9741 Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë, neni 2.

[6]Agjencia Telegrafike Shqiptare, Plani i veprimit me objektiva konkrete 2021 2025, publikuar më datë 15.03.2021.

Përsa i përket arsimit të lartë edhe opozita ka mbajtur që ndrimet e saj të cilat kritikojn pozitën pra partinë në pushtet dhe japin rekomandimet e tyre sesi mund të përmisohet situata, duke shpalosur kshu edhe programin politik përsa i përket edukimit në nivelin universitar. Sipas tyre kjo parti do të sjell arsimim cilësor për të gjithë. As edhe një nxënës nuk do të lihet pas dore e të diskriminohet duke arsimuar çdo fëmijë, pavarësisht statusit të tyre social, ekonomik apo aftësive të kufizuara.

Po kështu bursë të plotë për çdo student që vjen nga familje me të ardhura të pakta, praktika pune të paguara për studentët që bëjnë kërkime shkencore pranë universiteteve tona. Po kështu investimi tek studentë të shkëlqyer duke i çuar ata në universitetet më të mira të botës, si dhe duke mbështetur programin Brain Gain (Përfitimi i Mendjeve), i cili nuk do të bazohet më mbi nepotizëm e ndërhyrje politike, por mbi bazën e meritokracisë. Garantimi i pavarësisë e universiteteve dhe lirinë e nevojshme akademike, duke bashkëpunuar me akademikët, specialistët më të mirë e vetë studentët etj.

4.Reformat në sistemin e arsimit të lartë, si kusht i integrimit drejt BE-së.

Procesi i Bolonjës është një reformë madhore në sistemin e arsimit evropian e krijuar me qëllim që të gjenden përgjigje për çështje të tilla si përgjegjësia publike për arsimin e lartë dhe kërkimin, qeverisja e arsimit të lartë, dimensioni social i arsimit të lartë dhe të kërkimit, si dhe vlerat dhe roli i arsimit të lartë dhe kërkimit në shoqëritë moderne, të globalizuara, dhe gjithnjë e më komplekse. Me zbatimin e Procesit, sistemet e arsimit të lartë në vendet evropiane duhet të organizohet në një mënyrë të tillë që: Të jetë e lehtë për të lëvizur nga një vend në tjetrin (brenda Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë) - me qëllimin e studimit të mëtejshëm apo të punësimit; te rritet atraktiviteti i arsimit të lartë evropian, kështu që shumë njerëz nga vendet jo evropiane të vijnë për të studiuar dhe / ose punuar në Evropë; të ketë gjithashtu një konvergjencë më të madhe mes SHBA-ve dhe Evropës në pikëpamje të arsimit të lartë. [107]

Edhe Shqipëria nëpërmjet Procesit të Bolonjës ka hartuar synimet e saj që të plotësoj të gjitah angazhimet që rrjedhin nga antarsimi në këtë sistem.

VIZIONI: Sistem arsimor gjithëpërfshirës dhe i bazuar në parimet e barazisë dhe mësimit gjatë gjithë jetës, që mundëson formimin cilësor të të gjithë individëve, duke kontribuar në mirëqenien personale të tyre, si dhe në forcimin e demokracisë dhe integrimin e vendit në Bashkimin Evropian.

Pra arsim i lartë gjithëpërfshirës që plotëson standardet ndërkombëtare të cilësisë, integritetit akademik e transparencës, dhe është promotor i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit. Për këtë duhej;

1. Rritja e cilësisë së arsimit të lartë;

2. Mbështetja dhe shtimi i programeve të studimit që kanë si synim përmbushjen e nevojave të tregut të punës;

3. Sigurimi i një arsimi profesional që i korrespondon nevojave të fushave specifike dhe zhvillimeve të rajoneve specifike;

4. Rritja e autonomisë dhe lirisë akademike të IAL-ve;

[107] https://sq.ëikipedia.org/ëiki/Procesi Bolonjës

5. Ndërkombëtarizimi i arsimit të lartë dhe rritja e kontributit të "Albanian excellence" në tregun e punës.

Kështu lindi nevoja për tu hartuar njëDraft Pakt për Universitetin[108]në dhjetorin e vitit 2018 i cili paraqiti një dokument angazhimesh për të trajtuar kërkesat studentore për kushte më të mira të studimeve, përmirësim të cilësisë, integritet akademik, transparencë dhe llogaridhënie në arsimin e lartë. Disa nga pikat kryesore të Paktit ishin;

• Përgjysmimi i tarifës maksimale së studimit për ciklin e parë, përmirësimin e mësimdhënies dhe infrastrukturës (IAL dhe konvikte);

• Transparenca me buxhetin e të gjitha institucioneve publike të arsimit të lartë;

• Përfaqësimi i studentëve në Bordin e Administrimit të IAL-ve;

• Pajisja me Kartë Studenti e të gjithë studentëve brenda vitit akademik 2018 – 2019;

• Verifikimi i plagjiaturave të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore;

• Ndërtimi i bibliotekave me standarde evropiane dhe me libër universitar online falas për studentët në gjuhën shqipe.

• Vlerësimi i performancës në mësimdhënie të personelit akademik nëpërmjet Sondazhit Kombëtar të Studentëve.

5. Konkluzione.

Ligji Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisëi i dha një dimension të ri konceptit të lirisë akademike e financiare, duke krijuar një lidhje më organike midis studimeve dhe nevojave të tregut të punës, duke rritur konkurrueshmërinë midis vetë institucioneve të arsimit të lartë, unifikimit dhe standardizimittë sistemit të arsimit të lartë, duke krijuar më shumë lehtësi IAL-ve për përzgjedhjen e prurjeve të reja nga shkollat e mesme,Pavarësisht se Shqipëria ka firmosur "Magna Carta Universitarum Europaeum" dhe Deklaratën e Bolonjës në vitin 2007, arsimi i lartë në Shqipëri ka akoma probleme për t'u zgjidhur.

Ato që mbeten për tu pasur drejt një zgjidhje efektivemund të përmëndim ;praktikat profesionale kanë mangësi nga laboratorët përkatës dhe specifikë të cilët duhet të kenë buxhete të veçanta për t'i përmirësuar dhe përditësuar me qëllim që studentët të aftësohen, kurrikulat mësimore të programeve master të cilat duhen konsultuar ose duke kopjuar kurrikul të ndonjë universiteti tjetër europian, drejtuesit e Departamenteve, madje dhe dekanë, duhet të jenë të profilit, përgatitja e më sumëteksteve mësimore shqip nga pedagogë apo grup pedagogësh me tituj, tekste të cilat duhet të jenë të miratuara nga universiteti dhe Departamenti, bursat duhet të jenë totalisht të merituara, pra sistemi i meritës duhet të funksionoj në cdo strukturë universitare, titujt shkencorë duhet të jenë më efektivë sepse kjo ndihmon në përmisimin akademik të studiuesve dhe lektorëve por edhe në përgatitjen e studentëve cilësor ndërtimi i një Kampusi Universitar etj.

[108]Ministria e Arsimit dhe Sportit, Pakti për Universitetet, u publikua në Janar 2019, fq 3.

Ndërkoh në aspektin e integrimit në BE, Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026[109] është në koherencë të plotë me objektivat strategjike të kornizës Edukimi &Trajnimi 2020 për bashkëpunim midis vendeve të Bashkimit Evropian në fushën e arsimit dhe të formimit, me Kuadrin e ri të BE-së për kompetencat kyçe për të nxënit gjatë gjithë jetës,Procesi i hartimit të strategjisë, i mbështetur nga asistenca teknike e UNICEF, ka reflektuar rekomandimin e BE-së për analiza të qëndrueshme dhe të konsoliduara të bazuara në evidenca, si elemente kyç për diskutime politike të informuara dhe zhvillim të politikave në fushën e arsimit dhe aftësimit.

6. Referencat:

Legjislacion

1. Ligji Nr. 7635 datë 11.11.1992, "Për disa ndryshime në ligjin nr. 4624 datë 24.12.1969. "Për sistemin e ri arsimor".

2. Ligji Nr.8461, datë 25.2.1999, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë.".

3. Ligj Nr. 80/2015, Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.

4. Ligj i ri i arsimit të lartë Nr. 9741 'Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë'.

Libra

1. Popper K. (2009), "*Për filozofinë dhe shkencën*", Fan Noli.

Dokumente

1. Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe UNICEF, *Draft Strategjia Kombetare e Arsmimit2021-2026*, Tiranë Prill 2021.
2. Ministria e Arsimit dhe Sportit, Pakti për Universitetet, u publikua në Janar 2019.
3. Agjencia Telegrafike Shqiptare, Plani i veprimit me objektiva konkrete 2021 2025, publikuar më datë 15.03.2021.

Faqe Interneti

www. shqiptarja.com , *Partia Demokratike , 11 pika për arsimin*. publikuar në Qershor 2022.

https://sq.wikipedia.org/wiki/Procesi i Bolonjës

[109]Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe UNICEF, Draft Strategjia Kombetare e Arsimit2021-2026, Tiranë, Prill 2021.

STANDARTIZIMI I KURIKULAVE UNIVERSITARE NË FUSHËN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT.

Besmir Kanushi-1

Kolegji Universitar i Biznesit

Mariglend Pepmarku - 2

Kolegji Universitar i Biznesit

Jonada Pelivani - 3

Kolegji Universitar i Biznesit

Anisa Melishte - 4

Kolegji Universitar i Biznesit

Abstrakt.

Arsimi është një ndër fushat më delikate në vendin tonë. Ne jemi një popull arsimdashës, e si të tillë jemi të fokusuar në investimin për arsimimin sa më të mirë të vetes. Ndryshimet kurikulare të viteve të fundit, janë pjesë e një proçesi pune që bazohet në përvojat e ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Përsa i përket vlerësimit të pjesshëm ose tërësor të sistemit arsimor, ai nuk është bërë mbi bazën e kritereve të njësuara dhe të pranuara gjerësisht nga opinioni i gjerë arsimor dhe politik në Shqipëri. Në përgjithësi mund të themi se ndryshimet e derisotme nuk janë bërë në formën më të mirë dhe bazuar në cilësinë europiane, prandaj reforma e sistemit arsimor synon të sjellë ndryshime cilësore e të qëndrueshme, që të përfshijnë realizimin cilësor të objektivave në proçesin arsimor. Mes të tjerash synohet vendosja dhe zbatimi i standarteve për një mësimdhënie sa më efektive. Këto standarde do të njësojnë pikat e referencës për zhvillimin dhe vlerësimin e të gjithë sistemit arsimor. Termi "standard" ka gjetur një përdorim shumë të gjerë në teorinë dhe praktikën arsimore në Shqipëri, në 10-15 vitet e fundit. Standardet arsimore përkufizohen si "matëse të cilësisë së proçeseve dhe të rezultateve të sistemit arsimor". Sipas këtij përkufizimi, "ato vendosen në nivel kombëtar dhe u referohen mësimdhënies, përmbajtjes së programeve mësimore, arritjeve të studentëve, sasisë dhe cilësisë së burimeve që përdoren në arsim."

Punimi ka për qëllim të paraqesë një tablo lidhur me standartet në mësimdhënie kryesisht ne fushen e ICT, duke u fokusuar veçanërisht tek rasti i universiteteve shqiptare. Pra, sa ato janë në gjendje të punojnë sipas standarteve të duhura dhe sa përshtaten me të gjitha format e reja të mësimdhënies apo standartet europiane ne ICT.

Metodologjia e këtij studimi është e bazuar në një trajtim të thelluar teorik lidhur me standartet e sistemit arsimor në vendin tonë. Në metodologjinë e këtij studimi janë përfshirë çështje që lidhen me standarte si ekzistenca, zbatimi apo adaptimi i risive dhe standarteve të reja në sistemin tonë arsimor. Megjithë punën e bërë për hartimin dhe zbatimin e standardeve arsimore në Shqipëri, vihet re një dallim i konsiderueshëm midis standardeve europiane dhe atyre shqiptare, në disa element si: në koncepte, hartim, metodologji dhe zbatimi tyre në praktikë.

Keywords: *Standartizim, Universitet, TIK, Kurrikul*.

"Çdo njeri që pushon së mësuari, është plak, qoftë ai në moshën 20 apo 80 vjeç. Çdo njeri që vazhdon të mësojë mbetet i ri. Gjëja më e madhe në jetë është ta mbash mendjen tënde të re."

Henry Ford

1. STANDARTET PROFESIONALE PËR NJË MËSIMDHËNIE EFEKTIVE.

1.1 Rëndësia e një sistemi arsimor profesional

Arsimi dhe zhvillimi profesional i mësimdhënësve duhet të shihet si një detyrë e përjetshme, dhe duhet të jetë e strukturuar në përputhje me rrethanat. Pajisja e stafit akademik me aftësitë dhe kompetencat e nevojshme për rolet e tyre të reja, kërkon si domosdoshmëri që të ketë një cilësi në arsimimin bazik të mësimdhënësve në fakultetet e edukimit ku ata përgatiten dhe një proçes koherent të vazhdueshëm të zhvillimit të tyre profesional për ti mbajtur profesorët me njohuritë, shkathtësitë dhe aftësitë e kërkuara sot nga shoqëria. Ndërsa universitetet bëhen më autonome, me të hapura në mjediset e mësimit, profesorët marrin më shumë përgjegjësi për përmbajtjen, organizimin dhe monitorimin e procesit të të mësuarit, si dhe për zhvillimin e tyre profesional përgjatë karrierës së tyre personale (OESD, 2009). Për më tepër, si çdo profesion tjetër modern, mësimdhënësit kanë një përgjegjësi për të zgjeruar kufijtë e njohurive profesionale përmes një angazhimi reflektues për praktikat e tyre, përmes hulumtimit dhe përmes angazhimit sistematik në një zhvillim të vazhdueshëm profesional nga fillimi deri në fund të vitit të karrierës së tyre në mësimdhënie. Mangësitë janë të lidhura sidomos me mungesën e kompetencës për t'u marrë me zhvillimet e reja në fushën e arsimit (duke përfshirë mësimin e individualizuar, përgatitjen e studentëve për mësim autonom, punën në klasat heterogjene, në përgatitjen e studentëve për të shfrytëzuar më së shumti TIK-un, etj.). Prej një periudhe relativisht të gjatë, tashmë hulumtimet gjithnjë e më shumë kanë identifikuar zhvillimin e vazhdueshëm të mësimdhënësve si një nga aspektet kryesore për të përmirësuar cilësinë e universiteteve (Borko & Putnam, 1995; Talbert & McLaughlin, 1993; Thompson & Zeuli, 1999). Ky zhvillim profesional i vazhdueshëm, gjithashtu konsiderohet si një nga ndërmjetësit kritikë në efektivitetin e politikave për mësimdhënësit dhe praktikat e mësimdhënies (Desimone, Smith, & Frisvold, 2007; Smith, Desimone, & Ueno, 2005) dhe në përmirësimin e arritjeve të studentëve (Desimone, Smith, Hayes, & Frisvold, 2005).. Sipas Birman et al., (2007), në vitin 2004-2005, janë shpenzuar rreth 1.5 miliard dollarë për zhvillimin profesional për mësimdhënësit. Kështu, duke kuptuar se çfarë e bën zhvillimin profesional të efektshëm, është shumë e rëndësishme për të kuptuar suksesin apo dështimin e shumë reformave arsimore. Për dekada me radhë u zhvilluan studime për zhvillimin profesional të mësimdhënësve. nxënësve. Në mënyrë të veçantë, autorja pretendon se një mori e përvojave studimore e paraqesin zhvillimin profesional të mësimdhënësve si një sfidë për matjen profesionale. Si rrjedhim, tiparet kryesore të përvojave të të mësuarit përgjatë zhvillimit profesional të mësimdhënësve janë një mënyrë për të adresuar këtë sfidë.

Mësimdhënësit përjetojnë një gamë të gjerë të aktiviteteve dhe ndërveprimeve që mund të rrisin njohuritë dhe aftësitë e tyre dhe të përmirësojnë mësimdhënien e tyre në praktikë, si dhe të kontribuojnë në jetën e tyre personale, sociale, dhe rritjen emocionale si mësimdhënës. Këto përvoja mund të variojnë nga seminare formale, të strukturuara, specifike për temën e dhënë në shërbim, në diskutime të përditshme, takime informale dhe të tjera të mësimdhënësve për teknikat e mësimdhënies, jetën e përditshme të punës

etj. Literatura na ofron një rrjet të gjerë për atë që mund të përfshihet si zhvillimi profesional i mësimdhënësve, i përshkruar nga Little (1987:491) si "çdo aktivitet që ka për qëllim pjesërisht ose kryesisht të përgatisë stafin e paguar për përmirësimin e performancës në rolet e tashme apo të ardhshme në tekstetuniversitare". Të ndryshuarit apo lëvizja përtej veprimtarive diskrete të tilla si konferenca lokale dhe kombëtare, kurse, institute speciale dhe qendra (Little, 1993) janë këndvështrime më të reja, më komplekse dhe më të gjera se si të konceptohet zhvillimi profesional i mësimdhënësve, këndvështrime apo koncepte që kanë filluar të shfaqen gjatë dekadës së kaluar. Mbështetur edhe nga pikëpamjet njohëse të të mësuarit si interaktive dhe sociale (Greeno, 1997;), dhe në diskursin dhe praktikën e komunitetit (Anderson, Reder, & Simon, 1996, 1997; Cobb, 1994; Greeno, 1997;), janë aplikuar edhe tek mësimdhënësit (Putnam & Borko, 2000). Kjo është në përputhje me idenë se bashkësitë e të mësuarit formal apo joformal mes mësimdhënësve mund të veprojnë si mekanizma të fuqishëm për rritjen dhe zhvillimin e mësimdhënësve (Pak, 2002; Stein, Smith, dhe Silver, 1999).

1.2 Standartet ndërkombëtare për një mësimdhënie profesionale.

Standartet tregojnë pritshmëritë e praktikave efektive në arsim dhe trajnim. Ato u mundësojnë profesorëve, trajnerëve dhe praktikantëve të identifikojnë fushat për zhvillimin profesional. Standartet e mësimdhënies janë hartuar nga profesorët dhe trajnerët për të zhvilluar praktikat profesionale që mund të përfshijnë dhe motivojnë praktikantët dhe të mbështesin zhvillimin e tyre profesional. Standartet ndahen në tre seksione: vlerat dhe atributet profesionale, njohuria dhe kuptimi profesional, dhe aftësitë profesionale. Së pari, le të hedhim një sy tek seksioni i vlerave dhe atributeve. Profesorët dhe trajnuesit duhet vazhdimisht të jenë të përditësuar mbi atë që vlen për ta, si dhe duke sfiduar qëndrimet e tyre dhe duke marrë reagime nga kolegët, që të jetë e sigurt se ata janë vazhdimisht në zhvillim në mënyrë profesionale. Ata duhet të frymëzojnë dhe motivojnë studentët me anë të inovacionit të tyre, krijimtarisë dhe pasionit, duke promovuar përfshirjen dhe respektin për diversitetin, dhe duke punuar në bashkëpunim me kolegët e tyre për të mbështetur të mësuarit profesional." Seksioni i dytë tek standardet është njohuria dhe të kuptuarit profesional. Kjo pjesë e standardeve mbulon si mësimdhënësit duhet të mirëmbajnë dhe të përditësojnë njohuritë e tyre përmes hulumtimeve dhe të aplikojnë praktikat teorike në mjedisin e të mësuarit. Ai përshkruan se si profesorët duhet të përdorin këtë kuptim për të nxitur sjellje pozitive në të mësuar. Së fundi, mësimdhënësit duhet të kenë një pamje të qartë të kuptimit të rolit dhe përgjegjësive të tyre. Pjesa e tretë dhe e fundit e standardeve mbulon aftësitë profesionale.

Profesorët duhet të planifikojnë dhe të hartojnë programe efektive të mësimdhënies që kujdesen për nevojat e çdo studenti, motivimin e tyre për t'u rritur në detyrë, duke ndërtuar një mjedis të sigurt dhe gjithëpërfshirës. Mësimdhënësit duhet t'i mundësojnë studentëve për t'i ndarë përgjegjësi për mësimin e tyre dhe përfshirjen e tyre në metodat e drejta të vlerësimit.

Ato duhet të promovojnë përfitimet e përdorimit të teknologjisë dhe të mbështesin mësimin e gjuhës angleze dhe TIK. Mësimdhënësit duhet të punojnë në bashkëpunim me njëri-tjetrin për të rinovuar njohuritë e tyre profesionale.[110]

[110] https://www.britishcouncil.al/programmes/education/vocational/magazine-april 2017/professional-teaching-standards

Standardet profesionale të formimit të mësimdhënësit.

Standardet profesionale të formimit të përgjithshëm të mësimdhënësit janë hartuar duke u bazuar në dokumente rekomanduese hartuar nga Komisioni Evropian. Këto standarde janë zbërthyer në tregues, të cilët e ndihmojnë mësimdhënësin dhe të tjerët që të përcaktojnë nëse është përmbushur dhe në ç'shkallë është përmbushur një standard i caktuar. Standardet nuk mund të jenë të ndara prerazi nga njëri-tjetri, përkundrazi janë të ndërlidhura dhe duhen menduar si një e tërë, ku secili standard, bashkë me treguesit e tij, vështron një aspekt të rëndësishëm të profesorit cilësor. Standardet e mësimdhënësit përshkruajnë karakteristikat themelore të një profesori cilësor në mënyrë të përmbledhur, të qartë dhe e bëjnë dokumentin lehtësisht të përdorshëm. Ato vijnë si rezultat i kërkimeve dhe i përvojave më të fundit në fushën e zhvillimit profesional që kanë ndodhur në Shqipëri dhe në arenën ndërkombëtare. Standardet mbrojnë personalitetin e mësimdhënësit cilësor dhe ndikojnë ndjeshëm në rritjen e përkushtimit të tij për profesionin që ushtron. Profesori, duke u mbështetur te standardet, mund të bëjë vetë një vlerësim të profesionalizmit të tij për të konfirmuar nivelin ku ndodhet, përmirësimet që duhet të bëjë dhe të hartojë planin e zhvillimit profesional. Më poshtë përshkruhen 7 standarde në mënyrë të përmbledhur, të cilat lidhen me angazhimin, interesin dhe përfshirjen e profesorit në veprimtari trajnuese dhe kualifikuese; me zotërimin e përmbajtjes shkencore të lëndëve të ciklit bachelor; me krijimin e një mjedisi gjithëpërfshirës ku secili ndihet i mirëpritur dhe i mirëseardhur; me krijimin e një klime pozitive dhe me përdorimin e teknikave të disiplinimit pozitiv ku studentët pranojnë dhe respektojnë njëri-tjetrin; me interesimin e profesorit për t'u përditësuar me metodologjitë ndërvepruese të mësimdhënies me qëllim zbatimin cilësor të kërkesave të reja kurrikulare; me përdorimin e metodave të larmishme të vlerësimit të të nxënit e studentëve, si dhe me krijimin e një atmosfere bashkëpunuese dhe efektive në universitet ndërmjet drejtuesve, stafit akademik, prindërve dhe përfaqësuesve të komunitetit.

Për secilin standard është bërë një përshkrim i shkurtër i përmbajtjes dhe më tej janë dhënë treguesit specifikë të përmbushjes së tij.[111]

Standardi 1. Angazhimi i mësimdhënësit në zhvillimin e tij profesional

Standardi 2. Zotërimi i përmbajtjes së dokumentacionit kurrikular

Standardi 3. Krijimi i një mjedisi gjithëpërfshirës

Standardi 4. Pranimi dhe respektimi i diversitetit

Standardi 5. Përditësimi i metodologjive të mësimdhënies

Standardi 6. Njohja dhe zbatimi i metodave të vlerësimit

Standardi 7. Zbatimi i kodit të etikës

[111] http://www.portalishkollor.al/neës/standardet-profesionale-te-formimit-te-mesuesit

1.3 Standartet bazë për një mësimdhënie efektive.

Standartet profesionale për mësimdhënësit janë pjesë përbërësëse e një kuadri më të gjerë dokumentesh që përfshijnë të gjithë sistemin arsimor. Hartimi i standarteve profesionale të profesorit synon profesionalizmin e mësimdhënies që do të thotë marrjen në konsideratë të mësimdhënies si një profesion që duhet standartizuar, ashtu si profesionet e tjera, duke qënë në harmoni me partnerët e tjerë social, dhe me grupet e interesit. Standartet e përgjithshme bazë përshkruajnë karakteristikat profesionale që duhet të përmbushen nga çdo profesor që ka kaluar fazën fillestare dhe është licensuar si i tillë. Standartet profesionale janë një përmbledhje e të gjitha karakteristikave, njohurive dhe aftësive profesionale që duhet të ketë mësimdhënësi. Standartet ndihmojnë mësimdhënësin që të identifikojë nevojat e zhvillimit të tij professional.

Standartet e përgjithshme bazë të profesorit janë si më poshtë:

Standarti 1. Marrëdhëniet me fëmijët dhe të rinjtë

Mësimdhënësi tërheq në mënyrë të vazhdueshme të rinjtë në përvoja të përshtatshme që mbështesin zhvillimin e tyre intelektual, social dhe personal.

Standarti 2. Përditësimi

Mësimdhënësi është një praktikues reflektiv që vlerëson vazhdimisht efektet e zgjedhjeve e të veprimeve qëndërmerr dhe që vazhdimisht kërkon hapësira për ngritjen e tij profesionale.

Standarti 3. Komunikimi, puna në grup dhe bashkëpunimi

Mësimdhënësi bashkëpunon me kolegët, me prindërit etj, për të mbështetur procesin e të nxënit dhe për të zhvilluar te studentët aftësitë për të komunikuar dhe për të punuar në grup. Profesori punon si një anëtar ekipi me kolegët e tij dhe ndan me ta zhvillimin e praktikave të efektshme.

Standarti 4. Zhvillimi profesional individual

Profesori vlerëson performacën e tij të përgjithshme në përputhje me qëllimet e përgjithshme të arsimit në Shqipëri, rrit aftësitë e tij, përmirëson proceset e nevojshme, si dhe zbaton një planë zhvillimit të tij profesional.

Standarti 5. Kurrikulat

Profesori është kompetent për lëndët që jep mësim dhe për metodat e mësimdhënies që përdor.

Standarti 6. Arritjet e studentëve dhe diversiteti i tyre.

Profesori pranon dhe merr parasysh në punën e tij ndryshimet e mënyrave të të nxënit të studentëve, ai u krijon studentëve të ndryshëm mundësi dhe kushte për progres.

Standarti 7. Shëndeti dhe mbarëvajtja

Profesori informon studentët për masat e ruajtjes së jetës dhe të shëndetit të tyre, si dhe merr masa praktike për mbrojtjen e tyre. Merr masa dhe ndjek proçedurat e sigurisë së jetës së fëmijëve dhe të rinjve, përfshirë edhe studentët e abuzuar dhe të braktisur.

Standarti 8. Planifikimi

Profesori planifikon në shkallë vjetore dhe për çdo mësim zhvillimin e aftësive të studentëve, duke usiguruar atyre kushtet e nevojshme dhe duke u ngarkuar dhe vlerësuar detyrat dhe punimet e ndryshme.

Standarti 9. Mësimdhënia

Profesori zhvillon mësimdhënie alternative, nëpërmjet mësimeve të organizuara mirë për çdo

sekuencë, duke përdorur strategjitë e përshtatshme, metodat zhvilluese, teknologjitë e të nxënit si dhe duke kombinuar punën individuale me punën në grup.

Standarti 10. Vlerësimi, monitorimi, rezultatet

Profesori zotëron kërkesat për vlerësimin e arritjeve të studentëve, duke përdorur teknikat dhe instrumentet e diagnostikimit dhe të vlerësimit, si dhe u siguron studentëve dhe prindërve informacionet e nevojshme në kohën e duhur.

Standarti 11. Reflektim ndaj mësimdhënies dhe nxënies

Profesori rishikon vazhdimisht efektshmërinë e mësimdhënies dhe ndikimin e saj në ecurinë e studentëve, duke mbajtur parasysh arritjet e synuara që në fillim të procesit, duke mbajtur të dhëna e nevojshme që lidhen me progresin e studentëve. Këshillon dhe drejton studentët për progresin e arritjeve të tyre dhe është i hapur me ta.

Standarti 12. Mjedisi mësimor në klasë

Profesori siguron në klasë një mjedis të sigurtë, bashkëpunues, inkurajues, të hapur, të rregullt dhe me komunikim të dobishëm ndërmjet studentëve.[112]

1.3.1 Disa praktika mësimdhënie efektive

Praktikat e mësimdhënësit janë një nga elementët e mësimdhënies por ka edhe komponentë të tjerë në klasa që ndikojnë në edukim.[113] Këta komponentë të tjerë përfshijnë programet, strukturat e klasave si grupet, menaxhimi i klasave dhe synimet e mësimdhënies. Synimiet e edukimit janë të përfshira në mësimdhënien dhe në të mësuarit nëpërmjet programeve dhe aktiviteteve nëpër klasa. Një numër skemash

[112] https://www.academia.edu/17579746/STANDARTET_E_PERGJITHSHME_TE_MESUESIT

[113] https://www.researchgate.net/publication/268387095_STANDARTET_ARSIMORE_NE_BASHKIMIN_EUROPIAN_DHE_NE_SHQIPERI_Education_standards_in_EU_and_Albania

janë përdorur në analizimin e mjediseve edukative. Dy modelet që janë konsideruar sipas Fullan se kanë një ndikim të rëndësishëm në të mësuarit e studentëve janë: (Fullan, M. 2007, faqe 89):

- Udhëzimi direkt dhe zotërimi i të mësuari, karakteristikat kryesore në zotërimin e të mësuarit janë një sërë objektivash që studenti duhet të zotërojë në nivele të larta.

- Elementet e të mësuarit që i drejtohen një numri objektivash, vlerësimin e çdo studenti për të përcaktuar çfarë kanë realizuar ata e çfarë jo dhe si e kanë realizuar atë. Ky model përdoret si mbështetje për studentët, të cilët nuk e arrijnë dot nivelin kur elementët janë mësuar. Kjo i shtohet kërkesave të metodave. Efikasiteti i këtij modeli është i lidhur me burimet shtesë që i janë caktuar për të siguruar studentët të arrijnë nivele të larta nëpërmjet komponentëve të modelit. Modelet e fundit që njihen se janë efektive, përfshijnë elemente bazë, për të zotëruar të mësuarit në veçanti, besimin për çdo student në përvetësimin e aftësive, monitorimi i progresit të tyre kundrejt një tërësie standartesh të jashtme, dhe një mbështetje tjetër për studentët, që nuk i kanë përvetësuar ato në një nivel të lartë, në këndvështrimin e udhëzimeve normale.[114]

Menaxhimi dixhital i mësimit

Mjetet e teknologjisë që mund të ndihmojnë mësimdhënësit të hyjnë, krijojnë, organizojnë, përcaktojnë, dhe të gjurmojnë burimet dixhitale shpesh referohen si menaxhim i mësimit apo sisteme të menaxhimit. Mësimdhënësit më novatorë gjithmonë kanë përzier e bashkuar burimet në mësimet e tyre në një diapazon të gjerë të kurseve: tekstet, modulet e vetë-krijuara, burimet e publikuara, videot, sitet pa pagesë dhe me pagesë etj. Ka mësimdhënës, p.sh. që ruajnë shënimet e tyre në një website, kanë video në hard driver-at e tyre, dhe kanë mësimet e tyre në wiki. Ne duhet të mendojmë se tani i jemi nënshtruar një nga revolucionet më të rëndësishme teknologjike për arsimin. Kultura e librit duhet të përfshijë një transformim dramatik të arsimit, kanë argumentuar studiuesit (Marshall McLuhan 1961 & 1964) (Ëalter Ong 1988). Studiues të tjerë, kanë argumentuar se ristrukturimi i arsimit, kurrikulat e reja, pedagogjia, letërsia, praktikat dhe qëllimet duhet tu përshtaten teknologjive aktuale. Të dy tradicionalistët dhe reformatorët bien dakord se edukimi dhe arsimimi janë të lidhur ngushtë. Literaturat evoluojnë dhe zhvendosen në përgjigje ndaj ndryshimeve shoqërore dhe kulturore. Siç argumentoi (Dewey, 1997), arsimi është i nevojshëm për t'u mundësuar njerëzve të marrin pjesë në demokraci, sepse pa një qytetar të arsimuar të informuar dhe shkolluar, një demokraci e fuqishme është e pamundur.[115] Për më tepër, revolucioni teknologjik i kohës së sotme bën të mundur rindërtimin radikal, ristrukturimin e arsimit dhe shoqërisë, (Freire P. 1970) reforma rrënjësore arsimore.

1.4 Përfitimet e përdorimit të standarteve profesionale.

Shumica dërrmuese e mësimdhënësve bien dakort se Standardet kanë bërë një ndryshim në praktikën e tyre profesionale. Përfitimet më të zakonshme nga përdorimi i standardeve lidhen me faktin se ato

[114] Fullan, M. (2007), Leading in a Culture of Change.

[115] Marshall Mc Luhan (1961 &1964) Understanding Media, Walter Ong (1988) The Technologizing of the Word

përcaktojnë pritshmëri të qarta ose praktikë efektive në arsim dhe trajnim duke u mundësuar profesorëve të identifikojnë fushat e tyre për zhvillim profesional. Ato shërbejnë si një udhëzim më i qartë se si t'i përdorin ato për të realizuar një mësimdhënie sa më efektive. Standardet kanë për qëllime fillestare aftësimin e profesorëve me fokus arritjet më të larta në performancën e tyre. Stafi mësimor që përdor standartet vë re një ndikim më të madh në nxënien e mësimeve si dhe një ndryshim të rëndësishëm në krahasim me ato që nuk mbështeten sa duhet tek ato. Përdoruesit aktual të Standardeve Profesionale në përgjithësi i vlerësojnë ato dhe përfitimet që standardet sjellin në rolin e tyre. Në mesin e përdoruesve të Standardeve, shumica bien dakort me vlerën që mbajnë Standardet, dhe shkallën në të cilën ato funksionojnë për të mbështetur punën e tyre. Standardet po ashtu shërbejnë tek shumë mësimdhënës për të bërë disa ndryshime në praktikën e tyre profesionale. Përdoruesit të kënaqur nga përvojat pozitive janë një shembull për ti rekomanduar edhe tek të tjerët, pra ata janë gati të bëjnë promovimin e Standardeve për përdoruesit e ardhshëm. Mjeti i ri i vetëvlerësimit të Standardeve Profesionale është një burim ideal për të ndihmuar mësimdhënësit të përcaktojnë mbarëvajtjen e tyre në mësimdhënie si dhe rritjen e ndikimit që Standardet kanë në rezultatet e studentëve.

Efektiviteti i zhvillimit të vazhdueshëm professional.

Zhvillimi profesional nuk mund të konsiderohet vetëm në lidhje me ekspozimin e mësimdhënësve në një koncept ose sigurimin e njohurive themelore rreth një metodologjie të mësimdhënies. Në vend të kësaj, zhvillimi i vazhdueshëm profesional në një epokë të llogaridhënies kërkon një ndryshim në praktikat e mësimdhënësit që çon në rritje të të nxënit të studentëve.

2. STANDARTET ARSIMORE NË SHQIPËRI.

2.1 Koncepti dhe llojet e standarteve arsimore në Shqipëri.

Termi "standard" ka gjetur një përdorim shumë të gjerë në teorinë dhe praktikën arsimore në Shqipëri, sidomos në 10-15 vitet e fundit. Pothuajse në të gjitha dokumentet strategjike, teknike, ose normative që kanë të bëjnë me arsimin, gjen referenca ndaj standardeve, sidomos ndaj "standardeve ndërkombëtare dhe europiane". Pavarësisht këtij referimi dhe përdorimi të gjerë të termit "standard", vihet re që ende nuk ka një kuptim të njëjtë për të, si nga individë, ashtu edhe nga institucione të ndryshme të angazhuara në arsimin shqiptar. Në shumë raste termi "standard" merret me një kuptim të gjerë, p.sh. në rastet kur përdoret për të karakterizuar parimet arsimore, objektivat e përgjithshëm arsimorë, strukturat arsimore, fushat lëndore etj. Në raste të tjera, termi "standard arsimor" ka një kuptim më të ngushtë dhe më specifik, p.sh.kur u referohet përshkrimeve të niveleve të kualifikimeve (sidomos profesionale), përmbajtjeve specifike mësimore, arritjeve të studentëve, kërkesave për mjedise dhe mjete mësimore etj. Në fjalorin për "Arsimin dhe Formimin Profesional - 2013", standardet arsimore përkufizohen si "matëse të cilësisë së proçeseve dhe të rezultateve të sistemit arsimor". Sipas këtij përkufizimi, "ato vendosen në nivel kombëtar dhe u referohen mësimdhënies, përmbajtjes së programeve mësimore, arritjeve të studentëve, sasisë dhe cilësisë së burimeve që përdoren në arsim etj". Në këtë fjalor jepet kuptimi edhe për "standardet e kualifikimit", të cilat përcaktohen si "një tërësi treguesish sasiorë dhe cilësorë që karakterizojnë një kualifikim dhe që shërbejnë si bazë për hartimin e kurikulave përkatëse".

Standardet e input-eve.

• Standardet e përmbajtjes mësimore: gjejnë shprehje në kornizat kurikulare, planet mësimore, programet mësimore lëndore, planet dhe programet universitare, tekstet mësimore. Ato tregojnë se në ç'nivel duhet të trajtohet përmbajtja mësimore (faktet, parimet, proçeset dhe njohuri të tjera) në procesin mësimor.

Tradicionalisht kanë shërbyer si bazë për konceptimin dhe organizimin e proçesit mësimor nga mësimdhënësit, por njëkohësisht edhe për realizimin e procesit të inspektimit arsimor.

• Standardet e infrastrukturës mësimore: këto gjejnë shprehje në dokumente normative që u referohen kushteve dhe kërkesave për hapjen e universiteteve të reja dhe funksionimin normal të atyre ekzistuese. Ato kanë të bëjnë me numrin minimal dhe maksimal të studentëve në një klasë, me normativat e sipërfaqeve/vëllimeve të klasave për studentëve, me ndriçimin, me pajisjen e klasave, laboratorëve dhe reparteve të praktikave, me kushtet e higjienës dhe të sigurisë etj. Edhe këto standarde përdoren gjerësisht nga inspektimi arsimor. Duhet theksuar se megjithëse një pjesë e këtyre standardeve janë detyruese për t'u zbatuar nga universitetet, në shumë raste, për arsye të vështirësive financiare dhe materiale, ato nuk zbatohen, duke ndikuar dukshëm në rënien e cilësisë mësimore.

Standardet e proçeseve.

Janë të lidhura ngushtë me standardet e input-eve dhe në mënyrë të ngjashme, ato u referohen sistemeve dhe ofruesve. Këto standarde kanë një ndikim të madh në arsim, pasi përcaktojnë mënyrat (metodat ose proçedurat) se si kryhen proceset arsimore dhe tregojnë, gjithashtu, edhe përgjegjësitë e aktorëve të ndryshëm. Ato gjejnë shprehje në dokumente ligjore-normative.

Standardet e output-eve.

Këto përcaktojnë arritjet e pritshme të sistemit arsimor, të ofruesve arsimorë ose të individëve (studentëve) në fund të afatave kohore të caktuara dhe shërbejnë edhe si njësi matëse për shkallën e suksesit (ose të mossuksesit) në arsim. Ky grup standardesh arsimore po gjen gjithnjë e më tepër referencë edhe në arsimin shqiptar.

2.2 Analiza e standarteve arsimore në Shqipëri.

Hartimi i standardeve të reja në nivel strategjik dhe afatgjatë: Do të synojë sigurimin dhe rritjen e cilësisë së tërë sistemit arsimor shqiptar, vënien e tij në funksion të kërkesave të reja aktuale dhe perspektive të shoqërisë, si dhe integrimin e tij në sistemet arsimore të vendeve të zhvilluara demokratike (Kjo e parë edhe në kuadrin e mundësisë së ndryshimit të strukturës së universiteteve); Do të krijojë mundësinë e përcaktimit të cilësisë së sistemit arsimor, të monitorimit, të verifikimit dhe të vlerësimit të përmbajtjes së tij nga shoqëria dhe shteti; Do të krijojë dhe do të sigurojë sistemin e referimit për ndryshimet graduale afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata në arsim; Do të rritë shkallën e vlefshmërisë dhe të përdorimit të rrjedhojave të vlerësimit të sistemit arsimor. Duke i shërbyer këtij qëllimi strategjik, në nivel sistemi, standardet do të shërbejnë si udhëzues: për hartimin e programeve, të teksteve shkollore dhe të të gjitha materialeve të tjera mësimore. për organizimin e procesit të të nxënit, të mësimdhënies dhe të kualifikimit të burimeve njerëzore; për hartimin e kritereve të arritjeve në arsim dhe të vlerësimit të tyre për studentët, për profesorët e për universitetin në përgjithësi dhe si pika referimi për zhvillimin e testeve. Përveç sa më sipër, hartimi i standardeve, sidomos i atyre të arritjes, do të ofrojë kritere të njësuara për vlerësimin e

njohurive, të shkathtësive e të shprehive të studentëve, si dhe kritere të hollësishme për vlerësimin e nivelit të realizimit të objektivave. Në këtë mënyrë, ai do të mundësojë edhe sigurimin e të dhënave më të plota e më të besueshme për vlerësimin dhe përmirësimin e të gjithë sistemit në tërësi. Për këtë arsye, standardet e përmbajtjes, të paraqitura në këtë dokument, u ofrojnë jo vetëm universitetit, por të gjithë punonjësve të arsimit, vendimmarrësve, prindërve etj. elemente të rëndësishme për përcaktimin e përmbajtjes së kurikulës universitare.

2.3 Krahasimi i standarteve arsimore shqiptare me ato europiane.

Hartimi dhe zbatimi i politikave të përbashkëta, kohët e fundit, në nivel europian po konsolidohet prirja e përvijimit të politikave të përbashkëta evropiane, që synojnë të njësojnë (unifikojnë) treguesit e cilësisë pothuajse në të gjitha fushat e veprimtarisë njerëzore në kontinent. Të gjitha këto politika, që në shumë raste janë rrjedhojë e marrëveshjeve ose e angazhimeve afatshkurtra ose afatgjata, kanë rrjedhojat e tyre të drejtpërdrejta në fushën e arsimit. Në këtë fushë ato shfaqen si politika të rekomanduara ose të sugjeruara, që në nivel kombëtar trajtohen dhe përdoren si piketa për hartimin e standardeve të brendshme, si në drejtim të mësimdhënies, ashtu edhe në atë të trajnimit. Këto standarde, në fushën e arsimit, në shumë raste trajtohen si standarde daljeje (output-i) në fushën e njohurive dhe të shkathtësive e shprehive. Politika të përbashkëta europiane që janë pranuar dhe kanë shërbyer si piketa për zhvillimin e politikave të brendshme të vendeve të tjera evropiane, por edhe të vendeve të Ballkanit, janë të shumta. Disa prej tyre kanë pasur ndikimin e tyre të drejtpërdrejtë në arsimin shqiptar, si në nivel sistemi ose politike arsimore, ashtu edhe në nivelin e praktikave mësimore në universitet e në klasë.

Korniza Europiane dhe Shqiptare e Kualifikimeve.

Një ngjarje, që mund të vlerësohet e rëndësishme nga pikëpamja e zhvillimit të standardeve europiane dhe e zbatimit të tyre në vendet europiane, është hartimi i Kornizës Europiane të Kualifikimeve, e cila synon të unifikojë praktika të caktuara në fushën e arsimit në Europë e për rrjedhojë, të krijojë mundësi dhe lehtësi për njohjen dhe akreditimin e sistemeve arsimore të çdo vendi në nivel europian.Pasojë e drejtpërdrejtë e Kornizës Europiane të Kualifikimeve në vendin tonë është puna për hartimin dhe miratimin e ligjit për "Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve", si dhe projektvendimi i bazuar në këtë ligj për "Funksionet dhe detyrat e njësisë së Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve", e cila do të mundësojë hartimin e standardeve të kualifikimeve kombëtare në përputhje me praktikën e mirë ndërkombëtare, për të ndërtuar standardet e kualifikimit dhe për të siguruar që ato njihen në arenën ndërkombëtare.

2.4 Adaptimi i metodave bashkëkohore në mësimdhënie.

Politikat aktuale arsimore në Shqipëri prej vitesh janë orientuar nga drejtimet dhe zhvillimet kryesore progresive ndërkombëtare. Edukimi për të drejtat e njeriut Edukimi për të drejtat e njeriut në shkollën shqiptare gjen mbështetje të sigurt në përfshirjen e tij në përparësitë e politikave të MASH-it prej mëse një dhjetëvjeçari. Edukimi për të drejtat e njeriut në shkollë gjen pasqyrim në Ligjin për Arsimin Parauniversitar dhe në draftin e standardeve të lëndës së edukimit qytetar. Si rrjedhojë e kësaj përparësie, edukimi për të drejtat e njeriut është pjesë e kurikulës zyrtare dhe e programeve të kualifikimit të

mësuesve, si të fakulteteve të edukimit, ashtu edhe institucioneve të tjera arsimore, duke qenë, në të njëjtën kohë, edhe çështje e mjaft veprimtarive shkollore e jashtëshkollore në të gjithë vendin.

Edukimi ligjor Një nga ndërmarrjet që konsiderohet e rëndësishme në fushën e edukimit të qytetarëve të ndërgjegjëshëm dhe të përgjegjshëm për të respektuar normat dhe institucionet e shoqërisë demokratike është futja në kurikulën e shkollës së mesme të profilizuar, në kuadrin e lëndës së edukimit qytetar, të lëndës "Edukimi ligjor". Kjo lëndë synon të pajisë të rinjtë me njohuri rreth ligjit, sistemit ligjor dhe parimeve themelore e vlerave mbi të cilat ngrihet një demokraci kushtetuese. Ajo do t'u mundësojë të rinjve të njihen me të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, të fitojnë njohuritë, shprehitë dhe qëndrimet që i aftësojnë ata jo vetëm të veprojnë në përputhje me ligjin, por dhe të jenë qytetarë pjesëmarrës në jetën dhe bërjen e demokracisë.

*Edukimi global*Edukimi i të rinjve të aftë të veprojnë si qytetarë në një botë gjithnjë e më të ndërvarur dhe globale është një ndër objektivat e politikës së MAS-it dhe të IKT-së. Edukimi global, sipas konceptimit të sotëm europian, është një ndër përmasat e edukimit për qytetari demokratike, i cili mbështetet në shikimin e botës si një sistem. Ai synon të sjellë ndryshime në tri drejtime kryesore:

1. Së pari, në drejtim të konceptimit dhe të krijimit të një kurikule globale, e cila të jetë e aftë të reflektojë botën në globalitetin e saj dinamik.

2. Së dyti, në drejtim të kualifikimit të mësimdhënësve, për t'i aftësuar të nxënë vetë dhe të mësojnë të tjerët për një botë në zhvillim e ndryshim të pandërperë.

3. Së treti, në drejtim të edukimit të studentët global, si pjesëtar i njëkohshëm i të sotmes që jeton, por edhe i të ardhmes që e shqetëson. Sot kjo përmasë përfshihet në standardet dhe në kurikulën zyrtare të lëndës së edukimit qytetar, gjë që garanton edhe zbatimin e saj në shkallë të gjerë në tërë veprimtarinë e edukimit.

2.5 Mësimdhënia tradicionale përballë mësimdhënies për të mësuarit aktiv.

Cilat janë mendimet tuaja të para kur dëgjoni fjalën "mësues"? Dikush që qëndron përballë klasës duke dhënë një leksion dhe pastaj ju vë nota për kujtesën dhe përsëritjen rreth dijes së dhënë? Dikush që është një "predikues" ose "aktor kryesor", dhe i cili di dhe dëshiron ta transferojë dijen e tij apo të saj te studentët? Kjo figurë e profesrëve është e pajtueshme me atë që mund të shprehet si Mësimdhënie Tradicionale. Mësimdhënia Tradicionale është e qendërzuar te mësimdhënësi dhe kërkon dhënien e leksioneve të mira në mënyrë që të transferohet një tërësi e përcaktuar mirë e dijes te studentët. Mësimdhënia Tradicionale bazohet në dogmën që të mësuarit është përvetësim (ose mbledhje) e fakteve që duhen mbajtur mend dhe e procedurave që duhen zbatuar rëndom. Për të praktikuar Mësimdhënien Tradicionale ju vetëm duhet të njihni përmbajtjen që shpjegohet në mësim dhe si të jepet ajo te studentët. Një figurë alternative e profesorëve dhe mësimdhënies, e cila është e pajtueshme me të katër parimet e përmendura më sipër, është Mësimdhënia për të Mësuarit Aktiv. Tek Mësimdhënia për të Mësuarit Aktiv, të mësuarit shihet si proces i të kuptuarit të gjërave (ose më teknikisht një dije që ndërtohet personalisht) duke u angazhuar në veprimtari kuptimplotë dhe duke komunikuar me të tjerët. Çdo student hyn në klasë

ose fillon një mësim, me dije personale që ai apo ajo i përdor për të kuptuar çfarë jepet nëmësim. Çfarë është mësuar, varet jo vetëm nga çfarë ju dhe profesori, thoni dhe bëni, por edhe nga dija personale që studentët sjellin në situatën e të mësuarit.

Kalimi nga mësimdhënia tradicionale në mësimdhënien për të mësuarit aktiv.

Çfarë kriteresh përdorim apo duhet të përdorim për të përkufizuar përsosmërinë e mësimdhënies? Tek Mësimdhënia tradicionale kriteri kryesor është transmetimi i informacionit të përfshirë në një konspekt, tekst ose në ndonjë burim tjetër. Nga ana tjetër, tek Mësimdhënia për të Mësuarit Aktiv, kriteri parësor është cilësia e të mësuarit e përjetuar nga ata të cilëve u jepet mësim. Tek Mësimdhënia për të Mësuarit Aktiv, mësimdhënia dhe të mësuarit shihen si dy aspekte të të njëjtit proçes të gërshetuar. Ky proçes është i shprehur mirë në termin "mësimdhënie/të mësuarit" me njërën faqe të çiftit që ndikon dhe ndikohet nga tjetri. Për të praktikuar Mësimdhënien për të Mësuarit Aktiv ju jo vetëm duhet të njihni çfarë po jepni mësim, por po ashtu në një sasi të konsiderueshme, kujt po i jepni mësim. Bazuar në këtë diskutim mund të ofrohen dy sugjerime për ata që duan të kalojnë nga Mësimdhënia Tradicionale tek Mësimdhënia për të Mësuarit Aktiv. Së pari nevojitet të krijoni situata të mësuari që i angazhojnë aktivisht nxënësit tuaj në procesin mësimor. Së dyti, në këtë situatë mësimore ju duhet të jeni i ndjeshëm për atë çfarë po bëjnë nxënësit tuaj, dhe si ata po iu përgjigjen veprimtarive të të mësuarit dhe detyrave që u janë caktuar.

Rekomandim 1 Krijoni skenarë në vend që të shkruani plane mësimore

Shpesh thuhet që mësimdhënia është art. Në qoftë se është, atëherë mundësia për krijimtari qëndron në fazën planifi kuese të mësimdhënies. Faza planifikuese ndodh kur ju përgatiteni për mësim duke kërkuar mënyrat për të mbushur boshllëkun midis vendit ku janë nxënësit aktualisht në terma të objektivave tuaja dhe ku ata duhet të jenë për t'i zotëruar objektivat. Shumicës së Lektorëve u kërkohet nga anëtarët e personelit administrativ të përgatisin planet mësimore, zakonisht për leksionet që zgjasin nga 45 minuta deri në një orë ose më shumë (si në rastin e një mësimi pianoje për shembull). Herë pas here një mësim mund të fillojë në një ditë gjatë një periudhe të vetme mësimore, dhe të zgjerohet në një ditë tjetër apo periudhë mësimore.

Rekomandimi 2: Projektoni situata të të mësuarit që i angazhojnë aktivisht nxënësit në procesin e të mësuarit.

Mjediset janë vendet ose vendndodhjet në të cilat ndodh të mësuarit. Një klasë është një mjedis tipik i të mësuarit. Situatat janë ngjarjet që ndodhin brenda këtyre mjediseve. Brenda klasës suaj (një mjedis) një nxënës fillon ta ndërpresë mësimin (një situatë). Situatat mund të jenë negative (si në shembullin e mëparshëm) ose pozitive (kur nxënësit po interpretojnë krenarë një pjesë të shkurtër teatrale që e kanë shkruar vetë). Natyrisht, si mësues ne duam më shumë situatat pozitive se sa ato negativet.

Rekomandimi 3: Diagnostikoni statusin fillestar të nxënësve dhe aktivizoni dijet e tyre të mëparshme.

Nxënësit mund ta kuptojnë atë që iu jepet mësim vetëm kur janë të aftë ta lidhin atë me përvojën dhe dijen e tyre të mëparshme. Një mënyrë për të gjetur çfarë dinë tashmë nxënësit tuaj, është t'u jepni atyre kohë për të refl ektuar dhe për të shkëmbyer informacion për dijen e tyre të mëparshme. Kjo mund të

realizohet spontanisht duke bërë pyetje, bashkëbisedim ose më formalisht në një detyrë të shkurtër me shkrim (ku u kërkohet studentëve të mbajnë ditarë).

Rekomandimi 4: Krijoni ose përzgjidhni veprimtari të përshtatshme dhe të lidhura me të mësuarit

Të mësuarit aktiv kërkon nga studentët që ata të angazhohen në veprimtari të përshtatshme dhe të lidhura me të mësuarit. Përgjithësisht, i përshtatshëm i referohet lidhjes midis veprimtarive dhe studentëve (p.sh., të përshtatshëm për moshën dhe zhvillimin), ndërsa të lidhur i referohet lidhjes midis veprimtarive dhe objektivit. Megjithëse fraza "të mësuar aktiv" ka qenë i përdorur në arsim për shumë vite, kuptimi i saj ka ndryshuar me kalimin e kohës. Në fi llimin e shekullit të 20- të John Deëey argumentonte "të mësuarit duke bërë". Pikëpamja e Dewey-t e "të mësuarit duke bërë" ishte e kufi zuar në ekzekutimin e veprimtarive motore, manuale dhe praktike. Koncepti aktual i të mësuarit aktiv nuk i përjashton veprimtaritë motore, manuale dhe praktike, por megjithatë përqendrohet në aktivitetin mendor.

Rekomandimi 5: Jepni mësim në mënyra që i bëjnë aktivitetet e të mësuarit "të vijnë në jetë"

Pavarësisht sa të përshtatshëm dhe të lidhur janë veprimtaritë tuaja të të mësuarit "në letër", ju si mësimdhënës duhet të bëni që ato "të vijnë në jetë" në klasë. Në këtë aspekt, mësuesit mbështeten në një nga tre qasje të mësimdhënies. E para dhe ndoshta më e zakonshmja është të prezantohet informacioni, të shpjegohen konceptet dhe të modelohen aftësitë. Kjo qasje mund të emërtohet "thuaj e trego". Qasja e dytë është të bëhen pyetje ose të parashtrohen probleme dhe pastaj të udhëhiqen studentët me anë diskutimesh dhe zbulimesh që të vijnë vetë te përgjigjet e pyetjeve ose zgjidhjet e problemeve.

Rekomandimi 6. Edukimi i të menduarit kritik

Këshilli Kombëtar për Përsosmërinë në Mendimin Kritik ka dhënë një përkufizim gjithëpërfshirës të mendimit kritik. Mendimi kritik është "procesi intelektualisht i disiplinuar i konceptualizimit, zbatimit, analizës, sintetizimit dhe/ose vlerësimit aktiv dhe me aftësi të informacionit të mbledhur ose të gjeneruar nga vrojtimi, përvoja, refl ektimi, arsyetimi, ose komunikimi si një udhëheqje për besim dhe veprim."

Rekomandimi 7: *Jini mbikëqyrës i vetes*

Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies tuaj nuk do të jetë puna e një mbikëqyrësi të jashtëm. Më saktë, vetëvlerësimi është një pjesë integrale e punës profesionale të mësimdhënësve. Kësisoj, si mësimdhënësna nevojitet të përbrendësojmë cilësitë që e bëjnë një skenar të shkëlqyeshëm, të punojmë për të siguruar që ato cilësi të jenë të pranishme në secilin nga skenarët, dhe të bëjmë çfarë është e nevojshme për ta realizuar skenarin në mënyra që angazhojnë aktivisht studentët dhe sigurojnë suksesin e të mësuarit. Në këtë rekomandim ne do të marrim në konsideratë ato cilësi që diferencojnë skenarët e mirë, nga ata jo dhe aq të mirë. Këto cilësi duhet t'ju aftësojnë të "jeni mbikëqyrës i vetes" (përshtatur nga Ivić et al., 2003).

1) Përcaktoni idenë kryesore. Në një skenar, ideja kryesore është zamku që mban çdo gjë bashkë. Identifikoni idenë kryesore, përshkruajeni atë në terma mjaft të thjeshtë dhe emërtojeni atë. Pastaj shkruani një grup objektivash të të mësuarit, të krijuara rreth apo të bazuara mbi idenë kryesore.

2) Rendisni të gjithë veprimtaritë e të mësuarit në vazhdimësi. Cilat janë veprimtaritë e të mësuarit? Për çdo veprimtari, a e kam qartësuar çfarë duhet të bëjnë studentët? Shkruani mundësisht me saktësi të gjithë gjërat që duhet të bëjnë studentët, edhe nga ana njohëse edhe ndryshe, ndërsa ata punojnë me skenar. (duke marrë shënime, duke punuar në grupe, duke analizuar materialin e shkruar, zbatuar një procedurë, zgjidhur një problem). Më në fund a ka kuptim radha e veprimtarive dhe a ka të ngjarë që t'i udhëheqë studentët që ta kuptojnë idenë kryesore dhe të arrijnë objektivat?

3) Kontrolloni veprimtaritë në terma të mundësive që ato japin për angazhim aktiv. Disa veprimtari mund të jenë më angazhuese se të tjerat. Veprimtaritë më pak angazhuese mund të kenë të përbashkët një a më shumë nga këto karakteristika: tepër të gjata, të tepruara, të mërzitshme, çoroditëse, ose të pakuptim. Veprimtaritë me ndonjë nga këto karakteristika duhet të zëvendësohen me ato që ka të ngjarë që të jenë më angazhuese. Duhet shënuar që ky është një kontroll për përshtatshmërinë e veprimtarive.

4) Kontrolloni lidhjen midis veprimtarive dhe objektivave të të mësuarit. Si lidhen këto veprimtari me objektivat e të mësuarit? A ka veprimtari që mbivendosen? A ka hendeqe në renditjen e veprimtarive? Duhet shënuar që ky është një kontroll për rëndësinë e veprimtarive.

5) Vlerësimi dhe gjykimi. Çfarë prove më nevojitet që të më lejojë të kuptoj nëse studentët kanë qenë të suksesshëm në përpjekjet e tyre për të mësuar.

Faza e parë, që ne e përmendëm më parë në këtë sesion ndodh pasi skenari është përgatitur dhe është gati për realizim. Faza e dytë ndodh pasi skenari është vënë në jetë. Në fazën e parë ju e vlerësoni skenarin tuaj në terma të një klase të supozuar studentësh. Në fazën e dytë ju e vlerësoni skenarin tuaj bazuar në reagimet, komentet dhe ndoshta sugjerimet e një klase reale studentësh.

3. **PËRSHTATJA NDAJ RISIVE NË PROÇESIN ARSIMOR.**

3.1 Risitë në mësimdhënie dhe avantazhet e tyre.

Teknologjia si një risi në mësimdhënie

Shoqëria e bazuar në dituri nevojitet që të posedojë aftësi të mira komunikuese dhe sociale, të jetë e mirë informuar dhe të jetë gjithmonë e gatshme të mësojë gjëra të reja. Për t'u bërë pjesëtar të kësaj shoqërie qytetarët duhet të marrin pjese në mënyrë aktive në këtë shoqëri dhe ti ndjejnë benifitet e ofruara nga ajo. Atyre duhet t'ju jepet mundësia që ti kenë dhe arrijnë ato dituri dhe aftësi të nevojshme. Ato gjithashtu duhet që në mënyrë kreative ti arrijnë dituritë dhe eksperiencat duke krijuar zgjidhje origjinale për problemet. Në kohën bashkëkohore ndikimi i teknologjisë informatike dhe të komunikimit (TIK) gjithnjë e më shumë bëhet i gjitheperfshires në shumë sfera shoqërore. Ky zbatim nuk e anashkalon as arsimin. Arsimimi dhe dituria janë baza e çdo zhvillimi njerëzor dhe ato janë e drejta fondamentale për çdo qenie njerëzore. Dominimi i metodave tradicionale të cilat e fuqizojnë njohurinë enciklopedike dhe jo specifike apo praktike, mungesa e mësimdhenies interaktive dhe inovacioneve bëjnë që teknologjia informatike e komunikimit të shfrytëzohet si reformator për ti plotësuar kërkesat globale për mësimdhënie sa më pragmatike dhe për ti ndjekur trendet bashkëkohore arsimore ku nxënësi vendoset në qëndër të vëmendjes dhe ku amplifikohet të menduarit kritik dhe zgjedhja e problemeve. Nevoja dhe arsyeja e aplikimit të TIK-ut në arsim niset nga fakti i përgatitjes së të rinjve për tu bërë liderë dhe të suksesshëm në këtë

shoqëri të udhëhequr nga informacionet. Aftësitë e komunikimit, proçesimit, mendimit kritik dhe zgjedhjes së problemeve si dhe puna në grupe janë esenciale në shoqërinë teknologjike dhe socioekonomike të shekullit 21. Arsimimi në këtë mjedis të sofistikuar do të bëjë më shumë se vetëm lexim, shkrim apo përvetësim të shkathtësive aritmetike. Duhet të ofrojë edhe shkathtësi pune që do ti ndihmonin të rinjtë ta arrijnë potencialin e tyre njerëzor. Zhvillimi i shoqërisë informatike paraqet një nga detyrat prioritare të të gjitha qeverive botërore. Nuk ka dyshim se arsimimi është njëri nga segmentet kryesore në nxitjen dhe përkrahjen e zhvillimit të shoqërisë informatike, edhe atë në dy aspekte. Pikë së pari, ky segment duhet të jetë promotor i shoqërisë informatike dhe të inicojë krijimin e kuadrove profesionale dhe kompetente të cilët mund tju përgjigjen sfidave të shoqërisë informatike dhe nevojave të ekonomisë së bazuar në dituri. Së dyti, cilësia e proçesit edukativo arsimor në mënyrë të drejtë mvaret nga zbatimi i teknologjisë informatike dhe komunikimit në po atë proçes. Kursi jonë "TIK në arsim" do ti trajtojë ndryshimet dhe efektet e TIK-ut në arsimin fillor duke: vëndosur theksin në nevojën, në mënyrën e integrimit sa më efikas të TIK-ut, në ndryshimin e metodave mësimore nga ato tradicionale në interaktive, evaluimi i orëve me zbatim të TIK-ut, përpunim elektronik i të dhënave si dhe interpretimi i të dhënave. Sistemi jonë arsimor është duke i zbatuar principet e Strategjise Nacionale për Zhvillimin e Arsimit, vecanerisht programit për zhvillimin e TIK-ut në arsim. Qëllimi kryesor i strategjisë nacionale është që të maksimalizohet dhe të optimizohet shfrytëzimi i pajisjeve të TIK-ut nga kategori të ndryshme të pjesëmarrësve potencialë: mësimdhënës, nxënës, student, qytetar. Promovimi i arsimimit teknologjik paraqet hap logjik, posaçërisht në klasat e ulta të arsimit fillor. Kujdes i veçantë duhet pasur në përmbajtjet mësimore për grupe të ndryshme nxënësish. Posaçërisht theks të veçantë i jepet zbatimit të TIK-ut në arsimin fillor për kryerjen e detyrave shkollore e jo si qëllim vetëm për vete.

Integrimi i metodave bashkëkohore

Në teorinë dhe në praktikën e punës mësimore çështja e metodave është një nga përmbajtjet me rëndësi të veçantë, meqë ato përcjellin tërë ecurinë e zhvillimit të proçesit mësimor. Aplikimi i mësimit interaktiv në grupe të vogla kryesisht mund të organizohet në dy mënyra: Mënyra e parë është kur të gjithë grupet punojnë në një përmbajtje mësimore ose zgjidhin një detyrë, realizojnë një eksperiment apo një detyrë laboratorike, një vëzhgim. Kurse mënyra e dytë është kur secili grup punon në detyra të ndryshme.

Mësimi interaktiv – të nxënit aktiv promovon cilësinë e proçesit të dhënies, por paraqet një sistem dhe model inovator të punës mësimore e cila mbështetet në elemente të ndryshme të mësimit problemor, mësimit zbulues – kërkimor, mësimit ekipor e të individualizuar.

Në këtë kontekst mësimi interaktiv ka ecuri dhe trajtim tjetër të përmbajtjeve, të planifikimit dhe të përgatitjes së mësimdhënësit për punë.

Karakteristikat e mësimdhënies interaktive në arsim

Zbatimi i mësimdhënies interaktive kërkon mjete të ndryshme ndihmëse për mësim, hapsirë të volitshme për punë, rregullim të interierit, aftësim të profesorëve për të zbatuar mësimdhënie interaktive, aftësim i studentëve e të tjera që do të thotë se varet nga shumë faktor të rëndësishëm. Që të ndryshohet pasqyra e

mësimit tradicional si çështje mjaft e rëndësishme është vendosja e risive në mësim. Në teoritë praktike të didaktikës është pranuar qëndrimi për ndryshimin e mësimit pasiv ndaj atij aktiv. Mënyra aktive e organizimit të mësimit e karakterizon mësimin bashkëkohor, ndërsa mënyra pasive e karakterizon mësimin tradicional. Proçesin e të nxënit aktiv e dallojnë disa karakteristika nga mësimi i rëndomtë, ndër të cilat me rëndësi janë:

1. strukturim tjetërfare i përmbajtjes së temës, njësisë mësimore, planifikimit dhe pregatitjes për mësim;
2. trajtim gjithpërfshirës i temës mësimore;
3. kombinim qenësor i materialit teorik dhe praktik;
4. dominim i punës së individualizuar ose i punës së kombinuar individuale – grupore;
5. punë e pavarur e grupeve brenda orës mësimore për disa lëndë ose aktivitete mësimore dhe ndërrimi i roleve në orën tjetër;
6. dominimi i pozitës aktive të studentëve dhe roli drejtues e organizues i profesorit;

Çfarë është TIK?

Bota karakterizohet nga ndryshime të shumta dhe të shpejta, një pjesë e të cilave ka ardhur dhe nga zhvillimi i shpejtë i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Arsimi duhet t'u përshtatet ndryshimeve të vazhdueshme të teknologjisë, dhe t'i përdorë ato gjerësisht në procesin mësimor. Këtyre ndryshimeve arsimi duhet t'u përgjigjet, me ritme të shpejta, me zhvillime të brendshme sasiore e cilësore për të transmetuar njohuri e aftësi sistematike, koherente e të qëndrueshme te studentët, duke i reflektuar më pas këto në shoqëri për krijimin e një të ardhmeje më pozitive për të gjithë. Në epokën e zhvillimit të teknologjisë së informimit dhe komunikimit, përdorimi i kësaj teknologjie gjatë procesit mësimor është bërë një domosdoshmëri për profesorin.

Rëndësia e TIK-ut

Para shekullit të njëzetë, tre mjetet kryesore të mësimit ishin mësuesi, teksti dhe tabela e zezë. Librat, letrat, lapsat ishin mjetet themelore për të hyrë në komunikimin dhe shkëmbimin e informacionit. Shekulli i njëzetë, solli mbizoterimin e teknologjisë në arsim. Shumë individë do të argumentojnë se kjo është ende e vërtetë sot, por nuk mund të mohohet ndikimi në rritje i teknologjisë në arsim. Roli i profesorit si burimi kryesor i informimit në klasë ka ndryshuar në të mësuarit organizativ, i cili çon nxënësit apo studentët për të kërkuar informacion të pavarur. Një tipar dallues i arsimit në të gjitha nivelet në vitet e fundit është përfshirja e teknologjisë në procesin e të mësuarit Përdorimi i teknologjive të reja përbën një nga ndryshimet më dramatike në arsim. Kombinimi i kompjuterave dhe i përparësive të tjera teknologjike, si: videove me karakter didaktik, hipertekste e programeve të tjera përbën një aspekt reformues në fushën e arsimit. Në të gjitha vendet e botës janë bërë përpjekje të vazhdueshme për të inkorporuar arritjet teknologjike në mjedisin shkollor dhe për t'i pajisur ato me infrastrukturë informatike. Përdorimi i teknologjisë së komunikimit dhe të informacionit gjithnjë e më shumë në të gjitha aspektet e shoqërisë, bën të rëndësishëm futjen e TIK-ut si një lëndë me rëndësi të veçantë. Kjo bën të mundur që përdorimi produktiv dhe i besueshëm i TIK-ut të trajtohet si një mundësi thelbësore për jetën. Kjo lëndë përfshin jo vetëm mjeshtërinë e aftësive teknike, por edhe kuptueshmërinë për të zbatuar dhe aplikuar këto aftësi në jetën e përditshme, deri dhe në punësimin e studentëve, menjëherë pas përfundimit të studimeve 2-

vjecare. TIK-u u krijon mundësi studentëve të marrin pjesë dhe të angazhohen në shoqërinë bashkëkohore.

3.2 Zbatimi dhe përfshirja e risive në mësimdhënien në universitete.

TIK nënkupton të gjitha llojet e teknologjisë, të cilat përdoren për të shfrytëzuar dhe manipuluar informacionin, pra kemi një kombinim të Teknologjisë me Informacionin dhe Komunikimin. TIK në edukim kuptohet si një implementim i pajisjeve dhe mjeteve teknologjike në procesin mësimor për të regjistruar dhe përpunuar informacionin në formë digjitale. Përdorimi1 i teknologjisë në universitetet tona ka ndryshuar në mënyrë të ndjeshme këto vitet e fundit. Kështu, për të pajisur studentët me aftësitë e nevojshme teknologjike, duhet të përdorim metoda të reja të të mësuarit në krahasim me metodat e përdorura në të mësuarit tradicional. Teknologjia dhe mjetet teknologjike janë bërë pjesë e edukimit në universitet dhe synimi është të përdorim teknologjinë në klasa si një mjet që zhvillon dhe nxit më tej procesin e të mësuarit. Studentët, nga përdorimi i këtyre mjeteve të reja teknologjike kanë përfituar aftësi kompjuterike, aftësi të cilat do të mund t`i përdorin në të ardhmen në vendet e tyre të punës. Universitetet në sistemin arsimor shqiptar kanë krijuar një infrastrukturë teknologjike, e cila optimizon integrimin e teknologjisë në procesin edukativ.

Avantazhet e përdorimit të TIK në mësimdhënie

Fillimisht profesorët duhet të dallojnë qartë lidhjen midis përdorimit të TIK dhe programit të mësimdhënies. Ne duhet të dijmë ta përdorim teknologjine para se të mësojmë me ndihmën e saj. Ne përdorim teknologjinë për të mësuar të njëjtat gjëra si më përpara sepse TIK na lejon që të kemi një mësimdhënie: më të lehtë, më të shpejtë, më efikas. Shtrirje në një gamë më të gjerë materialesh njëkohësisht. Kemi të bëjmë edhe me një barazi mbi zgjedhjet e akseset e informacioneve.

3.3 Procesi i mësimdhënies sipas standarteve në universitetet shqiptare.

Në përshtatje me proçeset europiane të mësimdhënies do të ishte shumë efektive nëse për profesorët do të sugjeronim si më poshtë:

1. Ndërtoni klasa që e kanë të mësuarit e studentëve si përqendrim parësor, promovoni angazhimin e studentëve në të mësuarit dhe shmangni barrierat ndaj këtij proçesi.
2. Krijoni mjedise të personalizuara për të mësuarit, ku studentët të kenë një ndjesi të përkatësisë dhe të mbarëvajtjes.
3. Menaxhoni madhësinë e klasës, duke formuar grupe ose ekipe sipas nevojës, për të krijuar një mjedis funksional, produktiv për të mësuarit.
4. Promovoni sjellje pozitive të klasës duke trajtuar sjelljen e keqe dhe përçarëse me efektivitet dhe efikasitet.
5. Krijoni një mjedis fizik qëështë reagues ndaj nevojave tëstudentëve tuaj dhe i përshtatshëm për të lehtësuar të mësuarit në përputhje me synimet.

Nga ana tjetër, lidhur me arritjen e realizimit të objektivave iu sugjerohet:

1. Shkruajini objektivat në një format standard për të lehtësuar komunikimin midis dhe mes mësimdhënësve, studentëve dhe aktorëve të tjerë.
2. Ndërtoni kurse që përmbajnë objektiva në fusha të shumta, në mënyrë që të siguroni që sistemi ynë arsimor të formojëstudent të harmonizuar.
3. Përdorni një metodë sistematike për të shkruar objektivat për grup – mësimet …

Mësimdhënia e një ndryshimi: perspektiva dhe një vështrim i përgjithshëm

1. Krijoni skenarë në vend që të shkruani plane mësimore.
2. Krijoni situata të mësuari që angazhojnë aktivisht studentët në proçesin e të mësuarit.
3. Autorizojini studentët tuaj.

Sa i përket një mësimdhënie cilësore:

1. Duhet tëjeni në dijeni të larmisë së burimeve të të mësuarit që janëbrenda dhe jashtëuniversitetit tuaj.
2. Përzgjidhni burime të të mësuarit të cilat janë (a) të bashkërenduara me objektivat mësimore, (b) mbështetëse të veprimtarive tuaja të mësimdhëniestë të mësuarit, dhe (c) të përshtatshme për studentët tuaj në terma të dijes, përvojës së tyre të mëparshme, moshave ose niveleve të zhvillimit.
3. Lokalizoni një larmi burimesh të të mësuarit për të përmbushur nevoja të ndryshme, dhe stile të larmishme të të mësuarit tëstudentëve në klasën tuaj.
4. Bëjini burimet e të mësuarit të "vijnë në jetë", kujtohuni që jeni ju mësuesi, i cili vendos se si përdoren burimet për të krijuar mjedise nxitëse mësimore dhe i jep formë asaj që mësojnëstudentët.
5. Përdorni siç duhet dhe me efektivitet teknologjinë për të mbështetur mësimdhënien, për të shtuar mundësitë e të mësuarit dhe për të zmadhuar ndryshimet për suksesin e të mësuarit

Po ashtu sugjerime të vlefshme për mësimdhënësit do të ishin;

1. Bazojini vlerësimet tuaja kryesisht në objektivat tuaja mësimore, duke krahasuar nivelin ose llojin e objektivave me forma të përshtatshme të kontrollit.
2. Zgjidhni instrumente dhe teknika kontrolli, bazuar në qëllimin për të cilin po i kontrolloni studentët tuaj.
3. U mësoni studentëve tuaj strategji dhe teknika të vetëkontrollit dhe vetëvlerësimit.
4. Përdorni rezultatet e vlerësimeve formale për të kuptuar forcat dhe dobësitë e studentëve, dhe për të bërë përmirësime në mësimdhënien tuaj.

3.3.1 Shkollimi dhe të mësuarit në shoqëritë demokratike moderne.

Arsimimi formal gjithmonë ka pasur një qëllim të dyfishtë, domethënë të ushqejë zhvillimin e fëmijëve dhe adoleshentëve në mënyrë që ata të jenë të aftë të kenë sukses si të rritur dhe të kontribuojnë për funksionimin e qetë të shtetit dhe shoqërisë. Si pasojë, vendimet për arsimin gjithmonë kanë qenë politikisht shumë të motivuara, apo më pak të motivuara. Orientimi dhe përparësitë e arsimimit kanë qenë dhe do të vazhdojnë të formësohen nga orientimet dhe përparësitë e mbarë shoqërisë si edhe orientimi dhe

përparësitë e institucioneve të tjerëbrenda shoqërisë. Natyra politike e arsimimit ka qenë e dallueshme qysh në lashtësi. Leximi, shkrimi dhe aritmetika mësoheshin në mbretëritë e lashta të Mesopotamisë për të lehtësuar transaksionet midis prodhuesve bujqësorë dhe për t'i mundësuar mbretit t'i ndiqte dhe t'i rregullonte këto transaksione. Perandorët kinezë e përshtatnin arsimimin e mandarinëve për t'i aftësuar ata që të kishin dijet dhe njohuritë e domosdoshme për të administruar perandorinë. Ky arsimim përmbante mësimet e Konfucit, me supozimin që ato do t'i aftësonin mandarinët t'i trajtonin njerëzit dhe problemet me mençuri dhe drejtësi.

Në Athinën e lashtë, arsimimi synonte të jepte dije abstrakte dhe të zhvillonte aftësi për argumentim dhe arsyetim që do t'i aftësonin shtetasit të merrnin pjesë në vendimmarrje për të mirën e shtetit demokratik (Gardner, Kornhaber, &Ëake, 1991; Nisbett, 2003).

3.4 Sfidat me të cilat përballet sistemi arsimor, veçanërisht universitetet shqiptare.

Mësimdhënia, sfidë më vete.

Zhvillimet e një bote vazhdimisht në ndryshim, përcaktojnë qartë kërkesa të reja dhe sfiduese për sistemet tona arsimore, dhe për ata që jetojnë dhe punojnëbrenda tyre. Kërkesat për zotësi në punë në mijëvjeçarin e ri po ndryshojnë me shpejtësi. Kërkesat për profesione njohëse rutinë dhe punë krahu për shembull, po reduktohen. Në të njëjtën kohë, kërkesat për të menduar inventiv (për shembull menaxhim të kompleksitetit, vetë drejtim, kuriozitet, kreativitet, pranim të rrezikut, të menduarit e rendit të lartë dhe arsyetim të shëndoshë), mendim të ekspertëve (psh., zgjidhje e problemeve për të cilat nuk ka zgjidhje të bazuar në norma), dhe aftësi e kapacitete komplekse të komunikimit (psh., ndërveprim me të tjerët për të marrë informacion, ofrim i shpjegimeve ose bindje e tyre për implikimet për veprim) janë në rritje. Më tutje ka një nevojë të madhe për qytetarët që janë pjesëmarrës aktivë në problemet shoqërore dhe politike, dhe kanë temperamentin që nevojitet për stabilitet emocional dhe mbarëvajtje. Këto kërkesa të reja kërkojnë mënyra të reja të të menduarit për studentët dhe mësimdhënësit dhe për të mësuarit dhe mësimdhënien. Të menduarit inventiv, mendimi i ekspertëve dhe aftësitë e kapacitetet komplekse të komunikimit nuk mund të zhvillohen në një sistem në të cilin mësimdhënësit janë aktivë (p.sh., japin leksione) dhe studentët janë pasivë (p.sh., ata rrinë ulur e dëgjojnë). Studentët duhet të jenë aktivë (p.sh., duke punuar) dhe ju si mësimdhënës, duhet të siguroni strukturën, asistencën, nxitjen dhe mbështetjen për t'i bërë ata të aftë të mësojnë në të tashmen si edhe t'u jepni mundësi për të mësuarit në të ardhmen. Psikologu i famshëm belg Eric De Corte ka sugjeruar katër parime fundamentale të të mësuarit siç e kuptojmë ne atë tani.

Ata janë si vijon:

- Të mësuarit është konstruktiv. Mendimi nuk ekziston në botën e jashtme. Por mendimi formohet nga studentët ndërsa ata bashkëveprojnë me botën e jashtme.
- Të mësuarit është i vetë normuar. Studentët e vetënormuar vënë objektiva më të larta të veçanta e të afërta, e menaxhojnë mirë kohën e tyre, e monitorojnë përparimin e tyre drejt objektivave, bëjnë korrektime bazuar në monitorimin e tyre dhe këmbëngulin pavarësisht pengesave.

3.4.1 Shkencë e re e të mësuarit, teknologji të reja dhe ndryshim arsimor.

Ndryshimet në infrastrukturat teknologjike dhe metodat e mësimdhënies përgjithësisht janë më të lehta të bëhen nga sa janë ndryshimet në sferat më të mëdha, të ngarkuara më shumë politikisht të përmendura më sipër. Gjithashtu, është e pranuar përgjithësisht që ndryshimet në teknologji dhe mësimdhënie paguajnë pjesë të fitimit në terma të cilësisë së mësimdhënies dhe efektivitetit të të mësuarit. Në fakt, rëndësia e teknologjive dhe metodave të reja të mësimdhënies është element i domosdoshëm i ndërtimit të të ashtuquajturave "shoqëri të dijes". Veç kësaj, të paktën në dukje, mësuesit dhe administratorët janë në favor të këtyre ndryshimeve. Sidoqoftë, pranimi i nevojës për ndryshime të tilla, dhe realizimi i ndryshimeve janëdy gjëra të ndryshme. Realizimi dhe veçanërisht ruajtja e këtyre ndryshimeve kërkojnë nivele të larta të ekspertizës nga ana e një numri të madh njerëzish. Ato po ashtu kërkojnë koordinim midis ekspertëve nga fusha të ndryshme të lëndëve dhe disiplinave akademike. Së fundmi, ato kërkojnë angazhim afatgjatë nga udhëheqësit qeveritarë, gjë qëështë veçanërisht e vështirë në vazhdueshmërinë e ministrave dhe qeverive të ndryshme. Aktualisht ne jemi në një periudhë kalimtare të konceptimit tëtë mësuarit.

Të menduarit kritik është një koncept kompleks, i tillë që kërkon nga studentët të:

- përqendrohen në informacionin e përshtatshëm dhe të mos e përfillin informacionin e papërshtatshëm;
- skanojnë, krahasojnë dhe përzgjedhin informacionin në përputhje me objektivin ose qëllimin;
- paraqesin çfarëështë zgjedhur në një mënyrë kohezive (për shembull duke përdorur modele) dhe të bëjnë lidhjen me dijen ekzistuese;
- vlerësojnë modelet në terma të provave të disponueshme dhe që nevojiten;
- arsyetojnë me anë të deduksionit për të vlerësuar vërtetësinë dhe vlefshmërinë e modeleve dhe përfundimeve;

Pra, profesrët duhet të gjejmë mënyrat që ta ndihmojmë çdo student të zhvillohet si person, dhe si anëtar produktiv i një shoqërie demokratike në një botë gjithmonë të ndryshueshme. Kjo është një sfidë shumë më e madhe se sa përgatitja e studentëve për punë apo profesione të veçanta.

Konkluzione dhe rekomandime.

- Megjithë punën e bërë për hartimin dhe zbatimin e standardeve arsimore në Shqipëri, vihet re një dallim i konsiderueshëm midis standardeve europiane dhe atyre shqiptare, në konpcepte, në hartim, në metodologji dhe në zbatim të tyre në praktikë.
- Informacioni dhe njohja e standardeve europiane në arsim nëpërmjet botimit të materialeve, organizimit të veprimtarive të ndryshme njohëse dhe shkëmbimit të përvojave janë të pamjaftueshme.
- Strukturat dhe institucionet që trajtojnë politikat që kanë të bëjnë me konceptimin, hartimin dhe zbatimin e standardeve arsimore janë të pamjaftueshme, si në kapacitete, ashtu edhe në kualifikimet e nevojshme.
- Krijimi i institucioneve të reja për të mundësuar një menaxhim më të mirë të procesit të zbatimit të standardeve arsimore për momentin është i vështirë dhe fuqizimi i institucioneve ekzistuese që

janë të angazhuara me standardet arsimore për të qenë të afta të menaxhojnë ndryshimet e pritshme në këtë sektor, duket se nuk është përparësi e momentit.

- Brenda standardeve arsimore shqiptare, të përdorura deri tani, vihen re diferenca të mëdha, si në konceptim, ashtu edhe në mënyrën e zbatimit. Nuk ka terminologji të unifikuar dhe të pranuar zyrtarisht nga të gjithë ekspertët dhe nivelet arsimore.

Rekomandime.

- ✓ Është i domosdoshëm organizimi i punës për hartimin e standardeve të reja arsimore në Shqipëri, në përputhje me standardet europiane. Rekomandohet ngritja e një grupi pune për të rishikuar nivelet ekzistuese të standardeve dhe për të rekomanduar fushat ku duhet filluar ndërhyrja për hartimin e standardeve të reja hap pas hapi, në formën e një plani veprimi.
- ✓ Duhet të rritet shkalla e informacionit dhe e njohjes së standardeve europiane në arsim, nëpërmjet botimit të materialeve, organizimit të veprimtarive të ndryshme njohëse, shkëmbimit të përvojave me vendet europiane dhe nëpërmjet hartimit të projekteve të veçanta.
- ✓ Strukturat dhe institucionet që trajtojnë politikat që kanë të bëjnë me konceptimin, hartimin dhe zbatimin e standardeve arsimore duhet të fuqizohen, si në kapacitete, ashtu edhe në kualifikime. Vetë institucionet ose agjencitë shtetërore ose joqeveritare që merren me standardet arsimore duhet të orientojnë punën e tyre drejt europianizimit të standardeve arsimore në Shqipëri në të gjitha nivelet arsimore, duk hartuar planet e tyre të veprimit për europianizimin e standardeve
- ✓ Për shkak se brenda standardeve arsimore shqiptare të përdorura deri tani vihen re diferenca të mëdha, është e domosdoshme që të hartohet dhe miratohet një dokument zyrtar për direktivat, parimet, klasifikimin, procedurat etj, të hartimit të Standardeve Arsimore Shqiptare, mbështetur në linjat kryesore që ofron ky dokument dhe në direktivat e në përvojën europiane.
- ✓ Eliminimi i dukurisë së zbatimit të standardeve arsimore të dyfishta, për arsimin publik dhe atë jopublik, paraqet si domsodoshmëri hartimin e "Manualit të Akreditimit të Ofruesve të Arsimit", referuar standardeve kryesore (të personelit, infrastrukturës, kurikulës etj.).
- ✓ Garantimit të cilësisë në arsim, që kryejnë funksione të akreditimit, të vlerësimit, të monitorimit, të inspektimit, të certifikimit etj., për të krijuar një kornizë unike kombëtare në këto drejtime, duke përdorur standardet arsimore si nyje lidhëse.
- ✓ Është i domosdoshëm rinovimi i Legjislacionit arsimor, me elementet përkatëse të standardeve, parë në konteksin europian të standardeve, për ta përshtatur me ndryshimet që vijnë si pasojë e zgjerimit të shkallës së veprimit të standardeve arsimore në përvojën e BE-së, pasi është i pamjaftueshëm dhe i vonuar në kohë. Rekomandohet ngritja e një grupi pune për të identifikuar ndryshimet e nevojshme.

Bibliografia:

1. Alexander, P.A. and Murphy, P.K. (1998). The research base for APA's learnercentered psychological principles. In N.M. Lambert and B.L. McCombs (Eds.), Hoë students learn. Ëashington, DC: APA

2. Antić, S., Ivić, I. & Pešikan, A. (Eds.) (2007). Student u središtu nastave (Student in the center of teaching). Belgrade: Education forum and Faculty of Agriculture.
3. Autor, D. H., Levy, F., and Murname, R. J. (2001). The skill content of recent technological change: An empirical exploration. Cambridge, MA: National Bureau of Economic Research. http://ëëë.nber.org/ papers/ë8337.pdf?new_window=1
4. DeCorte, E. (2007). Learning from instruction: The case of mathematics. Learning Inquiry, 1: 19–30. http://competentclassroom.com/ pdfs/ErikDeCorte.pdf
5. Elias, M.J. (2006). The connection betëeen academic and social-emotional learning. In M. J. Elias & H. Arnold (Eds.), The educator's guide to emotional intelligence and academic achievement. Thousand Oaks, CA: Corëin Press.
6. International Information and Communication Technologies (ICT) Literacy Panel. (2002). Digital Transformation: A Frameëork for ICT Literacy. Princeton, NJ: Educational Testing Services (ETS). http:// www.ets.org/research/ictliteracy/ index.html.
7. Ivić, I., Pešikan, A., & Antić, S. (2003). Active Learning 2. Belgrade Institute for Psychology, Faculty of Psychology.
8. Lemke, C., Coughlin, E., Thadani, V., & Martin, C. (2003). En-Gauge 21st Century Skills – Literacy in the Digital Age: http://ëëë. metiri.com
9. Prince, M. (2004). Does active learning ëork? A revieë of the research. Journal of Engineering Education, 93(3), 223–231
10. U. S. Department of Labor. (1999). Futureëork: Trends and challenges for ëork in the 21st Century. Ëashington, DC: Author. http://ëëë.dol.gov/asp/ programs/history/herman/reports/ futureëork/report.htm.
11. Ëirth, K. R. & Perkins, D. (2009). Learning to learn. http://ëëë. macalester.edu/geology/ëirth/ CourseMaterials.html
12. Zeigarnik, B.V. (1967). On fi nished and unfi nished tasks. In Ë. D. Ellis (Ed.), A sourcebook of Gestalt psychology. Neë York: Humanities Press
13. Standards and Guidelines for Quality Assurance in the European Higher Education Area. European Association for Quality Assurance in Higher Education, 2005, Helsinki;
14. EFPA Declaration 2006. The European standards of education and training in professional psychology – EuroPsy
15. David Frankfurter, January 1, 2004. European education standards.
16. CEDEFOP. Quality standards and norms in European VET. Sept. 2003.
17. EURYDICE. Quality Assurance in Teacher Education in Europe.
18. Eurydice, 2004. Evaluation of Schools providing Compulsory Education in Europe
19. Raising education standards in schools. 2005. Organization for Security and Co-operation in Europe. Mission to Bosnia and Herzegovina;
20. https://ëëë.researchgate.net/publication/268387095_STANDARTET_ARSIMORE_NE_BASHKIMIN_EUROPIAN_DHE_NE_SHQIPERI_Education_standards_in_EU_and_Albania/link/5469f2200cf20dedafd2ee9c/doënload
21. http://Webquest.org/ [WebQuests from the San Diego State University Department of Educational Technology]

MODELET MË TË SUKSESSHME ARSIMORE NË EUROPË DHE KRAHASIMI ME MODELIN ARSIMOR SHQIPTAR.

MsC. Gentiana Boshku

genta_jm@hotmail.com

Abstrakt

Studenti ka nevojë për një mori kapacitetesh dhe kompetencash për të funksionuar në shoqërinë e së ardhmes, kështu që ata duhet të dinë se si të përshtaten me një mjedis në ndryshim që evoluon me shpejtësi. Ai gjithashtu duhet të punojë si ekip, të jetë krijues, të dijë të zgjidhë problemet, të marrë vendime dhe të përballet me to. Kjo do të thotë që ata duhet të kenë aftësinë për të vepruar dhe zgjidhur të gjitha problemet që lindin, ashtu siç e kërkon shoqëria e sotme.

Modeli i arsimit ka ndryshuar nga të qenit mësimdhënës në klasa me në qendër nxënësin/studentin. Nuk ka të bëjë më me marrjen e njohurive nga studentët që i përgatisin ata për mjedisin e punës, por për jetën. Prandaj, ata duhet të trajnohen për vetë-mësim, zgjedhje me mjete dhe rrugë mësimore, dhe kërkimin domethënës të njohurive. Në këtë studim paraqiten të dhëna krahasimore për sistemet arsimore të disa vendeve të zhvilluara europiane dhe Shqipërisë duke patur parasysh disa faktorë si zhvillimi i sistemit arsimor për publikun, cilësia e arsimit bazë dhe të lartë dhe shkalla e studentëve që ndjekin universitetin. Të dhënat janë bazuar nëklasifikimin e "Best 20 education systems in the world" (20 sistemet arsimore më të mira në botë), faqet zyrtare të sistemit të edukimit për secilin shtet si dhe testet e Pisa.

Keywords*:* *education, quality, development, Europe, Albania*

Abstract

The student needs a multitude of capacities and competences to function in the society of the future, so they must know how to adapt to a rapidly evolving changing environment. He must also work as a team, be creative, know how to solve problems, make decisions and deal with them. This means that they must have the ability to act and solve all the problems that arise, as today's society requires.

The model of education has changed from being teacher-centered to student-centered classrooms. It is no longer about students getting knowledge that prepares them for the work environment, but for life. Therefore, they should be trained in self-learning, choice in learning tools and pathways, and meaningful pursuit of knowledge. This study presents comparative data on the education systems of some developed European countries and Albania, taking into account several factors such as the development of the education system for the public, the quality of basic and higher education and the rate of students attending university. The data are based on the classification of the "Best 20 education systems in the world", the official websites of the education system for each country, as well as the Pisa tests.

Keywords: *education, quality, development, Europe, Albania*

1.Hyrje.

Në ndryshim nga klasat tradicionale, Dewey mendonte se shkollat dhe klasat duhet të jenë përfaqësuese të situatave të jetës reale, duke i lejuar fëmijët të marrin pjesë në aktivitetet e të mësuarit në mënyrë të ndërsjellë dhe fleksibël në një sërë mjedisesh sociale (Dewey, 1938, f.19; Gutek, 2014). Dewey mendonte se edukimi efektiv erdhi kryesisht përmes ndërveprimeve sociale dhe se mjedisi i shkollës duhet të konsiderohet një institucion social (Flinders & Thornton, 2013, f. 77). Ai e konsideroi edukimin si një "proces të të jetuarit dhe jo një përgatitje për të jetuar në të ardhmen" (Flinders & Thornton, 2013, f.35; Gutek, 2014).Në klasat me në qendër nxënësin, mund të shihet në veprim pjesa më e madhe e teorisë së të mësuarit social të John Dewey dhe besimeve edukative. Ai e shikonte klasën si një entitet shoqëror që fëmijët të mësojnë dhe t'i zgjidhin problemet së bashku si një komunitet. Në këto klasa fëmijët shihen si individë unikë; studentët mund të gjenden të zënë në punë duke ndërtuar njohuritë e tyre përmes kuptimit personal, në vend të njohurive të imponuara nga mësuesi dhe aktiviteteve të drejtuara nga mësuesi. Fëmijët duhet të shihen duke mësuar e duke u formuar në këto klasa dhe ata do të zgjidhin problemet përmes qasjeve praktike. Kur mësuesit planifikojnë mësimdhënie, interesat e nxënësve duhet të merren parasysh dhe lëndët kurrikulare do të integrohen me theks në të nxënit me projekte. Përvoja edukative përfshin rritjen intelektuale, sociale, emocionale, fizike dhe shpirtërore të fëmijës, jo vetëm rritjen akademike (Schiro, f. 17; 2013).

2.Vendet me sistemin më të mirë të arsimit në europë dhe botë.

Finlanda renditet si shteti me sistemin arsimor më të mirë në Europë dhe në botë. Ajo ofron arsim falas për qytetarët. Ajo ka qenë një performuese e lartë në çdo program me Anketa Ndërkombëtare të Vlerësimit të Studentëve. Finlanda ndjek kërkimet dhe filozofët e arsimit amerikan. (P.sh.: John Dewey), dhe frymëzohet prej tyre. Dewey ishte një besimtar i patundur në grupet e njerëzve që mblidheshin së bashku për të zgjidhur problemet në një mënyrë paqësore, përmes një procesi "diskutimi, debati dhe vendimmarrjeje" (Gutek, 2014, f. 78). Besimet e Dewey për demokracinë, komunitetin dhe zgjidhjen e problemeve, udhëhoqën zhvillimi i filozofive të tij sociale dhe arsimore (Theobald, 2009, f137). Edukimi progresiv, siç përshkruhet nga Dewey, duhet të përfshijë përvoja të të nxënit tërheqës nga ana shoqërore që janë të përshtatshme për zhvillimin e fëmijëve (Dewey, 1938, f. 37).

Po cilat janë parimet kryesore të sistemin arsimor të Finlandës? Ka disa fakte rreth kësaj:

- **a.** Ata kanë më pak ditë shkollore (190 ditë në vit)
- **b.** Ekzistojnë disa parime thelbësore që qëndrojnë në themel të sistemit arsimor të Finlandës
- **c.** Studentët janë të lirë të zgjedhin rrugën e tyre arsimore

Sistemi i edukimit të hershëm të Finlandës është i vendosur rreth konceptit të të mësuarit përmes lojës. Deri në moshën 6 vjeçare, nxënësve nuk u kërkohet të ndjekin shkollat.

Ata ofrojnë arsimin bazë kur fëmija mbush 7 vjeç. Për nëntë vitet e ardhshme ata ndjekin një strukturë të vetme arsimimi. Ata marrin hapa të veçantë për të rishikuar dhe rinovuar kurrikulën e tyre për të përmbushur nevojat e çdo individi.

Agjencia Kombëtare Finlandeze për Arsimin promovon vetëvlerësimin si për mësuesit ashtu edhe për shkollat për t'i ndihmuar ata t'i përmirësojnë ato. Gjithashtu, Finlanda nuk përfshin testimin e

standardizuar kombëtar, por ato bëjnë vlerësime për testimin e rezultateve të të nxënit. Arsimi i mesëm i lartë ndahet në dy kategori: i përgjithshëm dhe profesional.

Në arsimin e përgjithshëm, studentët kanë të gjithë lirinë për të zgjedhur oraret e tyre të studimit dhe në fund, ata duhet të ndjekin një provim mature. Dhe këto rezultate merren parasysh për aplikimet e tyre në kolegj.

Arsimi profesional është i fokusuar në punë, ndërsa mësimi në shkollë dhe praktika shkojnë paralelisht. Pas kësaj, studentët arrijnë kualifikime të bazuara në kompetenca. Arsimi i mesëm i lartë është gjithashtu plotësisht falas.

Kolegjet e Finlandës ndahen në dy grupe: Universitete të Shkencave të Aplikuara dhe universitetet e tjera. Universitetet në Finlandë fokusohen në shkencat e aplikuara, ndërsa Universitetet e shkencave të aplikuara theksojnë aplikimet praktike.

Danimarka është në vendin e dytë në Europë dhe në vendin e 4-të në botë për sistemin më të mirë arsimor. Treguesi që ndihmoi Danimarkën të ngjitej në vendin e 4-të është – rritja e raportit mësues-nxënës për shkollat e mesme dhe fillore. Viti shkollor në Danimarkë përbëhet nga 200 ditë të vitit (https://www.edsys.in/best-education-system-in-the-world/)

Fëmijët që dëshirojnë të studiojnë në universitet duhet të zgjedhin një nga katër programet arsimore që janë: shkencat natyrore ose sociale (kjo ka një kohëzgjatje prej dy vjetësh); biznes dhe ekonomi; shkenca ekzakte dhe/ose një program të gjerë arsimor i cili mbulon lëndë të ndryshme

Ekzistojnë pesë lloje të institucioneve të arsimit të lartë në Danimarkë:

- universitetet
- kolegjet universitare (për diploma të akademisë profesionale dhe diploma bachelor profesional)
- institucionet e arsimit të lartë artistik
- shkollat e arsimit dhe trajnimit detar
- akademitë e biznesit

Diplomë e Akademisë Profesionale janë diploma specifike universitare që fokusohen në mësimin e aplikuar dhe zhvillimin e aftësive profesionale. Përveç ndjekjes së leksioneve standarde universitare, studentët gjithashtu bashkëpunojnë me biznese dhe industri dhe zhvillojnë një projekt përfundimtar për vlerësim. Këto diploma kërkojnë dy vjet ose dy vjet e gjysmë për të përfunduar dhe akreditуar studentët me 120 ECTS.

Kjo diplomë nuk është e barabartë me nivelin bachelor. Sidoqoftë, ato mund të korrespondojnë me një diplomë bachelor nëse studentët marrin një vit e gjysmë shtesë studimi të njohur si diploma shtesë.

Për sa i përket diplomave Bachelor, ekzistojnë dy lloje të diplomave bachelor që mund të merrni në Danimarkë: një diplomë universitare dhe një diplomë bachelor profesionale. E para është programi i përbashkët trevjeçar universitar prej 180 ECTS që ndjek formatin tradicional akademik.

Këto fokusohen në një deri në dy lëndë, kryesisht bazohen në kërkime dhe teori, dhe duhen tre vjet për t'u përfunduar. Diploma bachelor profesional është e orientuar drejt hyrjes në tregun e punës. Ju e merrni këtë diplomë pasi të keni përfunduar një program AP me një diplomë shtesë siç shpjegohet më sipër. Kjo ofron njohuri si teorike ashtu edhe praktike, si dhe u ofron studentëve mundësinë për t'u vendosur në tregun e punës për përvojë profesionale të dorës së parë. (https://www.internations.org/denmark-expats/guide/education).

Norvegjia është e treta në europë dhe e gjashta në botë në sistemin arsimor. Raporti i saj mësues-nxënës, atëherë është "afërsisht 1 mësues me 10 nxënës" (https://www.edsys.in/best-education-system-in-the-world/). Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët mbulon fëmijët e moshës 6 deri në 15 vjeç ose klasat 1 deri në 10. Arsimi i mesëm i lartë zakonisht ofron tre vjet arsim të përgjithshëm ose katër vjet trajnim profesional pas programit të detyrueshëm 10-vjeçar. Norma për trajnimin e praktikës është dy vjet trajnim profesional në arsimin e mesëm të lartë pasuar nga një ose dy vjet trajnim praktik në industri. Programet e arsimit të lartë profesional janë pas shkollës së mesme, por nuk përkufizohen si arsim i lartë. Ato zgjasin nga gjashtë muaj deri në maksimum dy vjet. Arsimi i lartë bazohet në një model 3+2+3; me fjalë të tjera një diplomë bachelor trevjeçare, një diplomë master dy vjeçare dhe një program doktorature trevjeçare (https://www.lifeinnorway.net/education-in-norway/)

Mbretëria e Bashkuar është e 4-ta në europë dhe mund të përmirësohet nëse qeveria i trajton me maturi situatat aktuale, si dhënia e pagave më të mira për mësuesit, mbështetja e shtuar në klasë për studentët dhe pajisja me teknologji moderne arsimore për secilën klasë (https://www.edsys.in/best-education-system-in-the-world/).Sistemi arsimor në MB ndahet në katër pjesë kryesore, arsimi fillor, arsimi i mesëm, arsimi i mesëm i lartë dhe arsimi i lartë. Fëmijët në MB duhet të ndjekin ligjërisht arsimin fillor dhe të mesëm, i cili zgjat nga mosha rreth 5 vjeç deri në moshën 16 vjeç. Pasi një student të përfundojë arsimin e mesëm, ai ka mundësinë të vazhdojë në arsimin e mëtejshëm. Studentët në Mbretërinë e Bashkuar që planifikojnë të shkojnë në kolegj ose universitet duhet të përfundojnë arsimin e mëtejshëm (https://www.internationalstudent.com/study_uk/education_system/).

Ashtu si vendet e tjera nordike, Finlanda, Norvegjia dhe Danimarka, Suedia ka performuar vërtet mirë për të mbajtur ritmin.Progresi i saj në fushën e arsimit ka qenë mbresëlënës nga viti 2015 deri në vitin 2018 (https://www.edsys.in/best-education-system-in-the-world/). Ligji aktual vë më shumë fokus në shëndetin e nxënësve dhe mësuesve dhe lejon më shumë liri zgjedhjeje se më parë. Që nga 1 dhjetori 2013, kërkohet certifikim profesional për mësuesit e shkollave dhe parashkollorëve me kontrata të përhershme. Vendimi synonte ngritjen e statusit të profesionit të mësuesit, mbështetjen e zhvillimit profesional dhe në këtë mënyrë rritjen e cilësisë në arsim. Ministria punon për çështje që përfshijnë performancën e shkollës, kushtet për mësuesit dhe financimin e studimeve. Inspektorati Suedez i Shkollave mbikëqyr dhe shqyrton cilësinë e shkollave në të gjithë vendin nëpërmjet inspektimeve të rregullta. Inspektorati monitoron respektimin e Ligjit për Arsimin. Agjencia Kombëtare për Arsimin ofron informacion rreth arsimit, promovon mirëkuptimin dhe administron fondet dhe grantet publike.

Agjencia Kombëtare Suedeze për Arsimin e Lartë Profesional analizon kërkesat e tregut të punës për arsimimin e fuqisë punëtore, vendos se cilat programe do të përfshihen në arsimin e lartë profesional dhe cakton fonde publike për ofruesit e arsimit. Agjencia gjithashtu vlerëson dhe inspekton cilësinë dhe rezultatet e këtij edukimi (https://sweden.se/life/society/the-swedish-school-system)

Me sistemin arsimor më kompleks, duke përfshirë tre komunitete të ndryshme si flamande, gjermane dhe franceze, Belgjika shkëlqen në vendin e 5 në Europë dhe të 11-të në botë. Gjatë anketave vjetore, ajo siguroi vendin e 4-të dhe të 9-të për raportin mësues-nxënës dhe vendin e 5-të për rritjen e regjistrimit të moshës fillore dhe të mesme të nxënësve në shkollë (https://www.edsys.in/best-education-system-in-the-world/). Shkolla e mesme: ka 4 mundësi: e përgjithshme, teknike, artistike dhe profesionale (https://expatsinbrussels.be/en/education/the-school-system-in-belgium)

Gjermania është e njohur për drejtësinë e saj sociale dhe ekonomike në mbarë botën. Vendi ka punuar shumë për të arritur në top 10, por nuk mundi për shkak të mungesës së përmirësimit të disa treguesve në dy vitet e fundit.Aktualisht, vendi po lufton për të mbajtur një pozicion në top 10 (https://www.edsys.in/best-education-system-in-the-world/). Sistemi shkollor gjerman ndahet në 5 nivele: Edukimi në fëmijërinë e hershme, Shkolle fillore, Arsimi i mesëm, Arsimi terciar, Edukimi në vazhdim. Në Gjermani ekzistojnë dy sisteme arsimore të shkollave fillore. Në një sistem paraarsimor 5-ditor të javës shkollore, ka 188 ditë mësimore/në vit. Në sistemin parashkollor 6-ditor të javës shkollore, ka 208 ditë mësimore/në vit, duke përfshirë edhe mësimet gjatë 2 të shtunave/çdo muaj. Gjimnazi u ofron të rinjve njohuri, ekspertizë dhe njohuri gjithëpërfshirëse për gjuhën gjermane dhe të huaj, si dhe matematikën. Këto institucione gjithashtu u mësojnë të rinjve vetë-zhvillimin, përgjegjësinë sociale dhe pjesëmarrjen në shoqërinë demokratike. Gjithashtu, ata informohen dhe udhëzohen në lidhje me institucionet akademike dhe kërkesat e tyre për pranim, sferën profesionale dhe kërkesat e aksesit, së bashku me perspektivën e punësimit në profesione të ndryshme.

Arsimi i mesëm i lartë i ofruar gjatë 2 viteve me kohë të plotë nga shkollat e mesme profesionale gjermane përgatit të rinjtë për të marrë një kualifikim profesional për një punë të aftë si staf i kualifikuar. Një kualifikim i tillë u lejon atyre të gjejnë një punë në një profesion që kërkon një kualifikim formal. Në të njëjtën kohë, një kualifikim i tillë mund të çojë në një kualifikim për hyrje në universitet, nëse nxënësi tregon një zotërim të mirë të një gjuhe të dytë të huaj. Gjithashtu, me një kualifikim të tillë, nxënësi mund të studiojë në një universitet teknik, por para kësaj, ata duhet të studiojnë për 2 vjet derisa të marrin një certifikatë maturimi (https://www.studying-in-germany.org/german-educationsystem/#:~:text=All%20Germans%20are%20obliged%20to,for%20other%20general%20education%20school.)

3.Modeli arsimor i Shqipërisë.

Sistemi arsimor në Shqipëri përfshin këto nivele:

1. Arsimi parashkollor (3-6 vjeç)
2. Arsimi fillor
3. Arsimi i mesëm i ulët (*9-vjeçarja*)
4. Arsimi i mesëm i lartë (*gjimnazi*)
5. Arsimi universitar

Arsimi i mesëm i lartë përfshin shkolla profesionale dhe gjimnaze të përgjithshme. Gjimnazi i përgjithshëm është 3 vjet dhe vetëm në vitin e tretë ka një ndarje të nxënësve sipas preferencave ku përfshihen disa variante të profilit natyror dhe disa variante të profilit shoqëror, nxënësit mund të zgjedhin njërin prej varianteve. Nxënësit e arsimit parauniversitar kanë një ulje të vazhdueshme në numër në të gjithë programet, ulje e cila vitin e fundit arrin 13 %, krahasuar me nxënësit e arsimit parauniversitar 2016-17. Ulje në numrin e studentëve vihen re edhe në arsimin e lartë, me 12.5 % më pak, krahasuar me vitin 2016-17 (Ministria e Arsimit, Rinisë dhe sporteve, 2021). Një tregues i rëndësishëm në arsim, është raporti i nxënësve ose studentëve për 1000 banorë. Këto raporte paraqiten në rënie për disa arsye. Një arsye kryesore është që studentët por edhe nxënësit shqiptarë preferojnë të studiojnë jashtë vendit, por ndikon gjithashtu edhe plakja e popullsisë së vendit.

Arsimi luan një rol shumë të rëndësishëm në krijimin e kapitalit njerëzor dhe është një nga premisat për zhvillimin ekonomik dhe social të një vendi. Në universitetet shqiptare aplikohen programet e Bolonjës, standard i BE-së për arsimin e lartë. Nga krahasimi i të diplomuarve në arsimin e lartë për katër vitet e fundit, midis fushave të gjera të studimit, rezulton se numri më i madh i tyre i përket fushës së "Biznesit, administrimit dhe ligjit". Vendin e dytë e zë fusha "Shëndet dhe mirëqenie", megjithëse numri i të diplomuarve në këtë fushë është afërsisht sa ngjysma e atyre të vendit të pare (Ministria e Arsimit, Rinisë dhe sporteve, 2021).

Vitet e fundit në arsimin e lartë në shqipëri është aplikuar akreditimi nga agjensi të huaja të cilat veprojnë në Europë. Informacioni dhe njohja e standardeve europiane në arsim nëpërmjet botimit të materialeve, organizimit të veprimtarive të ndryshme njohëse dhe shkëmbimit të përvojave janë të pamjaftueshme. (Hoxha Edmond R. (2008). Standartet Arsimore në Bashkimin Europian dhe në Shqipëri, f. 11)

Konkluzione.

Modeli shqiptar i organizimit të sistemit arsimor është pak a shumë i ngjashëm me modelet e suksesshme europiane për sai përket ndarjes dhe klasifikimit në marrjen e njohurive, por ka dallime në:

- Raportin nxënës - mësues në Shqipëri është më i lartë sesa modelet e suksesshme europiane ku rezulton 1 mësues me 9-10 nxënës në arsimin parauniversitar.
- Kjo përbën një disavantazh për edukimin në shqipëri pasi ngarkesa më e lartë redukton mundësinë e efikasitetit në mësimdhënie dhe mësimnxënie
- Në përgjithësi mbarimi i arsimit të mesëm të lartë në modelet e marra në studim përkon me moshën 19 vjec ndërsa në Shqipëri përkon me moshën 17-18 vjec. Kjo paraqet disavantazh për sa i përket studimeve universitare pasi një moshë më e vogël ka më pak aftësi në përvetësimin e njohurive të thelluara në universitet
- Ngarkesa lëndore dhe provimet shtetërore apo kombëtare të zhvilluara në arsimin parauniversitar në përgjithësi në Shqipëri ka një ngarkesë më të lartë. Në Shqipëri zhvillohen provime në klasat e 5, 9 dhe 12, gjë që nuk ndodh thuajse në asnjërin model të studiuar më lartë. Gjithashtu numri i lëndëve që testohen në sistemin arsimor Shqipëri është përsëri më i lartë se në modelet e studiuara më sipër.
- Kualifikimi i mësuesve dhe përzgjedhja e tyre në disa raste në Shqipëri mbetet një problem akoma, ndërkohë që në disa nga vendet e zhvilluara ka agjensi të posacme që meret me kualifikimin e mësuesve.
- Përqëndrimi dhe edukimi më shumë teorik sesa praktik në disa lëndë gjithashtu është një disavantazh në sistemin arsimor shqiptar
- Në arsimin e lartë mbetet problem numri i pakët i projekteve dhe praktikave ku shpesh herë janë vetëm formale

- Akreditimi i bazuar vetëm në bazën materiale dhe kurrikulare apo zbatimin e projekteve e bashkëpunimeve është nevojshëm të zhvillohet më tej edhe në aspektin e mësimdhënies, testimit të aftësisë së studentëve për përvetësimin e njohurive apo për përballjen me tregun e punës.

- Nxitja e studimeve në drejtimet ku ka nevojë tregu i punës dhe parashikimi e rregullimi i kuotave sipas nevojave të tregut të punës në mënyrë që mos të krijohet mbingarkesë në drejtime të caktuara dhe mangësi në disa drejtime tjera të tregut të punës.

Literatura:

-Dewey, John. Experience & Education. New York, NY: Kappa Delta Pi, 1938.

-Dewey, J. (2013). My pedagogic creed. In D. J. Flinders, & S. J. Thornton (Eds.), The curriculum studies reader. New York, NY: Routledge.

-Friesen, J. (2014) *Philosophical, Ideological, and Theoretical Perspectives on Education*, Gerald L. Gutek (2014). 2nd Ed. Boston, MA: Pearson.

-Hoxha Edmond R. (2008). Standartet Arsimore në Bashkimin Europian dhe në Shqipëri (Education standards in EU and Albania).

-Michael Stephen Schrio, Curriculum Theory, Sage, 2 Edition, 2013.

-https://expatsinbrussels.be/en/education/the-school-system-in-belgium.

-https://www.edsys.in/best-education-system-in-the-world/

-(https://www.internations.org/denmark-expats/guide/education)

-https://www.internationalstudent.com/study_uk/education_system/

-https://www.lifeinnorway.net/education-in-norway/

-https://sweden.se/life/society/the-swedish-school-system.

-https://www.studying-in-germany.org/german educationsystem/#:~:text=All%20Germans%20are%20obliged%20to,for%20other%20general%20education%20school

ORIENTIMI GJEOSTRATEGJIK I SHQIPËRISË NËN TRYSNINË E FUQIVE JOPERËNDIMORE (TURQI-RUSI-KINË).

Erlis Hoxha,

Kolegji Universitar i Biznesit

erlishoxha@gmail.com;

Abstrakti

Pozicioni gjeografik i Shqipërisë, midis Lindjes dhe Perëndimit, e bën atë dukshëm të cenueshëm ndaj ndikimeve dhe implikimeve të Fuqive të Mëdha perëndimore, si SHBA, BE, por edhe karshi fuqive joperëndimore, si Turqia, Rusia dhe Kina. Qëllimi i këtij studimi është vlerësimi i orientimit gjeostrategjik të Shqipërisë nën peshën e ndikimit të vendeve joperëndimore, duke shqyrtuar dimensionet ekonomike, politike dhe social-kulturore.

Pyetja kërkimore: A është zhvendosur orientimi gjeostrategjik properëndimor i Shqipërisë nën ndikimin e vendeve joperëndimore?

Hipoteza: Ndikimi i Turqisë, Rusisë dhe Kinës, nuk e ka zhvendosur orientimin gjeostrategjik properëndimor të Shqipërisë.

Metodologjia në këtë studimi kombinon qasjen sasiore dhe atë cilësore. Instrumentet e ardhur në ndihmë janë:

a) Pyetësorët vetë-raportues, të cilët u shpërndanë me një kampionim prej 500 të rinjsh, anëtarë të forumeve politike të partive kryesore në vend, si dhe midis studentëve nga universitete të ndryshme në vend.

b) Pyetësorët cilësorë, të cilët iu dërguan 6 ekspertëve të përzgjedhur.

Rezultatet e studimit treguan, se, përgjithësisht, të dyja grupet e mësipërme bashkohen në idenë se influenca e vendeve joperëndimore: Rusi, Turqi dhe Kinë, shfaqet në të tri dimensionet: ekonomike, politike dhe kulturore, gjithsesi ajo nuk ka arritur të zhvendosë orientimin gjeostrategjik properëndimor të Shqipërisë. Nga të tri vendet e marra në analizë, Turqia perceptohet si vendi me influencën më të madhe ekonomike, politike dhe kulturore, në raport me dy vendet e tjera: Rusi, Kinë, si dhe me SHBA-BE, ndërsa vendi me influencën penguese më të madhe në dimensionin politik të Shqipërisë perceptohet Rusia. Sa i takon Kinës, influenca e saj më e madhe perceptohet kryesisht në dimensionin ekonomik, pavarësisht se efekti i saj në këtë dimension nuk është shumë nevralgjik.

***Fjalë kyçe**: gjeopolitikë, fuqitë joperëndimore, influencë, politikë e jashtme, orientim strategjik*

1.Konteksti i studimit.

Ky studim ofron një analizë të politikës së jashtme të Shqipërisë, me qëllim matjen e perceptimit të ndikimit të vendeve joperëndimore përballë ndikimit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Evropian.

Periudha kohore e marrë në analizë është 10-vjeçari i fundit: Përzgjedhja e kësaj periudhe kohore përkon me disa zhvillime të rëndësishme në rajonin e Ballkanit Perëndimor, ku në vitin 2009, Shqipëria dhe Kroacia do të bëheshin vende anëtare me të drejta të plota në Aleancën e Atlantikut të Veriut - NATO. Në aspektin e brendshëm, ky zhvillim do të konfirmonte orientimin gjeostrategjik properëndimor të Shqipërisë, ndërsa në rrafsh rajonal, dëshmoi edhe kahjen e vendeve të tjera të rajonit, si Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut, të cilat shfaqën vullnetin për t'iu bashkuar kësaj Aleance, por edhe interesin për integrimin e tyre në Bashkimin Evropian.(Garcia 2009).

Kjo qasje gjeopolitikee vendeve të Ballkanit Perëndimor, nuk mund të kalonte pa "tërhequr vëmendjen" e Rusisë, si një vend me interes të theksuar për zhvillimet në këtë rajon.

Me rimëkëmbjen e ekonomisë, Rusia filloi të rikuperojë edhe statusin e saj në marrëdhëniet ndërkombëtare, duke u shfaqur si fuqi globale e dorës së parë, për të rifituar lavdinë e dikurshme, sigurisht përballë rivalit të përhershëm - Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në këtë kontekst, këto zhvillime në Ballkanin Perëndimor do të shqetësonin Rusinë në "ambicien" e saj për të pasur me çdo kusht një rol ndikues në këtë rajon **(**Bugajski, 2020).

Nga ana tjetër, dy fuqi të tjera joperëndimore, si Turqia dhe më pas Kina, kanë shpalosur qëllimet e tyre për këtë rajon nëpërmjet investimeve në sektorë strategjikë: sistemin bankar, në telekomunikacion, në transport dhe në energjetikë. Turqia, ndryshe nga Kina dhe Rusia, identifikohet me një influencë më konkrete në Ballkanin Perëndimor, duke investuar në mënyrë strategjike në sektorët kyçë, të sipërpërmendur. Turqia, në raport me dy vendet e tjera, ka një avantazh më të madh në këtë rajon, që lidhet me shkaqe historike, pasi është fakt i njohur historik, që Ballkani ka qenë për shekuj me radhë nën pushtimin otoman. Për rrjedhojë, kjo trashëgimi politiko - kulturore ka lënë gjurmët e saj.

Nga ana tjetër, pavarësisht orientimit gjeostrategjik proevropian të Shqipërisë dhe partneritetit strategjik me SHBA-në, Rusia po bën të gjitha përpjekjet e mundshme për ta frenuar influencën e Perëndimit në Ballkanin Perëndimor.(Bieri, 2015).

1.2 Qëllimi i studimit dhe pyetjet kërkimore.

Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë orientimin gjeostrategjik të Shqipërisë në 10-vjeçarin e fundit, duke u fokusuar kryesisht në ndikimin e fuqive joperëndimore Rusisë, Turqisë dhe Kinës. Përcaktimi i këtij qëllimi lidhet me faktin se pas viteve "90, kursi i Shqipërisë në politikën e jashtme ishte euroatlantik, por në fund të viteve 2000, në rajonin e Ballkanit Perëndimor, fillon një fazë e re e ndikimeve të fuqive joperëdimore, sic janë, Rusia, Turqia dhe më pas Kina.

Rritja e vazhdueshme e prezencës së tyre në këtë rajon, vë në diskutim vijimësinë e orientimit gjeostrategjik properëndimor të Shqipërisë.

Në funksion të përmbushjes së këtij qëllimi, objektivat kryesore janë:

Analizimi dhe identifikimi i ndikimit të fuqive joperëndimore me fokus në dimensionet: ekonomike, politike dhe social-kulturore.

a) Vlerësimi i prezencës dhe ndikimit të vendeve aleate të Shqipërisë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Evropian.
b) Matja e perceptimit të ndikimit të këtyre vendeve nga dy grupe të ndryshme, ekspertë të fushës dhe studentë.

***Pyetja kërkimore**: A është zhvendosur orientimi gjeostrategjik properëndimor i Shqipërisë nën ndikimin e vendeve joperëndimore?*

***Hipoteza:** Ndikimi i Turqisë, Rusisë dhe Kinës nuk e ka zhvendosur orientimin gjeostrategjik properëndimor të Shqipërisë.*

Politika e Jashtme e Shqipërisë.

2. Politika e jashtme dhe diplomacia shqiptare.

Hyrje

Për një kohë të gjatë, shqiptarët kanë vuajtur sistemin komunist, i cili do t'i privonte shtetasit e saj nga liritë dhe të drejtat themelore të njeriut. Vendi ynë mbeti i izoluar nga bota për plot 45-vjet, nën perden e hekurt. (Human Rights Watch, 1996).

Kjo qasje e nomenklaturës komuniste do të sillte pasoja tepër të rënda brenda dhe jashtë vendit. Në aspektin e brendshëm, në fund të viteve '80-të, ekonomia vendase do të binte në kolaps nga pamundësia për t'iu përgjigjur kërkesave dhe nevojave bazike të shtetasve të saj. Nga ana tjetër, në aspektin politik dhe të ndërveprimit me vendet e tjera, Shqipëria mbeti e izoluar si asnjë vend tjetër në këtë rajon, pa asnjë komunikim apo marrëdhënie shtetërore me vendet e tjera, sikundër dhe me organizmat e huaja ndërkombëtare. Pasojat e këtij izolimi, dhe tejkalimi i tyre, do të shndërroheshin në sfidat më të mëdha të qeverive të mëpasshme, të cilat pasuan lidershipin e fundit komunist, në fund të viteve '80-të dhe fillim të viteve '90-të. (The Balkanista, 2018).

Kalimi i stafetës dhe ndryshimet e sistemit politik në Shqipëri, do ta vendosnin vendin përpara disa përgjegjësive krejt të reja në diplomaci dhe marrëdhëniet ndërkombëtare.

Shqipëria, nga një vend i izoluar totalisht nga bota dhe zhvillimet ndërkombëtare, tanimë, si në shumë fusha, edhe në atë të politikës së jashtme dhe diplomacisë, do t'i duhej t'i përshtatej nivelit të përgjegjësive që i takonin si aktor i rifutur në skenën ndërkombëtare, kryesisht në këto dimensione:

a) Në raport me fqinjët, si aktor rajonal dhe përfaqësues i drejtpërdrejtë, në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të shqiptarëve jashtë kufijve shtetërorë (Kosovë, Mali i Zi, Maqedoni e Veriut dhe Luginën e Preshevës).
b) Në raport me aktorët evropianë dhe ata globalë, si vendet e Evropës Perëndimore dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kinës, Rusisë, etj.
c) Në raport me organizmat ndërkombëtare prestigjioze, si: NATO, OSBE, FMN, OBT, etj. (Montgomery, 1991).

Në këto rrethana, riangazhimi i Shqipërisë nëpolitikën e jashtme dhe diplomaci do të përbënte një sfidë të vështirë, por të rëndësishme për vendin, pasi avancimi i kësaj agjende do të ndikonte në mënyrë të drejtpërdrejtë për normalizimin dhe demokratizimin e jetës dhe veprimtarisë së saj ekonomike, politike, diplomatike dhe kulturore. Dy dekadat e para postkomuniste, të diplomacisë dhe politikës së jashtme të Shqipërisë, kanë qenë fazat e hapjes dhe përpjekjeve të vazhdueshme për të "kalibruar" orientimin e saj gjeopolitik, sigurisht duke pasur në vëmendje aspiratat, interesat kombëtare dhe zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Shqipëria do të rilidhte marrëdhëniet e saj me shumë vende evropiane dhe përtej Atlantikut, si dhe me organizata ndërkombëtare, të cilat do të kontribuonin në forcimin e institucioneve dhe konsolidimin e tyre, si dhe vijimin e reformave të thella strukturore që do të çonin në modernizimin e vendit. (Misha, 2015).

Në dekadën e tretë, postkomuniste, interesat e diplomacisë shqiptare dhe orientimi i politikës së saj të jashtme, do të bëhej edhe më i qartë në favor të agjendës euroatlantike (North Atlantic Treaty Organization: Official Website, 2014).

a) Anëtarësimi i Shqipërisë në NATO, në vitin 2009,
b) Kërkesa bërë Brukselit, nga ana e Shqipërisë, për marrjen e statusit të vendit kandidat për në BE (2009) (European Commission, 2020),

Këto dy momente, do të konfirmonin pa asnjë ekuivok orientimin gjeostrategjik properëndimor të Shqipërisë. Me ardhjen e qeverisë socialiste në pushtet, në vitin 2013, diplomacia dhe politika e jashtme shqiptare do të kishte një qasje të re, edhe më vitale, për çështjet e vjetra dhe ato të mbetura pezull. Po ashtu, kemi një rikonfirmim të vazhdimësisë së rrugës euroatlantike të Shqipërisë dhe zgjerimin e ndërveprimit diplomatik dhe rritjen e bashkëpunimit me fqinjët, duke ulur tensionet dhe rritur rolin e diplomacisë (jo vetëm politike), duke zgjeruar gamën e ndërveprimit ndërinstitucional, por edhe të bashkëpunimit bilateral e multilateral me vendet e tjera.

Mbështetja e vazhdueshme e Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian kanë qenë domethënëse në tejkalimin e shumë proceseve të vështira demokratizuese dhe konsolidimin e shtetit dhe institucioneve shqiptare.

Anëtarësimi me të drejta të plota në Bashkimin Evropian dhe forcimi i miqësisë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës përbëjnë një prioritet kombëtar dhe një angazhim të pakontestueshëm të të gjitha palëve politike në vend, pavarësisht kaheve apo ideologjive politike që ato përfaqësojnë.

Akset më të rëndësishme të politikës së jashtme të shtetit shqiptar dhe përfaqësimi i saj në botë përfshijnë:

1) Partneritetin Strategjik me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Aleancën e Atlantikut të Veriut (NATO).

Deklarata e përbashkët për partneritet strategjik mes Republikës së Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, do të firmosej në prill të vitit 2015 nga Ministri i Punëve të Jashtme z. Ditmir Bushati dhe Znj.Victoria Nuland, Ndihmës Sekretarja e Shtetit për Europën dhe Euroazinë. Ky dokument ishte i një rëndësie të veçantë për Shqipërinë, pasi dëshmon në mënyrë të qartë, orientimin gjeostrategjik properëndimor të saj, dhe bashkëpunimin si aleate e ngushtë përkrah Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

2) Partneritet Strategjik me Bashkimin Evropian dhe përshpejtim të proceseve integruese deri në anëtarësim të plotë në BE;

Është e qartë se, integrimi në Bashkimin Evropian ka qenë një prioritet i Shqipërisë postkomuniste dhe është artikuluar si i tillë nga çdo qeveri që ka qeverisur vendin në këto 30 vitet e fundit.

Politika e jashtme e Shqipërisë, vazhdimisht është artikuluar nëpërmjet dokumenteve dhe strategjive të hartuara për realizimin e këtij objektivi të rëndësishëm kombëtar.
Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015 – 2020, përbën dokumentin kryesor kombëtar, të politikës së jashtme të Shqipërisë që parashikon zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik të vendit, si dhe përmbushjen e kërkesave të integrimit evropian. Kjo strategji është e përbërë nga gjashtë prioritete:

a) Integrimi Europian,
b) Mirëqeverisja, demokracia dhe sundimi i ligjit,
c) Stabiliteti makroekonomik dhe fiskal,
d) Rritja e konkurencës,
e) Zhvillimi njerëzor dhe kohezoni social (**Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020)**

2) Bashkëpunimi rajonal nëpërmjet diplomacisë ekonomike
Kjo qasje, midis Shqipërisë dhe vendeve të rajonit, do të arrihej nëpërmjet vijimësisë së Procesit të Berlinit, duke rritur më tej kuadrin e bashkëpunimit ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor ndaj sfidave të përbashkëta rajonale.

3.NDIKIMI I VENDEVE JOPERENDIMORE (TURQI – RUSI – KINË) NË BALLKAN DHE PREZENCA E TYRE NË SHQIPËRI.

3.1 Ndikimi turk në Shqipëri.

Turqia është një vend me ndikim rajonal, si politikisht, ashtu edhe ekonomikisht. Roli i saj në Shqipëri është mjaft domethënës, falë dhe lidhjeve historike të saj në të kaluarën. (Zhelyazkova, 2000). Sidoqoftë, perceptimi për ndikimin e saj, siç raportohet nga të dhënat statistikore, ashtu dhe intervistat cilësore të studimit, na ofrojnë një pikënisje të rëndësishme jo vetëm të klimës aktuale politike, por edhe të orientimit gjeostrategjik të Shqipërisë në politikën e jashtme.

Reformat me qasje liberale politike në Shqipëri, vitet e fundit kanë rritur ndjeshëm investimet e huaja në vend. (Bieber, Taleski, & Dimitrov, Nikola, 2017). Sipas të dhënave të vitit 2014, partnerët më të mëdhenj të tregtisë së jashtme të Shqipërisë ishin: Italia, Serbia, Spanja, Malta dhe Turqia. (Banka e Shqipërisë, 2014). Për më tepër, anëtarësimi në NATO dhe Banka Botërore (si dhe negociatat për anëtarësim në BE) kanë krijuar kushte të favorshme për tërheqjen e drejtpërdrejtë të investimeve të huaja, që shkojnë deri në 750 milionë euro në vit (në Evropën Juglindore ky është vendi i tretë pas Serbisë dhe Kroacisë). Rezultati përfundimtar i këtij procesi ishte një rritje ekonomike mbi 6% në baza vjetore. (Banka e Shqipërisë, 2017).

Interesat e Turqisë në rajon nuk janë risi, ndërsa Shqipëria dhe Kosova përfaqësojnë dy partnerë të rëndësishëm ekonomikë të këtij vendi në rajonin e Ballkanit Perëndimor. (Grigoriadis, 2010). Marrëdhëniet e ngushta ekonomike me të dyja këto vende mund të jenë të shpjegueshme në aspektin e afërsisë kulturore dhe fetare. (Hide, 2015). Vlen të theksohet se popullsia shqiptare është kryesisht

myslimane. Sipas ambasadorit turk, z. Yörük (2018) aktualisht ka më shumë se 400 kompani turke që veprojnë në Shqipëri, në sektorë të ndryshëm, si: energjia, minierat, telekomunikacioni, bankat, etj., me një fuqi punëtore prej rreth 15 000 punonjësish, me potencial për zhvillim të mëtejshëm në vitet e ardhshme. Disa shembuj konkretë të fushave të investimeve turke përfshijnë: investimet në telekomunikacion "AlbTelekom", në arsim, nëpërmjet institucioneve arsimore si "Universiteti Epoka" dhe Kolegjet "Mehmet Akif College", në sistemin bankar: "Banka BKT" (Turkish Embassy, 2017).

Falë Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të nënshkruar midis Shqipërisë dhe Turqisë në vitin 2006, iu dha mundësia zhvillimit të tregtisë dhe bashkëpunimit midis dy vendeve. Sipas këtij traktati, nuk ka asnjë dallim midis mallrave turke dhe mallrave nga vendet e Bashkimit Evropian. Sidoqoftë, duhet të vihet në dukje, se, në të njëjtin vit, 2006, Shqipëria nënshkroi edhe Marrëveshjen për Stabilizim dhe Asociim me BE-në. Sipas një raporti nga SETA, organizatë kërkimore për çështjet politike, ekonomike dhe sociologjike, në vitin 2015 eksporti turk drejt Shqipërisë arriti vlerën prej 287 milionë euro. (SETA, 2018). Vlen të përmendet, se Shqipëria së bashku me Kosovën janë vendet e vetme ballkanike, ku eksportet turke dominojnë ato gjermane, ku në vitin 2015 eksporti gjerman drejt Shqipërisë ka arritur vetëm vlerën prej 223 milionë euro. (SETA, 2018).

Në fakt, Shqipëria mban vendin e tretë në Evropën Juglindore (pas Serbisë dhe Kroacisë), sa i përket investimeve të huaja të drejtpërdrejta, duke arritur në 750 milionë euro në vit me Turqinë, që ofron një kontribut të konsiderueshëm; për shembull investimet e huaja direkte turke gjatë vitit 2017 arritën vlerën prej 45 milionë euro (Banka e Shqipërisë, 2017).

Një dimension tjetër me ndikim, i cili shkon pa u vënë re, por është shumë i rëndësishëm, i referohet ndikimeve socio-kulturore. Lidhja historike midis Turqisë dhe Shqipërisë ka sjellë ngjashmëri të rëndësishme në kuptimin e normave, vlerave dhe mënyrës së jetesës, të cilat mund të jenë ose të lidhura drejtpërdrejt me religjionin (dominimi i fesë myslimane në Shqipëri), (Vracic, 2016).

Si konkluzion, vlerësohet se influenca turke në Shqipëri ka qenë më e pranishme në dimensionin ekonomik, pasi rezultatet në këtë fushë janë më të matshme. Megjithatë, aspektet politike dhe kulturore kanë qenë të ndërthurura me ato ekonomike, por nuk kanë ndikuar drejtpërsëdrejti.

3.2 *Ndikimi rus në Shqipëri.*

Ndonëse Shqipëria nuk është e listuar në mesin e dhjetë vendeve me interes ekonomik rus, vitet e fundit ka pasur disa sinjale të dukshme pro saj. Ndikimi ekonomik në rritje i Rusisë është ndihmuar nga përpjekjet politike për të ringjallur dhe zhvilluar marrëdhëniet ekonomike midis dy vendeve; fokusi ka qenë në rritjen e investimeve ruse në sektorët e energjisë, transportit dhe turizmit. (Kurbatskiy, 2012). Ndryshimet e para po bëhen tashmë të dukshme. Për shembull, ka disa tregues të negociatave midis kompanive kineze dhe turke "Lukoil" dhe "Gasprom" lidhur me nxjerrjen e naftës në zonën e Patos-Marinzës. (Metohu, 2017). Në të njëjtën linjë, vërehet se Ambasada Ruse në Tiranë po përpiqet të marrë kontrollin mbi pjesën shqiptare të Tubacionit Trans-Adriatik (TAP) duke rritur ndjeshëm investimet ruse në vendin tonë. Varësia e vendeve evropiane në gazin rus dhe kërcënimi në rritje i rrugës alternative të gazit Azerbajxhan në Evropë e justifikon interesin në rritje të Rusisë për projektin TAP, duke kaluar nëpër territorin shqiptar. (Metohu, 2017).

Interesi i fuqishëm ekonomik dhe gjeopolitik i Rusisë në rajon është plotësuar me përpjekjet për të ndryshuar diskursin mediatik në Shqipëri, përveç vendeve të tjera në rajon. Shembujt përfshijnë një seri artikujsh të diskutueshëm, që haptazi denoncojnë përpjekjet e Rusisë për të "blerë" influencën e medies në Shqipëri; një strategji e tillë do të përfshijë disa stacione televizive shqiptare, gazeta dhe media online në kompanitë ruse, qëllimi përfundimtar i të cilit është përhapja e "propagandës ruse". (Gjonaj, 2017, Mejdini, 2016). Sidoqoftë, duhet theksuar se ky informacion është kontestuar zyrtarisht nga Ambasada Ruse në Tiranë.

Vizita e papritur e shefit të CIA-s, John Brenon, në Shqipëri në vitin 2016, ngriti dyshime mbi ndikimin rus në Shqipëri, megjithatë mund të thuhet se marrëdhëniet politike mes dy vendeve nuk mund të përshkruhen si shumë aktive, sikurse dimensionet më të spikatura të ndikimit rezultojnë të jenë ato ekonomike dhe kulturore. (Kurbatskiy, 2012).

Në të vërtetë, një takim dypalësh ndërqeveritar midis vendeve të Rusisë dhe Shqipërisë do të mbante sesionin e tij të shtatë në Tiranë pas 7 vjet ndërprerjeje, (Mlloja & Hunci, 2016).

Ndonëse marrëdhëniet midis dy vendeve po përmirësohen ngadalë (siç u konfirmua nga ambasadori shqiptar në Rusi dhe ambasadori rus në Shqipëri në intervista të ndara), përpjekjet në rritje për të mbajtur një dialog dypalësh, pavarësisht ndryshimeve themelore në çështjet politike, janë mjaft të qarta. Në kontekstin shqiptar, këto zhvendosje në rrafshin gjeopolitik dhe ekonomik ngrenë një pikëpyetje të madhe mbi orientimin gjeostrategjik të Shqipërisë përballë identitetit lindor dhe prezencës ruse. Debati i përkatësisë, në një sistem ose tjetrin, për shekuj me radhë ka zënë hapësira politike dhe akademike, aq sa shpeshherë është kthyer në një pikë të nxehtë të identitetit kombëtar shqiptar. Disa studiues pohojnë, se ekziston një ndarje në mes të modeleve formale demokratike perëndimore që ndiqen nga shteti dhe identiteti i saj i lindur lindor, që është në kundërshtim me të parën. (Hide, 2015).

Si konkluzion, vlerësohet se influenca ruse në Shqipëri ka qenë më së shumti e pranishme si faktor pengues në dimensionin politik, ndërsa në aspektin ekonomik dhe kulturor ka qenë më pak domethënëse dhe nuk ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë.

3.3 Ndikimi kinez në Shqipëri.

Zanafilla e marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Kinës është e kahershme. Viti 1954, që do të shënonte fillimin e marrëdhënieve zyrtare midis Shqipërisë dhe Kinës, kohë kur secili shtet dërgoi përfaqësinë diplomatike në vendin përkatës dhe hapën siparin e bashkëpunimit midis tyre, kuptohet me një fokus modest bashkëpunimi, por që do të zgjerohej në vitet në vijim, si rrjedhojë e ndryshimit të konfigurimit gjeopolitik brenda Bllokut Komunist. (Intervistë Gjon Boriçi, 2019).

Në ditët e sotme, në Shqipëri, kompanitë e ndryshme kineze i ushtrojnë aktivitetet e tyre në fusha, si: industria minerare, telekomunikacioni, infrastruktura, energjetika, nafta dhe sektorët e ndryshëm të shërbimeve. Nga ana tjetër, për Shqipërinë investimet kineze janë shumë të rëndësishme, madje kanë një domethënie shumë të madhe, e parë kjo në katër aspektet kryesore.

Së pari, këto investime tregojnë besimin e kompanive të ndryshme kineze tek tregu dhe tek zhvillimi i ardhshëm i Shqipërisë.

Së dyti,nëse do të përmendnim projekte të ndryshme të mëdha, siç është blerja e kompanisë së naftës "Bankers", si dhe blerja e disa prej aksioneve të Aeroportit "Nënë Tereza", të cilat mund të përdoren si strategji për të tërhequr vëmendjen e shumë firmave të tjera për të investuar, në mënyrë që të nxiten dhe të zhvillohen sektorët e tjerë industrialë.

Së treti, ne konstatojmë se bashkëpunimet e ndryshme kanë maksimizuar përdorimet e burimeve, të cilat janë shumëpalëshe. Nëse do të përmendnim këtu projektin e Aeroportit "Nënë Tereza", do të shihnim një ndërthurje të burimeve të palëve kineze për sa i përket kapitaleve, klientelës, që mund të jenë udhëtarë ose mallra, si dhe zgjerimit të bizneseve të palëve shqiptare dhe asaj gjermane për sa i përket pjesës së menaxhimit. Ndërkohë, si rezultat mund të përmendim, se numri në tremujorin e parë të vitit 2018 në aeroport u rrit me 10%. (Instat, 2017).

Dhe së katërti, shumë kompani kineze, përveç bizneseve të ndryshme, kanë mirëmenaxhuar të gjitha përgjegjësitë e tyre shoqërore, njëhohësisht kanë dhënë një ndihmesë të madhe për sa i përket shtimit të taksave, rritjes së punësimit apo trajnimeve profesionale.

Këtu mund të përmendim kompaninë e naftës "Bankers", ku janë të punësuar mbi 2000 punëtorë, të cilët, përveç njohurive, kanë përfituar dhe përvojë profesionale, gjë e cila i ka ndihmuar në shtimin e të ardhurave vetjake.

Në ditët e sotme po vërehet një trend rritës, ku kompanitë kineze po përqendrohen që ta shtrijnë kapitalin e tyre në Shqipëri dhe në vende të tjera të Ballkanit Perëndimor, duke zëvendësuar partnerët tradicionalë evropianë. (Mardell, 2020).Kina, si ekonomia numër dy e botës, po përpiqet të investojë në pasuri strategjike me kompani të cilat në shumicën e rasteve janë në pronësi të vet qeverisë, të cilat propagandojnë vetveten në arenën evropiane për potencialitetin dhe aftësitë e tyre. Në dekadën e fundit, Kina është shndërruar në një nga partnerët më të rëndësishëm ekonomikë të Shqipërisë, ku kompani të rëndësishme të saj si "Geo-Jade Petroleum" po eksplorojnë rrugë të reja për investime afatgjata.

Edhe pse Kina është përpjekur të imponohet në Ballkanin Perëndimor, posaçërisht në Shqipëri, ndikimi i saj ka qenë kryesisht në aspektin ekonomik, megjithëse ka elemente që nuk e favorizojnë në raport me "konkurrentët" e tjerë, perëndimorë dhe joperëndimorë, në këtë rajon. Distanca gjeografike dhe diferenca në aspektet kulturore mes dy vendeve, shpjegojnë ndikimin e dobët të Kinës në dimensionet politike apo kulturore në Shqipëri.

4. KONKLUZIONE.

Synimi i ketij punimi ishte të kuptuarit e ndikimit të tri aktorëve ndërkombëtarë joperëndimorë, si: Rusia, Turqia dhe Kina në Shqipëri, në politikën e jashtme dhe kursin e saj properëndimor. Është pikërisht pozicioni i saj gjeografik, midis Lindjes dhe Perëndimit, që e bën atë të prekshme ndaj ndikimeve dhe implikimeve të Fuqive të Mëdha, qofshin këto në Lindje, ashtu edhe fuqive perëndimore. E gjendur në këtë kontekst, Shqipëria e ka bërë zgjedhjen e saj. Pas rënies së komunizmit në Shqipëri, në

vitet '90-të, elita e kohës dalë prej zgjedhjeve të para pluraliste u pozicionua pa asnjë ekuivok drejt Evropës Perëndimore dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Tashmë, kanë kaluar afërsisht 30 vite dhe kursi i Shqipërisë postkomuniste nuk shihet të ndryshojë orientimin pro-Perëndimor, në të gjitha dimensionet që ajo përfaqëson. E megjithatë, në një kontekst global, aktorët perëndimorë, nuk janë të vetmit aktorë dhe faktorë ndikues në Ballkanin Perëndimor. Kjo do të thotë se Shqipëria është jo imune ndaj ndikimeve gjeopolitike nga vendet joperëndimore, siç është Rusia, Turqia dhe Kina.

Pikërisht, në këtë kontekst gjeopolitik mori rrugë ky punim, nëpërmjet të cilit do të vlerësohej në mënyrë shkencore influenca e secilit aktor gjeopolitik rajonal dhe ndërkombëtar: perëndimor (SHBA–BE) dhe joperëndimor (Rusi, Turqi, Kinë).

Pyetja kërkimore e ngritur në këtë studim ishte: ***A është zhvendosur orientimi gjeostrategjik properëndimor i Shqipërisë nën ndikimin e vendeve joperëndimore?***

Ndërsa hipoteza e studimit ishte: ***Ndikimi i Turqisë, Rusisë dhe Kinës, nuk e ka zhvendosur orientimin gjeostrategjik properëndimor të Shqipërisë.***

Nisur nga analiza në këtë studim rezulton, se: *Të tri vendet joperëndimor kanë ndikim të moderuar në Shqipëri.*

Turqia është vendi, i cili perceptohet si më veprues në Shqipëri krahasimisht me dy vendet e tjera joperëndimore, po ashtu edhe ndaj SHBA-së dhe BE -së, në të tri dimensionet e marra në analizë.

Në dimensionin ekonomik, Turqia shihet si vendi me prezencën më të madhe të investimeve të huaja të drejtpërdrejta në ekonominë e vendit tonë, duke qenë një investitor i rëndësishëm në sektorët më strategjikë: në sistemin bankar, telekomunikacion dhe infrastrukturë.

Sa i takon Rusisë, referuar të dhënave, rezulton se ajo perceptohet si vendi me më pak ndikim në politikën e jashtme të Shqipërisë në raport me vendet perëndimore: SHBA–BE, dhe Turqisë nga vendet joperëndimore. Mirëpo, nga ana tjetër Rusia perceptohet si pengesa kryesore e Shqipërisë në rrugën e saj euroatlantike, krahasimisht me dy vendet e tjera joperëndimore: Turqia dhe Kina. Së fundmi, influenca kryesore e saj perceptohet në dimensionin politik, krahasimisht me atë ekonomike dhe kulturore.

Kina renditet e fundit për nga influenca, krahasimisht me Rusinë dhe Turqinë. Kina ndryshe nga dy aktorët e tjerë joperëndimorë, Turqia dhe Rusia, interesat e saj kryesisht ekonomike i ka shfaqur së fundmi në rajonin e Ballkanit, ku bën pjesë edhe Shqipëria. Nëse i referohemi të dhënave krahasuese midis SHBA-së dhe BE-së, ajo perceptohet si pak ndikuese në dimensionet politike dhe kulturore, ndërsa në dimensionin ekonomik ajo pozicionohet përafërsisht në të njëjtën shkallë influence. Në fakt, nisur nga të dhënat e Bankës së Shqipërisë, të referuara në këtë studim, rezulton se SHBA-ja dhe BE-ja janë në pozicion superior absolut në dimensionet ekonomike.

Nisur nga të dhënat e nxjerra nga studimi, konsiderojmë se të tri vendet e marra së bashku me gjithë ndikimin dhe implikimet e tyre në rajonin e Ballkanit, konkretisht në Shqipëri, rezulton se ndikimi i tyre është minimal, për pasojë nuk arrin të zhvendosë aksin e politikës së jashtme të shtetit shqiptar. E vetmja e dhënë, e cila nuk është në përputhje të plotë me hipotezën e ngritur në studim, është rasti i Turqisë, ku paraqitet me vlera më të larta influencuese në raport me SHBA-në dhe BE-në.

5. BIBLIOGRAFIA:

1. Banka e Shqipërisë (2017). Fakte dhe shifra. Marrë nga https://www.bankofalbania.org/Statistikat.
2. Bieber, F., Taleski, D., & Dimitrov, N. (2017). The avoidable return of geopolitics in the Balkans. Atlantic Council. Retrieved from http://www.atlanticcouncil.org/blogs/new-atlanticist/the-avoidable-return-of.
3. Bieri, M. (2015). The Western Balkans Between Europe and Russia. CSS Analyses in Security Policy, 170.https://css.ethz.ch/content/dam/ethz/special-interest/gess/cis/center-for-securities-studies/pdfs/CSSAnalyse170-EN.pdf
4. Bugajski.J (2020). "Can the Kremlin Take on the West"?https://www.cepa.org/the-great-balkan-game
5. European Commission (2020).European Neighbourhood Policy And Enlargement Negotiationshttps://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/countries/detailed-country-information/albania_en
6. Garcia, M.J. (2009) "NATO Enlargement: Albania, Croatia, and Possible Future Candidates". https://www.everycrsreport.com/reports/RL34701.html
7. Grigoriadis, I. (2010). The Davutoglu Doctrine and Turkish Foreign Policy. Hellenic Foundation for European and Foreign Policy. http://www.eliamep.gr/wp-content/uploads
8. Gjonaj, M. (2017). Akuza e forte: Rusia ka blere nje televizion dhe tre portale ne Tirane. Pamfleti. Retrieved from http://www.pamfleti.com/akuza-e-forte-rusia-ka-blere-nje-televizion-dhe-tre-portale-ne-tirane
9. Hide, E. (2015). Assessment of risks on national security//the capacity of state and society to react: Violent extremism and religious radicalization in Albania.
10. Human Rights Watch (1996).Human Rights In Post-Communist Albaniahttps://www.hrw.org/legacy/summaries/s.albania963.html
11. Intervistë Gjon Borici. (2019) .Marrëdhëniet shqiptaro-kineze në syrin e një historian.
12. INSTAT. (2017). Foreign Trade data. Marrë nga http://www.instat.gov.al/.
13. Kurbatskiy, V. (2012).Albania and Russia: Rapprochement.Russian International Affairs Council.https://russiancouncil.ru/en/analytics-and-comments/analytics/albania-and-russia-rapprochement/
14. Mardell, J. (2020).China's Economic Footprint in the Western Balkans. http://aei.pitt.edu/102545/1/asia-policy-brief-chinas-economic-footprint-in-the-western-balkans-28c4d775834edcc469f4f737664f79f932d6f9a1.pdf
15. Metohu, F. (2017). Si Rusia kontrollon tregun e hidrokarbureve në Ballkan dhe tenton të kapë Shqipërinë. Retrieved from http://www.gazetatema.net/2017/06/23/si-rusia-kontrollon-tregun-e-hidrokarbureve-ne-ballkan-dhe-tenton-te-kape-shqiperine/.

16. Mlloja, G., & Hunci, D. (2016). Russia-Albania economic ties need to be revived. Albanian Daily News. http://www.albaniannews.com/index.php?idm=6635&mod=2
17. Misha, P. (2015).ALBANIANS AND THE EUROPEAN SOCIAL MODEL Disadvantages, obstacles, challenges and visions.http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/12304.pdf
18. Montgomery, (1991).Non-Communist Rule Begins in Albania : Eastern Europe: The new leadership faces stiff economic and political challenges after 47 years of Stalinist control. Los Angeles Times.
19. SETA Foundation for Political, Economic and Social Research (2018). Retrieved from http://setav.org/en/
20. Turkish Embassy. (2017).Relations between Turkey and Albaniahttp://tirana.emb.mfa.gov.tr/Mission/ShowInfoNote/255500
21. The Balkanista (2018).The communist history of Albania.http://thebalkanista.com/2018/02/25/communist-history-albania/
22. Vracic, A. (2016). Turkey's role in the western Balkans. SwP Research Paper. Marrw nga https://www.swpberlin.org/fileadmin/contents/products/research_papers/2016RP11_vcc.pdf.
23. Zhelyazkova, A. (2000). Albanian Identities.http://pdc.ceu.hu/archive/00003852/01/Albanian_Identities.pdf

BOTH ERASMUS+ PROGRAMME AND VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING (VET) IN FOCUS TO INTEGRATE HIGHER EDUCATION INSTITUTIONS IN EU.

Ardi Bezo, PhD

abezo@kub.edu.al

University College of Business

Armila Xhebraj, MSc

University College of Business, ZKSHP

axhebraj@kub.edu.al

Abstract.

Nowadays globalization is in the center of discussions not only in everyday life, but also the internationalization of universities is an important part and the main discussions of these countries that aspire to join the EU. Through capacity building projects in education in recent years, a special focus has been given to it by local policies through the framework of the internationalization of higher education institutions in our country. Higher education institutions in Albania in recent years have begun to have an even more present approach to the projects of the European Union by tracking them and becoming part of the large network of these projects that serve to align the mobility of academic staff, exchanging their experiences whether in teaching or in training and definitely gaining a valuable experience. These projects brings in our country's higher education institutions the best European universities, where through them the academic staffs are not only familiar with these universities, but they can learn how they are organized, they can see the best methods of teaching, learning and training ect. Through the Erasmus+ and VET projects, our students can stay for a longer period in those university where the university has an agreement between universities. In these semester experiences, they will not only benefit from a different education in western universities, but they also get to know the different cultures of those countries. This is much more than just an experience. Through this way our institutions and universities can progress and integration towards the EU. This study aims to show how strongly higher educations can be connected by entering into project colaborations and involving each other, with a focus on the exhange of experinces in teaching and training.

Keyword; Education mobility, Vet, Erasmus+, Integration on Higher Education.

CAPACITY BUILDING PROJECTS AND ERASMUS+ MOBILITIES

Capacity building projects are international cooperation projects based on multilateral partnerships between organizations active in the field of VET in EU Member States and third countries associated with the Program, and third countries not associated with the Program. They aim to support the relevance, accessibility and responsiveness of VET institutions and systems in
third countries that are not linked to the Program as a sustainable driver of socio-economic development. Vocational education and training (VET) aim to equip young people and adults with the knowledge, skills and competences required in specific occupations or more broadly on the labour market. It covers a wide range of qualifications: initial VET at secondary level, continuing VET for adults and vocationally oriented education and training at higher levels. In recent years, the offer of VET programmes has become more diverse, driven by the importance of lifelong learning and the needs of a changing labour market, notably the green and digital transitions. Or Erasmus+ supports training periods for staff working in higher education institutions. The 2020 Council Recommendation on VET sets out key principles to ensure VET provides quality learning opportunities for young people and adults. The Recommendation is strongly focused on increased flexibility, increased opportunities for work-based learning and apprenticeships, and improved quality assurance. The Recommendation also sets three EUlevel objectives to be achieved by 2025:

(1) at least 60% of recent VET graduates benefit from some form of work-based learning during their studies;
(2) at least 8% of VET learners study abroad and
(3) at least 82% of VET graduates are employed

With Erasmus+, you can train at a higher education institution in an Erasmus+ Programme or at an organisation outside the sector in a Programme country. A training period between two Programme countries must last a minimum of 2 days and cannot last more than 2 months. This excludes travelling time. o train abroad with Erasmus+, your higher education institution must either, in the cases of Programme countries, hold the Erasmus + programe the Erasmus Charter for Higher Education (ECHE) provides the general quality framework for European and international cooperation activities a higher education institution may carry out within Erasmus+.

The award of an ECHE is a pre-requisite for all higher education institutions located in a programme country and willing to participate in learning mobility of individuals and/or cooperation for innovation and good practices under Erasmus+. For higher education institutions located in Partner countries, the ECHE is not required and the quality framework will be established through inter-institutional agreements between higher education institutions.

Or, in the case of Partner countries, have signed an INTER INSTITUTIONAL AGREEMENT with the receiving institution. By signing an inter-institutional agreement, the institutions involved agree to cooperate on the exchange of students and/ or staff in the framework of Erasmus+.They mutually commit to respecting the quality requirements of the Erasmus Charter for Higher Education in all aspects of the

organisation and management of mobility, and agree on a series of quantitative and qualitative measures to ensure mobility of high quality and impact.

It is recommended that HEIs sign this inter-institutional agreement as soon as an Erasmus+ grant is awarded, and in any case before the first mobilities take place. The ECHE principles have been adapted to match the novelties of the Erasmus+ programme 2021-2027, such as digitalisation, inclusion and sustainability.

Some of the most important additions to the new ECHE are the commitment to reach out to underrepresented groups in mobility through inclusion strategies, to ensure green practices in organising Erasmus+ activities, the implementation of digitalisation through the European Student Card Initiative and the Erasmus+ Mobile App, as well as the commitment to enhance the civic engagement of mobile students.

In addition, higher education institutions are requested to comply with the requirements of the Council Recommendation on automatic mutual recognition, in order to ensure the full automatic recognition of learning periods abroad in the smoothest way possible and without the student having to do any extra coursework or exam.

The new ECHE principles have been designed in consultation with the ECHE Working Group, which is made out of Erasmus+ National Agencies representatives, Higher Education experts and student organisations.

Your higher education institution and the organisation at which you will train must be part of an Erasmus+ National Mobility Consortium.

Before beginning your training, you, your higher education institution and the receiving institution sign a Mobility Agreement. A Mobility Agreement sets out the programme of teaching/training to be followed and is approved by the staff member, the sending and the receiving institution/organisation. The agreement defines the components of the teaching or training period abroad and emphasises the mutual responsibility for the quality of the mobility of both the sending institution/organisation and the receiving institution/organisation. This document sets out your learning goals, rights and responsibilities and also how your training will be formally recognised.

Erasmus + is a unique experience that should be experienced at least once in a lifetime.

Erasmus is one of the most significant experiences in the life of profesor and specialty in life of a student. For those of you who have the fortune and possibility to go, Erasmus is an opportunity to be seized by the horns: it is an experience which will encourage you to mature and grow as a person. It is a fundamental phase in your life in which you will discover about yourself and the world. However, you will have to approach Erasmus with a certain amount of maturity and responsibility so that it can truly be a formative experience, a chance to meet a different version of you.

INVOLVEMENT OF HEI UNIVERSITY COLLEGE OF BUSINESS IN IMPLEMENTATION OF VET PROJECT (CO-HOST).

Based on the study carried out and the vision for the future, with the aim of increasing participation in projects of this spectrum, higher education institutions, in this case the University College of Business, have a wide involvement mainly in projects for vocational and educational training.

The University College of Business requires a capacity building to create a bridge between the European communities of professions mainly in the Hospitality and Tourism sector as well as students, pupils and the whole society as a whole.

The project focuses on the subject of Hospitality, Tourism and Marketing, with a strong emphasis on green and entrepreneurial skills. Precisely in countries that are experiencing rapid growth and social changes, development must be understood as sustainable development, in accordance with the objectives of the Global Agenda 2030. CO-HOST encourages forms of tourism that respect the environment, local cultures and that contribute to the development of stable territories. It will be particularly interesting and strategic, for VET students and staff, to experience during their internship periods in the EU, the most advanced practices in this field, which are provided by experienced partners.

Given the fact that the EU is supporting many projects that include green skills, we also try to reach their standards with the same focus. Therefore, involvement in all the diversity of these projects helps anyone, be it society, individual, student, teacher or business to incorporate new ways in their daily work processes.

At the same time, starting from the fact that Albania is a country that aims to join the EU, all these projects help us to start and reflect on the steps we need to take to reach the standards of a European country, starting from the reliability and financial support that is currently giving.

Conclusion

The VET programs serve to further strengthen the third countries that are not connected to the VET systems and that aim to approach the labor market opportunities through this system. Improving knowledge, technical, managerial and pedagogical skills of VET teachers and trainers; Integrating input from teachers/trainers, VET students and employers, from the private sector in particular, into curriculum, profiling and training reform; Promoting cooperation in different regions of the world through joint initiatives.

Erasmus + program is a direct contributor to the implementation of innovative, quality methods and the continuous improvement of knowledge, whether in an academic or professional framework. Also, this program is the best support in the possibility of expanding the network and extending the cooperation in a wider spectrum and in all new fields of studies or professional, whether they are.

RECOMMENDATIONS

HEI's cooperation with the ESN office in Albania for outgoing and incoming students.

Awareness of students and academic staff for all academic and social inclusion in partner universities.

Higher education can share knowledge through Erasmus + Programs by holding fairs with internal, public and private HEIs in Albania.

The Erasmus+ Programme addresses the citizens' limited participation in its democratic processes and their lack of knowledge about the European Union, and tries to help them overcome the difficulties in actively engaging and participating in their communities or in the Union's political and social life. Strengthening citizens' understanding of the European Union from an early age is crucial for the Union's future and in this part a huge contribution have also the HEIs.

Increased engagement of the young people in Albania is a key element in the process of building societies that are more resilient and are based on mutual trust and intercultural understanding.

REFERENCE:

European Commission (2017).„From Erasmus to Erasmus+: a story of 30 years". Retrieved from: https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/MEMO_17_83. 4. European

Commission (2022). „Investing in young Europeans". Retrieved from: https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/projects/priorities_2019-2024_ro. 5. European

Commission, Directorate-General for Education, Youth, Sport and Culture, (2021). Erasmus+ 2021-2027: enriching lives, opening minds through the EU programme for education, training, youth and sport, Publications Office.

https://erasmus-plus.ec.europa.eu/opportunities/opportunities-for-individuals/staff-training/higher-education-staff-training,

https://erasmusplus./?p=8087&lang=sq

https://op.europa.eu/webpub/eac/education-and-training-monitor-2022/downloads/comparative-report/Education-and-Training-Monitor-Comparative-Report.pdf

https://erasmus-plus.ec.europa.eu/programme-guide/part-a/important-characteristics-of-the-erasmus-programme

https://erasmus-plus.ec.europa.eu/programme-guide/part-a/priorities-of-the-erasmus-programme

EFFECTIVE ESP TEACHING STRATEGIES: A NEW APPROACH TOWARDS BOOSTING LEARNING IN ESP STUDENTS

PhD.Cand. Inesa Toska

Faculty of Law and Political Sciences

University College of Business,

itoska@kub.edu.al

Abstract.

Nowadays, due to the tremendous opportunities offered to students for study and employment in many countries of the world, the demand for the acquisition of English for Specific Purposes has increased significantly. The methodology of English for Specific Purposes differs from the methodology of teaching English. English for Specific Purposes teaching is based on the needs of the students. This study focuses mainly on the strategies that the English for Specific Purposes teacher uses during the lesson in order to achieve the objectives. Clarity of objectives in teaching is one of the main factors that enable an effective teaching. The combination of strategies with different activities, make the teacher achieve the objectives of the lesson in a more cooperative and interactive way with the students and more motivating at the same time. What are the main strategies that characterize the attitude of successful students towards learning? What are the methods of an effective teaching? Collaborative learning, debate, peer tutoring, classroom discussion, brainstorming can enable students to effectively interact with one another while the ESP teacher implements these teaching strategies. What are the advantages and disadvantages of each of them?

Key words: *Effective Teaching Strategies, Learning, English for Specific Purposes*

1.Introduction.

The term "learning strategy" has been used in various cases to refer to deliberate actions that students, consciously or unconsciously, use to understand and enhance their foreign language skills. They include any set of actions, steps, routines used by students to facilitate the acquisition, storage, recall, and use of information.

According to Rebecca L.Oxford, learning strategies are specific actions taken by the students in order to facilitate, enhance learning, making it more enjoyable, more self-directed, more effective and more transferable to new situations.[116]

According to Wenden and Rubin, learning strategies are the strategies that contribute to the development of the language system that the student builds and that directly affect the learning process.[117]

According to Weinstein and Mayer, learning strategies are defined as behaviors and thoughts with which the student engages in the learning process, which aim to influence the information processing process.[118]

Ana Chamot describes learning strategies as intentional techniques, approaches, or actions that students take to facilitate learning and reflection of linguistic and content information.[119]

According to Tarone, learning strategies are defined as an attempt by students to develop linguistic and sociolinguistic competence in the foreign language.[120]

The term "learning strategy" is generally used for all strategies that include communication strategies and constitute a type of learning strategy. According to Oxford, learning strategies are particularly important for foreign language learning because they serve as tools for active and self-directed involvement, which are essential for the development of communicative competences.

According to Lessard-Clouston, communication strategies are used by the speaker deliberately and consciously to overcome communication difficulties. Strategies are effective if teachers help students not only in learning knowledge, but also in being successful foreign language students. The teacher's help begins with becoming familiar with the student and motivating the student.[121]

According to Holl S., the most important role of the teacher in teaching a foreign language is to present a range of tasks to suit different learning styles.

Teachers should analyze textbooks to see if they include learning and training strategies, and when they are not provided in the textbooks, the teacher should look for other materials in order to provide them.[122]

---

[116] Oxford Rebecca, *Language Learning Strategies*,HeinleCengage Learning,1990, p.8
[117]Wenden A. &Rubin J., *Learner Strategies in Language Learning,* Prentice Hall, 1987, p.23
[118] Weinstein C &Wayer R, *The Teaching of Learning Strategies*, 1996, p.531
[119]Chamot A, *Strategies:The learning strategies of ESL*, Longman, 1987, p.71
[120]Tarone E, *On the variability of interlanguage systems,*Applied Linguistics, Vol.4, No.2, 1983, p.4
Many countries have chosen to go back to ecotourism after many negative experiences, and Albania should also build such a model, in order to contribute in the economic development of the community, not forgetting that the contribution of ecotourism in the local economy do not hang only on the money that come to the region, but also overall from the part of this money circulating in the country. The fruits of the invested capital are the money coming from the implementation on tourist development and one of the best ways to avoid money going outside our country, would be the implication of the local communities in all the phases of tourist projects, aiming that this capital be multiplied within it, ensuring further economic increase.

Social cultural impact:

Compared to the two first ones, the social cultural impact are often more difficult to be identified in the quantitative point of view. For example, beginning from this moment is anyone finding a community that due to tourism reasons its traditions are being denied? According to Fox:

Social and cultural impacts of tourism are manners based on which tourism contributes in change of the system of human values, in individual behavior, family relations, in the manner of collective life, in the security level, in the moral aspect, in the creative expressions, traditional ceremonies and in the organizing of the community".

The analysis of the social cultural impacts of tourism is made based on three elements which are:

- Tourists: their demands for service, their behavior, their purposes and actions;
- Hosting community: their role and behavior towards the services demanded from the tourists and their concern regarding the behaviors of the visitors on the traditional way of living of the community.
- Linkages between tourists and hosting community: being somewhere transitory and limited in time and space, this linkage often proves spontaneity and inequality.

According to the well-known authors in this field, one of the oldest impacts of tourists with the local community is with no doubt the objection, commercialization of the cultural, traditional observances, such as the observance of the religious ceremony. This may be called "zoo effect", because there is no interactivity between the visitors and the visiting persons. In some regions tourism is a revitalization instrument or an instrument of the reevaluation of the cultural practices – sometimes forgotten – of the autochthons, contributing in cohabitation with the visitors and visiting persons and establishing a collective identity.

Behaviors and actions of tourists in appearance – sometimes banal – may have foreseen and unchangeable consequences on the social structure or traditions of an isolated community. Due to their delicacy, ecotourism is vigilant to the negative effects of tourism in the social cultural plan, by making different researches in this field and giving the respective solutions for their protection.

CONCLUSIONS

- "Ecotourism: the most complete model, like gold it is very difficult to be found". But in life you should dare, you should dare to win. Therefore we should attempt to realize it, if we do really want development, if we really want citizenship, if we do really want integrity.

- It is a need of the day, because the whole world is already towards it, that is why there should be made specific studies for different tourist areas in the country, in order to establish norms or exact indicators in order that they be implemented from the respective competent organs in function to the realizing of the development sustainability and integration in the modern civic world.

- Ecotourism makes you have dreams:
  Passengers' have drowned in a "luxurious jungle", in the heart of a protected environment of rare and colorful spaces. Community is considered as a possessor of its traditions, being safe for the

future. State is considered as a beneficiary of a part of the financial incomes, being respondent to its strategies to adhere in a sustainable development and a civilized integration.

- In order to make these dreams come true, efforts for making studies should be multiplied aiming better understanding of situations, approaching echo tourism as an area to consult on the social economic development of our society and protection of the environment in our countries. This dream may come true only if the proposal of the echo tourism indicators will be studied based on specific issues of the area and if their implementation is really possible.

REFERENCES

[1] "The economics of recreation, leisure and tourism, sixth edition, John Tribe, 2020", Routledge publications, ISBN 978-0-367-23081-4 (hbk), ISBN 978-0-367-23083-8 (pbk), ISBN 978-0-429-27825-9-4 (ebk),

[2] "Tourism Economy", BAKIU V, first edition, 2011, publication of "Erik Edition", ISBN: 978-99956-36-95-1

[3] "L'Economie du Tourisme", "Robert LANQUAR", fourth edition, 1994, edition of "Presses Univeritaires de France", ISBN: 978-82130-46397-9, ISBN: 2-13-046397-5

[4] "L'economie de la culture", Françoise BENHAMOU, first edition, 1996, edition of "La decouverte", Paris. ISBN: 2-7071-2549-0

[5] "La valeur economique du patrimoine", Xavier Greffe, first edition, 1990, Anthropa edition, Paris. ISBN: 2-7178-1845-6

[6] Economie applique a la gestion, third edition, 1996, Edwin Mansfield, edition of "ECONOMICA", ISBN: 978- 27178-3008-8

[7] "Tourism & Environment", Pierre ESCOURROU, first edition, 1993, SEDES edition, ISBN: 2-7181-4838-1

[8] "Le Tourisme", François VELLAS, first edition, 1992, edition of ECONOMICA, ISBN: 2-7178-2234-8

[9] "Management of Hotel & Tourism Businesses", Bakiu V., first edition, 2013, edition of "Erik Edition", ISBN: 978-9928-123-64-0

TOLERANCA FETARE NË SHQIPËRI.

Msc. Morena Karaj

aldo.karaj@gmail.com

Abstract:

Religious coexistence in Albania is seen as a fundamental value, deeply rooted in tradition and moral and social values. Most Albanians live a secular life and oppose the idea that religious vieës should shape or condition their way of life, thus respecting the spirit of tolerance and religious coexistence.
Albanians welcome the religious diversity that is present in the country and strongly oppose the idea of the superiority of one particular religion over others, regardless of the size of the respective religious community.
Religious affiliation is not a factor by which to characterize people according to qualities, such as hardworking, friendly, intelligent, violent or lazy. Most Albanians share the same opinion about the feeling of danger or concern when it comes to members of other religious groups, thus revealing a non-sectarian empathy (sensitivity).
Secularism and non-interference of the state in religious belief is evident and a distinguishing feature not only from society but also from local and foreign researchers.

Keyword: religious tolerance, trust, secularism, religion

Abstrakt:

Bashëkjetesa fetare në Shqipëri vërehet si një vlerë themelore, e rrënjosur thellë në traditën dhe vlerat morale e shoqërore. Shumica e shqiptarëve bëjnë jetë laike dhe kundërshtojnë idenë se pikëpamjet fetare duhet të formësojnë apo të kushtëzojnë mënyrën e tyre të jetesës duke respektuar në këtë mënyrë frymën e tolerancës dhe të bashkëjetesës fetare.
Shqiptarët e mirëpresin diversitetin fetar që është i pranishëm në vend dhe e kundërshtojnë me forcë idenë e epërsisë së një feje të caktuar ndaj të tjerëve, pavarësisht nga madhësia e komunitetit përkatës fetar.
Përkatësia fetare nuk është faktor me të cilin të karakterizohen njerëzit sipas cilësive, si punëtorë, miqësorë, inteligjentë, të dhunshëm ose dembelë. Shumica e shqiptarëve ndajnë të njëjtin mendim rreth ndjenjës së rrezikut apo shqetësimit kur bëhet fjalë për anëtarë të grupeve të tjera fetare, duke zbuluar kështu një empati (ndjeshmëri) jo-sektare.
Laicizmi dhe mosndërhyrja e shtetit në besimin fetar është evident dhe tipar dallues jo vetëm nga shoqëria jonë por edhe nga studiues vendas dhe të huaj.

Fjalë kyçe: *tolerancë fetare, indiferentizëm fetar, besim, laicizëm*

1.Hyrje.

Shqipëria ashtu si çdo vend tjetër në botë ka historinë e saj, dhe në këtë histori pasqyrohen si anët pozitive të një populli ashtu dhe ato negative.
Shpesh herë Shqipërisë i janë vënë etiketa se përbëhet nga një popull i pa kulturuar, i pa arsimuar, barbar dhe që nuk është në gjendje të qeverisë as veten e tij. Por natyrisht këto shtete që kanë bërë këto gjykime ndaj shqiptarëve janë nisur nga faktorë të ndryshëm, dhe zakonisht janë bërë nga qarqe të caktuara të shteteve fqinje që gjithmonë janë munduar që të ndryshojnë apo „përkeqësojnë" figurën e shqiptarit dhe atë të Shqipërisë në arenën ndërkombëtare. Por këto shtete harrojnë se populli shqiptar është një nga popujt më të vjetër të Ballkanit dhe që është zhvilluar në rrjedhën e shekujve edhe pse gjatë kohës ka qenë i pushtuar nga perandoritë e kohës. Natyrisht që pushtimi për një kohë të gjatë sjell prapambetje e cila vihet re në kushtet dhe mënyrën e jetesës, gjë që i bënte fqinjët tanë t'i quanin shqiptarët anadollakë. Megjithatë populli shqiptar edhe në këto kushte të vështira është munduar që të arsimohet, të kulturohet dhe të organizojë një qëndresë ndaj pushtuesve. Dhe si kundërpërgjigje e kësaj qëndrese pushtuesit janë përpjekur t'i përçajnë shqiptarët duke përdorur dhe shprehjen e famshme romake "Përça e sundo". Një nga këto përpjekje është edhe ajo për ti futur shqiptarët në përçarje fetare. Por pa rezultat se shqiptarët kishin jetuar gjithmonë në paqe pavarësisht nga besimet e tyre."Ky ishte nje realitet historik dhe këtë e kanë vënë në dukje shumë historian, orientalist e udhëtarë të huaj të cilët thonë se kur i pyesin shqiptarët e çfarëdo lloji besimi, se çfarë ishin të përgjigjeshin jemi shqiptarë"[1].

2. **Bashkëjetesa fetare në Shqipëri.**

Populli shqiptar nga sa konstatuam edhe më sipër kishte përqafuar në fillim kristianizmin për të ardhur në shekullin e XI-të kur ky besim do të ndahej në dy rite, në atë që orientohej sipas riteve të Romës e që u quajt katolike dhe në atë që u drejtua nga Kostandinopoja që u quajt ortodoks. Pavarësisht nga kjo ndarje populli shqiptar nuk ju përgjigj luhatjeve që bënin krerët e kishave në Romë e Kostandinopojë. Populli shqiptar vazhdoi të jetojë në një harmoni fetare përsëri, pavarësisht se mbi të rëndonte akoma pushtimi i huaj. Për të ardhur në shekullin e XV-të , shekull në të cilin do të depërtojë një besim i ri ai Mohamedan (Musliman), besim që erdhi së bashku me pushtimin turk. Ndoshta nga detyrimi, ndoshta për karrierë. Elementë të veçantë dhe krerë shqiptarë filluan të përqafojnë këtë besim të ri, për të ardhur në shekujt XVI-XVII.
kur ky besim do të bëhet masiv për popullsinë shqipëtare.
Pushtuesit përdornin politika të tilla që të nxisnin myslimanizimin e popullsisë shqiptare sa më shpejtë. Dhe për ti mbajtur të nënshtruar ata e nxisnin popullsin shqiptare në mosmarrëveshje njëri me tjetrin, duke konsideruar njerën palë si turke dhe tjetrën si të pa fe ose kaurre. Por popullit shqiptar do ti dilnin në mbrojtje bijtë e tij, siç ishin rilindasit. Këtu vlen të permendet thënia e Pasho Vasës "feja e shqiptarit është shqipëtaria". Kjo jo për të treguar se populli shqipëtar është i pa fe siç propogandonte historiografija komuniste, por se për shqiptarët fondamentalë ishte kombësia pavarsishtë se kujt feje i përkisnin.

[1] Q. Xhelili :"Vehbi Dibra personalitet dhe veprimtare I shquar I Levizjes Kombetare ",fq.195

Sami Frashëri thotë "në Shqipëri grindjet fetare nuk ndihen dhe kurrë në këto vende nuk ka ngjarë që midis myslimanëve dhe të krishterëve"[2]

Pra kjo tregon edhe një herë se shqiptarët jetonin në harmoni pavarësisht besimeve të tyre. Por politika përçarëse e pushtuesit kishte arritur deri aty sa ata nuk lejonin as martesat ndërmjet besimeve të ndryshme, varret i ndanin ndërmjet të krishterëve dhe myslimanëve. Megjithatë kjo politikë nuk mundi që ti verë shqiptarët kundra njëri- tjetrit. Këtë e tregon dhe fakti se populli ynë një popull kaq i vogël, por me një histori të madhe nuk u përfshi në ndonjë luftë fetare siç u përfshinë shtete të mëdha si Gjermania. Këto tipare janë evidente si para krijimit të shtetit të pavarur shqiptar, ashtu edhe gjatë periudhës 1912-1939 dhe pas çlirimit nga nazifashistët. "Në kohën e Rilindjes Kombëtare një pjesë e mirë klerikësh të shtresës së mesme dhe asaj të ulët që kishin gjak shqiptari devijuan nga urdhrat e klerikëve të lartë dhe si patriotë të vërtetë e vunë fenë në shërbim të çështjes kombëtare"[3]

"Besoj se dihet botërisht se shqiptarët janë tolerant ndaj besimit të tjetrit dhe Shqipëria është i vetmi vend në botë ku nuk janë zhvilluar luftra fetare"[4]. Udhëtarët e huaj theksojnë se shqiptarët jo vetëm që nuk janë prekur nga luftërat fetare por kur e ka kërkuar nevoja janë bashkuar.

"Ndryshe nga vendet e tjera të Ballkanit, shqiptari në fillim e quan veten shqiptar. Luftërat ndërmjet shqiptarëve kanë qenë luftra midis bejlerëve ku luftonte i krishteri me të krishterin dhe myslimani me myslimanin. Shqiptari mysliman dhe ai i krishterë përpara armikut janë bashkuar"[5]

Megjithatë shpallja e pavarësisë kërkonte një mobilizim të të gjithë besimtarëve."Shpallja e pavarësisë u shfrytëzua nga klerikët atdhetarë që të punonin e të ndikonin për të lëkundur fort identifikimin e fesë me kombësinë"[6]. Sikur të mos mjaftonin këta faktorë për të treguar tolerancën e bashkëjetesën midis besimtarëve të besimeve të ndryshme në vitet XX-të në Shqipëri vendoset kryegjyshata botërore e bektashinjeve. E ndërsa bektashinjtë nuk shkonin në Turqi për arsye të ndryshme me myslimanët, populli shqiptar, i cili vazhdonte akoma të jetonte në paqe midis besimeve të ndryshme pranon këtë besim të ri të vendosë qendrën e tij në Shqipëri. Populli shqiptar i ndarë nga katër lloje besimesh të ndryshme vazhdonte të jetonte akoma në paqe dhe pa urrejtje ndërmjet komuniteteve të ndryshme fetare.

Me krijimin e shtetit të ri shqipëtar më pas në Shqipëri, besimi bëhet i lirë dhe nuk përcaktohet një fe zyrtare, gjë që vazhdon edhe në ditët tona. Në shoqërinë shqiptare ka pasur dhe ka një vetëdije politike mjaft të zhvilluar përsa i përket raporteve midis popullit dhe kombit nga njëra anë dhe fesë nga ana tjetër. Dhe këtë vetëdije ne e kemi trashëguar brez pas brezi. Për çështje kombëtare, për shkollën, për kulturën e për shkencën kanë luftuar në të njëjtën llogore si myslimanët dhe ortodoksët, si katolikët dhe bektashinjtë. Në veprimtarinë e madhe në shërbim të kombit shqiptar nuk mund të ndahet veprimtaria e Budit, Bardhit dhe Bogdanit që ishin katolikë nga ajo e rilindasve ortodoks De Radës dhe Darës. Apo veprimtaria e Petro Nini Luarasit e Pandeli Sotirit që ishin ortodoksë nga ajo e Bajo e erçiz Topullit që ishin mysliman, apo veprimtaria e vëllezërve Frashëri si bektashinj. Ne krenohemi si me Nolin që është ortodoks ashtu edhe me Konicën që është mysliman. Kjo tolerancë do të vazhdojë të egzistoj edhe në vitet e ndërtimit të shtetit shqiptar gjatë periudhës së viteve 12 –39. Kjo duket dhe në politikë ku krerë të shtetit apo anëtarë të qeverisë ishin gjithmonë pjestarë të katër besimeve egzistuese në Shqipëri. Kjo duket edhe në zakonet popullore ku në dasmën e një myslimani vinte për të uruar si ortodoksi ashtu edhe katoliku.

[2] S.Frasheri:"Shqiperia cka qene ceshte e cdo te behet",fq.39
[3] Q. Xhelili:"Vehbi Dibra, personalitet dhe veprimtare I shquar ilevizjes kombetare" fq 194
[4] F.Konica:"Shqiperia kopeshti shkembor I Evropes juglindore"fq134
[6] Q.Xhelili :Vehbi Dibra personalitet dhe veprimtare I shquar I levizjes kombetare", fq. 194

Po ashtu në vdekjen e një ortodoksi gjendej pranë një mysliman. Kulmin kjo tolerancë do ta arrijë me martesën e mbretit shqiptar Ahmet Zogu që ishe mysliman me një të krishterë si Xheraldina. Këtë fakt e pranoi edhe populli shqiptar që në momentin e ardhjes së mbretëreshës doli dhe e priti me gëzim ndonëse 80% e popullsisë ishe myslimane.

E ndërsa në Shqipëri kemi këtë harmoni midis komuniteteve, në shtete të ndryshme të botës megjithëse me një shkallë të lartë civilizimi është ulur këmbë kryq urrejtja fetare si p.sh. në Irlandën e Veriut midis protestantëve e katolikëve, apo ai i baskëve në Spanjë, si në Indi ashtu edhe në Lindjen e Mesme, si në Nigeri ashtu edhe në Rusi. Pra Evropa e më gjerë ka se çfarë të marrë nga Shqipëria ashtu edhe Shqipëria ka se ç'tu japë këtyre shteteve pra çelësin e kësaj harmonie dhe tolerance fetare. Kjo tolerancë vazhdon edhe sot në ditët tona që pas rrëzimit të sistemit komunist, kohë kur në Shqipëri u njoh e drejta e besimit dhe liria e kulteve fetare.

Që nga kjo kohë ka vazhduar të egzistojë përsëri ku populli shqiptar vazhdon të jetojë në një liri të gjerë besimi. Kjo tolerancë duket edhe në jetën politike ku lufta politike nuk ka marrë kurrë ngjyra fetare, po ashtu edhe në jetën e përditshme të njerëzve si në martesa ku ato lejohen e janë të përhapura në masë midis besimeve të ndryshme, po ashtu edhe në varret ku shqiptarët nuk varrosen të ndarë sipas besimeve. Pa u ndalur më në këtë çështje duhet thënë se në vlerat e botës shqiptare ka diçka të veçantë që e pohojmë ne, por dhe që e njohin të tjerët. Kjo është toleranca fetare.

2**. Tolerancë apo indiferentizëm fetar.**

Kjo është një çështje për të cilën janë rrahur mendime të ndryshme dhe për një kohë të gjatë. Natyrisht mendimet kanë qenë të ndyshme për vetë faktin se autorë të ndryshëm e shikojnë këtë fenomen të shqiptarëve jo si diçka pozitive të kultivuar tek ata për shekuj me radhë, por si diçka që është karakteristikë për shqiptarin, ky është indiferentizmi fetar. Pra indeferentizmi ka përfshirë edhe fushën e besimit. Këta autorë e quajnë indiferentizëm të shqiptarit lejimin e depërtimit të besimeve të ndryshme në Shqipëri. Ata indiferentizmin e shikojnë edhe tek ajo, se kur shqiptarit i është kërkuar që të heqë dorë nga një fe dhe të besojë në nje fe tjeter e ka bere kete pa hezitim. Apo rasti tjeter kur ju kerkua qe te mohoje besimin plotesisht ne sistemin komuninst, ai e pranoi menjehere duke treguar se nuk i interesonte feja. Se gjoja shqiptari shikon interesat e tij ekonomike apo politike e në fund vendos fenë. Në këtë linjë futet edhe një argumentim se shqiptarët janë indiferent dhe nuk besojnë në Zot, se në rast të kundërt ata do të bëheshin besimtarë fanatikë dhe nuk do të ishin tolerantë ndaj besimeve të tjera. Dhe këtu fusin atë argument që ka të bëjë me"Luftën e shenjtë apo xhihadin, që në vetevete konstaton në përhapjen e islamit në tërë botën pra dhe mbi kahuret apo të pafetë"[7]."pra në mësimet e kuranit egzistonte gjendja e luftës së vazhdueshme dhe se kjo do të merrte fund kur islami të pushtojë gjithë botën"[8]. Atëhere shqipëtarët po të zbatonin udhëzimet e kuranit do të ishin në luftë me të krishterët ashtu siç janë në shumë vende të botës. Por këto argumenta bien poshtë se në radhë të parë vetë"mësimet e islamit nga ana tjetër janë të shoqëruara me zbatimin e tolerancës fetare. Dhe kjo duket me anë të kompromiseve që bëri Muhamedi në Medinë për ti futur të krishterët dhe hebrejtë në rrjedhën e jetës së përditshme"[9]. Pra shqiptarët jo se ishin indiferentë apo nuk ishin besimtarë të mirë por se ata respektonin besime të tjera ashtu siç i respektojnë

[7] I. Caushi, Ll.Filo : "Ngritja dhe renia e civilizimeve" fq 139
[8] Po aty.fq 139
[9] Po aty.fq 137

edhe sot."Shqipëtarët ndryshe nga besimtarët e tjerë myslimane e shikonin fenë myslimane si mbartëse të tolerancës fetare. Vehbi Dibra thotë se në pasazhet e kuranit fryn erë tolerance sepse në ato shprehet qartë se popujt islamikë nuk kanë të drejtë ekskluzive dhe absolute, ata nuk janë të zgjedhurit e perëndisë, përpara saj të gjithë popujt janë të barabartë"[10]. Dhe nuk është e rastit që katër udhëheqësit e komuniteteve fetare në Shqipëri dalin shpesh herë bashkë në ambjente publike bashkë. Kjo tregon se respektimi dhe toleranca ndaj besimit tjetër është në shkallë të lartë, gjë që duhet vlerësuar dhe jo të thurësh arsyetime të tilla që të hedhin poshtë këtë veti që e kanë vetëm shqiptarët. Fakt është se në Shqipëri nuk ka patur dhe nuk ka ndonjë organizatë fondamentaliste që të mbrojë në mënyrë fanatike besimin përkatës.po ashtu dhe fakti tjetër që ka të bëjë me vitet e fundit ku në Shqipëri pas hapjes që bëri ndaj kulturave perëndimore, në Shqipëri depërtuan dhe shumë sekte urdhëra fetare. Kjo tregon edhe një herë se shqiptarët janë tolerantë dhe lejojnë lirinë e besimit të çdo individi.Vlerat e këtij kohezioni dhe tolerancës fetare dolën edhe një herë në dukje pas goditjes që mori Amerika më 11 shtator 2001, ku i akuzuari kryesor ishte një mysliman, që gjoja luftonte për "Xhihade". Populli shqipëtar që në shumicën e tyre ishin myslimane u solidarizuan me popullin amerikanë duke dënuar këtë veprim.

3. Konkluzione.

Bazat e tolerancës fetare në Shqipëri janë thellësisht të rrënjosura në traditat dhe kulturën shoqërore dhe nuk burojnë nga vetëdija, njohuritë, apo ushtrimi i riteve fetare. Laicizmi dhe mosndërhyrja e shtetit në besimin fetar është veçori dhe tipar dallues jo vetëm nga shoqëria por edhe nga studiues vendas dhe të huaj.

Faktori më i rëndësishëm që mbështet tolerancën fetare në Shqipëri argumentohet se është kultura e përbashkët e bashkëjetesës fetare që bashkon myslimanët, të krishterët dhe jobesimtarët.

Shqiptarët nuk kanë një fe mbizotëruese, "Feja e shqiptarit është shqiptaria" slogani që ka rrugëtuar përkrah shqiptarëve dhe vazhdon të jetë evident edhe në ditët e sotme.

Pa e zgjatur më tej me fakte ne nuk na mbetet gjë tjetër veçse ta mbrojmë dhe ta çojmë më tej tolerancën fetare, si tipar të vetëdijes kombëtare. Ajo përbën një pasuri me të cilën populli shqiptar mund të krenohet si dhe bota ka se çfarë të mësoj nga shoqëria shqiptare.

Literatura:

1) Durham, Edith : "*Brenga e Ballkanit",* Shtepia Botuese "Argeta", Tirane 1998
2) Frasheri, Sami : "*Shqiperia c`ka qene c´eshte e c´do te behet",* Tirane 1962
3) Konica, Faik : "*Shqiperia kopeshti shkembor I Evropes Juglindore",* Tirane 1993
4) Konica, Faik :" *Vepra 1*", Tirane 2001
5) Sulo, Ilira & Filo Llambro: "*Ngritja dhe renia e civilizimeve*", Tirane 2002
6) Qiriazi, Dhori :"*Krishterimi ne Shqiperi*" Tirane 2000
7) Xhelili, Qazim*"Vehbi Dibra, personalitet dhe veprimtar I shquar I Levizjes Kombetare",* Tirane 1998

[10] Q. Xhelili: "Vehbi Dibra, personalitet dhe veprimtar I shquar I levizjes kombetare" fq233

AFP-TË SI MJET I PAVARUR DREJT KARRIERËS

Dr. Marjeta Shaholli,

Kolegji Universitar i Biznesit

Abstrakt.

Ndër zgjedhjet e para në jetën e njeriut është zgjedhja e arsimit dhe më tej e profesionit. Ndërsa para viteve '90 zgjedhjet ishin të ndërthurura si arsim professional ashtu edhe arsim i lartë, kjo e ndikuar edhe nga partia-shtet por edhe kushtet e përgjithshme të punësimit. Pas viteve '90 arsimi profesional humbi pikë në përzgjedhje nga të rinjtë. Arsimi dhe formimi profesional duhet të ishte zgjedhja e parë e të rinjve për integrimin sa më shpejt në tregun e punës, për arsyen se arsimi profesional është një mjet i drejtëpërdrejtë për marrjen e një kualifikimi dhe punësim i shpejtë në tregun e punës. Por mungon lidhja e drejtëpërdrejtë midis tregut dhe arsimit e formimit profesional.

Me miratimin e Strategjisë Kombëtare për Punësimin dhe Aftësimin u krijua kuadri ligjor gjithëpërfshirës nëpërmjet të cilit përcaktohen parimet udhëzuese dhe struktura e sistemit të AFP-së. Por ende ka mungesa të theksuara të aftësive dhe mangësitë aftësive në tregun e punës në Shqipëri. Pergjithësisht gjejmë që kjo mungesë vjen nga bashkëpunimi i pjesshëm midis tregut të punës dhe institucioneve arsimore të AFP.

Metodologjia: Punimi paraqitet në formën e analizës së mendimit dhe krahasimit të legjislacionit vendas dhe të BE.

Keywords: *aftësi, tregu punës, akte nën ligjore, strukturë mbështetëse, shërbime të dobishme.*

AFP-të si mjet i pavarur drejt karrierës.

Aristoteli e cilësonte rrënjët e edukimit si të hidhura por frutet e tyre të ëmbla.

Qëllimi kryesor i arsimit është përfitimi i aftësive specifike të cilat vihen në zbatim për realizimin e individit në planin personal. Mënyrat e realizimit mund të jenë të ndryshme, të cilat mund të zbulojnë herët prirjet por ka raste kur mund të nevojitet thellim apo studim më i angazhuar. Njëra prej mënyrave të realizimit personal është edhe karriera profesionale.

Karriera është profesioni i marrë përsipër nga individi për një periudhë të gjatë me mundësi për progres dhe rritje profesionale. Nëpërmjet saj individi arrin si realizimin personal por edhe realizimin profesional e ekonomik.

Si Shqipëria ashtu edhe Kosova kanë ende një popullatë relativisht të re në moshë, të aftë për punë por që si zgjedhje të par kanë vazhdimin e universitetit me qëllim ngritjen e karrierës. Një ndër pyetjet që përpiqemi të japim përgjigje nëpërmje tkëtij punimi është: Si duhet ndryshuar legjislacioni, cilat janë

strukturat apo manuale/ procedura që mungojnë dhe do të mundësonin lidhjen midis Tregut të punës dhe Arsimit?

Arsimi dhe Formimi Profesional nuk duhet parë thjesht si një mundësi për të krijuar bagazh paraprakisht për ndjekjen e fakultetit të njëjtës degë apo profil. Arsimi dhe Formimi Personal duhet pare si një mjet i vecantë, jo si një mënyrë për të vazhduar universitetit me njohuri të marra paraprakisht por si një rrugë e vecantë dhe e plotë për karrierën.

1. Mësim gjatë gjithë jetës apo të mësuarit gjatë.

Shpesh herë kemi dëgjuar apo jemi përballur me këshillën e kahershme, mëso një herë dhe tërë jetën do të punosh.

Por a është e frytshme, e arritshme dhe sa rendiment ka studimi i shkurtër për të arritur në një vend pune, ku nuk rritesh më profesionalisht. Mëson një proces pune për të qëndruar në të njëjtin stad profesional. Ndoshta pozicioni mund të të japë të gjithë mbështetjen financiare për të cilën ka nevojë individi dhe familja e tij. Këtu plotësohet njëri prej kritereve apo qëllimeve të punësimit, realizimi i të ardhurave. Por duke bërë këtë gjendemi me individë e punëmarrës mekanikë të cilët qëndrojnë në të njëjtin nivel aftësie profesionale. Pasojat negative të situatës janë disa por do të përmend vetëm dy; asnjë punëdhënësi nuk i nevojitet dikush që di të bëjë vetëm një proces pune, nëse është një punë mekanike shumë shpejt mund ta zëvendësojë me një makineri që kryen atë proces pune. Ndërsa nga ana tjetër vetë individi është një qënie e cila ndryshon mendim me kalimin e kohës, ndryshon qëndrime dhe interesa dhe të kryerit të të njëjtit proces pune nuk është më e mira e mundshme.

Nga ana tjetër, tendencat edhe të punëdhënësve janë të orientuara drejt trajnimeve dhe rritjes së vazhdueshme profesionale. Këto tendenca të ndikuara edhe nga orientimet e drejtuesve të Burimeve Njerëzore të cilët mbajnë qëndrimin e rritjes dhe trajnimit të vazhdueshëm. Drejtuesit preferojnë të zhvillojnë trajnime të vazhdueshme për të punësuarit e tyre, për ti rritur profesionalisht por edhe për të përmirësuar aftësitë e punës së përditshme.

Pra, zhvillimit eknologjik, tendencat e dyaftësimit të punëmarrësve si dhe trajnimi i vazhdueshëm përforcon idenë e qëndrimit të studimit dhe zhvillimit të aftësive përgjatë gjithë jetës.

2. AFP si mjet i pavarur drejt karrierës.

A duhet që AFP të mbetet thjesht një tjetër mjet drejt arsimit të lartë apo duhet të bëhet një rrugë e mëvetësishme, e pavarur drejt karrierës, e cila prodhon një forcë punëtore që është e aftë dhe e zhdërvjellët për të nxitur produktivitetin dhe rritjen ekonomike.

Sistemi shqiptar i AFP-së përbëhet nga dy shtylla të rëndësishme: AFP fillestare dhe formimi profesional si dhe AFP e vazhduar.

Programet e AFP fillestare në shkollat publike kanë një kohëzgjatje prej katër vitesh. Shumica e tyre kanë strukturën 2+1+1 që konsiston në formimin profesional bazë dy vjecar, një vit specializim dhe një vit faze konsolidimi. Në përfundim të këtij cikli nxënësit marrin një certifikatë si teknikë/drejtues të mesëm e cila korrespondon me Diplomën e Maturës Shtetërore Profesionale e cila mundëson kalimin në arsimin e lartë. Përpos tyre, nxënësit marrin një Certifikatë Profesionale "Punëtor gjysëm i kualifikuar" pas përfundimit dhe testimit nga arsimi profesional bazë (viti 2 të) dhe një "certifikatë si punëtor i kualifikuar" pas përfundimit me sukses të fazes së specializimit (viti 3 të). Këto certifikata janë një parakusht për të vijuar në nivelin tjetër të formimit, por edhe mundësojnë kalimin direkt në tregun e punës.

Opsioni tjetër është struktura 4 vjecare, e cila disponohet vetëm në pak fusha profesionale. Ky lloj programi parashikon vetëm testimet përfundimtare pas mbarimit të ciklit katër vjeçar. Provimet janë perfundimtare dhe certifikatat një lloj si strukturat 2+1+1 dhe 2+2. Provimi profesional përfundon me dhënien e certifikatës AFP si Teknik apo Drejtues i mesëm dhe provimi i maturës çon në Diplomën e Maturës Shtetërore Profesionale.

Një ndër parimet kryesore të legjislacionit shqiptar në fushën e AFP-ve është fleksibiliteti së bashku me autonominë, cilësinë, bashkëpunimin, pjesëmarrjen, lëvizshmërinë dhe diversitetin.

Këto parime gjenden edhe në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve, duke sanksionuar edhe se kualifikimet e të nxënit formal, joformal dhe informal gjatë gjithë jetës të përftuara përms programeve të formimit profesional mund të përfshihen në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve por edhe të njihen zyrtarisht. Por duke qënë se legjislacioni përkatës nuk është miratuar certifikatat e lëshuara nuk janë ende të harmonizuara sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Për shembull, validimi i nxënies së mëparshme joformale dhe informale është aktualisht i kufizuar për kualifikimet profesionale të niveleve 2-5 sipas KSHK-së dhe strukturat institucionale përkatëse nuk janë ngritur ende. Pra, mund të themi se ka një mospërputhje të madhe ndërmjet pritshmërive të përcaktuar në ligje dhe realiteti në zbatim i fleksibilitetit të sistemit të AFP-së.

Tjetër pengesë e arsimit të lartë është nota mesatare. Rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore dhe rezultatet e programit të mesëm të lartë përcaktojnë hyrjen ose jo në arsimin e lartë. Teorikisht, fleksibiliteti brenda llojeve të ndryshme të arsimit është e mundur, por mënyra se si secili nënsektor i arsimit është strukturuar nuk ofron mundësi të mjaftueshme për mobilitet dhe fleksibilitet. Njohja e aftësive profesionale të përftuara jashtë sistemit formal të arsimit dhe formimit janë të parashikuar në legjislacion por ende të pa mundura për tu realizuar, si shkak kryesor mungesa e institucioneve përkatëse.

3. Format duale të të nxënit.

Përgjatë viteve ka pasur disa herë reforma dhe politika sociale për të përfshirë në skemat e të nxënit edhe mësimin me bazë punën. Por në një studim të vitit 2017 të UNDP-së ku u shqyrtuan 18 ofrues publikë dhe privatë të AFP-së, studimi identifikoi gjashtë modele të ndryshëm të të nxënit me bazë punën dhe mori në vlerësim potencialin e tyre në tërësi kriteresh. Përfundimi i këtij studimi nxorri në pah se bashkëpunimi me sektorin privat zhvillohet mbi baza informale dhe të pastrukturuar. Gjithashtu studimi vë në dukje se mungojnë rregulla të mirë strukturuara të instrumentave të matjes së performancës për të përmirësuar cilësinë e ofrimit të trajnimit.

Në përgjithësi për këtë çështje ana dhe aspekti i kornizës juridike pak ka nevojë për ndryshim apo plotësim. Mendoj që ka nevojë për studim nga ana sociologjike e çështjes më shumë se një trajtim juridik nëpërmjet kërkimit shkencor.

Por përse AFP nuk janë tërheqëse për të rinjtë si zgjedhje të parë për karrierën e tyre? Përse prindërit nuk orientojnë fëmijët e tyre në një rrugë të shpejtë aftësimi profesional të vazhduar? Përse mungon lidhja midis tregut të punës dhe të rinjve që kërkojnë punë apo të zhvillojnë një karrierë?

Këto çështje për diskutim mund të jenë temë punimi dhe kërkimi shkencor nga të tjerë studiues.

4. Konkluzione.

Në vijim të sa diskutuar dhe analizuar më lart kam arritur në përfundimet e mëposhtme:

- Ka nevojë për përmirësimin e standarteve profesionale dhe të kualifikimit në standarte vlerësimi në mbështetje me specialistët e sektorit dhe ekspertëve të fushës në sektorin privat, për garantimin e provimeve sipas nivelit të përshtatshëm për të verifikuar kompetencat profesionale të kandidatëve. E realizuar kjo edhe periodikisht në kohë në cikle 5-vjeçare psh. Kujtoj këtu procedurën e kualifikimit profesional të arsimtarëve (5-vjeçar, 10-vjeçar dhe 20-vjeçar).
- Është e nevojshme hartimi i një moduli për trajnimin e vlerësuesve: për të trajnuar aftësitë e mësuesve/instruktorëve por edhe për të kualifikuar një grup vlerësuesish të jashtëm nga industria.
- Ka nevojë për pjesëmarrjen e nxënësve në bordin drejtues të AFP-së. Përfshirja e tyre si pjesëtarë të institucionit duke marrë përsipër përgjegjësitë dhe dhënien e kontributit në përmirësim. Këshillimi mes nxënësve, ku nxënësit më të mëdhenj me përvojë në AFP ofrojnë mbështetje nxënësve më të rinj në momentin e marrjes së vendimit për karrierën.
- Konsultimi me sektorin privat/ Tregun e punës pë rmënyrën se si koncepti aktual i Maturës të bëhet më i orientuar drejt formimit profesional. Gjetja e mjeteve alternative për të diplomuarit që nëpërmjet AFP-së të shkojnë drejt pozicioneve drejtuese të nivelit të mesëm dhe të lartë apo nëpërmjet vlerësimit periodik në punë të mund të përfitojnë diploma universitare.

Bibliografia dhe literature:

Abele, AE, T. Hagmaier, and D.Spurk 2016. Does career success make you happy? The mediating role of multiple subjective success evaluations. Journal of Happiness Studies 17:1615-1633 ; https://doi.org/10.1007/s10902-015-9662-4 . A të bën të lumtur karriera dhe suksesi? Roli ndërmjetësues i vlerësimeve të shumta subjektive të suksesit. (parë më 25/05/2022)

Austraian Government n.d. National career development strategy. https:docs.education.gov.au/system/files/doc/other/national_career_development_strategy.pdf. (paree mee 24/05/2022)

Castleman, T. and M. Allen 1995 The forgotten workforce: Female general staff in higher education. Australian Universities Review 38 (2): 65-69; Forca e punës e harruar: Stafi i përgjithshëm femër në arsimin e lartë.

Flynn, S.V., and K.J Duncan, and L.L.Evenson. 2013. An emergent phenomenon of American Indian secondary students' career development process, 124-140. Një fenomen emergjent i procesit të zhvillimit të karrierës së studentëve të shkollave të mesme indiane amerikane.

Gottfredson, L.S. 1981. Circumscription and compromise: A developmental theory of occupational aspirations. Journal of Counseling Psychology 28: 545-579.Rreth shkrimi dhe kompromisi: Një teori zhvillimore e aspiratave profesionale.

Graham, C. 2009. Investing in early career general staff/ Investimi në stafin e përgjithshëm të karrierës së hershme. Journal of Higher Education Management and Policy 31 (2): 37-41. https://doi.org/10.1080/136008009028258 (parëmë 20/05/2022)

Higher Education Academy. 2011. The UK Professional Standards Framework for teaching and supporting learning in higher education 2011.Kuadri i Standardeve Profesionale të Mbretërisë së Bashkuar për mësimdhënien dhe mbështetjen e të nxënit në arsimin e lartë 2011. Retrieved from https://www.heacademy.ac.uk/system/files/downloads/uk_professional_standards_framework.pdf(parëmë 25/05/2022)

Ligji nr 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"

Ligji nr. 10247/2010 "Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve" i ndryshuar me ligjin 23/2018.
Procesi i Torinos 2018-2020, Shqipëria, Raporti Kombëtar, faqe 8.

Shtojca nr. 1, ligji nr 23/2018 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10247, dates 04/03/2010, "Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve".

Udhëzimi i përbashkët nr. 6, i dates 24/02/2015 "Për kriteret dhe procedurat e përgjithshme për rekrutimin e stafit mësimdhënës të lëndëve teorike dhe praktike në ofruesit publikë të arsimit dhe formimit profeisonal".

UNDP: Studim fizibiliteti i skemave të të nxënit me bazë punën në Shqipëri, 2017.
Vështrim i përgjithshëm i sistemit të arsimit të lartë në Shqipëri, 2017, Komision i Europian, Erasmus+, faqe 8.

THE DIFFERENCES OF THE HIGHER EDUCATION IN ALBANIA TO EUROPEAN UNION.

Msc. Altea Sulaj

alteas124@gmail.com

Technische Universität Ilmenau, Germany

Abstract.

For young students in Albania being able to study abroad is a great opportunity, but for the country means that there is a tendency for intellectuals to go away from investing in their country academically.

In this research paper I have analyzed the differences that the higher education systems in some of the EU countries have and why they are more interesting to Albanians. By being able to understand these differences we can work into having a better higher education system so Albania can be closer to its European dream and be on the same level as other academic institutions in the EU.

1.An Overview of the Albanian Higher Education System.

The Albanian education system is a part of the Bologna System that is divided in bachelor's degree for three academical years and a master's degree for one and a half or two years. The masters that are offered are usually Master of Science of Arts and Professional ones. If someone wants to dive into the academical journey they can deepen their knowledge with the possibility of a Ph.D. This gives the opportunity to everyone that sees themselves in the academic life be able to pursue it. (EACEA, 2012)

After the hardships of 50 years of communism the Albanian higher education system had to undergo different changes through the years and in the year 2012 it undertook the transformation into the Bologna System, which makes it more compatible to the degrees offered in the European Union. The importance that every Albanian prime minister has given to the possibility of being part of the EU has been enormous and this is the reason why most of the youth of the country has its eyes directed at the more developed countries especially when it comes to education.

In the Albanian university education are around 15 public and 26 private Universities and Academies, where altogether the number of the students were around 123.880 in the year 2021. (Instituti i Statistikave Tirane - INSTAT, 2021).

2.The Problems that the Albanian Higher Education System Faces.

In the official ranking of universities in the world the Albanian ones are always not that high in comparison to some of it's different ones in Central Europe. (Universities)

Some of the most talked about problems that the education system must face have to do with corruption and scandals about dubious diplomas offered. In 2014 the administration had to close 18 universities because of a report that uncovered the scandal of dubious diplomas given to students that were dubious. These were called the "diploma factories inAlbania". (Balkaninsight, 2014).

Research of the Project Against Corruption in Albania (PACA) has brought to life some of the biggest concerns in the higher education system in Albania. The first recommendation consisted of the standards for the schoolteachers followed by the need to make teaching an attractive career for young professionals and the concern about the recruitment ways that sometimes might have to do with corruption. (Project Against Corruption in Albania, 2012)

3.Brain Drain: The Migration of Students from Albania.

It isn't just a trend of the last 20 years, but usually the academic elites throughout history have been formed in different countries outside of Albania. After the year 2000 with the transition in full force the need to study abroad for the Albanian youth it was a growing curve. In 2017 Albania had the largest number of International Students per 1000 residents.

In a survey of Albanian students studying abroad, what these young people appreciated from the universities outside of their home country was the possibility of attending a world class university, different opportunities of study fields, the push from their family and the prospect of having an international career in the future. (Gerdeshi & King, 2020).

The latest data from UNESCO show that the countries that the youth of Albania mostly go tostudy are Greece, Italy, Germany, Turkey, and the United States of America. This is a mixture of countries that they are close by and the countries where the most of Albanian Diaspora lives in. (UNESCO, 2021)

4.The Italian Higher Education System

The Italian higher education system consists of Universities, The Higher Education for Fine Arts, Music and Dance sector (AFAM) and Higher Technical Institutes (ITS). There is a possibility of studying in public and private universities. (Study in Italy)
The Albanian students who want to study in this country can enroll in it if they fulfill the criteria according to the University. To be able to study after admission they must get a visaat the Embassy of Italy in Albania.

The different degrees offered in very prestigious institutions and affordable fees is an advantage for the students that come from developing countries like Albania. The possibilities of pursuing a degree in a country where the highlight of architecture, fashion and history is located is alluring for everyone. The Albanian students that don't have enoughfinancial opportunities are also illegible for scholarships.

5.The Greek Higher Education System.

The higher education system in Greece consists of Universities and Technological Sectors. The University has three different branches Universities, Technical Universities and The School of Fine Arts. The technological part of the higher education system is created from The Technological Education Institutions (TEIs) and The School of Pedagogical and Technological Education (ASPETE). (European Education Directory)

Different Universities are focused on different aspects of the academics, and this is the reason why everyone can find everything they want to. The immigrants in Greece from Albania consist of a large number and this is a reason why a lot of young people want to beable to study near their families.

6. The German Higher Education System.

In Germany there are different possibilities of pursuing a higher education when you havestudied in Albania until high school. Before 2017 you had to do an extra year for the high school diploma to be known in the German system, but since 2017 you only need to have the High School Diploma and the admission is possible.
There are different kinds of universities between public and private ones. They are divided into Universities, Universities of Applied Sciences, Schools of Art, Film and Music and Duales Hochschule. There are more than 20'000 study programs offered which can make it possible for everyone to find the ones that fit.
The semester fees are relatively low in public universities where they can vary from 200-600 per semester. Which is an advantage for the students from Albania, who might have to work and fund themselves. (Ministry of Education and Research, 2022)

Conclusion:

In conclusion what we might see is that the different EU countries offer varieties of study degrees and research fields, where the Albanian Higher Education System lacks. This is one of the reasons why a lot of young ambitious students seek a more professional education abroad. Unfortunately, a lot of the youth that migrates don't want to come back to their homecountry which has a big negative impact on the economic development of the country.
The solution to this problem can be achieved through hard work of the institutions so thatthey can actually complete the demand for a better education to the students.

References:

Balkaninsight. (2014, August 7). *Balkaninsight*. Retrieved from https://balkaninsight.com/2014/08/07/albania-axes-suspected-diploma-mills/

Dr. Tomi Treska, D. E. (2013). Albanian "Bologna" How close/far is Albanian Higher Educaiton to European Standarts. *Vol 4 No. 10* , 666-674.

EACEA. (2012). Higher Education in Albania.

European Education Directory. (n.d.). *EuroEducation* . Retrieved from https://www.euroeducation.net/prof/greeco.htm

Gerdeshi, & King. (2020, Novermber). The actual and potential migration of students from Albania: a putative Brain Drain? Tirana, Albania.

Instituti i Statistikave Tirane - INSTAT. (2021). *Instituti i Statistikave Tirane*. Retrieved from http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/START_ED_REG/Ars004/table/tableViewLayout1/

Project Against Corruption in Albania. (2012). *UNDERPINNING INTEGRITY IN THE ALBANIAN EDUCATION SYSTEM: COMPILATION OF PACA OUTPUTS* . Albania.

Study in Italy. (n.d.). *Study in Italy*. Retrieved from https://studyinitaly.esteri.it/en/the-italian-higher-educaton-system

UNESCO. (2021). *Global Flow of Tertiary Level Students*. Retrieved from http://uis.unesco.org/en/uis-student-flow

Universities, R. W. (n.d.). *Ranking Web of Universities*. Retrieved from Webmetrics: https://www.webometrics.info/en/Ranking_Europe

NDIKIMI I KANCERIT TË GJIRIT TEK TË SËMURËT E MBIJETUAR DHE FAMILJARËT E TYRE.

Dr. Orneda GEGA
Aleksander Moisiu University Durrës,
Faculty of Education, Albania,
gegaorneda@gmail.com

Abstrakt.

Kanceri i gjirit është një nga shkaqet kryesore të sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë për gratë në të gjithë botën, situata e krijuar nga COVID-19 ka shtuar pasojat psiko-sociale në përballimin e kancerit të gjirit.
Ky punim ka si qëllim identifikimin e pasojave psiko-sociale në përballjen me kancerin e gjirit. Objektivat e studimit janë: 1: Të eksplorohet jeta personale dhe emocionale e femrave para diagnostikimit me kancer gjiri, eksperienca e jetuar e tyre gjatë kësaj perjudhe, përshirë perjudhën e Pandemisë. 2.Të identifikohet fazat më të rëndësishme gjatë diagnostikimit të sëmundjes. 3. Të identifikohet gjëndja psikosociale e femrave me kancer gjiri gjatë diagnostikimit dhe gjëndja psikologjike e familjarëve. 4. Të vlerësohen impaktet që kanë përjetuar këto gra në jetën e tyre, zakonet e jetës, lidhja familjare (mes bashkëshortëve, prind-fëmijë).

Është zbuluar nga të mbijetuarat e intervistuara se si ka qënë personaliteti i këtyre grave dhe a ka ndikuar ai në kalimin e sëmundjes dhe fazave të saj. Të mbijetuarat raportuan histori me ndryshime pozitive dhe negative të shoqëruara me dyshime dhe frikë si dhe rinovimin e marrëdhënieve dhe prioriteteve të ndryshme. Historitë e ndara në këtë punim ndihmojnë në kuptimin e gjendjes së të mbijetuarave me kancer gjiri në realitetin shqiptar, sidomos gjatë kësaj perjudhe të vështirë të Pandemisë. Gjithashtu, informacioni i ndarë mund të informojë praktikën e këshillimit për ofrimin e mbështetjes dhe për të promovuar kujdesin shëndetësor tek gratë të cilat kanë mundësi prekje nga kjo sëmundje.

Fjalët kyçe: *1) Kancer Gjiri, 2) Grua, 3) Pasoja psiko-sociale, 4) Sfida, 5) Covid-19*

Hyrje.

Ai që të gjithë vlerësojnë në jetë është shëndeti, pa të asgjë nuk do të kishte kuptim. Nuk ka mënyrë të mirë për të marrë lajmin që ti je me kancer, sido që të thuhet ai është tronditës. Kanceri i gjirit është cilësuar si vrasësi i parë i cili shkakton vdekjen tek gratë. Sipas vlerësimeve, më shumë se 7 milion njerëz në botë vdesin nga kanceri (National Library of Medicine, 2022). Kanceri i gjirit është një sëmundje që përfshin pacientin, familjen dhe komunitetin dhe harxhon shumë burime financiare dhe shpirtërore. Ky kancer zhvillohet në indet e gjirit duke përfshirë kanalet (tubat e vegjël që mbajnë qumështin) dhe lobulat (gjëndrat prodhuese të qumështit). Në Shqipëri kanceri i gjirit ka tendencë në rritje. Ai prek afro 600 gra dhe vajza në vit, prej të cilave një e treta humb jetën (Zëri Amerikës, 2018). Gjatë pejudhës së COVID - 19 studimet kanë nxjerrë si rezultatet se gratë që u pushuan nga puna ose nuk ishin në gjendje të vazhdonin punën raportuan pasiguri më të lartë në punë krahasuar me ato që kishin punuar gjatë gjithë pandemisë. Përtypja më e madhe u shoqërua gjithashtu me ankth dhe depresion më të keq, si dhe me funksion më të dobët njohës (Champan et al., 2020) Kanceri i gjirit është cilësuar ndryshe si sëmundja e shekullit i cili po prek gjithnjë e më shumë gratë. Kjo sëmundje sjell pasoja të shumta në jetën e personit duke shkaktuar si problem shëndetësore por edhe probleme psiko-sociale. Komunikimi i diagnozës së kancerit të gjirit mund të ndryshojë jetën e personit përkatës. Një ndryshim i tillë është i vështirë për tu përballuar. Është normale për vetë personin, për familjen dhe për miqtë që ka pranë që të kenë nevojë për të përballuar ndjenja të cilat një diagnozë e tillë sjell. Shqetësimet rreth trajtimeve dhe menaxhimit të efekteve anësore të tyre, qëndrimet dhe vizitat e shumta në spital dhe recetat mjekësore janë të zakonta dhe të shpeshta kur personi diagnostikohet me këtë sëmundje. Gjithashtu, pavarësisht këtyre personi duhet të shqetësohet dhe të kujdeset në të njëjtën kohë jo vetëm për sëmundjen që e ka prekur por edhe për përkujdesin ndaj familjes, për të mbajtur punën dhe për vazhdimësinë e angazhimeve të përditshme të jetës. Gruaja e prekur me kancer gjiri i frikësohet faktit që të qenit me kancer gjiri nuk do të ndikojë vetëm në pamjen e saj të jashtme, por edhe se si të tjerët do ta shohin dhe do të reagojnë rreth saj. Të mbijetuarat e kancerit të gjirit përballen dita ditës me frikën e rikthimit të sëmundjes. Për këtë arsye ato kanë nevojë për mbështetje dhe përkujdesje. Vështirësia e përballimit të një gjendje e cila duket e papërballueshme sa vjen dhe rritet dita ditës për këto femra por gjendja e fortë emocionale, optimizmi, inkurajimi dhe shpresa bën që një diagnozë si "kanceri i gjirit" të kalohet me sukses. Të mbijetosh do të thotë të jesh i fortë.

Rishikimi i Literaturës.

Kanceri i gjirit është një tragjedi individuale për të prekurit. Aksesi në kujdes me cilësi të lartë që çon në diagnostikimin e hershëm; në trajtimin e duhur kirurgjik dhe mjekësor mund të nënkuptojë ndryshimin midis jetës dhe vdekjes (N.S. El Saghir, et.al.,2012). Trajtimi i duhur kirurgjik kërkon pajisje të përshtatshme të sallës së operacionit dhe ofrues të kujdesit shëndetësor shumë të kualifikuar. I gjithë trajtimi i sofistikuar i kancerit të gjirit kërkon burime të patologjisë së përparuar, përfshirë imunohistokiminë dhe analizën patologjike molekulare. Terapitë e reja të synuara mbeten një fushë në zhvillim, ku vetëm një gjë është e sigurt: kostot individuale të trajtimit tashmë po kërcënojnë sistemet më të mira të kujdesit shëndetësor të financuara (N. Elster, et.al., 2015).

Cilësia e përgjithshme e instrumenteve të jetës mund të japë informacion të vlefshëm dhe të lejojnë krahasimin midis cilësisë afatgjate të jetës së pacientëve me kancer dhe të individëve të shëndetshëm. Ekzaminimi në cilësinë e jetës në të mbijetuarit e kancerit të gjirit me periudhë të gjatë është e nevojshme që për shkak të të mbijetuarave afatgjatë mund të ballafaqohen me efekte anësore të trajtimit të cilat mund të zgjasin për disa vite ose shqetësime të reja të kancerit lidhur me periudhën kohore e cila mund të zhvillohej me kalimin e kohës. Këto shqetësime kanë shfaqur një ndikim të drejtpërdrejtë në cilësin e jetës (Bloom, et.al, 2004).

Sipas studimit të Musche (Musche et al., 2020) nevojiten ndërhyrje specifike për të parandaluar ankthin dhe për të përmirësuar shëndetin mendor gjatë pandemisë COVID-19.

Ndikimi i COVID-19 në sëmundjen e kancerit të gjirit.

Pandemia COVID-19 po vazhdon të përballet me institucionet e kujdesit shëndetësor në të gjithë botën me sfida të pashembullta klinike dhe operacionale. Kjo është një situatë e jashtëzakonshme pasi ata u përpoqën dhe po përpiqen të kujdesen për pacientët me COVID-19, por gjithashtu vazhdojnë të kujdesen për pacientët e tjerë. Shumë gra, nga frika e infektimit me COVID – 19, anulojnë takimet e tyre me një efekt të paparashikueshëm në numrat e rasteve të kancerit të gjirit në të ardhmen. Departamentet e mamografisë në spitale u përballen me sfida krejtësisht të reja, si detyrimi për të ndryshuar rutinat dhe rrjedhat e punës për të qenë në përputhje me standardet e reja sanitare, për të rregulluar emërimet e tyre ose për të futur metoda të reja diagnostikuese si konsultat mamografike. Klientët tanë po përballen me kohë sfiduese (Siemens-Healthineers; 2020). Nga ana tjetër, në disa vende pothuajse kanë ndaluar kontrollimin dhe diagnostikimin e gjirit, spitale të tjera në mbarë globin kanë përparësi dhe trajtojnë vetëm pacientët që kanë nevojë për kujdes urgjent. Rënia e madhe në shqyrtimin e kancerit të gjirit ka shqetësuar ekspertët për një kërkesë të madhe dhe një shpërthim në diagnozat më të rënda, kur hiqen kufizimet. Sapo programet e shqyrtimit të rikthehen përsëri, me siguri do të shohim tendosje të mëtejshme në departamentet e mamografisë, të cilat shpesh luftonin për të mbajtur me kërkesën edhe para pandemisë (Siemens-Healthineers, 2020).

Kriza e COVID-19 jo vetëm që ka prishur shërbimet onkologjike por ka kërkuar më tej grupe ekstremisht të ndjeshme që të ndjekin udhëzimet e mbrojtjes sociale për mbrojtjen e tyre.

Nga kjo rrjedh se ndryshime të tilla mund të shkaktojnë shqetësime të mëtejshme në këtë popullatë mbi efektet e stresit të lidhur me COVID-19. Gjetjet e studimit realizuar në vitin 2020 (Swainston et al., 2020) së pari tregojnë se ata që përjetuan ndërprerje të shërbimeve të tyre onkologjike kishin nivele më të larta të ankthit të përgjithshëm, depresionit dhe ndjeshmërisë emocionale të lidhur me COVID-19. Për fatin e keq është e paqartë për sa kohë do të preken popullatat e prekshme nga ndikimi i krizës COVID-19; megjithatë, pasojat mund të jenë të rënda. Ndikimi i shpërthimit të COVID-19 është thelbësor për të mbështetur popullatën e kancerit të gjirit për të ecur përpara.

Metodologjia.

Metoda kërkimore që është zgjedhur për realizimin e këtij studimi është kërkimi cilësor. Instrumenti i përdorur në këtë studim është intervista. Intervista është e ndarë në tre seksione ku secili seksion ka pyetjet specifike. Seksioni i parë, është i lidhur me gjendjen e të mbijetuarave para se të

diagnostikoheshin. Seksioni i dytë, ka të bëjë me gjendjen emocionale dhe fizike të të mbijetuarave ne momentin e diagnostikimit. Seksioni i tretë, lidhet me gjendjen psikologjike pas diagnozës.

Secili seksion ndahet në nënçështjet specifike. Përveç një seksioni social-demografik pyetjet e bëra në intervistë pasqyrojnë çështjet tematike të organizuara në seksione, duke filluar nga: Karakteristikat e personalitetit të të mbijetuarave, gjëndja shëndetësore e tyre, përjetimet në momentin e diagnostikimit me kancer gjiri, marrëdhënia me familjen dhe njerëzit e afërm, gjëndja emocionale gjatë kurimit, ndikimi i sëmundjes në jetën aktuale, ndryshimet në jetën private dhe sociale, lidhjet dhe ndjesitë me personat e së njëjtës sëmundje. Për realizimin e këtij studimi është përdorur kampionimin në formë orteku. Qëllimi i punimit është të identifikojë pasojat psikosociale në përballjen me kancerin e gjirit. Ky studim do të përfshijë edhe marrëdhëniet që kanë këto gra me familjarët, të afërmit, miqtë e tyre dhe të eksplorojë mbështetjen që ato kanë marrë nga këta persona. Pjesëmarrësit në studim kanë qënë 7 (shtatë) femra të mbijetuara nga kanceri i gjirit. Mosha e femrave të intervistuara i përket moshës së rritur të mesme.

Diskutimi.

Për realizmin e këtij studimi janë marrë në intervistë të mbijetuarat e kancerit të gjirit.

Karakteristikat e personalitetit të të mbijetuarave

Çdo person karakterizohet nga tipare te ndryshe dhe të veçanta të personalitetit në ndryshim nga një person tjetër. Karakteristikat personale ndikojnë shumë në mënyrën se si një person reagon dhe ndihet ndaj një fenomeni të caktuar.

Për këtë arsye do të shpjegohet se si kanë ndikuar këto karakteristika personale në përceptimin e kancerit nga gratë e mbijetuara dhe cilat kane qene pasojat psiko-sociale qe kanë përjetuar ata.

Sipas Carver (1985), njerëzit reagojnë ndaj kërcënimeve në mënyrë të ndryshme, duke reflektuar në këtë mënyrë ndryshimet e tyre të personalitetit. Këto ndryshime mund të kenë ndikim tek perceptimet e stresit të një personi (Scheier & Carver, 1985). Njerëzit optimistë kanë treguar që provojnë më pak hidhërim dhe raportojnë një cilësi jete më të mirë kur ballafaqohen me situata të vështira. Ndërsa, në rastin e personave pesimistë stresi përjetohet me më shumë vështirësi dhe me ndjenja mosshprese nga personat. Të mbijetuarat e intervistuara deklaruan se kanë qenë femra me karakter të fortë dhe të cilat vështirësitë në jetë i mësuan të ishin akoma dhe më të forta në karakter. Shumë nga këto femra theksojnë që pikërisht ky karakter i fortë i ka ndihmuar që të mund të përballeshin me lajmin e një diagnoze të tillë si kanceri i gjirit. Ndërsa femrat të cilat nuk kishin hasur shumë vështirësi në jetë e kishin shumë të vështirë lajmin e marrjes së një diagnoze të tillë. Shumica e të mbijetuarave të kancerit të gjirit të cilat kanë marrë pjesë në këtë studim kanë shfaqur një nivel të lartë shprese dhe optimizmi. Në shumë raste besimi i thellë në Zot dhe përkushtimi që këto femra kishin ndaj fesë, bënë që shpresa dhe besimi i tyre për një përmirësim të rritet. S.T shprehet: "*Kisha dhe kam një besim të thellë në Zot. Unë jam muslimane dhe dija që një fat më të mirë për mua dhe një shërim vetëm zoti mund të ma sillte. Askush tjetër përvec atij nuk e kishte fuqinë ta ndryshonte gjëndjen time. Besimi në Zot më ka bërë që unë të eci përpara me shumë besim për tu shëruar*". Disa nga gratë theksonin se ato nuk kishin besim ne një fe apo në Zot dhe ndodhte që kur një e papritur apo një problem që i dilte të fajësonin pikërisht atë, edhe pse besimi i tyre ishte i cekët. Ato e kishin më të lehtë që të fajësonin Zotin për fatkeqësitë që i binin dhe sidomos gjatë periudhës që morën lajmin për diagnozën e tyre. Një nga të mbijetuarat shprehet (H.G): *"Unë nuk besoj dhe nuk jam e përkushtuar në një fe të caktuar. Jam me origjinë muslimane sepse kështu janë dhe prindërit e mi, por unë nuk kam nje besim të caktuar. Edhe pse ne periudhën e diagnozës dija vetëm të fajësoja fatin për atë*

që më ndodhi. Dhe e dija që unë nuk kisha faj, vetëm një fuqi atje lart mund të ma shpjegonte atë që po ndodhte dhe vetëm ai mund të ma kishte sjell një fatkeqsi të tillë".

Përjetimet në momentin e diagnostikimit me kancer gjiri.

Nuk ekziston një mënyrë e mirë për ti komunikuar një personi që ai është i diagnostikuar me kancer. Gjithmonë momenti i komunikimit dhe i marrjes së kësaj diagnoze është e vështirë. Të mbijetuarat raportojnë se është shumë e vështirë të harrosh momentin ku e vetmja gjë e cila të vjen në mënd është vdekja. E. SH shprehet kështu: *"Gjithçka mori fund në atë moment, asgjë nuk kishte më kuptim*". Të mbijetuarat theksojnë se pyetja e vetme që i shkonte në mëndje ishte "*Çfarë do të bëhet tani me mua*?!". Diagnoza e marrë është komunikuar nga doktori përkatës për fushën (sëmundjen). E. SH thekson se: "*Dëshiroja që të kisha pranë tim shoq në ato momente. E dija që vetëm ai do të ishte në gjëndje të më kuptonte dhe të më mbështeste në atë moment".*

Marrëdhënia me familjen dhe njerëzit e afërm.

Ndihma/ mbështetja që vjen nga familja, miqtë, të afërmit është një ndihmë e domosdoshme dhe gati jetësore, për këtë arsye personit të prekur me kancer gjiri i duhet treguar gjithmonë që "je aty me të". Sipas O'Brien (1997), marrëdhënia e fokusuar në përballim përfshin pjesë të nevojave të njerëzve të tjerë mbi nevojat e tyre emocionale duke ruajtur integritetin e një marrëdhënie, dhe menaxhimin e stresit të dikujt pa u tronditur ose duke krijuar probleme për të tjerët. Shumë nga të mbijetuarat raportuan që marrëdhënia e tyre me miqtë dhe të afërmit ka ndryshuar pas marrjes së diagnozës. Lidhjet e krijuara më parë nuk ishin më të forta. Kjo gjëndje lidhej me dëshirën e të mbijetuarave për të qëndruar larg të tjerëve dhe për të qëndruar vetëm. Femrat që kishin ndjekur këto stile të vepruari kishin një nivel më të lartë stresi se sa femrat e tjera të cilat nuk kishin ndjekur një rruge veprimi të tillë. Niveli i stresit bie tek ato femra të cilat kishin komunikuar me të tjerët rreth problemit të tyre dhe ndihenin më mirë duke e bërë këtë gjë. L.F shprehet se: *"Të pasurit e personave të cilët kujdesen dhe të duan pranë është shumë e rëndësishme. Kisha shumë nevojë për njërëz të cilët të më qëndronin pranë dhe të më tregonin që ishin aty për mua për të më dhënë mbështetje dhe dashuri. Të qëndroja veteëm them se do të kishte bërë që unë të bija në një gjëndje tepër të vështirë".* Disa nga të mbijetuarat e intervistuara mendonin se të tjerët nuk do të arrinin të kuptonin dot gjëndjen e tyre dhe përjetimet që ato kishin. Gjithashtu mendohej se nëse këto persona do të qëndronin pranë të mbijetuarave do të ishte thjesht sepse ndienin mëshirë për to. Ato dëshironin që i gjithë stresi, dhimbja dhe ankthi që ato kishin të mbetej vetëm i tyre dhe jo ta ndanin me të tjerë. Ndjesia se të tjerët do ta merrnin për dobësi sëmundjen e tyre dhe do ta shikonin si një njeri jo normal ka ndikuar gjithashtu në atë që këto femra dëshironin të rrinin vetëm. Disa nga të mbijetuarat kanë preferuar mos të ndajnë këtë informacion me të tjerët, pasi preferojnë që asnjë të dijë gjendjen e tyre. Një nga të mbijetuarat shprehet: *"Nuk doja që të tjerët të më shihnin dhe tiu dhimbsesha, nuk e duroja dot këtë gjë. Kështu që vendosa më mirë të mos i tregoja askujt për gjëndjen time"*. Por në të njëjtën kohë ka dhe disa femra të mbijetuara të cilat preferonin që dhimbjen e tyre ta ndanin me të tjerët. Disa nga këto gra mendonin se të ndash këtë vuajtje më të tjerët e afërm të ndihmon në kalimin e situatës dhe kanë qënë pikërisht këto femra ato të cilat nuk e kanë ndryshuar lidhjen e tyre me të tjerët. Ato shprehen se personat e tjerë ishin një mbështetje e fortë për to, ishte pikërisht lidhja me këto persona e cila i ka bërë që ta kalojnë më me optimizëm fazën e diagnostikimit me kancer gjiri. H.G shprehet se: *"Të kesh persona të tjerë afër që të tregojnë cdo cast që janë aty me ty dhe të japin dashuri është një gjë shumë e mirë. Them*

se po mos të kishte qënë për këto persona do të kisha rënë në një depresion të thellë". Kështu që prania e të tjerëve dhe dashuria, mbështetja dhe përkrahja që ato të japin është shumë pozitive për të kaluar një fazë të vështirë të jetës, siç është të diagnostikohesh më kancer gjiri. Disa të mbijetuara të tjera kanë krijuar një raport më të fortë me fëmijët e tyre dhe donin që gjithë kohën ta kalonin bashkë me to.

Duke qenë se këto femra mendonin që së shpejti vdekja do ti afrohej dhe preferonin që kohën e mbetur ta kalonin me njerëzit e dashur. S.T shprehet: "*Mendoja se fëmijët e mi do të mbeteshin pa nënë dhe doja që ti ndieja dhe ti kisha sa më afër këto kohë".* Periudha që familjarët po kalonin si pasojë e sëmundjes së njeriut të tyre të dashur por nga ana tjetër dhe vështirësitë që i shtoheshin si pasojë e perjudhës së COVID - 19 shtonte nevojën për përkrahje ndaj njëri- tjetrit, mbështetje, bashkëpunim si forma të vetme për të shtuar forcën për tia dalë mbanë. Nga ana tjetër marrja e informacioneve të plota dhe të vlefshme dhe mbështetja emocionale e dhënë si nga stafi i spitalit kanë ndikuar në dhënien e një shprese për të vazhduar përpara. Për të gjitha të mbijetuarat e intervistuara kuptimi dhe qëllimi i jetës së tyre kishte ndryshuar, tani ato kishin vetëm një qëllim që të shërohenin sa më parë nga sëmundja. Të shpëtonin nga "kthetrat" e kancerit të gjirit ishte kthyer objektivi kryesor në jetën e tyre. Rëndësia që merr jeta në këtë fazë për gratë e prekura me kancer gjiri është shumë e madhe. Në këtë periudhë krahas shqetësimeve dhe problemeve për të cilat këto gra duhet të mendojnnë është edhe një dilemë me të cilën ato duhet të përballen. Këto gra duhet të ndermerrnin vendime të rëndësishme në lidhje edhe me pamjen e tyre fizike. Duke qenë se sëmundja e kancerit të gjirit është një sëmundje e cila prek gjinjtë, në momentin kur sëmundja ka avancuar dhe ka arritur në një fazë që mund të shkaktojë probleme dhe që mund të ndikojë në jetën e personit të prekur, duhet të ndërmerren disa ndërhyrje kirurgjikale për heqjen e gjinjve. Kështu këto gra të prekura nga kjo sëmundje janë përfshirë në një dilemë të madhe lidhur me heqjen e gjinjve ose mos heqjen e tyre. Ky është një vendim i cili është i vështirë për tu marrë dhe bërja e një zgjidhje kërkon guxim dhe kurajo nga personi i cili do të ndërmarrë një gjë të tillë. TH. K thekson se: *"E kisha shumë të vështirë të aprovoja dicka të tillë. Nuk dija cfarë të bëja, kisha frikë, kisha turp dhe ndieja që do më ikte dicka nga vetja po të hiqja gjirin. Mbi të gjitha ishte frika dhe mendimi I të tjërëve për mua. Pastaj vinte edhe se si do të mund të shihja unë veten në atë mënyrë, mendoja dhe për bashkshortin tim. Ka shumë e shumë mendime që të vijnë në mëndje në një cast. Por më pas mendojë vetëm për jetën dhe sa dëshirë kisha që të jetoja dhe të rrija me personat e dashur. Kështu që të gjith të tjerat u hidhnin pas dhe vendosa të operohesha. Edhe pse me një frikë të madhe".* Pamja nuk është më një problem për këto femra, ato tashmë ndihen shumë më mirë rreth kësaj gjëje. GJ.F shprehet kështu : *" Ndihem më mirë me pamjen time. Jam mësuar tani me këtë pamje timen, dhe e dua veten për këtë që jam"*.

Ndryshimet e bëra nga këto gra janë domethënëse për jetën aktuale të tyre, sepse kjo do të thotë se ato kanë mundur të kalojnë gjëndjen në të cilën ndodheshin më parë dhe të fillojnë një jetë të re dhe me një dëshirë të madhe për të jetuar.

Ndikimi i sëmundjes në jetën e përditshme.

Shumë nga të mbijetuarat e intervistuara raportuan se periudha e kaluar duket si një ëndërr e keqe e cila është tepër e vështirë për tu harruar. Sipas Bouchard (2003), si efektet psikologjike dhe fizike të kancerit të gjirit ndikojnë në cilësinë e jetës, kanceri i gjirit mund të kufizojë aftësinë për të kryer detyrat e përgjithshme dhe me forcë të kufizuar dhe dëshirën për një jetë aktive. Rikërkimet kanë treguar se nivelet e aktivitetit fizik kanë tendencë të ulen ndjeshëm pas diagnozës por tentojnë të kthehen në nivelin origjinal pasi trajnimi ka përfunduar.

Disa të mbijetuara të tjera theksojnë se duket sikur ajo periudhë nuk ka ndodhur kurrë dhe ndihen më mirë duke e lënë pas impaktin që ajo ka pasur në jetën e tyre. Duket që këto gra dëshironin të ndërronin faqe dhe ti linin pas të gjitha përjetimet e ndryshme që i ka sjellë ajo periudhë. Shëndeti për këto gra është shëndrruar tashmë në dicka shumë të shenjtë dhe të rëndësishme.

Optimizmi i fituar, dëshira për një jetë të shëndetshme i kanë dhënë grave një guxim për të ecur përpara. Tani ato bëjnë një jetë të qetë dhe normale përkrah familjarëve të tyre. Meraku më i madh që këto gra kanë është rreth frikës se mos sëmundja rikthehet sërish në jetën e tyre, duke i prishur kështu edhe një herë të tërë rregullin që ato kanë vendosur tashmë në jetë. Kjo është e vetmja gjë e cila ndikon në jetën e tyre të tanishme.

Lidhjet dhe ndjesitë me personat që vuajnë nga e njëjta sëmundje.

Gratë e intervistuara treguan se ato kanë njohur persona të tjerë të cilët ishin diagnostikuar me kancer gjiri në të njëjtën kohë me to, po ashtu edhe persona që u kanë diagnostikuar më mbrapa tyre. Disa nga këto gra theksuan se kishin raporte të mira edhe me personat të cilët kishin marrë një diagnozë të tillë pas tyre. Lidhja me këto persona është cilësuar si shumë e rëndësishme dhe e fortë për të mbijetuarat. S.T shprehet kështu: *"Shpeshherë ndihesha sikur vetëm kur ndodhesha me persona të cilët kishin kaluar të njëjtën vuajtje si unë, mund të isha e pranuar dhe të ndihesha mirë"*. I vetmi problem ishte gjatë perjudhës së karantinimit, shkëputja fizike, mungesa e takimeve mes njëra tjetrës, të gjitha këto gjëra bënë që ata të mbeten në zgjidhjen e vetme në komunikimin nëpërmjet mjeteve elektronike, në të shumtën e rasteve nëpërmjet telefonave. Ky komunikim edhe pse vetëm në këtë formë lindi si nevojë e domosdoshme pasi kjo ndodh për faktin sepse këto persona kishin aftësinë që të mund të kuptonin këto të mbijetuara, pasi po kalonin apo kishin kaluar në të njëjtën situatë me të njëjtat dhimbje dhe përjetime emocionale. Kjo lloj marrëdhënie ruhet edhe tani pasi këto gra e kanë kaluar periudhën e diagnozës dhe kemi kaluar perjudhën e karantinimit, duke u cilësuar si shumë e rëndësishme dhe gati e pamundur që të shkëputej. Gratë të cilat tashmë e kanë kaluar periudhën e marrjes së diagnozës dhe të cilat ndihen më mirë si nga ana shëndetësore po ashtu edhe nga ajo emocionale tregojnë se, nëse një person tjetër do të zbulonte që vuante nga një sëmundje vdekjeprurëse do të ishte e pamundur të bisedoje qartë dhe kuptimisht me to. Vetëm një person i cili ka kaluar në të njëjtën gjëndje mund të bisedojë me një person të tillë, që në këtë mënyrë i prekuri nga sëmundja të mund të besojë dhe të marrë forca për të vazhduar kurën. Të mbijetuarat raportojnë se gjëja e parë që këto persona duhet të bëjnë është që të shkojnë të kryejnë vizitat dhe terapitë e caktuara. L.F shprehet: *"Personave të prekur me sëmundjen që unë kam pasur do ti thoja që të vazhdonin terapinë rregullisht duke mos i lënë pas dore. Është e vështirë ti flasësh për shpresë një personi me sëmunjden tonë sepse duken fjalë boshe port ë cilat marrin vlerë me kalimin e kohës. Për këtë arsye duhet të flasim sa më shumë dhe tu japim sa më shumë kurajo".*

Në këtë mënyrë është e vështirë që të këshillosh apo të ndihmosh personat e pekur me një sëmundje vdekjeprurëse, por nuk është e pamundur. Gratë e mbijetuara nga kanceri i gjirit janë ato të cilat mund të japin një ndihmë të madhe për këto persona dhe tia dalin mbanë që ti nxjerrin ato nga gjëndja e vështirë tek e cila kanë rënë. Kjo sepse informacioni dhe shpresa që vjen nga një person i cili ka kaluar të njëjtën gjëndje është më i besueshëm dhe pranohet më shumë. Pasi të mbijetuarat e cilësojnë periudhën e kaluar si një fazë të vështirë dhe e cila nuk mund të përshkruhet dhe të përblidhet me një fjalë. Një nga të mbijetuarat shprehet: *"Nuk di si ta përshkruaj. Të them se ishte një periudhë e vështirë është shumë pak,*

mund ta përshkruaj vetëm si periudhën më të vështirë të jetës time dhe të cilën nuk do ia uroja askujt që ta kalonte. Të jesh një e mbijetuar nga kanceri i gjirit të bën të ndihesh sikur ke vdekur dhe ke rilindur sërish, por që sërish rri me atë frikën që vdekja mund të vij të të prekë nga moment në moment. Kështu që ajo periudhë nuk mund të shpjegohet dhe të përshkruhet me një fjalë. Është sikur të përshkruash cdo të thotë të shohësh vdekjen me sy dhe të thuash ishte kështu……(hesht).....askush nuk do të kuptojë dhe as nuk do të besojë, për këtë gjë jam shumë e bindur".

Të mbijetuarat nga kanceri i gjirit të cilat u morën në intervistë raportuan se të jetosh me kancer gjiri është një nga gjërat më të tmerrshme që një person mund të përjetojë, përfshirë dhe problematikat që shtuara si pasojë e COVID-19 dhe mbi të gjitha këto gra (pavarsisht që tashmë gjithcka ka kaluar) jetojnë me frikën se gjëndja e kaluar mund të rikthehet sërish. Por tani për tani e vetmja gjë që ka rëndësi është që ato gëzojnë shëndet të mirë dhe ndodhen sëbashku me njerëzit e dashur duke jetuar jetën në mënyrë të plotë, kjo është e vetmja gjë për të cilën këto gra duhet të kujdesen tashmë.

Analizë.

Studimi zbuloi nga të mbijetuarat e intervistuara se si ka qënë personaliteti i këtyre grave dhe a ka ndikuar ai në kalimin e sëmundjes dhe fazave të saj. Të mbijetuarat raportuan histori me ndryshime pozitive dhe negative të shoqëruara me dyshime dhe frikë si dhe rinovimin e marrëdhënieve dhe prioriteteve të ndryshme. Ka pasur raportime të një zemërimi drejt Zotit dhe njerëzve të tjerë, histori të një besimi të thellë por edhe histori altruizmi. Ndërkohë që ato përpiqeshin të kuptonin natyrën e kancerit të gjirit, ata duhet që në të njëjtën kohë të përballeshin me frikën e prekjes së një vdekje të mundshme prej kësaj sëmundje. Krahas kësaj ato janë përballuar me dilemën e madhe se çfarë duhet të bënin me pamjen e tyre fizike. Kur trajtimi aktiv për kancerin e gjirit mbaron, të mbijetuarat raportojnë që iu është dashur të përballonin një luftë për të rinisur një jetë të re, me sfida të reja dhe me një identitet të ri. Historitë e ndara në këtë punim ndihmojnë në kuptimin e gjendjes së të mbijetuarave me kancer gjiri në realitetin shqiptar, sidomos gjatë kësaj perjudhe të vëshirë të Pandemisë. Gjithashtu, informacioni i ndarë mund të informojë praktikën e këshillimit për ofrimin e mbështetjes dhe për të promovuar kujdesin shëndetësor tek gratë të cilat kanë mundësi prekje nga kjo sëmundje.

Përfundimet.

Të mbijetuarat e kancerit të gjirit janë një target grup të cilat kanë nevoja të caktuara emocionale, psikologjike dhe mjekësore. Ndihma dhe mbështetja që mund ti japin personat e ndryshëm këtyre grave është mjaft e domosdoshme. Pavarsisht gjithçkaje gjëja e vetme të cilat këto gra kërkojnë është gjetja e një shprese sado e pakët qoftë ajo. Ato mund ta gjejnë këtë shpresë kudo tek familja, fëmijët, një i mbijetuar tjetër, tek Zoti, etj. Pasi këto gra e gjejnë atë për të cilën ato kanë më shumë nevojë, e vetmja gjë që ato duhet të bëjnë është të kapen pas saj dhe të ecin drejt shërimit të tyre.

Përfundimet e nxjerra janë:

- Të mbijetuarat e kancerit të gjirit të cilat kishin një karakter të fortë e kanë pasur më të lehtë përballjen me stresin që sjell një diagnozë si kanceri i gjirit dhe e kanë kaluar më me sukses periudhën e diagnostikimit me kancer gjiri.
- Të mbijetuarat të cilat ishin kujdesur më parë për gjëndjen e tyre shëndetësore dhe ishin përballur me ambjente të tilla si spitali apo me bërjen e analizave, ndihenin më pak të trembura nga

kërcënimi që sillte spitali për to në krahasim me femrat të cilat nuk kishin përjetuar ndonjëherë shtrimin apo vizitat e gjata në spital.

- Gratë të cilat në momentin e marrjes së diagnozës kanë pasur një person të dashur pranë e kanë pasur më të thjeshtë që të përballojnë dhe të kalojnë periudhën e përballimit të stresit në marrjen e diagnozës. Ato të cilat kishin këtë mbështetje dhe përkrahje të fortë në këtë peridhë e kaluan më me pak stres dhe më me guxim diagnozën me kancer gjiri.
- Të mbijetuarat të cilat nuk preferuan të tregonin rreth sëmundjes së tyre dhe të cilat i larguan kontaktet me njerëzit e dashur, e kanë pasur shumë më të vështirë kalimin me sukses të periudhës së diagnostikimt me kancer gjiri se sa femrat të cilat, i forcuan akoma dhe më shumë lidhjet e tyre duke përfituar suport dhe përkrahje nga njerëzit e afërt të tyre.
- Të kurohesh me kancer gjiri ka një shkallë të lartë stresi dhe vështiresie emocionale, vështirësi të cilat u shtuan Akoma më tepër si pasojë e COVID -19; gratë e intervistuara kanë raportuar një nivel të lartë vështirësie në këtë fazë. Ato theksuan se vështirësia në këtë fazë sa vinte dhe rritej dhe përballimi dhe dalja nga kjo gjëndje bëhej çdo ditë e më e vështirë.
- Të mbijetuarat kanë filluar përsëri të ndiejnë lumturi në jetën e tyre dhe të hedhin pas krahëve sëmundjen si një kujtim të hidhur të së kaluarës. Pavarsisht se sëmundja ka lënë shenjë tek ato për të tërë jetën ato sërish ndihen të lumtura që tashmë gjithcka i përket së shkuarës.
- Gratë tashmë bëjnë një jetë normale krahas familjarëve të tyre dhe njerëzve të dashur duke shpresuar për një të ardhme më të mirë por edhe duke qëndruar me frikën se mos sëmundja rikthehet, sidomos këtë perjudhë stresuese për shkak të COVID-19.
- Lidhja e këtyre grave me personat e tjerë të së njëjtës sëmundje ka qënë shumë efektive dhe e rëndësishme në përballimin e stresit të këtyre grave. Lidhja me të mbijetuarat e tjera ka ndikuar në përmirësimin e gjendjes së tyre dhe në krijimin e një shoqërie e cila i kuptonte dhe në të cilën këto të mbijetuara ndihenin mirë.
- Bazuar dhe në studimet e fundit rekomandohet se popullata e kancerit të gjirit është në një rrezik në rritje të zhvillimit të çrregullimit psikologjik gjatë pandemisë COVID-19. Pasoja të tilla duhet patjetër të merren në konsideratë. Theksojnë më tej rëndësinë e ndërhyrjeve të shëndetit mendor që mund të jepen nga distanca. Kërkimet e ardhshme duhet të vazhdojnë të monitorojnë efektet afatgjata të COVID-19 në shëndetin psikologjik në kancerin e gjirit.

Referencat:

1. Bloom, J.R. Stewart, S.L. Chang, S. & Banks, P.J. (2004). *Psycho-Oncology*, *13*, 147-160.
2. Bouchard, G. (2003). *Canadian Journal of Behavioural Science*, *35*,1-12.
3. Breast, 24 (1) (2015), pp. 90-92
4. Chapman, Bethany, Swainston ,Jessica Grunfeld, Elizabeth Derakshan, Nazanin (2020) COVID-19 Outbreak Effects on Job Security and Emotional Functioning Amongst Women Living With Breast Cancer Https://doi.org/10.3389/fpsyg.2020.582014
https://doi.org/10.3389/fpsyg.2020.02033
5. Jessica Swainston, Bethany Chapman, Elizabeth A. Grunfeld and Nazanin Derakshan (2020) COVID-19 Lockdown and Its Adverse Impact on Psychological Health in Breast Cancer
6. N. Elster, D.M. Collins, S. Toomey, J. Crown, A.J. Eustace, B.T. Hennessy,HER2 - family

signalling mechanisms, clinical implications and targeting in breast cancer, Breast Cancer Res Treat, 149 (1) (2015), pp. 5-15.

7. N.S. El Saghir, B.O. Anderson, Breast cancer early detection and resources: where in the world do we start? (2012)
8. National Library of Medicine, https://www.ncbi.nlm.nih.gov/
9. O'Brien,T. B.,&DeLongis, A. (1997).*Coping with Chronic Stress*(pp. 161-191).New York.
10. Scheier, M. F. & Carver,C. S. (1985). *Health Psychology, 4*, 219-247.
11. Siemenes Healthineers (2020) How COVID-19 is also impacting breast imaging Facing new challenges during the pandemic, https://www.siemens-healthineers.com/mammography/news/how-covid-19-is-also-impacting-breast-imaging.html

12. Venja Musche, Alexander Bäuerle, Jasmin Steinbach, Adam Schweda, Madeleine Hetkamp, Benjamin Weismüller, Hannah Kohler, Mingo Beckmann, Ken Herrmann, Mitra Tewes, Dirk Schadendorf, Eva-Maria Skoda and Martin Teufel (2020) COVID-19-Related Fear and Health-Related Safety Behavior in Oncological Patients, https://doi.org/10.3389/fpsyg.2020.01984
13. Zëri i Amerikës (2019), Kanceri i gjirit në Shqipëri 30 vjet në rritje, zyrtarët: Nuk është dënim me vdekje, https://www.zeriamerikes.com/a/4794495.html

Shtojca

INTERVISTA

- **<u>Para se të diagnostikohej me kancer gjiri</u>**

1. Beqare apo e martuar?
   1.a Keni femijë?
   1.b Si ka qënë raporti juaj me fëmijët?
2. Cili është niveli arsimor i juaj (jeni i kënaqur me arsimin tuaj)?
3. Keni qënë i punësuar? (Nëse jo, kaloni tek pyetja 3)
   2.a Ku?
   2.b Ishit e realizuar në atë profesion /punë?
4. Cilat ishin besimet tuaja dhe ana juaj shpirtërore?
   4.a. Ishit e lidhur me ndonjë besim fetar?
5. Cilat ishin prioritet e juaja në jetë?
   5.a Po qëllimet tuaja cilat ishin?
6. Lidhja juaj me familjarët si mund të cilësohet?
   6.a Po jeta lidhja juaj sociale me të afermit, miqtë tuaj?
7. Si e cilësoni fëmijërinë tuaj?
   7.a Po vitet tuaja të adoleshencës?
   7.b Po rininë tuaj?
8. Si do ta përshkruanit veten tuaj?
   8.a Cilat ishin ato karakteristika kryesore të personalitetit tuaj?
9. A ishit e kënaqur nga jeta në atë kohë?

9.a Ndihenit e realizuar?

10. Cfarë konsideroni si më të rëndësishme në jetë?
11. Keni pasur probleme shëndetësore më parë (të tipit psikologjike, fiziologjike) ?
12. A dyshonit për ndonjë gjë që nuk ishte mirë me shëndetin tuaj përpara se të merrnit diagnozën?
13. Keni qënë e shtruar më parë në spital?

13.a Nëse po, për çfarë arsyeje?

- **Gjatë diagnozës**

1. Cilat ishin simptomat e para të cilat iu shqetësuan?

1.a Në saj të tyre ju arritët të kuptonit që nuk ishit mirë?

2. Shkuat vetëm apo e shoqëruar për të kryer vizitën?

2.a Si jeni ndjerë në ato momente?

3. Si e morët vesh diagnozën aktuale?

3.a Cili iu a ka komunikuar (doktori apo një i afërm, familjar)?

4. Cili ishte reagimi juaj në atë moment, mendimet, ndjenjat (përjetimet e ndryshme emocionale) ?
5. Cili ka qënë personi i parë me të cilin folët rreth kësaj çështjeje dhe pse zgjodhët pikërisht atë person?
6. Familjarët tuaj, (miqtë, të afërmit tuaj) janë në dijeni të këtij fakti?

6.a Nëse po, cili ka qënë reagimi i tyre?

7. Si jeni ndjerë ju ndaj personave që e dinin gjendjen e sëmundjes tuaj?

7.a Ndryshuat sjellje ndaj personave që iu rrethonin?

8. Po ata si u sollën ndaj jush pasi morën vesh per sëmundjen tuaj?

8.a Keni vënë re ndonjë ndryshim të sjelljes së tyre ndaj jush?

9. Çfarë mbështetje kishit në këtë kohë?

9.a A ndjeheshit e mbështetur nga njerëzit që ishin rreth jush?

10. Si ishte lidhja juaj me fëmijët në këtë fazë?
11. Gjatë terapisë pati ndonjë moment ku ju i humbët të gjitha shpresat?

11.a Si e përballuat dhe kush iu ndihmojë të kalonit këtë gjendje?

12. A e keni pyetur veten për kuptimin e jetës tuaj gjatë kësaj faze?

12.a A ndryshonin qëllimet e juaja rreth jetës në këtë fazë me ato që ju kishit më parë?

13. Keni kërkuar informacion rreth sëmundjes tuaj gjatë kësaj kohe?

13.a Nëse po, ku e gjetët atë?

13.b A ju ndihmojë ky informacion që morët për të përballuar sadopak situatën në të cilën ndodheshit?

14. Cila ishte ndihma që iu dha ekipi mjekësor përkrah terapisë?

14.a Cilat ishin ato trajtime që iu ndihmuan më shumë që iu të mund të përballonit këtë situatë?

15. Ka pasur ndonjërast në të cilin ju keni dyshuar të shkonit për të bërë kurimin?

15.a Ose jeni ndjerë tepër e lodhur emocionalisht që të shkonit?

16. Çfarë ju ka dhënë forcë që të vazhdonit përpara?
17. Duke e menduar veten si një njeri me një sëmundje kërcënuese për jetën cfarë ndryshimesh ndërmorët të bënit në jetën tuaj?
18. A ju është dashur të ndërmerrni vendime të vështira në lidhje me pamjen tuaj fizike?

18.a Si ka ndikuar kjo në marrëdhënien tuaj me të tjerët?

- **Pas diagnozës**

1. Si ndiheni tani kur mendoni rreth situatës së kaluar në të cilën ndodhenit?
2. A ndieheni e kënaqur nga jeta juaj e tanishme?
   2.a Çfarë ka ndikuar që ju të ndiheni në këtë mënyrë?
3. Si do të mund ta përshkruani gjendjen tuaj aktuale?
4. Si ka ndikuar periudha e diagnozës në jetën tuaj të tanishme?
5. A mendoni se tani pas diagnozës jeta juaj ka ndryshuar?
   5.a Nëse po, në çfarë aspekti?
6. A ka ndryshuar dicka në marrëdhënien tuaj me familjarët dhe të afërmit?
   6.a Si ju përceptojnë ata tani?
7. A është pamja juaj fizike e njëjtë si më parë?
   7.a Si ndjeheni për këtë fakt?
8. A ndikojnë këto ndryshime në jetën tuaj të përditshme?
9. Njihni ndonjë person tjetër i cili ka mbijetuar nga kjo sëmundje?
   9.a Nëse po i ruani lidhjet me to?
   9.b Çfarë ndjeni kur jeni sëbashku?
10. Si ndieheni tani që situata që ju përjetuat i përket së shkuarës dhe ka kaluar?
11. Çfarë këshille do ti jepnit dikujt që sapo ka marrë vesh se vuan nga një sëmundje kërcënuese për jetën?
    11.a Çfarë do ti thonit atij personi?
    11.b Po familjes së tij / saj?
12. Si do ta përshkruanit me një fjalë periudhën e kaluar (të diagnozës)?
13. Çfarë ka ndryshuar në jetën tuaj sociale?
14. Ka ndonjë pyetje që do të dëshironit t'ju ishte drejtuar në këtë intervistë?

ARRITJET DHE PROBLEMATIKAT NË LIDHJE ME KURRIKULAT BASHKËKOHORE NË ARSIMIN E LARTË PROFESIONAL DY VJEÇAR.

Dr. Artan MANUSHAQE
Pedagog në Universitetin Kolegji Universitar i Biznesit (KUB)
Dr. Jaup ZENUNI
Shef i Departamentit të Studimeve të Larta Administrative në Kolegjin Universitar të Binzesit,
Endri SALIASI,
Bachelor, Business Administration, University of Macedonia Greece.

Abstrakt:

Ky punim synon t'u qaset disa problematikave që lidhen me hartimin dhe realizimin në praktikë të kurrikulave në programin dy vjeçar të studimit "Asistent Administrativ" aktualisht "Asistent i Lartë", veçanërisht në profilin "Asistent i Lartë Ligjor" dhe të hedh dritë në atë se sa dhe si kjo kurrikulë u afrohet përvojave të vendeve të zhvilluara europiane. Arsimi i lartë dy vjeçar është ende risi në tregun e arsimit të lartë në Shqipëri. Për rrjedhojë, në rrugëtimin e tij për t'u konsoliduar ai në fushën e kurrikulave dhe planeve mësimore u referohet përvojave më të mira europiane dhe botërore. Fokusi i tij do të jetë puna që është bërë për hartimnin e kurrikulave, ndryshimet kurrikulare të kryera si rezultat i reflektimit mbi bazën e praktikës së realizimit të tyre. Gjithashtu, vëmendje do t'i kushtohet edhe problematikave që lidhen me literaturën përkatëse në funksion të kurrikulës dhe pasqyrimit në programet e lëndëve të specifikave që ka arsimi i lartë dy vjeçar përsa i përket raportit teori-praktikë.

Fjalët kyçe: *Student, pedagog, kurrikulë, universitet, treg pune, program studimi.*

I. Hyrje:

Kolegji i Studimeve të Larta Profesionale (KSLP) në Kolegjin Universitar të Biznesit (KUB) u hap në vitin akademik 2018-2019 duke u licensuar nga Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë me urdherin nr. 139, date 23.03.2018[152]. Në këtë urdhër specifikohet se kjo njësi përbërëse e KUB do të përbëhet nga dy njësi bazë: Departamentin e Studimeve të Larta Administrative dhe Departamentin e Studimeve të Larta Teknike. Ndërsa programi i studimit "Asistent Administrativ" sot "Asistent i Lartë" u hap me urdhërin nr. 354, date 28.06.2018[153] të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Ai përmbante tre profile: Asistent i Lartë Administrativ, Asistent i Lartë Kontabël dhe Asistent i Lartë Ligjor.

[152] Urdhër i MASR nr. 139, datë 23.03.2018, "Për hapjen e njësisë kryesore "Kolegji i Studimeve të Larta Administrative" në Kolegjin Universitar të Biznesit."
[153] Urdhër i MASR nr. 354, datë 23.06.2018 "Për hapjen e programit të studimit me karakter profesional në "Asistent Administrativ" të Kolegjit Universitar të Biznesit."

Duke reflektuar mbi vendimin e Bordit të Akreditimit nr. 10, date 22.01.2021[154] dhe duke patur parasysh problematikën e krijuar gjatë realizimit në praktikë të kurrikulës me të cilën u licensua ky program nga ana e ministrisë përgjegjëse për arsimin, ky program u riorganizua në vitin 2021 me urdhërin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 255, date 19.07.2021[155], duke marrë emrin "Asitent i Lartë" me profilet përkatëse: Asistent i Lartë Administrativ, Asistent i Lartë Financë dhe Asistent i Lartë Ligjor. Riorganizimi konsistoi më tepër tek disa ndryshime kurrikulare për të shmangur paralelizmin me programet bachelor dhe duke i dhënë përparësi raportit 50% orë teorike dhe 50% orë praktike sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 379, date 18.12.2019[156]. Gjatë këtij riorganizimi vëmendje e veçantë iu kushtua edhe reflektimit në kurrikulën e re të përvojës së vendeve që kanë përvojë në arsimin e lartë profesional dhe konsultimit me aktorët e tregut të punës.

Në këtë punim do të përpiqemi t'u japim përgjigje disa pyetjeve që lidhen me hartimin, përditësimin dhe zbatimin e kurrikulave në Departamentin e Studimeve të Larta Administrative, sidomos në profilin "Asistent i Lartë Ligjor" si: Sa dhe si merren parasysh specifikat e arsimit të lartë dyvjeçar në hartimin e kurrikulave; sa merren parasysh kërkesat e tregut të punës në hartimin e tyre; sa pasqyrohen në kurrikulat e këtij programi standardet e vendeve europiane me përvojë në këtë fushë; sa dhe si pasqyrohen e zbërthehen kurrikulat në planet dhe programet mësimore dhe në praktikën e përditshme të mësimdhënies dhe; cilat janë problemet që lidhen me materialet mësimore (tekstet, literatura) në funksion të realizimit të kurrikulës.

Për t'ju dhënë përgjigje këtyre pyetjeve do të bëhet një analizë krahasuese të kurrikulave të profilit "Asistent i Lartë Ligjor" para akreditimit dhe mbas riorganizimit të programit mësimor dhe do të përdoret një vështrim analitik mbi rrugët, mjetet dhe mënyrat e hartimit dhe realizimit të kurrikulave në këtë program studimi.

II. Vështrim teorik.

Fjala "kurrikulë" është me rrënjë latine nga fjala "Currus" që do të thotë "Course" në gjuhën angleze[157] apo "Kurs" në gjuhën shqipe. Ajo gjithashtu ngjan shumë me termin "Karyakram" përdorur në gjuhën sanskrite apo indiane dhe i referohet çdo programi apo kursi të kryer nga një individ apo grup i caktuar. Prej këtej rrjedh edhe përkufizimi i kurrikulës si: "Program i mësimnxënies apo kurs i kryer nga një student gjatë një periudhe të caktuar kohore për një qëllim të caktuar".[158] Sipas Byrosë Ndërkombëtare të Arsimit, pjesë e UNESCO-s, kurrikula: "Është një përshkrim i asaj se çfarë, pse, si dhe sa mirë studentët duhet të mësojnë në një mënyrë sistematike dhe të qëllimshme. Kurrikula nuk është një qëllim në vetvete,

[154] Vendim i Bordit të Akreditimit nr. 10, datë 22.01.2021, "Për akreditimin e parë të programit të studimit dy vjeçar "Asistent Administrativ", me profile: Asistent i Lartë Administrativ, Asistent i Lartë Kontabël dhe Asistent i Lartë Ligjor të Kolegjit Universitar "I Biznesit".

[155] Urdhër i MAS, nr. 255, datë 19.07.2021, "Për riorganizimin e programit të studimit me karakter profesional ne "Asistent i Lartë", me profile: "Asistent i Lartë Administrativ, Asistent i Lartë Financë dhe Asistent i Lartë Ligjor" në Kolegjin Universitar të Biznesit."

[156] Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 879, datë 18.12.2019, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41 "Për elementët e programeve të studimit ë ofruara nga institucionet e arsimit të lartë".

[157] A.T. Theressiakutty, L. Covinda Rao, "Curriculum for vocational education", National Institute for the Mentally Handicapped, 2001, fq. IX.

[158] Po aty, fq. IX.

por një mjet për të nxitur të nxënit cilësor."[159] Sipas Stotsky (2012), kurrikula është një plan veprimi që synon arritjen e qëllimeve dhe objektivave të dëshiruara. Ajo është një grup veprimtarish mësimore që synojnë ta bëjnë studentin të arrijë qëllimet e përcaktuara nga sistemi arsimor. Në përgjithësi, ajo përfshin lëndët dhe aktivitetet për të cilat është përgjegjës një sistem i caktuar shkollor. Për më tepër, ajo përcakton mjedisin ku zhvillohen aktivitete të caktuara mësimore. Po ashtu, kurrikula përcakton se çfarë ndodh në çdo institucion arsimor formal dhe asnjë shkollë apo universitet nuk mund të ekzistojë pa të."[160] Në artikullin me titull "Curriculum definition: a misleading philosophy", Uëak, Sylvanus Okon (2018, fq. 28-31) rendit 49 përkufizime të ndryshme mbi kurrikulën të bëra nga autorë të ndryshëm.[161] Qasjet në përkufizimin e kurrikulës nga studjues të ndryshëm variojnë në varësi të qëllimit që ata kanë patur në trajtimin dhe elaborimin e këtij termi.

Kurrikula e arsimit profesional mund të përkufizohet si një "…organizim sistematik i përmbajtjes së materialit mësimor i ndërtuar në atë mënyrë që t'u jap studentëve një pjesë kuptimplot të veprimtarive që lidhen me një profesion të caktuar që kryhen nga një agjensi e caktuar me qëllim që studenti të përfitojë një profesion të dobishëm ekonomikisht."[162] Reid dhe Petocz ndërtuan një kornizë për entitetin profesional që bazohet në marrëdhënien ndërmjet perceptimeve të studenteve dhe pritshmërive të tyre të punës profesionale. Sipas tyre:

"Entiteti Profesional është një teori unifikuese që mund të përdoret për zhvillimin e kurrikulës së duhur për studime profesionale, të krijojë lidhje ndërmjet të mësuarit të integruar në punë dhe mjediseve të bazuara tek puna, dhe të ndihmojë studentët të gjejnë një fokus të rëndësishëm për mësimin e tyre në një institucion. Mundet të përdoret gjithashtu si bazë për reflektim dhe kritikë ndaj vlerave profesionale që i transmetohen brezit të ardhshëm."[163] Autorët e mësipërm mendojne se: "Që kurrikula të ketë efekte afatgjata mësimnxënia e studentëve ndoshta duhet të synojë zhvillimin e 'Entitetit Profesional"[164].

Ramsden (2003) gjithashtu është mbështetës i idesë se: "Që studentët kanë nevojë të jenë më të përgatitur për jetën në botën reale. Pra, kështu, është e mundur që efektiviteti i kurrikulës mund të matet kur studentët bëhen 'entitete profesionale'. Të diplomuarit kompetent dhe me besim në vetvete mund të jenë rezultat i kurrikulës me bazë epistemologjinë të integruar me një fokus ontologjik."[165]

Child (2004, fq.431) është i mendimit që: "Kurrikula të jetë efektive, ajo mund të jetë efektive nëse hartohet dhe zhvillohet në atë mënyrë që të inkurajojë studentët dhe pedagogët të përfshihen në çështje të rëndësishme që shpien si në përftimin e njohurive të thella intelektuale ashtu dhe të aftësive praktike për t'i zbatuar ato njohuri për zgjidhjen e problemeve në botën reale."[166]

Sipas Jessica Ellis (2022) kurrikula profesionale i lejon studentët të fokusohen vetëm tek trajnimi për një karrierë në fushën e zgjedhur.

---

[159] http://www.ibe.unesco.org/en/glossary-curriculum-terminology/c/curriculum-plural-curricula, 2011

[160] Stotsky, S. (2012). The death and resurrection of a coherent literature curriculum: What secondary English teachers can do. Lanham, MD: Rowman & Littlefield Education.

[161] Uwak, Sylvanus Okon, "Curriculum Definition: a Misleading Philosophy", International Journal of Advancement in Development Studies, Volume 13, Number 2, 2018 ISSN: 2276-8246, fq. 28-31.

[162] A.T. Theressiakutty, L. Covinda Rao, "Curriculum for vocational education", National Institute for the Mentally Handicapped, 2001, fq. IX.

[163] Reid, A. and Petocz, P. (2003) The Professional Entity: researching the relationship between students' conceptions of learning and their future profession. Paper presented at the 11th Improving Student Learning Symposium, Hanover International Hotel, Hinckley, Leicestershire, 1st – 3rd September 2003, fq. 3.

[164] Po aty

[165] Ramsden, P. (2003) Learning to teach in higher education 2nd edition. London: Routledge Falmer.

[166] Child, D. (2004) Psychology and the Teacher, 7th edition, Suffolk UK: Continuum.

Në vend që të shkaktojë hutim tek studentët me kërkesat e arsimit të përgjithshëm ose orët e mësimit jashtë fushës së tyre kryesore, shkollat dhe programet profesionale janë të orientuara drejt nxjerrjes së shpejtë të profesionistëve kompetentë. Për këtë arsye, shkollat me një kurrikulë profesionale janë të njohura për të rriturit që kërkojnë të ndryshojnë karrierë pasi ato shpesh premtojnë trajnime të shpejta dhe të drejtuara që synojnë kualifikimet për punë."[167]

Më tej ajo shprehet se: "Shkollat profesionale mund të ekzistojnë për shumë fusha që kërkojnë aftësi teknike në vend të njohurive akademike apo intelektuale. Shpesh, shkollat me theks profesional, të njohura gjithashtu si shkolla të profesioneve, ofrojnë çertifikata për përmbushjen e kërkesave te orëve të mësimit dhe jo një titull akademik. Disa nga industritë kryesore që mështeten tek trajnimi profesional përfshijnë mekanikën, teknologjinë e informacionit, industrinë e modës, turizmin dhe punët e zyrës apo ato të sekretarive."[168] Duke folur për avantazhet e arsimit profesional, Ellis thekson se: "Një tjetër avantazh i madh për një kurrikulë profesionale është se programet janë shpesh fleksibël dhe të disponueshëm nga një shumëllojshmëri burimesh. Shumë kolegje komunitare ofrojnë programe certifikimi të hartuara për të funksionuar si një shkollë profesionesh, e cila mund të jetë shumë më pak e shtrenjtë se arsimimi universitar ose një shkollë private profesionale. Kolegjet komunitare janë zakonisht mjedise shumë të hapura dhe mikpritëse me studentë të të gjitha moshave, duke i lejuar të rriturit që të marrin trajnime për karrierë të ndihen më rehat në një atmosferë shkolle, pavarësisht se kanë qenë larg shkollës për shumë vite."[169]

III. Kurrikulat – jo tabu por pasqyrë e zhvillimeve në arsimin e lartë profesional në kushtet tona.

Qëllimi i mirë për hapjen e një Kolegji për Studime të Larta Profesionale në Kolegjin Universitar të Biznesit në përputhje me ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015, neni 21[170] me gjithë përpjekjet për të hartuar një kurrikulë që do të përmbushte kërkesat e nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve[171] nuk arriti ta justifikonte plotësisht veten për programin "Asistent Administrativ" sidomos në profilin "Asistent i Lartë Ligjor". Mungesa e përvojës në këtë lloj arsimimi, referimi jo sa dhe si duhet kurrikulave të vendeve të zhvilluara dhe studimi i përciptë i tregut të punës bëri që kurrikula e dërguar për licensimin e këtij programi në MASR të ngjante më shumë me kurrikulën e programeve bachelor. Kështu, në profilin "Asistent i Lartë Ligjor" ajo në masën 80% ishte identike me programin bachelor për studime në drejtësi duke mëshuar më shumë tek përgatitja e përgjithshme teorike dhe akademike dhe jo sa duhet tek aftësitë dhe shprehitë praktike të cilat synojnë të ngulitin dhe kultivojnë tek studentët programet e studimeve të larta profesionale. Kjo ishte dhe një ndër arsyet kryesore që Bordi i Akreditimit me të drejtë në vendimin

[167] Jessica Ellis, https://www.practicaladultinsights.com/what-are-the-advantages-of-a-vocational-curriculum.htm

[168] Po aty.

[169] Po aty.

[170] Ligji 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".

[171] LIGJ Nr.10 247, datë 4.3.2010, "Për kornizën shqiptare të kualifikimeve" ndryshuar me ligjin Nr. 23/2018, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 247, datë 4.3.2010, "për kornizën shqiptare të kualifikimeve"

nr.10, date 21.01.2021 rekomandoi që: "Institucioni (KUB) të përshtasë lëndët e këtij programi studimi me nivelin e programeve të studimit me karakter profesional."[172]

Duke patur parasysh problematikën e krijuar nga mangësitë e mësipërme, Departamenti i Studimeve të Larta Administrative rishikoi kurrikulën ekzistuese në kuadrin e riorganizimit të programit duke realizuar konsulta me ekspert të fushave përkatëse, duke iu referuar përvojës dyvjeçare dhe përvojave të vendeve perëndimore dhe duke ribërë studimin e tregut të punës. Pas një pune intensive dhe serioze për hartimin e kurrikulave që të përshtateshin me nivelin e programeve të studimit me karakter profesional, riorganizimi i programit të emërtuar "Asistent i Lartë" u miratua nga MAS me Urdhërin nr. 255, date 19.07.2021[173].

Në kuadër të këtij riorganizimi kurrikula pësoi ndryshime në emërtime lëndësh dhe akordimin e kreditive për secilën prej tyre duke patur si synim kryesor orientimin e studentëve të këtij programi drejtë njohurive dhe shprehive praktike. Nëse i referohemi kurrikulës së profilit "Asistent i Lartë Ligjor", të cilin po e marrim në shqyrtim, tabela që vijon bën pasqyrimin e ndryshimit të kryer si rezultat i këtij riorganizimi.

Kurrikula e programit të licensuar në vitin 2018 për profilin "Asistent i Lartë Ligjor" përmbante midis të tjerash lëndët e mëposhtme:	***Kurrikula e programit të riorganizuar në vitin 2021 për profilin "Asistent i Lartë Ligjor" përmban lëndët e mëposhtme:***
Mikro Ekonomi	Njohuri mbi Sistemin e Drejtësisë në Shqipëri
Makro Ekonomi	Hyrje në Ekonomi
E Drejtë Romake	Etika e Biznesit
Histori Institucionesh	Menaxhim Zyre
E Drejtë Penale e Posacme	Praktikat e Zyrave Juridike
E Drejtë Civile II	Sjellje Kosumatore
E Drejtë Ndërkombëtare Publike	Hartim dhe Shkrim i Dokumentave Zyrtare
E Drejtë Ndërkombëtare Private	E Drejtë e Punës dhe Sigurimeve Shoqërore

Tabela nr.1: Lëndët e hequra nga kurrikula 2018-2020 dhe lëndët që i zëvendësuan ato pas riorganizimit.

Nga pikëpamja sasiore vihet re një ndryshim prej tetë lëndësh nga 24 gjithsej ose 33.3%. Sidoqoftë, duhet theksuar se ndryshimi nuk është thjesht sasior, në thelb ai është cilësor sepse në kurrikulën e programit të riorganizuar janë përfshirë lëndë të formimit praktik të studentëve si: Njohur mbi Sistemin e Drejtësisë në

[172] Vendim i Bordit të Akreditimit nr. 10, datë 22.01.2021, "Për akreditimin e parë të programit të studimit dy vjeçar "Asistent Administrativ", me profile: Asistent i Lartë Administrativ, Asistent i Lartë Kontabël dhe Asistent i Lartë Ligjor të Kolegjit Universitar "I Biznesit".

[173] Urdhër nr. 255, datë 19.07.2021, "Për riorganizimin e programit të studimit me karakter profesional në "Asistent i Lartë", me profile "Asistent i Lartë Administrativ", Asitent i Lartë Financë" dhe "Asistent i Lartë Ligjor" në Kolegjin Universitar të Biznesit.

Shqipëri, Menaxhim Zyre, Praktika të Zyrave Juridike dhe Hartim dhe Shkrim Dokumentash Zyrtare të cilat synojnë t'i përgatisin studentët si asitent të aftë për zyrat ligjore, studiot e avokatisë, zyrat e përmbarimit dhe ato noteriale. Tjetër risi është pasqyrimi në të gjitha lëndët i raportit 50% njohuri teorike dhe 50% njohuri dhe aftësi praktike.

Kjo shprehet në syllabuset e secilës lëndë dhe në shpërndarjen e orëve leksion/seminar në orarin mësimor. Duhet theksuar se edhe studentët e kanë mirëpritur këtë ndryshim. Megjithatë, praktika e mësimdhënies dhe kërkesat e tregut të punës në të ardhmen mund të shtrojnë nevojën e rishikimeve të tjera kurrikulare, për këtë arsye, përfundimi se kurrikulat nuk janë tabu, se ato kanë dhe duhet të kenë dinamikën e tyre të zhvillimit e korigjimit, është i drejtë.

Kurrikula e programit të riorganizuar për profilin "Asistent i Lartë Ligjor" e krahasuar me disa kurrikula Kolegjesh Profesionale në Europë dhe SHBA rezulton se është afër tyre, edhe pse jo plotësisht. Tabela e mëposhtme pasqyron nivelin e ngjashmerisë se kurrikulës së këtij profili me atë të disa kolegjeve apo universiteteve në botë.

Nr.	Emri i Kolegjit apo Universitetit	Vendi	Ngjashmeria në numër lëndësh	Ngjashmëri në %
1.	Alexandria Technical and Community College[174]	Minnesotta, USA	Nga 19 lëndë 14 janë të njëjta ose të përaferta	73.6%
2.	Bronx Community College[175].	Bronx, USA	Nga 9 lëndë profilizuese janë të njëjta ose të ngjashme 5 lëndë.	55.5%
3.	Instanbul Medipol University[176]	Stamboll, Turqi	Nga 36 lëndë për të katër semestrat janë të njëjta ose të ngjashme 26 lëndë.	72.2%
4.	Arlington Career Institute[177]	Texas, USA	Nga 13 lëndë janë të njëjta ose të ngjashme 7 lëndë	53.8%
5.	Instanbul Bilgi University[178]	Stamboll, Turqi	Nga 29 lëndë 19 lëndë janë të njëjta ose të ngjashme	65.5%

Tabela nr. 2: Krahasim i kurrukilave te profilit "Asistent i Lartë Ligjor" me kurrikulën e disa kolegjeve profesionale ne Europe dhe SHBA.

Fakti që për lëndët profilizuese kjo simestri dhe ngjashmëri shkon në mbi 80% tregon se konceptet dhe njohuritë profesionale të përfshira në kurrikulën e këtij profili janë në shtratin e duhur, por ajo që bien në sy është që në të ardhmen në ndryshimet e mundshme kurrikulare duhet të vihet theksi më shumë tek harmonizimi më mirë i njohurive teorike me shprehitë praktike.

[174] https://bigfuture.collegeboard.org/college-profile/alexandria-technical-college/academics
[175] https://bigfuture.collegeboard.org/college-profile/city-university-of-new-york-bronx-community-college/academics
[176] https://www.medipol.edu.tr/en/academics/undergraduate-schools/school-of-law/course-program
[177] https://www.arlingtoncareerinstitute.edu/paralegal-legal-assistant/
[178] https://www.bilgi.edu.tr/en/academic/faculty-of-law/law/about/

Në lidhje me ndryshimet kurrikulare në të ardhmen është domosdoshmëri konsultimi me aktorët e tregut të punës për të pare se cilat janë njohuritë praktike që i duhen një asistenti të aftë të zyrave juridike dhe cilat janë lëndët që i kultivojnë këto njohuri. Në këtë kuadër, Departamenti i Studimeve të Larta Administrative, lipset të shtojë kontaktet me ekspertë të fushës dhe me studio ligjore, avokatie, përmbarimi apo noteriale si dhe të organizojë konsulta në department duke ftuar juristë nga institucionet publike apo studiot private, sidomos me ata me te cilet ka marreveshje bashkepunimi. Nga ana tjetër, feedback-u që departamenti merr nga institucionet dhe studiot ligjore ku studentët kryejnë praktikën profesionale duhet shfrytëzuar më mirë në funksion të ndryshimeve të mundshme kurrikulare.

IV. Zbërthimi dhe realizimi i kurrikulave në terren praktik. Risi dhe probleme.

Një kurrikulë vërtetohet sa e mirë dhe efektive është në terren praktik, pra në procesin e planifikimit, të hartimit të planeve mësimore (syllabuseve të lëndëve). Kurrikula vetë është një dokument sintetik që përmban lëndët të organizuara sipas VKM nr.41[179] dhe 879[180] në lëndë bazë (për përgatitje metodologjike dhe kulturë të përgjithshme, në lëndë karakterizuese (përgatitje për programin e studimit), në lëndë ndërdisiplinore/itegruese (nëndisiplina, profile dhe grup lëndësh me zgjedhje dhe lëndë plotësuese (gjuhë të huaja, praktika profesionale); numrin e krediteve për secilën lëndë, semestrin kur do të zhvillohet ajo lëndë dhe shumëm e orëve në auditor dhe të orëve të studimit individual nga ana e studentit. Janë planet mësimore (syllabuset) elementi kurrikular analitik që zbërthejnë më në detaje konceptet themelore që synon të formojë tek studentët secila prej lëndëve, objektivat e lëndës, temat e lëndës respektive për çdo javë mësimore dhe modul, raportin teori praktikë për çdo temë, mënyrën e vlerësimit të studenteve, literaturën kryesore dhe literaturën plotësuese.

Kjo është arsyeja që departamenti i kushton shumë rëndësi fazës së hartimit të syllabuseve nga ana e pedagogëve duke i instruktuar ata me kujdes, sidomos pedagogët e rinj. Për këtë qëllim krahas udhëzimeve me shkrim, me pedagogët e rinj punohet edhe kokë më kokë duke e vënë theksin tek specifika pedagogjike që ka mësimdhënia në arsimin e lartë profesional. Në veprimtarinë e mësimdhënies ndodh që edhe pedagogë me përvojë në mësimdhënie në programet bachelor dhe master të hasin vështirësi gjatë mësimdhënies në arsimin e lartë profesional dhe kjo vjen nga specifika që ka ky lloj arsimimi. Për këtë arsye, në raste të caktuara departamentit i është dashur të ulet me këta pedagogë për të diskutuar mbi mënyrën e gërshetimit efektiv të koncepteve teorike me elementet e punës dhe shprehive praktike. Kjo punë gjithashtu bëhet edhe nga titullarët e lëndëve.

Një element i rëndësishëm për hartimin e syllabusit është literatura, qoftë ajo kryesore, qoftë edhe ajo ndihmëse. Duke qënë se arsimi i lartë profesional, në vendin tone është ende një risi, përsa i përket literaturës pedagogët në fazën e hartimit të syllabuseve dhe realizimit praktik të temave mësimore hasin tre vështirësi të mëdha:

1. Mungesa e teksteve mësimore enkas për lëndët që përmban kurrikula e arsimit të lartë profesional, (e profilit "Asistent i Lartë Ligjor") në rastin tone. Në këto kushte atyre u duhet të përshtasin tekstet e përdorura në programet bachelor me nivelin 5 të Kornizës Shqiptare të

[179] Po aty
[180] Po aty

Kualifikimeve duke thjeshtëzuar ngarkesën teorike dhe duke përfshirë më shumë veprimtari praktike sipas natyrës së lëndës. Kjo, krahas punës për përditësimin e literaturës kryesore me koncepte që përmban teksti mësimor, kërkon punë të kujdesshme nga ana e pedagogut gjatë përgatitjes ditore për mësim që të bëjë seleksionim të elementëve teorik që do t'i paraqes auditorit dhe të mendojë për veprimtaritë praktike që do të ndërtojë.

2. Kurrikula e profilit "Asistent i Lartë Ligjor" përmban edhe lëndë për të cilat nuk ka as tekste që përdoren në programet bachelor apo master. Të tilla janë lëndët: Njohuri mbi Sistemin e Drejtësisë në Shqipëri, Menaxhim Zyre, Hartim dhe Shkrim Dokumentash Zyrtare. Kjo e vështirëson edhe më shumë punën e pedagogëve në këto lëndë. Nëse në lëndën "Menaxhim Zyre" ky problem u zgjidh sepse pedagogu i lëndës hartoi dhe botoi tekstin "Asistenti i Zyrës"[181] në dy lëndët e tjera punohet me leksionet e hartuara nga pedagogët përkatës duke përshtatur literaturë nga burime të ndryshme. Për këtë qëllim, është e nevojshme që edhe puna studimore e pedagogëve të këtyre lëndëve të orientohet në hartimin e teksteve mësimore dhe dispencave.

3. Ka lëndë për të cilat pedagogu e ka tekstin mësimor por ai nuk gjendet në treg për studentin. Në këto raste zgjidhja është dhënë duke u kërkuar pedagogëve që të hedhin në portalin e KUB leksionet e përgatitura me qëllim që studentët të kenë mundësi t'i marrin ato.

Hallka e fundit, por më e rëndësishmja, në zinxhirin kurrikular është ora e mësimit. Këtu gërshetohet liria akademike e pedagogut, përgjegjësia e tij profesionale dhe aftësia pedagogjike për të përdorur metoda aktive mësimdhënie. Departamenti i Studimeve të Larta Administrative i ka kushtuar dhe i kushton vëmendje të posaçme vënies së studentit në qendër të orës së mësimit, duke kërkuar nga pedagogët që të përdorin metoda aktive të mësimdhënies sikundër janë debatet e diskutimet, kazuset, shembuj dhe ushtrime nga jeta praktike apo vizita në studio ligjore si dhe leksionet e hapura. Për të shkëmbyer përvojën pedagogjike janë organizuar gjithashtu orë të hapura si ajo në lëndën "Procedurë Penale".

Në këtë aspekt, është e domosdoshme që secili pedagog të njoh dhe studjojë përvojën pedagogjike dhe didaktike të kolegjeve simotra në Europë e më gjërë me qëllim që ta pasurojë orën e mësimit me metoda dhe prurje të reja në fushën e mësimdhënies duke patur parasysh specifikat e tregut të punës dhe nivelin e studentëve të programit "Asistent i Lartë" (profili "Asistent i Lartë Ligjor").

V. Përfundime.

Lëmia e kurrikulave është shumë e gjërë dhe me mjaft interes sidomos në kohët e sotme të zhvillimeve të vrullshme teknologjike. Në këtë punim ne u përpoqëm t'i qasemi problemit nga këndvështrimi i kurrikulave në arsimin e lartë profesional dyvjeçar si risi në kushtet e vendit tonë. U përpoqëm t'u japim përgjigje disa pyetjeve që lidhen me hartimin, përditësimin dhe zbatimin e kurrikulave në Departamentin e Studimeve të Larta Administrative, sidomos në profilin "Asistent i Lartë Ligjor". Duke u ndalur në rrafsh teorik dhe sidomos ne terren praktik pyetje të tilla si: Sa dhe si merren parasysh specifikat e arsimit të lartë dyvjeçar në hartimin e kurrikulave; sa merren parasysh kërkesat e tregut të punës në hartimin e

[181] Jaup Zenuni, "Asistenti i Zyrës", Maluka, 2022.

tyre; sa pasqyrohen në kurrikulat e këtij programi standardet e vendeve të zhvilluara me përvojë në këtë fushë; sa dhe si pasqyrohen e zbërthehen kurrikulat në planet dhe programet mësimore dhe në praktikën e përditshme të mësimdhënies dhe; cilat janë problemet që lidhen me materialet mësimore (tekstet, literatura) në funksion të realizimit të kurrikulës, gjejnë përgjigje të përmbledhura në këtë punim.

Pavarësisht mangësive që kishte kurrikula e programit "Asistent Administrativ" me anën e të cilit ky program u licensua nga Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë në vitin 2018, ajo ka meritën e madhe se hodhi themelet e një programi për të cilin ka nevojë tregu i punës. Këto themele na lejojnë të bëjmë ndryshime dhe rregullime sipas kërkesave të kohës sikundër u veprua nga Departamenti i Studimeve të Larta Administrative për t'ju përgjigjur kërkesave të kohës dhe rekomandimeve të Bordit të Akreditimit duke riorganizuar programin e studimit. Ky riorganizim në thelb kishte përmirësimet kurrikulare duke shmangur paralelizmat me programet bachelor në Fakultetin e Drjtësisë dhe Fakultetin Ekonomik. Vlen të theksohet se vetën në profilin "Asistent i Lartë Ligjor" u ndryshuan 8 lëndë ose 33.3% e kurrikulës ekzistuese.

Synimi kryesor ishte përafrimi i kurrikulës me kërkesat e tregut të punës dhe me përvojat e vendeve të zhvilluara me qëllim që ato të reflektonin specifikat e programeve profesionale të studimit. Në funksion të realizimit të këtij objektivi u zhvilluan konsulta me ekspertë të fushës, u krye ristudim i tregut të punës dhe u studjuan kurrikulat e disa vendeve perëndimore. Kurrikulat e reja ishin pasqyrë e ndryshimeve cilësore duke reflektuar drejtë edhe kërkesën për një raport 50% njohuri teorike me 50% njohuri dhe shprehi praktike. Nëse krahasohet me kurrikulën e disa kolegjeve te studimeve profesionale në fushën e drejtësisë, kurrikula e re e profilit "Asistent i Lartë Ligjor" është 80% e njëjtë apo e ngjashme për lëndët profilizuese.

Aspekti sintetik i kurrikulës (emërtimi i lëndëve, numri i krediteve ECTS, ngarkesa në orë dhe shtrirja në semestra) lidhet pazgjidhshmërisht me aspektin analitik të saj, me zbërthimin e saj në planet dhe programet mësimore. Në këtë drejtim, Departamenti i Studimeve të Larta Administrative ka krijuar një përvojë positive, duke iu përmbajtur rigorozisht kërkesave të VKM 41 dhe 379. Hartimi i syllabuseve në përputhje me kërkesat e këtyre VKM ka qënë dhe mbetet prioritet i punës së departamentit duke u fokusuar tek udhëzimi i drejtë i pedagogëve, sidomos i pedagogëve të rinj, për pasqyrimin e koncepteve të lëndës, të objektivave të saj, për zbërthimin tematik në javët mësimore, për mënyrën e vlerësimit të studentëve dhe përdorimin e literaturës kryesore dhe ndihmëse.

Në lidhje me literaturën praktika ka treguar se pedagogët ndeshen me tre vështirësi kryesore: 1. Ka lëndë të reja si: Njohuri mbi Sistemin e Drejtësisë në Shqipëri, Menaxhim Zyre, Hartim dhe Shkrim Dokumentash Zyrtare, për të cilat nuk ekzistojnë tekste mësimore të botuara. Nëse në lëndën "Menaxxhim Zyre" ky problem u zgjidh sepse pedagogu i lëndës hartoi dhe botoi tekstin "Asistenti i Zyrës" në dy lëndët e tjera pedagogut i duhet që në bazë të syllabusit të ndërtojë leksionet duke shfrytëzuar literaturën e rekomanduar në syllabus apo edhe literature më të freskët nga burime shqiptare apo të huaja. 2. Edhe në lëndët ku për programet bachelor dhe master ka tekste të botuara, ato kërkojnë një punë selective nga ana e pedagogëve për t'i përshtatur me kërkesat e kurrikulës së programit professional. 3. Ka lëndë për të cilat pedagogu e ka tekstin mësimor por ky tekst nuk gjendet në treg për studentin.

Departamenti i Studimeve të Larta Administrative i ka kushtuar kujdes të shtuar orës së mësimit pasi aty gërshetohen liria akademike e pedagogut, përgjegjësia e tij profesionale dhe aftësia pedagogjike për të përdorur metoda aktive mësimdhënie. Sot kërkohet që studenti të jetë në qendër të orës së mësimit prandaj është kërkua dhe kërkohet nga pedagogët që të përdorin metoda aktive të mësimdhënies sikundër janë debatet e diskutimet, kazuset, shembuj dhe ushtrime nga jeta praktike apo vizita në studio ligjore si dhe leksionet e hapura. Për të shkëmbyer përvojën pedagogjike janë organizuar gjithashtu orë të hapura. Sot është e domosdoshme që në kuadër të përpjekjeve për ngritjen e vet profesionale, secili pedagog të njoh dhe studjojë përvojën pedagogjike dhe didaktike të kolegjeve simotra në Europë e më gjërë me qëllim që ta pasurojë orën e mësimit me metoda dhe prurje të reja në fushën e mësimdhënies duke patur parasysh specifikat e tregut të punës dhe nivelin e studentëve të programit "Asistent i Lartë".

Referenca:

1. A.T. Theressiakutty, L. Covinda Rao, "Curriculum for vocational education", National Institute for the Mentally Handicapped, 2001
2. Child, D. (2004), Psychology and the Teacher, 7th edition, Suffolk UK: Continuum.
3. http://www.ibe.unesco.org/en/glossary-curriculum-terminology/c/curriculum-plural-curricula, 2011
4. https://bigfuture.collegeboard.org/college-profile/alexandria-technical-college/academics
5. https://bigfuture.collegeboard.org/college-profile/city-university-of-new-york-bronx-community-college/academics
6. https://www.medipol.edu.tr/en/academics/undergraduate-schools/school-of-law/course-program
7. https://www.arlingtoncareerinstitute.edu/paralegal-legal-assistant/
8. https://www.bilgi.edu.tr/en/academic/faculty-of-law/law/about/
9. J. Zenuni, "Asistenti i Zyrës", Maluka, 2022
10. Jessica Ellis, https://www.practicaladultinsights.com/what-are-the-advantages-of-a-vocational curriculum.htm

11. Ligji 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".

12. Ligj Nr.10 247, datë 4.3.2010, "Për kornizën shqiptare të kualifikimeve" ndryshuar me ligjin Nr. 23/2018, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 247, datë 4.3.2010, "për kornizën shqiptare të kualifikimeve".

13. Ramsden, P. (2003) Learning to teach in higher education 2nd edition. London: Routledge Falmer.

14. Reid, A. and Petocz, P. (2003) The Professional Entity: researching the relationship between students' conceptions of learning and their future profession. Paper presented at the 11th Improving Student Learning Symposium, Hanover International Hotel, Hinckley, Leicestershire, 1st – 3rd September 2003.

15. Stotsky, S. (2012). The death and resurrection of a coherent literature curriculum: What secondary English teachers can do. Lanham, MD: Rowman & Littlefield Education.

16. Urdhër i MASR nr. 139, datë 23.03.2018, "Për hapjen e njësisë kryesore "Kolegji i Studimeve të Larta Administrative" në Kolegjin Universitar të Biznesit."

17. Urdhër i MASR nr. 354, datë 23.06.2018 "Për hapjen e programit të studimit me karakter profesional në "Asistent Administrativ" të Kolegjit Universitar të Biznesit."

18. Urdhër i MAS, nr. 255, datë 19.07.2021, "Për riorganizimin e programit të studimit me karakter profesional ne "Asistent i Lartë", me profile: "Asistent i Lartë Administrativ, Asistent i Lartë Financë dhe Asistent i Lartë Ligjor" në Kolegjin Universitar të Biznesit."

19. Uwak, Sylvanus Okon, "Curriculum Definition: a Misleading Philosophy", International Journal of Advancement in Development Studies, Volume 13, Number 2, 2018 ISSN: 2276-8246.

20. Vendim i Bordit të Akreditimit nr. 10, datë 22.01.2021, "Për akreditimin e parë të programit të studimit dy vjeçar "Asistent Administrativ", me profile: Asistent i Lartë Administrativ, Asistent i Lartë Kontabël dhe Asistent i Lartë Ligjor të Kolegjit Universitar "I Biznesit".

21. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 879, datë 18.12.2019, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41 "Për elementët e programeve të studimit ë ofruara nga institucionet e arsimit të lartë".

22. Vendim i Bordit të Akreditimit nr. 10, datë 22.01.2021, "Për akreditimin e parë të programit të studimit dy vjeçar "Asistent Administrativ", me profile: Asistent i Lartë Administrativ, Asistent i Lartë Kontabël dhe Asistent i Lartë Ligjor të Kolegjit Universitar "I Biznesit".

EFEKTI I ARSIMIT PROFESIONAL NË TREGUN E PUNËS

MSc. Lorela Reçi
koordinatorekub@kub.edu.al
Kolegji Universitar i Biznesit

MSc. Armando Tanasica
atanasica@kub.edu.al
Kolegji Universitar i Biznesit

Abstrakt

Një temë e përsëritur në debatet arsimore është shkalla në të cilën duhet të sistemet arsimore
të përcjellë aftësi të përgjithshme ose më mirë aftësi profesionale që përgatiten për punë në një punë të caktuar. Në rradhë me këto debate, literatura e ekonomisë bën dallimin midis aftësive të përgjithshme dhe atyre profesionale.

Kriteri përcaktues i aftësive profesionale është se ato janë specifike për vendin e punës, domethënë kërkohen vetëm në profesione të veçanta.

Në të kundërt, kriteri përcaktues i aftësive të përgjithshme është se ato përdorimi i tejkalon profesionet specifike. Në këtë kuptim, aftësitë e përgjithshme përfshijnë çdo aftësi dhe
kompetencat që rezultojnë të dobishme për një gamë të gjerë profesionesh, të tilla si shkrim-leximi bazë, shkathtësitë numerike dhe shkencore, por edhe aftësitë sociale dhe personale dhe aftësitë transversale si p.sh. kreativiteti, zgjidhja e problemeve dhe të menduarit kritik në përgjithësi.

Ky dallim është i ngjashëm me atë të miratuar nga Komisioni Evropian në vitin 2012 Komunikimi "Rimendimi i arsimit: Investimi në aftësi për më të mirë socio-ekonomik Rezultatet", e cila – në diskutimin e nevojës për të ndërtuar aftësi për shekullin 21 – dallon ndërmjet aftësive transversale dhe bazë nga njëra anë dhe aftësive profesionale nga ana tjetër.

Shkathtësitë tërthore dhe themelore janë të dyja shembuj të aftësitë e përgjithshme siç përdoren në literaturën e ekonomisë. Në mënyrë të ngjashme, të gjithë gamën e kompetencave kryesore përshkruar nga Komisioni Evropian (2018), duke qenë i zbatueshëm në një gamë të gjerë kontekstesh, do të binte në fushën e aftësive të përgjithshme siç specifikohet në literaturën e ekonomisë në masën se ato janë të rëndësishme në tregun e punës.

Programet e arsimit profesional si sistemet e praktikës janë veçanërisht të forta duke përcjellë aftësitë profesionale dhe për këtë arsye kanë tërhequr interes në shumë vende kohët e funditvjet. Avokatët lavdërojnë sistemet e praktikës që janë të zakonshme në vendet gjermanishtfolëse për mënyrën se si lehtësojnë kalimin e të rinjve nga shkolla në punë, me sa duket lufta kundër papunësisë së të rinjve.

Vende të tjera kanë programe profesionale të bazuara në shkolla që gjithashtu përgatituni për një profesion specifik, por pa lidhje të ngushtë me përvojën e punës Brenda firmave. Ende vende të tjera kanë braktisur kryesisht programet profesionale, duke u mbështetur në përgjithësi programet arsimore me shpresën se ato mund të përcjellin aftësi të përgjithshme që ofrojnë bazën për më vonë duke mësuar në punë.

Sigurisht, fokusi i politikave arsimore në vende të ndryshme dhe i programeve të ndryshme brenda vendeve kanë evoluar vazhdimisht me kalimin e kohës, duke u përshtatur me ato aktuale ose të perceptuara kërkesat nga tregu i punës dhe gjetkë. Është përtej qëllimit të këtij raporti te përshkruani evolucionet që ndodhin në vende të ndryshme dhe në lloje të ndryshme arsimi programet në mënyrë më të detajuar, ose për të vlerësuar dallimet specifike në cilësinë e përgjithshme dhe të 10 programet profesionale që ekzistojnë në vende te ndryshme.

Raporti fokusohet në një më shumë diskutim i stilizuar i meritave relative të programeve arsimore që fokusohen në përcjelljen aftësitë profesionale ose të përgjithshme, përkatësisht, për perspektivat e pjesëmarrësve në tregjet moderne të punës.

Në të njëjtën kohë, është e rëndësishme të theksohet se në praktikë, shumë programe profesionale dhe të përgjithshme jep të dyja llojet e aftësive në përmasa të ndryshme. Në disa programe profesionale gjithashtu përcillet një sasie e mirë e aftësive të përgjithshme dhe disa programeve të përgjithshme kanë një nivel të lartë përmbajtje specifike për punën.

Studimet e fundit sugjerojnë se në një ekonomi dinamike të bazuar në njohuri, punësimi i hershëm përfitimet e programeve që fokusohen në përcjelljen e aftësive profesionale mund të çojnë në probleme të mëvonshme kur aftësitë specifike bëhen të vjetruara dhe punëtorëve u mungon aftësia për t'u përshtatur me një ndryshim mjedisi ekonomik. Kështu, mund të ketë një shkëmbim ndërmjet përfitimeve afatshkurtra dhe kostove afatgjata të fokusimit në përcjelljen e aftësive specifike të punës.

Programet e orientuara duket se lehtësojnë kalimin në tregun e punës, por më vonë bëhen i vjetëruar me një ritëm më të shpejtë. Në të kundërt, aftësitë e krijuara nga programet e arsimit të përgjithshëm mund të nuk përgatiten aq mirë për hyrjen e drejtpërdrejtë në tregun e punës, por mund t'i ndihmojnë punëtorët të përshtaten më shumë lehtësisht për ndryshimin e mjediseve më vonë. Ky raport përshkruan konceptin themelor kornizë, përmbledh dëshmitë dhe nxjerr përfundime për politikën arsimore në Bashkimin Evropian.

Arsimin e përgjithshëm krahasuar me atë profesional lehtëson hyrjen në tregun e punës, por mund të dëmtojë mundësitë e punësimit më vonë për shkak të përshtatshmërisë së kufizuar ndaj ndryshimit të mjediseve ekonomike. Aftësitë e përgjithshme dhe specifike të punës: Shkëmbimi bazë gjatë ciklit jetësor. Një aspekt që është i një rëndësie të veçantë për të kuptuar meritat relative të profesionit dhe programet e arsimit të përgjithshëm është ndryshim ekonomik. Në një ekonomi statike, profesioni specifik aftësitë e fituara në programet e arsimit profesional do të jenë po aq të rëndësishme deri në fund në jetën e një personi si në fillim të karrierës. Por në realitet, ekonomitë tona janë vazhdimisht në ndryshim.

Ka shumë aspekte të ndryshimit ekonomik dhe për analizat në këtë raport nuk është e rëndësishme se nga vjen shtysa e ndryshimit. Por si shembuj të përgjithshëm mund të themi dy tendenca kryesore që kanë çuar në ndryshime thelbësore në vendet e Bashkimit Evropian gjatë dekadave të fundit janë globalizimi dhe ndryshimi teknologjik.

Së pari, integrimi i ish-Bllokut Lindor dhe Kina në ekonominë botërore ka nënkuptuar që shumë sektorë të ekonomive perëndimore kanë qenë u zhvendos në Evropën Lindore dhe Azinë Lindore. Ky proces i globalizimit ka qenë më tej lehtësuar nga zhvillimet teknologjike në komunikimin dhe logjistikën globale.

Së dyti, përparimi teknologjik ka qenë veçanërisht i theksuar në informacion dhe komunikim teknologjive. Në përgjithësi, kompjuterizimi, automatizimi, robotët industrialë dhe dixhitalizimi ka çuar në ndryshime teknologjike të paragjykuara nga aftësitë dhe rutinë, duke zëvendësuar shumë detyrat që profesione specifike përdoren për të kryer nga makinat, robotët dhe rrjetet kompjuterike (p.sh., Katz dhe Autor (1999); Autor, Levy dhe Murnane (2003); Akerman, Gaarder dhe Mogstad (2015)). Ndërkohë që këto zhvillime nuk prekin të gjithë sektorët e një ekonomie dhe të gjithë ekonomitë në të njëjtën mënyrë, ato pasqyrojnë prirje të përgjithshme që sollën ndryshime thelbësore për të gjithë vendet e Bashkimit Evropian.

Në një ekonomi të bazuar në dije që ndryshon vazhdimisht, hyrja e lehtësuar në tregun e punës është e nevojshme dhe aftësitë profesionale mund të duhet të peshohen kundrejt punësueshmërisë së reduktuar të mëvonshme kur është specifike se aftësitë bëhen të vjetruara dhe punëtorëve u mungon aftësia për t'u përshtatur me ndryshimet ekonomike. Pjesa më e madhe e diskutimeve të fundit rreth zhdukjes së ish-klasës së mesme vendet e punës në shumë shoqëri perëndimore për shkak të përparimit teknologjik lidhet pikërisht me temën e duke iu përshtatur kushteve të ndryshuara.

Prandaj, përçimi i aftësive që u mundësojnë punëtorëve të përshtaten ndryshimi i mjediseve duhet të jetë një aspekt qendror në vlerësimin e masës në të cilën programet e arsimit profesional dhe të përgjithshëm i përgatisin studentët për mundësitë e jetës në punë modern dhe në tregje.

Për të nxjerrë në pah kompromiset e përfshira në lloje të ndryshme të programeve arsimore, kjo ndihmon dallojnë dy lloje aftësish. Nga njëra anë, ka aftësi të përgjithshme dhe aftësitë bazë në gjuhë, komunikim, matematikë, shkencë dhe çdo gjë tjetër njohëse, aftësi sociale ose personale që janë të vlefshme në tregun e punës në shumë profesione të ndryshme.

Këto aftësi shërbejnë si bazë për të mësuarit e mëtejshëm në punë. Kështu ato mund të përdoren për hyjnë në punë të ndryshme. Për më tepër, në një moshë të mëvonshme, aftësi të përgjithshme që lehtësojnë mësimin e vazhdueshëm të tilla si aftësitë konjitive themelore, aftësitë transversale, përshtatshmëria, kreativiteti, zgjidhja e problemeve dhe aftësitë e të menduarit kritik mund të ofrojnë një bazë të dobishme për t'u përshtatur me ndryshimin e tregut të punës kërkesat dhe lehtësojnë mësimin e një grupi të ndryshëm aftësish të lidhura me punën.

Nga ana tjetër, ka aftësi specifike për punë që kërkohen vetëm në një specifikë profesion. Mësimi i këtyre aftësive të lidhura me punën i përgatit studentët mirë për të punuar në atë specifike profesioni, por ato janë më pak të rëndësishme në profesionet e tjera. Duke u pajisur me perkatese aftësitë specifike të punës i bëjnë studentët produktivë pikërisht kur hyjnë në tregun e punës, ashtu si ata kanë aftësitë që punëdhënësit kërkojnë tani. Por nëse kërkesa për këto aftësi shpërndahet në punë në treg, këto aftësi bëhen kryesisht të vjetruara.

Natyrisht, dallimi midis aftësive të përgjithshme dhe atyre specifike të punës është disi i paqartë.

Ndërsa dikush mund të argumentojë se të gjitha aftësitë bazë janë tërthore, shkalla në të cilën janë më të avancuara aftësitë janë specifike për një punë, një kompani ose një industri mund të ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme. Prandaj, përtej aftësitë bazë, shumë aftësi do të kenë një element specifik të punës, në varësi të nivelit të tyre.

Për shembull, kërkohen disa aftësi bazë TIK dhe të ngjashme për shumë lloje të punës, por shumë aftësitë në Teknologji Informacioni do të jenë gjithashtu specifike për profesionin, sektorin apo edhe firmën përkatëse.

Në mënyrë të ngjashme, nivelet bazë të shkrim-leximit janë shumë tërthor, disa punë si redaktori kërkojnë shumë nivele të larta të shkrim-leximit që nuk janë aq të rëndësishme në shumicën e profesioneve të tjera. Gjithashtu, aftësitë të tilla si krijimtaria që përdoren përgjithësisht si shembuj kryesorë të aftësive transversale do të jenë më shumë punësuar shumë në disa profesione sesa në të tjera, duke hyrë në një element specifik të punës përdorimin e tyre.

Fuqia punëtore e Shqipërisë tani është në moshën e artë, por mungesa e aftësive profesionale dhe mospërshtatja me kërkesat e teknologjisë së kohës po bëhet shkak që modeli ekonomik të orientohet nga "skllavërimi", ku shitja e lirë e krahut të punës dominon në ofruesit e mallrave dhe shërbimeve. Zhvillimi në këtë mënyrë, përveçse po mban të ndrydhur vlerën e shtuar të ekonomisë, po zbeh perspektiven për të ardhmen.
Vetëm dy vite më parë, kompanitë CapCon, Johnson Control dhe Lear Coporation, me aktivitet në prodhimin e aksesorëve për industrinë automatike, kanë dështuar të hapin linjat e tyre në Shqipëri për shkak të mungesës së krahut të kualifikuar të punës, duke zhvendosur më pas projektet në Maqedoni. Kompanitë tashmë kanë investuar miliona euro në vendin fqinjë dhe kanë punësuar mijëra persona me paga mujore mbi 500-600 euro. Gazsjellësi TAP, për të njëjtat arsye, ka kontraktuar një pjesë të madhe të fuqisë punëtore të specializuar nga jashtë.
Vendet fqinjë, kur dolën nga regjimet komuniste, ruajtën modelin e arsimit profesional dhe nuk i shkatërruan fabrikat. Shqipëria, edhe 27 vite pas terapisë së shokut, vijon të zhvillohet pa një model ekonomik të orientuar, ndërsa sot e kësaj dite arsimi profesional po zhvillohet pa asnjë lidhje me tregun e punës.

Në tre anketa që Shërbimi Kombëtar i Punësimit ka bërë në vitet 2008, 2010 dhe 2012 me bizneset, ka gjetur se mungesa e aftësive është e pranishme në të gjithë sektorët e ekonomisë. Këshilli i Investimeve, në një anketë që zhvilloi vitin e kaluar, referoi se mungesa e kualifikimit të punonjësve ishte një ndër gjashtë shqetësimet kryesore.
Kualifikimi jo i përshtatshëm i forcës së punës ishte një nga problemet kryesore në bizneset e agro-përpunimit, në industrinë përpunuese e nxjerrëse, dhe në industrinë energjetike. Ndërsa kultura e punës u referua si një problem madhor për gjysmën e bizneseve në sektorin e bujqësisë, tregtisë, hotelerisë e restoranteve, si dhe në sektorin arsimor.
Një ekspert me përvojë në sektorin e arsimit profesional që preferoi të komentonte duke ruajtur anonimatin, thotë se mungesa e një hallke që të lidhë nevojat e tregut të punës me arsimin profesional është emergjente. Ai sugjeron ngritjen e një strukture që të orientojë numrin e nxënësve me nevojat që ka ekonomia.
Qeveria Rama e ka vënë arsimin profesional në krye të prioriteteve të sektorit arsimor, por në realitet struktura e shpërndarjes së shkollave është gati e njëjtë me atë të para viteve '90. Trupa mësimore nuk është e kualifikuar me nevojat e kohës, ambientet dhe laboratorët e praktikave mësimore janë krejt të vjetruara, ndërsa arsimi profesional ndiqet nga nxënësit më të dobët të ciklit nëntëvjeçar.

Nota mesatare në drejtimet profesionale të elektronikës, TIK, informatikës, mekanikës ishte poshtë 6.5-s këtë vit që u mbyll, një tregues jo pozitiv për aftësitë që tregu i punës kërkon. Zhvillimeve kaotike që po kalon arsimi profesional aktualisht i përgjigjen projeksione jo shumë optimiste në të ardhmen.
Informacionet demografike tregojnë se numri i nxënësve që pritet të regjistrohen në arsimin e mesëm (klasa 10) do të zbresë nga 60,139 (për grupin e personave të lindur në vitin 1998) te 39,612 (për ata të lindur në vitin 2005). Ministria e Mirëqenies Sociale, në një raport strategji për arsimin profesional 2014-2020, referon se për shkak të zhvillimeve demografike, shkollat profesionale do të përballen me një rënie të numrit në masën 55% midis viteve 2013 dhe 2020. Në vitin arsimor 2016-2017 u regjistruan në shkollat profesionale 20,981 nxënës, me një rënie të lehtë nga viti 2015-2016. Mirëpo nga regjistrimi në diplomim, firot janë shumë të mëdha. INSTAT raportoi se, për vitin shkollor 2014-2015 në shkollat profesionale e morën dëftesën e pjekurisë vetëm 4702 nxënës.

Por eksperti i arsimit profesional pohon se, me gjithë problematikën në të cilën përballet sektori, të dhënat tregojnë se të papunët me arsim profesional janë në përqindje më të ulët në raport me kategoritë e tjera.
Të papunët me arsim profesional janë vetëm 11% sipas të dhënave të 2016-s, teksa kjo përqindje është më shumë se dyfishi në të papunët me arsim të përgjithshëm.
Ndonëse nuk ka një sistem gjurmueshmërie për integrimin e atyre që mbarojnë arsimin profesional me tregun e punës, të dhënat indirekte tregojnë se kjo kategori ka pasur më shumë shanse të punësohet.

Nuk do të kalojnë edhe shumë vite kur brezi i punonjësve të arsimuar para viteve 1990 do të dalë në pension dhe atëherë kambanat e alarmit do të bien në të gjithë sektorët me aftësi profesionale të drejtuara. Të arsimuarit e pas viteve 1990 nuk janë në gjendje t'u përgjigjen nevojave të kohës as në numër dhe as në cilësi. Sot, arsimi edhe në vende të zhvilluara po përballet me dilema të mëdha, pasi teknologjia po avancon me hapa më të shpejta se kurrikulat mësimore dhe modelit klasik të orëve teorike do t'i duhet përshtatje.

Rekomandimet:
1. Nxitja e të rinjve dhe pajisja e tyre me instrumente pragmatike për të ndërmarrë një rol më proaktiv në formësimin e drejtimeve të karrierës së tyre. Instrumente të tilla, si profili i orientimit professional mund t'i ndihmojnë nxënësit në fazën e tyre të orientimit profesional për të zbuluar personalitetin, interesat, kapacitetet dhe talentet e tyre, për të eksploruar se cila karrierë profesionale mund t'u përshtatet dhe cilat programe/drejtime trajnimi ofrohen nga ofrues të ndryshëm. Studentet duhet të nxiten që të eksplorojnë tregun lokal/rajonal të punës dhe të identifikojnë mundësitë për praktikë profesionale me iniciativën e tyre.

2. "Aktivizimi" i pjesëmarrjes së studenteve në bordin drejtues të ofruesit të AFP-së. Krijimi i mendësisë se studenteve nuk janë vetëm "klientë", por edhe pjesëtarë të një institucioni, se ata duhet të luajnë një rol, të marrin përsipër përgjegjësi dhe mund të kontribuojnë në përmirësim. Prezantimi i metodave novatore të tilla si këshillimi mes nxënësve, ku nxënësit më të mëdhenj/me përvojë në AFP i ofrojnë mbështetje nxënësve më të rinj në momentin e marrjes së vendimit për një drejtim karriere.

3. Përfshirja e prindërve të cilët shprehin vullnetin për të dhënë kontributin përmes përvojës së tyre në

biznes. Ata mund të ndihmojnë me identifikimin dhe lehtësimin e mundësive për praktika profesionale dhe forma të tjera bashkëpunimi me kompanitë.

Referencat:

European Commission. 2014. Sector Reform Contract for Employment and Skills.
Sector Information. IPA II Sectors. Education, employment and social policies. Available at: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/albania/ ipa/2015/ipa-2015-038716-01-al-sector-reform-contract-for-employment-and-skills.pdf
European Commission. 2014 IPA, Indicative Strategy Paper for Albania (2014–2020).
Gjendet në:
https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/ key_documents/2014/20140919-csp-albania.pdf
INSTAT.2020. Population and Housing.
INSTAT. 2018. Albania in Figures.
INSTAT. 2019. Foreign Trade in Good

Matthias Jäger. 2013. Meandering through Policy Development: Observations on Vocational Education and Training in Albania. SwissContact Albania
Ministry of Finance and Economy. 2018. Mid-Term Review of National Employment and Skills Strategy (NESS) 2014–2020.

Projektligji per arsimin dhe formimin profesional ne Republiken e Shqiperise https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2018/06/ligj-nr-15-dt-16-2-2017.pdf.

"IMPAKTI I REFORMËS NË DREJTËSI MBI KURRIKUALT STUDIMORE TË PROFESIONISTËVE TË RINJ NË FUSHËN E DREJTËSISË"

Ph.D. Av. Enida Bozheku
Lektore e Jashtme:
Kolegji Universitar i Biznesit, E drejte Penale
***Doktore Shkencash (Ph.D.)** në të Drejtë dhe Proçedurë Penale – Universiteti "Sapienza" – Fakulteti Juridik, Romë (Itali)*
***Avokate**: Urdhri i Avokatëve, Romë (Itali) - Urdhëri i Avokatëve, Tiranë (Shqipëri)*

1. Hyrje.

Reforma në Drejtësi, si një proçes katarsisi në drejtësinë shqiptare të këtyre 30 viteve tranzicion të institucionalizuar, ka bërë që të rritet vëmëndja e operatorëve të drejtësisë edhe ndaj impaktit qe kjo reformë ka prodhuar në sistemin arsimor kurrikular në lidhje me Fakultetet e Drejtësisë.

Ndryshimi I strukturës organike të pushtetit gjyqësor duke nisur nga struktura normative rendore kushtetuese e deri tek ligjet me impak social domethënës kanë bërë që I gjithë sistemi qarkor arsim – sistem drejtësie – cilësi europiane të ndërvaren në mënyrë simbiotike. Sot nevoja themelore në fushën e drejtësisë është në kuadër të formimit të brezave të rinj të juristëve, të cilët do të operojnë në tregun e punës me frymë dhe mëndësi normativo-interpretative të ndryshuar dhe të adaptuar me strukturën e *Acquis Communautaire*.

Mungesa e theksuar në sistemin e drejtësisë të magjistratëve dhe prokurorëve, si pasojë e proçesit të vettingut, ka shtuar edhe më shumë vëmëndjen ndaj prurjeve të reja të juristëve, të cilët duhet të vinë nga nje profil studimor kurrikular bashkëkohor dhe të përshtatur me nevojat dhe kërkesat e sistemit drejtësi me qëllim garantimin e një funksionimi të mirë të organikës shtetërorë në përbërësin e tij thëmelor sistemin gjyqësor dhe koadiuvantët e tij.

Nevoja urgjente për trajnime dhe specializime specifike në fushën e drejtësisë bën që, ndërmjet Universitetit - Fakultetet e Drejtësisë si prodhues elitash në sistemin drejtësi (referuar figurave të juristëve specialist, avokatëve, noterëve, prokurorëve, gjyqtarëve, përmbaruesve) dhe organizmave profesionale mbikqyrëse të këtyre profesioneve elitare, të rritet niveli I bashkëpunimit dhe të orientohet dija në kuadër të standardizimit përshtatës me atë të Bashkimit Europian.

Fjale kyçe*: *Reform, Profesionalizëm, Acquis Communautaire, Kurrikula, Bashkëpunim

2. Metodologjia.

Hulumtimi kërkimor shkencor në këtë fushë multi-displinore bazohet mbi aplikimin e metodologjisë dialektalo-cilësore të përshtatur me të dhëna sasiore që lidhen me proçesin e "Vetingut" dhe aftësinë e tregut shqiptarë për të përthithur talente në fushën e drejtësisë dhe përgatitjen e brezave të rinj të juristëve me qasjet më të mira europiane. Kësisoj lind nevoja për adaptimin e formateve kurrikulare - profesionale me strukturën e të menduarit juridik të përshtatshëm për konkurim në tregun europian.

3. Rënia e sistemit totalitar dhe efektet socio-arsimoro – juridike.

Me rënien e sistemit totalitar në Shqipëri, në vitin 90' dhe vendosjen e sistemit demokratik, edhe struktura shoqërore-arsimore dhe mbi të gjitha ajo juridike bazë mbi të cilën bazohet jetesa e shtetit, u riorganizuan dhe rithemeluan sipas rendit të ri politik-institucional-juridik të vendosur në kuadër të shtetit të së drejtës dhe parimeve demokratike.

Kështu sistemi demokratik[182] solli për shqiperinë e viteve 90', një frymë mendimi të re të përshtatur me ngjarjet e kohës dhe me rithemelimin normativ të strukturës shtetërore.

U rikonceptua e drejta e bazuar, tashmë, mbi principe të lidhura me të drejtën e pronës private, lirisë së shprehjes apo të drejta të tjera si ajo e arsimit pa dallime, ku në dyert e universiteteve mund të shkonte kushdo pa ndasi përkatësie politike.

Kjo frymë e re zhvillimi e ngritur mbi principe demokratike solli edhe një riorganizim të strukturës mendore të shoqërise shqiptare të atyre viteve duke e çuar atë në një rrugtim demokratizimi të gjatë e të mundimshëm.

Pasojat epokale[183] të ndryshimit të sistemeve sollën edhe një përplasje nocionesh, formësimi dhe institucionalizimi si në kuadër të qarqeve akademike ashtu edhe në ato arsimore të ngushta, duke prodhuar, në shumicën e rasteve kaos mendimi dhe dyzim strukturash analitike formative, të cilat ndikuan drejtpërsëdrejti në brezat pasardhës.

Kështu, në një analizë dialektike të fenomenit demokratizues mund të themi që efekti I parë I prodhuar nga rënia e sistemit diktatorial ishte riformatimi I elitës akademike[184] dhe nevojës së saj për t'u përshtatur dhe azhornuar me risitë e tipizuara si në sistemin ekonomik ashtu edhe në atë juridik. Dy shtylla këto shtet-mbajtëse!

Tranzicioni shqiptar, vështirësitë e tij 30 vjeçare, shpejtësia e trasformimit të strukturës shoqërore dhe degradimi si pasojë e lirisë pa konroll e pa kuptim të lidhur me nocione filozofiko-morale kanë bërë që në këto 30 vite demokraci sistemi shqiptarë, I cili zanafillën e tij e ka në arsim, si themeli i formimit të elitave drejtuese të një shteti, ka pësuar metamorfoza të atilla që kanë ndikuar dhe ndikojnë në botëkuptimin e fenomeneve me karakter negativ pjesë e shoqërisë shqiptare.

Analiza evolutive e Shqipërisë pas rënies së regjimit totalitar[185] do të ishte jashtëzakonisht komplekse dhe e gjatë për synimin e këtij punimi por në linja të përgjithshme, pa dashur të kalohen 30 vite aktivitete jetësore, poltike, juridike, sistemike demokratizimi, vëmëndjen do ta ndalim në dy

[182] Krasniqi A., "*Sistemet politike në Shqipëri, 1912-2008*", II. ed, Ermal, Tirana
[183] Fischer B. J., "*Shqipëria që prej vitit 1989: trashëgimia hoxhiste*", in "*Shqipëria në dhjetë vitet e ardhshme – vështrim drejt së ardhmes*", AIIS, Tirana, 2012
[184] Dahl R. A., *Sulla democrazia*, Laterza, Roma-Bari, 2006
[185] Biberaj E., *Shqipëria në tranzicion, Rruga e vështirë drejtë demokracisë 1990-2010,* AIIS, Tiranë, 2011

momente kulmore të 7 viteve të fundit siç është ajo e Reformës në Arsimin e Lartë dhe Maksi Reformës në Sistemin e Drejtësisë, pushtetin e tretë, gjyqësorin.

3.1. Reforma në Arsimin e Lartë dhe Maksi Reforma në Drejtësi.

Le t'a ndalim analizën tonë në kuadër të Reformës në Drejtësi të vitit 2016, e cila erdhi si domosdoshmëri për të ndryshuar dhe rithemeluar konceptin e së drejtës në Shqipëri, që pas rënies së regjimit totalitar në vitin 1990, ajo duket të ketë humbur vet-vehten dhe idealet mbi të cil ngrihet.

Kështu, tranzicioni i tejzgjatur juridik shqiptarë, ka prodhuar një sistem në të cilin siguria juridike edhe pse parim bazë I egzistencës së një shteti demokratik, të mos jetë e garantuar në formë proporcionale me ato që janë parimet e përcaktuara në vet kushtetutën e Republikës së Shqipërisë[186].

Korrupsioni[187] i theksuar i gjyqësorit, emigracioni i të rinjve dhe kuadrove profesional, reformat e pakoordinuara sistemike siç është ajo në arsim e lidhur me reformën në gjyqësor prodhon hendikap formativ të rëndësishëm dhe me impakt afat-gjatë në strukturën shtetërore dhe shoqërore.

Për t'u ndalur më në detaj në lidhje me reformën në arsim dhe atë të gjyqësorit ndërveprimi i rëndësishëm funksional mes të dyjave, lexohet në karakteristikat specifike që Ligj n. 80/2015 "*Për Arsimin e Lartë*" i ka njohur kohëzgjatjes së kryerjes së studimeve në fushën e drejtësisë.

Kështu, në nenin 82, të Ligj n. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë", lexohet: "*1. Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në fushën e drejtësisë realizohen me 300 kredite, për një kohëzgjatje* ***prej jo më pak se 5 vite akademike****.*
2. Personat që kanë kryer studimet e integruara në drejtësi, ose në një program të ciklit të dytë të studimeve, të barasvlershëm me to, mund të konkurrojnë për t'u përgatitur si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, noterë, avokatë të shtetit, përmbarues privatë ose shtetërorë, si dhe juristë në administratën shtetërore, qendrore dhe vendore, pasi të kenë kryer provimin e shtetit në drejtësi.
3. Provimi i shtetit organizohet nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe Ministria e Drejtësisë, sipas rregullave dhe procedurave, të parashikuara në legjislacionin në fuqi".

Ligji për arsimin e lartë, nga përmabjtja normative kuptohet që i ka kushtuar një vëmëndje specifike një prej strukturave arsimore më të rëndesishme, siç është ajo e formimit të brezave të rinj të juristëve. Po ashtu në analizë normative, ligjvënësi është kujdesur që studimet në drejtësi ti përcaktojë edhe në raport me degët e formimit specifik qe aksesi në sistemin e drejtësisë – faze e parë formuese ajo e Fakultetit të Drejtësisë, i jep të rinjve qe nesër do të jene pjesë e Shtetit. Sa kaq shkon edhe në raport me sa përcaktuar edhe në interpretim të kombinuar mes nenit 7 dhe nenit 57 të Kushtetutës së Shqipërisë, ku përkatësisht lexohet: **Neni 7** "*Sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet* ***në ndarjen dhe balancimin*** *ndërmjet* ***pushteteve*** *ligjvënës, ekzekutiv dhe* ***gjyqësor*****", neni 57 "***Kushdo ka të drejtën për arsimim***".

Lexuar në këndvështrim evolutiv metodik, mund të themi me arsyetim llogjik se me anë të së drejtës kushtetuese për arsimim, çdokush në Republikën e Shqipërisë, parë sistemin normativ referent ka

[186] Kushtetuta e R.SH., neni 3 "**Pavarësia e shtetit** dhe tërësia e territorit të tij, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, **drejtësia shoqërore**, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili **ka për detyrë t'i respektojë dhe t'i mbrojë**".

[187] Jano D., *Rreth shkaqeve dhe faktorëve që lidhen me korrupsionin: Rasti i Shqipërisë*, in Riv. Polis 6, UET Press, Tirana, 2008

të drejtë të arsimohet dhe të ndjekë studimet e larta 5 vjeçare për drejtësi, të cilat mundësojnë qasjen në karrierën përbërëse të sistemit të drejtësisë, specifikisht në karrierën e gjyqësorit, avokatisë, përmbarimit, noterisë apo akses në administratën publike.

Ky përcaktim i artikuluar në bazë të ligjit për arsimin e lartë, sot, në kuadër të formimit të kurrikulave arsimore për juristët e ardhshëm duket të jetë themeli mbi të cilin bazohet pushteti gjyqësor në kuptim të ngushtë. Pra, vet ligji për arsimin e lartë e sheh Fakultetin e Drejtësisë si tempullin parësor ku formohen juristët e së ardhmes dhe se ata, në kuptim shmërinë bazike të formimit të tyre do të jenë kuadër të lartë në profile si gjyqtarë, avokatë, noterë, prokurorë, përmbarues apo juristë në administratën shtetërore.

Të gjitha këto profesione lidhen me mirëfunksionimin e shtetit dhe për këtë arsye qasja e tyre në sistemin qeverisës pushtetas duhet të kalojë në filtra ligjor të posaçëm që rregullojnë aksesimin në profesionet e sipër-përmëndura apo sipas ligjeve specifike për aksesin në administratën publike.

3.2. Reforma në Drejtësi – Ndryshimet rrënjësore.

Për ta çuar mëtej analizën tonë, le të ndalemi te Reforma në Drejtësi, e cila vjen vetëm një vit pas miratimit të reformës në arsim dhe strukturave arsimore të larta.

Kështu me ligj n. 76/2016 "*Për disa ndryshime në Kushtetutën e Republiks së Shqipërisë*", u ndërhy në atë që mund t'a quajmë "***maksi-reforma gjyqësore post tranzicioni demokratik në R.Sh***", ku u riorganizua tërësisht struktura e sistemit/pushtetit gjyqësor.

Kjo reformë vjen si pasojë e nevojës për të kryer një ***katarsis*** në sistemin tonë të drejtësisë, që ka treguar, në vite, se është i prekur në mënyrë rrënjësore nga fenomeni i korrupsionit, paaftësisë. Ndikimit politik dhe lidhjeve me krimin e organizuar. Ndryshimet kushtetuese dhe shoqërimi i tyre me paketën e 7 ligjeve themelore bën që kjo maksi-reformë sistemike në gjyqeësor të jetë e lidhur edhe me botën akademike – formative të juristave të rinj.

Kështu, reforma në Drejtësi, në 5 vjeçarin e parë të saj ka nxjerr në pah probleme të theksuara në lidhje me formimin e trupës së juristëve, gjyqtarë e prokurorë, si në aspketin profesional ashtu edhe atë moral dhe penal.

Krijimi i anekseve kushtetuese tranzitore, specifikisht të lidhura me proçesin e ashtëquajtur "Vetting[188]" është kthyer në një barometër vlerësimi mbi tërësinë e sistemit drejtësi dhe ka evidentuar pikat e dobta të sistemit si në profilin formues, ku kemi gjyqtarë e prokurorë të cilët janë konsideruar të paaftë në ushtrimin e profesionit ashtu edhe atë moral e penal, ku kemi prokurorë e gjyqtarë moralisht të pa pranueshëm për të ushtruar funksionet e tyre pasi me probleme përsa i takon lidhjes me krimin e organizuar apo me elemente penal siç janë ato të fshehjes së pasurisë apo deklarimit të rremë, të konsideruara nga sistemi ynë penal, në nenin 257/a K.P., vepër penale.

Në këtë kuptim strukturat si K.P.K. (Kolegji i Pavarur i Kualifikimit) apo K.P.A. (Kolegji i Pavaur i Apelimit), aktualisht me mandat 7 vjeçarë[189], kanë marrë në shqyrtim 60%[190] të trupës gjyqësore

[188] Ligj n. 84/2016 *"PËR RIVLERËSIMIN KALIMTAR TË GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"*

[189]https://www.reporter.al/2022/02/10/kuvendi-miraton-zgjatjen-e-afateve-te-organeve-te-vetingut/(akses 13.06.2022)

[190] https://kpk.al/wp-content/uploads/2021/12/RAPORTI-4-VJECAR-SHKURT-2018-NENTOR-2021.pdf (akses 14.06.2022)

dhe prokuroriale, ku për periudhën nga 8 shkurt 2018 deri në 30 nëntor 2021 janë shkarkuar nga rradhët e gjyqësorit 178 magjistrat e prokurorë, jane konfirmuar në detyrë 185 magjistratë e prokurorë, kane dhënë dorëhqejen nga rradhët e gjyqësorit, me qellim mos nënshtrimin ndaj proçesit të vettingut 70 magjistratë e prokurorë.

Shifrat e dhëna rezultojnë të jenë alarmante dhe të pohojnë nevojën e reformës në drejtësi me të gjithë problematiakt që ajo ka krijuar.

Në lidhje me strukturën e reformës në drejtësi, përtej pjesës fizike, pra atë të largimit nga sistemi të gjyqatrëve dhe prokurorëve të cilët nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në ligj, profil tjetër analitik mbetet kuadri normativ reformues i ligjeve themelore pjesë të organikës së strukturës së funksionimit të sistemit të drejtësisë.

3.3. Institutet e reja kushtetuese në kuadër të reformës në drejtësi.

Krijimi i institutive të reja juridike në sistemin e drejtësisë, si Këshilli i Lartë Prokurorial (K.L.P), Këshilli i Lartë Gjyqësor (K.L.GJ.). Këshilli i Emërimeve në Drejtësi[191], Isoektoriati i Lartë i Drejtësisë, ristrukturimi i përzgjedhjes së antarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, rithemelimi i funksioneve të Gjylkatës së Lartë në të ashtëquajturin proçesi nomofilakisë, kanë çuar edhe në një riformatim – përshtatje të vet strukturës arsimore kurrikulare universitare, të lidhur me efektet e kësaj reforme.

Kështu, në kuadër të reformës në drejtësi[192] ndryshime thelbësore kanë pësuar edhe ligjet organike siç janë Kodi i Proçedurës Penale, me futjen e figurës filtër si Gjykatësi i Hetimeve Paraprake, Gjykatësi i Seancës Paraprake, gjykimi me marrëveshje apo riformulimi i gjykimit të shkrutuar, ri-përcaktimi i rolit të gjykatës së lartë si gjykatë legjitimiteti dhe taksativitetit të motiveve për rekurs, prezenca e avokatit si figurë e domosdoshme në proçes, të drejtat e të pandehurit dhe të viktimës apo ristrukturimi I proçesit civil me futjen e deklaratës së mbrotjes, regjistri elektronik I ekspertëve, taksativiteti I motiveve për rekurs ne dhomën civile të Gj.L., apo futja në sistem I së drejtës minorile, me anë të Kodit për Drejtësin Penale për të Mitur.

Këto janë *vetëm disa nga ndryshimet* thelbësore të cilat, në prizëm akademik studimor duhet t'I përshtaten kurrikulave të studentëve të rinj të fakulteteve të drejtësisë, duke krijuar kështu bazën përshtatëse me evolucionin normativ aktualisht në fuqi.

3.4. Kurrikulat e reja Universitare, Fakultetet e Drejtësisë dhe Acquis Communautaire.

Aktualisht Shqipëria është vënd me statusin kandidat për në Bashkimin Europian. Status ky i fituar që prej vitit 2014[193]. Kjo do të thotë që të gjitha politikat e shtetit Shqiptar janë të orientuara drejt familjes europiane dhe adaptimit të legjislacionit të saj me frymën europiane, të drejtat dhe garancitë qe sistemi europian garanton për shtetasit e saj. Në këtë rrugtim të Shqipërisë, pajisja që në bankat universitare të studentëve me njohuri të azhornuara si në kuadër të reformës në Drejtesi[194] ashtu edhe të gjithë ligjeve bazike të domosdoshme për antarsimin e Shqipërisë ne B.E., duket të jetë I domosdoshëm.

[191] Kushtetuta e Republikws sw Shqipwrisw nw - https://www.parlament.al/Files/sKuvendi/kushtetuta.pdf

[192] Bozheku E., Bozheku E., "*The Reform of the Albanian Legal System Between Challenges and Problems, With Particular Focus on the Criminal Justice Issues*", https://doi.org/10.36941/ajis-2021-0169

[193] https://www.eupolicyhub.eu/rrugetimi-i-shqiperise-drejt-bashkimit-europian/ (akses 10.06.2022)

[194] Bozheku E., Bozheku E., Skënderaj K., "*Theoretical-Conceptual, Legal and Social Problems of the*

Më në konkret mund të themi se në kurrikulat universitare - të fakultetit të drejtësisë, më shumë interes do të kishte përgatitja e studentëve me profile komparative njohurish, kryesish mbi strukturën ligjore[195] bazë të vëndeve themeluese të bashkimit europian por edhe thellimi I analizave studimore me modulë të posaçmë që lidhen me ligjet organike të shteteve nga ku Shqipëria ka marrë pjesë të legjislacionit të saj, për t'a aplikuar në sistemin tonë juridik.

Me interes do të ishte pasurimi I kurrikulave universitare – në fushën e drejtësisë me module teknike bashkëkohore, nën frymën e *Acquis Communautaire*, si p.sh. e drejta e konsumatorit, e drejta energjitike, e drejta e privatësisë apo e drejta e migracionit në kuadëer krahasimor me qëllim që brezat e rinj të juristëve të kënë një qasje mendore, studimore dhe analitike më të shpejtë, më të azhornuar dhe më të përafruar me sistemin juridik *erga omnes* të Bashkimit Europian.

Gjithashtu investimi në kuadro trupash pedagogjike me qasje bashkëkohore dhe formim dual si brënda ashtu edhe jashtë vëndit, në kuadër të një ngritje të sistemit arsimor, gur themeli për përgatitjen e juristave të rinjë, shihet si një bashkëpunim afat-gjatë mes analizës së sistemit aktual juridik, frymës dialektale të stimuluar nga aftësitë krahasimore mes sistemeve juridike dhe implementimit të mëndësisë interpretuese përshtatëse të *Acquis Communautaire*[196].

Në një Shqipëri, ku vit pas viti, kemi rrjedhje të trurit, largim të të rinjëve dhe një varfërim intelektual të brezave, e vetmja mënyrë për të ringritur shtetin dhe sistemin e besueshmërisë në gjyqësor është që të ndërtohet që tani baza për strukturimin teknik, profesional, human dhe të përgjegjshëm të trupës së re të juristëve shqipëtar.

4. Përfundime.

Reforma në Drejtësi, pas reformës në Arsimin e Lartë janë shtyllat kryesore mbi të cilën Shqipëria në fazën e demokratizimit institucional duhet të ngrerë bazat për një vazhdimësi të suksesshme dhe për një të ardhme më të mirë investimi në brezat e rinj.

Ndryshimet thelbësore të ndodhura në sistemin gjyqësor, në veçanti, por edhe ato të ndodhura në reformën për arsimin e lartë, I hapin rrugë një forme të re të menduari, llogjikuari dhe vepruari karshi aspiratave të Shqipërisë për t'u antarësuar në familjen europiane.

Vetëm nëpërmjet ndërtimit të figurave të juristëve/"shtetarëve" apo profesionistëve të përgjegjshëm, konkurrent në tregun e punës, profesional dhe me ambicje për zhvillim mund të ndërtohet një Shqipëri më e mirë dhe e aftë për t'u prezantuar në tregun europian si e barabartë dhe dinjitoze.

5. Rakomandime.

Aktualisht, arsimi i lartë në Shqipëri në raport me numrin e studentëve që regjistrohen çdo vit në fakultetet e drejtësisë qofshin ato privat apo shtetëror[197], bën që Fakulteti I Drejtësisë të mbetet I

Albanian Criminal Code: Some Useful Observations in view of its Reform", https://doi.org/10.36941/ajis-2022-0053

[195] Bozheku E., *Hybridization of socio-legal system in transition - Legal and Judicial Reform*, in Riv. *Mendimi*, Università "Luarasi" Press, Tirana, 2018

[196]https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2019/02/MANUAL-PER-HARTIMIN-E-LEGJISLACIONIT.pdf

[197] Në vitin akademik 2021-22, vazhdojnë studimet në të gjithë programet e arsimit të lartë 123.880 studentë, duke shënuar një rritje prej 0,1 % krahasuar me 2020-21. Studentët që marrin pjesë në arsimin e lartë publik, përbëjnë 76,3 % të numrit total të studentëve. Rreth 32.227 studentë në vitin akademik 2021-/2022 janë regjistruar për "Ligj,

preferuari mes cikleve studimore në shkencat humaniste, edhe pse tregu ka një numër të lartë Institutesh të Arsimit të Lartë private dhe shtetërore që ofrojnë këtë degë studimi.

Kjo ka bërë që konkurrenca të duhet të fokusohet në cilësinë e mësimdhënies, në investimin e dijes sa më bashkëkohore tek të rinjtë dhe me joshjen e tyrë drejt profesioneve të drejtësisë nën frymën e një prespektive europiane, bazuar mbi kurrikula perëndimore, të azhornuara dhe me stafe padegogjike multi-kulturore të afta për të përcjell tek të rinjtë një frymë e mëndësi europiane të bazuar mbi kulturën e punës, leximit, azhornimit, metodikës dialektale krahasimore dhe profesionalzimit pa kompromis.

Në këtë mënyrë fenomene negative si ajo aktuale ku gjysma e trupës së rradhëve te magjistratëve dhe prokurorëve, të cilët janë shkarkuar nga detyra për shkak se kanë cënuar rënd besimin në sistemin e drejtësisë, të mos përsëriten më kurrë.

Bibliografia:

Biberaj E., *Shqipëria në tranzicion, Rruga e vështirë drejtë demokracisë 1990-2010,* AIIS, Tiranë, 2011

Bozheku E., Bozheku E., "*The Reform of the Albanian Legal System Between Challenges and Problems, With Particular Focus on the Criminal Justice Issues*", https://doi.org/10.36941/ajis-2021-0169

Bozheku E., Bozheku E., Skënderaj K., "*Theoretical-Conceptual, Legal and Social Problems of the Albanian Criminal Code: Some Useful Observations in view of its Reform*", https://doi.org/10.36941/ajis-2022-0053

Bozheku E., *Hybridization of socio-legal system in transition - Legal and Judicial Reform,* in Riv. *Mendimi*, Università "Luarasi" Press, Tirana, 2018

Dahl R. A., *Sulla democrazia,* Laterza, Roma-Bari, 2006

Fischer B. J., "*Shqipëria që prej vitit 1989: trashëgimia hoxhiste*", in "*Shqipëria në dhjetë vitet e ardhshme – vështrim drejt së ardhmes*", AIIS, Tirana, 2012

Jano D., *Rreth shkaqeve dhe faktorëve që lidhen me korrupsionin: Rasti i Shqipërisë,* in Riv. Polis 6, UET Press, Tirana, 2008

Krasniqi A., "*Sistemet politike në Shqipëri, 1912-2008*", II. ed, Ermal, Tirana

Webgrafia

http://www.instat.gov.al/media/9773/statistika-t%C3%AB-regjistrimeve-n%C3%AB-arsim-2021-2022.pdf

https://kpk.al/wp-content/uploads/2021/12/RAPORTI-4-VJECAR-SHKURT-2018-NENTOR-2021.pdf

https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2019/02/MANUAL-PER-HARTIMIN-E-LEGJISLACIONIT.pdf

https://www.eupolicyhub.eu/rrugetimi-i-shqiperise-drejt-bashkimit-europian/

https://www.parlament.al/Files/sKuvendi/kushtetuta.pdf

biznes dhe administrim" - http://www.instat.gov.al/media/9773/statistika-t%C3%AB-regjistrimeve-n%C3%AB-arsim-2021-2022.pdf

"THE FUTURE OF EDUCATION AND THE LACK OF CURRICULA IN REAL ESTATE IN ALBANIA".

IRNA DOBI

Lecturer at University College of Business

Abstract:

The future of real estate education and its authors represent the diversity and breadth reflective of the field itself. Issues related to the study of real estate are too complex to easily resolve, resulting in a lack of education curricula. This paper is unique in that it not only identifies issues and challenges inherent in today's academic climate, it also provides for a collection of options, both applied and inspirational, that build on existing and potential structures o real estate.

Indeed, there is one best model for the future of real estate education, Albanian education should expect there to be more international in this industry. Rather, this paper is an important addition to the existing body of literature for its identification of solutions that embrace the breadth of both practical and academic knowledge in the expansive and ever-evolving field of real estate.

Key words: Real Estate, Education, Integration etc.

This study investigates the compatibility of the needs of the sector. Unlike other sectors, the Real Estate sector lacks professional education. The training of professionals in the field is carried out mainly through the trainings of the companies where they are engaged and through the experience they gain at work.

One of the strong points of this profession is the construction of an entrepreneurial mentality among real estate brokers. Building the model, clarity on income and expenses, difficulties and benefits of building the business, are an asset that will serve you for a lifetime. In fact, many of the world's most successful entrepreneurs got their start as real estate consultants.

As we mentioned above, building a career in Real Estate is the right education to develop future successful entrepreneurs in various business fields and therefore, investing in the training of consultants is indirectly investing in the mindset of the successful businessman who optimizes resources, offers a very good service and thus affects the generation of added value for the economy and the state.

1. Introduction: The general context of the study.

In today's development conditions, the importance of Real Estate has already become a reality that affects fast-growing sectors for the Albanian economy.

This makes Real Estate turn into an often-fierce competition, but in our reality, it faces great challenges from the lack of education, confronting us with discussions and debates from different perspectives.

Real estate is property consisting of land and the buildings on it, along with its natural resources such as crops, minerals or water; immovable property of this nature; an interest vested in this (also) an item of real property, (more generally) buildings or housing in general. In terms of law, real is in relation to land property and is different from personal property while estate means the "interest" a person has in that land property.

In the United States, the transfer, owning, or acquisition of real estate can be through business corporations, individuals, nonprofit corporations, fiduciaries, or any legal entity as seen within the law. Real estate is different from personal property, which is not permanently attached to the land, such as vehicles, boats, jewelry, furniture, tools and the rolling stock of a farm.

The natural right of a person to own property as a concept can be seen as having roots in Roman law as well as Greek philosophy. The profession of appraisal can be seen as beginning in England during the 1500s as agricultural needs required land clearing and land preparation. Textbooks on the subject of surveying began to be written and the term "surveying" was used in England, while the term "appraising" was more used in North America.

Natural law which can be seen as "universal law" was discussed among writers of the 15th and 16th century as it pertained to "property theory" and the inter-state relations dealing with foreign investments and the protection of citizens private property abroad. Natural law can be seen as having an influence in Emerich de Vattel's 1758 "Law of Nations" which conceptualized the idea of private property

One of the largest initial real estate deals in history known as the "Louisiana Purchase" happened in 1803 when the Louisiana Purchase Treaty was signed. This treaty paved the way for western expansion and made the U.S. the owners of the "Louisiana Territory" as the land was bought from France for fifteen million, making each acre roughly 4 cents. The oldest real estate brokrage firm was established in 1855 in Chicago, Illinois, and was initially known as "L. D. Olmsted & Co." but is now known as "Baird & Warner." In 1908, the National Association of Realtors was founded in Chicago and in 1916, the name was changed to the National Association of Real Estate Boards and this was also when the term "realtor" was coined to identify real estate professionals.

In the context of the dynamics of the international approach where the education of real estate agents and consultants has been given special importance to the preparation of generations of experts and professionals in this field. Referring to Albanian education, where there is a lack of an education opportunity for young graduates in this profile, this study will highlight the needs that Albania has for enabling a school curriculum in the profile of Real Estate Consultants

Unlike other professions, in which the phase of learning, practicing and starting to generate income lasts, the average real estate consultant starts earning by learning. Regardless of the specific characteristics that this profession has, the side effects of a wrong transaction are very serious and therefore the professional and academic preparation of a consultant must be complete. At the end of the day, the real estate consultant handles the most important financial transaction of a family.

1. STUDY METHODOLOGY.

Purpose and objectives of the study.

This study aims to: bring to attention the need and necessity of qualified professionals in the Real Estate profession. Also, this study focuses on bringing a broad overview of the promotional dynamics with which Real Estate operates. The study will bring to attention the impact and investment that the qualification of young entrepreneurs in this sector has for the state and the economy.

The main purpose of this research is to identify the needs for professionals in the field of Real Estate in Albania. The main objectives on which the development of this study is oriented are:

• The difficulties of professionals in this sector.

• Identifying the lack of professional schools in Real Estate as a necessary potential for increasing their capacities and employment in the coming years.

• Lack of university curricula in the field of real estate.

The main purpose of this profession lies in the study of the object that is required to be evaluated, sold, bought, or privatized. In the dynamics of this process, the "Real Estate Appraisal" specialist model in the field of Albanian education is still in its infancy, where in the absence of a public or private educational institution that offers courses or qualification programs, the analysis was carried out by take into consideration: consultants, brokers or agents in this sector.

1. ANALYSIS OF THE RESULTS.

This study was carried out through interviews conducted on the real estate sector. In the study, a group of 30 consultants, managers and brokers were interviewed who came out with the conclusions that success and innovation for the development of real estate depends a lot on the qualification of the staff in the company. The interviewees who are included in the study offer services related to real estate mediation, consulting or property management.

- The industry today operating in the Real Estate business sector in Albania faces difficulties in recruiting qualified real estate consultants in the areas of mediation/communication skills, financial analysis, property management, negotiation skills or legal responsibility.
- From the interviews we have done with Brokers, managers and trainers, we concluded that the main trend that real estate companies are looking for is a specialist with an interdisciplinary background.
- During the interview with the managers, they emphasized that: "this industry today is creating more and more models of success, therefore the importance of the educational qualification of young entrepreneurs will be the key to success".

- The importance of cooperation with educational institutions for this business sector remains a great challenge. Since the difficulty of cooperation with educational institutions such as colleges or universities have not expressed mutual cooperation and there is a lack of such education in the real estate profile, this has led to a lack of cooperation and a lack of investment in licensing for programs in the real estate profile.

- The interest in qualified agents is a measuring indicator that confronts real estate companies with the difficulties in the education profile of the recruiting staff, focusing on the demand of a high number of young people with an academic background in this sector.
- Regarding the lack of potential professionals in this sector, it shows the urgency of opportunities to create educational institutions in the profile of the real estate consultant.
- Regarding the educational knowledge that a real estate broker should have, they conclude in the emergency of the profile that a real estate consultant to be a skilled entrepreneur in this work must have either professional education or higher education. In the dynamics of the answers to the interviews, it was found that the necessary skills to be a professional in the position of real estate broker consist precisely in the educational offer between the possibility of vocational school education and higher education.
- The professionals of the sector have expressed themselves quite optimistic about the possibilities for cooperation in the future for the improvement of the educational offer as a current lack by offering their contribution by participating in the school board, offering professional practices/internships, engaging as an expert for the design of curriculum for new skills in Real Estate.

CONCLUSIONS & RECOMMENDATIONS.

The Real Estate industry is one of the most important sectors in the country's economy and as such real estate education should be unique. Commercial real estate activity is a leading indicator of expanding market activity. Real estate is a privileged investment opportunity for the growth and development of the economy, this has been evidenced in recent years, even in the conditions of the global pandemic, this sector showed that there is continuous expansion.

This study is a novel contribution to the education literature not because it advises educational institutions and practitioners on how best to regulate educational provision, but because the real estate industry offers inexhaustible employment opportunities for young people who can adapt very easy with the concept of entrepreneur, or property management specialist, working in dynamic environments and with satisfactory financial benefits. The lack of educational offer in this sector is at low levels or in complete absence, reflecting in the professional preparation of young people with knowledge and skills that do not serve the needs of the target sector.

The lack of educational curricula in this industry has brought great financial costs to the operating companies in the real estate market for the qualification of their staff, but this method has not been fully successful. In this industry, the maturation of business companies has not progressed in parallel with the specialization of the recruiting staff, therefore the current demand for professionals in the field of real

estate seems to be the most urgent trend for Albanian educational institutions, since in the next years this industry will to be entitled to regional expansions and cooperations."Property management specialist", "sales techniques specialist" or "entrepreneur" will be one of the most sought-after profiles and will continue to be the main criteria for hiring professionals in the real estate sector.

On the other hand, skills such as responsibility, the ability to work in a group, orientation towards problem solving, time and project management, flexibility, creativity, integrity, respect for laws and rules seem to be some of the measuring criteria of business representatives for current professionals. and future in the field of real estate. Growing urbanization as a result of migration from the provinces to the city has brought an increase in the demand for quality or luxury constructions, and consequently this has significantly increased the performance of companies operating in the real estate market, therefore we strongly recommend the inclusion not only practically of the curriculum , but also the combination with the professionals of the companies, connecting bridges of cooperation between the educational offer and the professionals of the sector.

Educational institutions, which will provide professional qualification to young people who will be certified in this industry, will rely on occasional collaborations from the real estate business, attracting the attention and awareness of policy makers to take emergency measures in infrastructure investment. properly. This study highlights the country's need for specialists in this field, bringing to attention some of the most important measuring criteria that this industry urgently requires for the progress of their business. Although recruitment is an unstoppable process in real estate, we would emphasize that there is always room and space in every real estate office for a qualified broker.

Referenca.

- INSTAT: http://www.instat.gov.al/;
- ETF (2017), *Albania: Country strategy paper 2017-20*, European Commission: *https://ec.europa.eu/epale/sites/epale/files/albania_country_strategy_paper_2017-2020_0.pdf*
- Ligji Nr. 15/2017, 'Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë': https://www.parlament.al/wp-content/uploads/2017/02/ligj-nr-15-dt-16-2-2017.pdf;
- Nr. 9/2022 Për Profesionin E Ndërmjetësit Të Pasurive Të Paluajtshme

SFIDAT E CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

M.S.C Marjeta Gjelaj
Kolegji Universitar i Biznesit
Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Politike
mgjelaj@kub.edu.al,

Abstrakt

Arsimi i lartë cilësohet si një nga faktorët kryesorë të zhvillimit social-ekonomik tëshoqërisë. Sigurimi i cilësisë në arsimin e lartë duhet të jetë një nga prioritet kryesore përqeverinë dhe shoqërinë civile. Pritshmëria për një performancë më të mirë në cilësinë emësimdhënies,kërkimitshkencordheaktivitetevetëtjeratëngjashme,idetyronpërgjegjësitpër menaxhimin dhe administrimin e universiteteve të rishikojnë strategjitë e tyre. Për këtëarsye,kërkesatpërcilësinë arsimine lartëporriten.

Ky studim do të shqyrtojë nëse miratimi i MCT (menaxhimi i cilësisë totale) nga universitetet e IAL-ve (institucioni i arsimit të lartë) mund të çojë në përmirësimin e cilësisë në nivelin akademik dhe menaxherial. Objektivi i përgjithshëm i këtij punimi është të paraqesëparimet e përgjithshme të MCT dhe të tregojëse si kjo qasje mund të vazhdoje të përdoret për të përmirësuar cilësinë e një institucioniakademik.

Pas shqyrtimit të gjendjes aktuale të institucioneve arsimore private në kontekstin e cilësisëdhe identifikimit të problemeve ekzistuese, do të ofrohen disa rekomandime dhe sugjerimepërpërmirësim e cilësisë në lidhjemesfidat eardhshme.

Ky studim propozon një kornizë përmenaxhimin ecilësisënëarsimin elartë bazuarnëvlerat dheparimetkryesoretëcilësisë

Fjalët kyçe: Arsimi i Lartë,Cilësia,Menaxhimi i Cilësisë Totale, TQM, Universitet Private

HYRJE.

Koncepti i cilësisë është i vjetër sa vetë njerëzimi. Njerëzit kanë prirjen për të qenë vazhdimisht në kërkim të së përkryerës, asaj më së mirës, me cilësi absolute. Shënimet më të hershme në lidhje me cilësinë i gjejmë në dokumentin më të vjetër legjislativ të njerëzimit, që në Historinë e Institucioneve njihet si "Kodi i Hamurabit", dhe pikërisht koncepti i cilësisë shfaqet në Nenin 229 dhe përkufizohet:

"Nëse një ndërtues ndërton një shtëpi për dikë, por nuk e ndërton siç duhet, dhe shtëpia që ai ndërton bie dhe vret pronarin e saj, atëherë ndërtuesi do të dënohet me vdekje."

Gjatë përditshmërisë tonë, në shumicën e rasteve, cilësinë e marrim si të mirëqenë dhe hasim vështirësi për ta përkufizuar si koncept. Edhe pse cilësia për shumë nga ne mund të jetë një term subjektiv dhe për të mund të kemi përkufizime të ndryshme, të gjithë e dimë dhe jemi të sigurt për cilësinë vetëm kur e përjetojmë atë. (Levin J., 2013).

Institucionet e ndryshme të biznesit po kërkojnë vazhdimisht jo vetëm përmirësimin e performancës organizative të përgjithshme, duke u bërë më të efektshëm dhe konkurrues në treg, por, në të njëjtën kohë, këtë situatë duhet ta arrijnë në kohën më të shkurtër. Kjo, pa dyshim, nuk mund të arrihet pa një vizion të qartë, pa një plan strategjik dhe pa synuar cilësinë e duhur në produkte dhe shërbime, si një përcaktues i rëndësishëm i suksesit të kompanive.

Përkufizimet e cilësisë bazuar në kritere: Sipas kësaj kategorie përkufizimi i cilësisë bazohet në kriteret që institucioni vendos për të përcaktuar cilësinë e një produkti apo shërbimi. Ajo mund të përcaktohet si niveli i efektivitetit, niveli i efikasitetit apo i kënaqësisë së klientit. Për shumë njerëz cilësia është sinonimi i efektivitetit. Duke u bazuar në këtë përfundim, Jurani e përcakton cilësinë si:

"Tërësia e karakteristikave që i nevojiten produktit për të përmbushur nevojat e klientëve dhe njëkohësisht edhe tejkalimin e tyre". (J. M. Juran, 1989)

Përkufizimet e cilësisë duke u bazuar në konceptet fillestare: Përkufizimi i cilësisë mund të marrë një trajtë ndryshe nga një institucion në një tjetër, duke u bazuar tek iniciativat e ndryshme fillestare që ato kanë pasur. Ekziston një përkufizim shumë i gjerë i koncepteve fillestare të cilësisë ose mënyra të ndryshme të vlerësimit të produkteve e të shërbimeve. Njerëzit kanë perceptime të ndryshme për atë që mund të quhet shërbim i mirë apo i keq / produkt i mirë apo i keq, prandaj është shumë e rëndësishme vendosja e kritereve që përcaktojnë cilësinë, në mënyrë që palët e interesit të jenë të qartë në lidhje me përkufizimin e saj.

Përkufizimi i cilësisë duke u bazuar në modele të ndryshme: Kur bëhet fjalë për modele referimi të cilësisë, të parat që mund të radhiten janë seritë e modeleve të ISO 9000, të cilat kanë prodhuar standarde cilësie për institucionet e bizneseve në fushën e manifakturimit dhe të shërbimeve. Këto sisteme, përveç vlerësimeve që u bëjnë burimeve njerëzore, vlerësojnë edhe proceset e ndryshme që lehtësojnë menaxhimin e cilësisë.

Vlerësimi i cilësisë sipas standardeve minimale: Duke marrë në konsideratë se shumë kompani synojnë në vijueshmëri rritjen e cilësisë së produkteve ose shërbimeve të tyre, është shumë me vend përcaktimi i disa

standardeve bazike, që do të formojnë edhe pragun më të ulët të cilësisë, që duhet te arrihet nga një produkt ose shërbim, i cili të konsiderohet si cilësor. Në këtë kategori futen standardet minimale të cilësisë që kanë prirjen të pranohen nga të gjitha palët e interesit.

Mbi të gjitha, nocioni i cilësisë ka një rëndësi të veçantë dhe gjithmonë ka prirjen të shoqërohet me çfarë është më e mirë, më e përsosur dhe më e vlefshme. Rritja e mirëqenies, cilësia e jetës, kushtet ekonomike kanë ndryshuar rrënjësisht perceptimin që kanë klientët në lidhje me cilësinë. Pritshmëria e klientëve për produkte dhe shërbime cilësore është vazhdimisht në rritje. Mund të thuhet se suksesi i vërtetë i organizatave të biznesit qëndron në faktin sesa të afta janë për të kuptuar pritshmërinë e klientëve dhe sa të suksesshme janë ato në përmbushjen dhe realizimin e këtyre pritshmërive. Cilësia mund të përcaktohet si "përputhje me kërkesat dhe standardet" Crosby (1979), si "përshtatshmëria për shfrytëzim" J. M. a. G. Juran, F. M., (1980), ose Deming, sipas të cilit cilësia është "një shkallë e parashikueshme e uniformitetit, siguri në kosto të ulët dhe përshtatshmëria për tregun". Tani shumë institucione dhe kompani e gjejnë përkufizimin e hershëm të cilësisë "përshtatshmëri me standardet", shumë të ngushtë sepse, sipas tyre, në qendër të cilësisë është vendosur fitimi dhe si pasojë tejkalimi i kënaqësisë së përftuar prej klientit. Deming dhe Harvey (1986) përkufizojne cilësinë si përshtatshmëri për qëllimin duke u bazuar në përmbushjen e nevojave dhe dëshirave që kanë klientët. (L. Harvey, 2005)

I. Cilësia në Arsimin e Lartë.

Kohët e fundit masivizimi i Arsimit të Lartë dhe ndërkombëtarizimi i institucioneve të tij ka ndikuar ndjeshëm në ndërgjegjësimin e aktorëve kryesorë të fushës për rëndësinë dhe rolin që ka cilësia në arritjen e suksesit në tregun e institucioneve të Arsimit të Lartë, ku konkurrenca sa vjen e shtohet. Përkufizimi i cilësisë në fushën e shërbimeve nuk është i lehtë, por kjo vjen dhe bëhet edhe më e vështirë në Arsimin e Lartë. Edhe pse shumë teori dhe modele cilësie të ndryshme janë përpjekur për të përkufizuar dhe matur cilësinë në Arsimin e Lartë, cilësia në këtë nivel arsimor merr një trajtë enigmatike dhe subjektive, kështu që arritja e një përkufizimi universal të cilësisë në arsimin e lartë është pothuajse e pamundur.

Harvey i referohet nocionit të cilësisë si koncept relativ duke u mbështetur në arsyen se përkufizimi i cilësisë është relativ dhe i ndryshueshëm nga individi në individ në varësi të rrethanave dhe pritshmërive, ku cilësia nënkupton gjëra të ndryshme në momente të ndryshme. (L. a. G. Harvey, D., 1993).

Aktorët e shumtë në Arsimin e Lartë në të cilët përfshihen: studentët, lektorët, personeli administrativ, punëdhënësit etj., mund t'i japin nuanca krejt të ndryshme nocionit të cilësisë në varësi të eksperiencave që kanë, rrethanave në të cilat ndodhen, perceptimeve që kanë në lidhje me nevojat dhe dëshirat e mundshme. Institucionet e Arsimit të Lartë, ashtu si organizatat e tjera të biznesit, janë të përfshirë në procesin e prodhimit, por, në kundërshtim me organizatat e mirëfillta të biznesit, cilësinë e prodhimit nuk mund ta përkufizojmë duke u bazuar vetëm në disa komponentë. Një përkufizim më i saktë i cilësisë mund të arrihej nëse do të analizonim me kujdes të gjithë komponentët përbërës të cilësisë, si në fazën e ideimit, hartimit ashtu edhe gjatë proceseve të tjera. Një mënyrë për të parë më qartë çështjen e cilësisë në Arsimin e Lartë është fokusimi tek të gjitha elementet e mundshme përbërëse të cilësisë. Në veçanti, cilësia në hartimin në arsimin e lartë ka të bëjë me outputet (rezultatet) sesi mund të konsiderohet një program i planifikuar për të plotësuar të gjitha nevojat e studentëve dhe cilësia në proces është më shumë

e lidhur me zbatimin e programeve akademike, planifikimet, vlerësimet dhe faktorët e tjerë që ndikojnë programin. (Chaffee, 1992)

Disa nga elementët përbërëse të Arsimit të Lartë, që konsiderohen të rëndësishme nga agjencitë e vlerësimit të cilësisë janë si më poshtë.

a. Infrastruktura fizike (godinat, komplekset sportive ose hapësirat) e universiteteve;

b. Infrastruktura akademike (laboratorët, libraritë, dokumentacioni, komunikimi dhe informatika);

c. Kurrikula mësimore bashkëkohore dhe në koherencë me nevojat e tregut;

d. Provimet dhe sistemi i vlerësimit;

e. Sistemi i mundësimit dhe i zhvillimit të personelit akademik/administrativ;

f. Punimet shkencore-kërkimore dhe botimet;

g. Plani i zhvillimit institucional (planifikimi strategjik afatshkurtër dhe afatgjatë);

h. Marrëdhëniet në trinomin universitet-industri-shoqëri.

Në formën absolute cilësia nuk nënkupton më të mirën. Shumëllojshmëria konceptuale e nocionit të cilësisë bazohet tek perceptimi i klientëve, e thënë ndryshe, tek shkalla e besimit që klientët kanë në përmbushjen e nevojave dhe kërkesave të tyre. Por megjithëkëtë nocioni i cilësisë është multidimensional, prandaj nuk mund të kemi një përkufizim të cilësisë duke u fokusuar vetëm në një karakteristikë të saj. (Deming, 1986)

Harvey në një studim akademik të tij trajton përkufizimet e mundshme që mund t'i bëhen nocionit të cilësisë në Arsimin e Lartë, bazuar në perceptimet e ndryshme që kanë palët e interesit për cilësinë në këtë nivel arsimi duke filluar nga studentët, ekipi, punëdhënësit në sektorin privat dhe publik, shoqëritë civile. (L. a. G. Harvey, D., 1993).

- Cilësia si ekselencë (përsosmëri): Sipas këtij koncepti cilësia konsiderohet e veçantë, e dallueshme dhe përdoruesit i jep një status të veçantë duke u frymëzuar nga përsosmëria e natyrës së saj, e karakterizuar nga karakteri i saj ekskluziv dhe i diferencuar. Në terminologjinë e arsimit, nocioni cilësia si ekselencë, është i lidhur edhe me pamundësinë e arritjes së cilësisë së lartë dhe tepër të lartë nga të gjithë.

- Cilësia si përkryerje: koncepti i cilësi si përputhshmëri me standardet bazohet në karakteristikat e nevojshme të një produkti ose shërbimi, ndërsa ky përkufizim parashtron qëllime të veçanta për institucionet në Arsimin e Lartë, që të renditen gjithmonë si më të mirët dhe të jenë të orientuar gjithmonë drejt outputeve më cilësore. E thënë ndryshe, ky nocion nuk paraqet standarde për matjen e cilësisë, as nuk përpiqet të përcaktojë çfarë është cilësia.

- Cilësia është e pashmangshme: një person e njeh instinktivisht cilësinë kur e përjeton atë. (L. a. G. Harvey, D., 1993)

- Cilësia si përshtatshmëri me qëllimin: ky nocion i cilësisë synon përmbushjen e qëllimeve dhe objektivat e deklaruara.

E thënë ndryshe nocioni i cilësisë është i bazuar në aftësinë që ka institucioni për të përmbushur misionin dhe vizionin e tij. (K. Watty, 2003) Mund të themi se ky nocion i cilësisë është ndër më të përdorurat në arsimin e lartë. Ky përkufizim u mundëson universiteteve vendosjen e objektivave në misionin e tyre dhe cilësia arrihet në përmbushjen e objektivave të parashtruara në qëllimet përkatëse të institucioneve, duke u bazuar edhe në përmbushjen e kërkesave të palëve të interesit në këtë nivel arsimi.

II. S**fidat e arsimit të lartë privat në Shqipëri.**

Arsimi i lartë në vendin tonë nuk është akoma në standardet ndërkombëtare, edhe pse viteve të fundit janë bërë përpjekje për përmirësimin e standardeve shtetërore të cilësisë në arsimin e lartë dhe monitorimin e tyre nga akreditues të brendshëm dhe të jashtëm. Për më tepër është bërë edhe një tentative për rankimin e universiteteve por, rezultati ka qenë disi zhgënjyes, për faktin se në këtë proces nuk janë përfshirë të gjitha universitetet në vend.

Paqartësitë dhe ndryshimet e vazhdueshme në ligjin për arsimin e lartë kanë ndikuar negativisht në botën akademike, duke u bërë pengesë në përmirësimin e standardeve të arsimit të lartë. Nevoja për një sistem të efektshëm dhe mungesa e një metodologjie të avancuar dhe të dizajnuar për sigurimin dhe menaxhimin e cilësisë totale në arsimin e lartë dhe në veçanti atë jopublik, e ka bërë më të vështirë arritjen e standardeve të cilësisë në arsimin e lartë.

Ngjarjet e reja pas viteve 90, si në çdo sektor tjetër, edhe në fushën e arsimit sollën nevojën e riorganizimit të arsimit të lartë, hapat që duhej të ndiqeshin për të kaluar në një stad më të lartë për t'ia përshtatur përgatitjes së studentëve kushteve të reja të zhvillimit të vendit.

Arsimi i lartë kaloi disa faza, me uljet dhe ngritjet, dhe në koherencë me dinamikat e zhvillimit ekonomik të vendit dhe kërkesës në rritje të rinjve për ndjekjen e arsimit të lartë.

Shqipëria në vitin 2003 bëhet zyrtarisht pjesë e procesit të Bolonjës. Ky vit është edhe fillimi sistematik i përshtatjes së programeve akademike në arsimin e lartë sipas sistemit të Bolonjës, me konceptimin e ECTS dhe implementimin e tyre. Ky proces është thelbësor në formatimin e arsimit të lartë, duke e përshtatur atë me Europën, i cili mbetet akoma jo i plotë, në veçanti në aspektin e përshtatjes së kurrikulave, sipas cikleve të studimeve dhe njëkohësisht sipas profilit të universitetëve në rang kombëtar dhe europian. (Gjonça, 2014)

Duke filluar nga viti 2002, në Shqipëri licencohen IAL-të e para private, të cilat kryesisht ishin të profilizuara dhe deri në vitin 2005 numëroheshin 5 të tilla. Gjatë kësaj periudhe, problemi kryesor i këtyre IAL-ve ishte mungesa e një kuadri ligjor të plotë, gjithmbulues dhe me standarde bashkohore të cilësisë dhe mënyrës së funksionimit të këtyre institucioneve private. Kjo mund të konsiderohet edhe sfida më e madhe që patën këto institucione gjatë funksionimit të tyre në këtë periudhë. Më pas, gjatë viteve 2005-2009 u hapën 34 universitete private të reja, ndërsa në periudhën 2009-2013 u hapen edhe 10 instuticione private (Duro, 2014).

Problemi që u shfaq me hapjen në një numri të lartë të IAL-ve private, ishte më shumë se numri i lartë, mungesa e një monitorimi dhe mosndëshkueshmëria për shkeljet e ndryshme, ku filloi të abuzohej me funksionimin brenda standardeve të IAL-ve dhe deformim të tregut të arsimit të lartë, deri në lëshime diplomash pa plotësimin e kushteve ndonjëherë edhe minimale të procesit mësimor.

Viti 2014 shënoi një kthesë të fortë njëkohësisht edhe shumë të vështirë. Rishikimi i ligjshmërisë së institucioneve të arsimit të lartë privat ishte një domosdoshmëri dhe rezultoi me mbylljen e 15 IAL-ve private, të cilave iu hoq e drejta e aktivitetit mësimor me pezullimin e licencave të dhëna. Megjithëse pati një situatë kaotike, brenda një kohe jo shumë të gjatë, ky hap solli një vetëkontroll në sistemin e arsimit të lartë privat, edhe në atë shtetëror dhe filloi një proces disiplinimi në zgjerimin e mëtejshëm, megjithëse jo me një plan të qartë, por gjithsesi më të ngadaltë dhe të kontrolluar në hapjen e institucioneve të reja.

III. Sfidat në lidhje me personelin akademik, kërkimin shkencor dhe inovacionin.

Mungesa brenda vendit në këtë treg të ri të një ekipi të kualifikuar dhe me eksperiencë akademike ka ndikuar negativisht në plotësimin e ekipit me kohë të plotë të universiteteve jo shtetërore duke u mbështetur më shumë në pedagogët e jashtëm që vijnë me kohë të pjesshme. Kjo gjendje është më shumë e pranishme në universitet e çelura rishtas. Situata e tillë ka ndikuar negativisht në formimin e një kulture institucionale por dhe në krijimin e mangësive përsa i përket kërkimit shkencor.

Kërkimet shkencore të trajtuara në një perspektivë më të gjerë, si përshtatje risish në fushën e arsimit dhe rrjedhimisht arritje e mjaftueshme si në fushat kërkimore edhe në ato mësimore, mund të arrihet vetëm falë të bashkëpunimit të vazhdueshëm të personelit akademik me kolegët e tyre si brenda institucionit edhe më gjerë. Themeli i suksesit të punëve kërkimore bazohet te vëzhgimi që të jep material për analiza dhe përfundime të frytshme; një njeri i cili s'ka dijeni për ndryshimet që ndodhin në vendet e tjera, s'do të mund të jetë i vetëdijshëm as për rrugën që duhet të ndjekë dhe as për destinacionin ku do të arrijë.

Në shumicën e universiteteve në shoqërinë tonë ekziston një raport arkaik mes lektorit si autoritar që ligjëron në auditorin, i cili vetëm dëgjon a shkruan dhe studentit kokë ulur që kopjon dhe riprodhon mekanikisht dijen e marre nga i pari, ku tradicionalisht studentit nuk i mundësohet pjesëmarrja aktive gjatë mësimdhënies (Tarifa, 2012). Për më shumë, angazhimi i një pjese të ekipit akademik të brendshëm të ngarkuar me përgjegjësi administrative dhe me mbingarkesë të lëndëve mësimore, ka ndikuar ndjeshëm në uljen e kërkimit shkencor dhe sidomos në cilësinë e tij, duke u përqendruar më tepër në mësimdhënie, por duke i qëndruar larg ndërthurjes së mësimdhënies me punën kërkimore (Laze, 2011).

Në fushën e arsimit të lartë koncepti i inovacionit merr një trajtë të veçantë. Kur thuhet inovacion në arsim, në përgjithësi të vijnë në mendje çështje si: rritje e orëve ose ditëve të mësimit,rishikim i mundësive financiare, përmasat e auditorëve, arsimi me bazë të dhënat digjitale, përmirësim i sistemit të vlerësimit dhe kualifikim në vijim për personelin akademik.

Sidoqoftë, të gjitha këto mbeten iniciativa që e pranojnë saktësinë e qasjes klasike të arsimit dhe synojnë ta çojnë më tej (Brennan & Steve, 2014), (Hansen, 2015).

IV. Sfidat me studentët.

Sfida më e rëndësishme e universiteteve në vendin tonë dhe po ashtu edhe në botë, është e lidhur me brezin e ri të studentëve, që është vazhdimisht në ndryshim, qoftë ky ndryshim kulturor, ekonomik dhe social, i cili nuk arrihet të kuptohet mirë nga personeli akademik i universiteteve duke çelur një hendek mes atyre që mëndojnë se transmetojnë dije dhe atyre që kanë nevojë ta marrin atë dije (Tarifa, 2012).

Situata që ka nisur të kthejë duhet të mos injorohet nga bota akademike, përkundrazi të jetë një shtysë e rëndësishme për krijimin e platformave, programeve akademike në përputhje me nevojat dhe pritshmëritë e studentëve, brezave të rinj që po rriten në epokën e internetit apo të komunikimit dhe arsimit digjital.

Konkurrenca e fortë mes universiteteve shtetërore dhe atyre jo të tillë apo private, ka lindur garën që sjell zhvillim si dhe ka ndikuar fuqishëm edhe në vendosjen e kritereve të pranimit të studentëve. Shumë universitete private janë më të interesuar për numrin e studentëve, se sapër cilësinë e tyre.

Kjo situatë ka ndikuar në demotivimin e studentëve gjatë procesit mësimnxënies, sepse një numër jo i pakët i studentëve i frekuentojnë universitetet për të siguruar një diplomë, të cilën e konsiderojnë si një mjet për të siguruar një vend pune e bashkë me të dhe një status të privilegjuar social (mendësi e trashëguar prej sistemit totalitar, që në kushtet e reja të Shqipërisë u sjell zhgënjime të rinjve, që nuk arrijnë të punësohen në profesionin ku udiplomuan).

Universitet private duhet të largojnë qasjet ndaj studentëve të tyre duke u pranuar si klientë që sigurojnë të ardhura për jetëgjatësinë e institucionit të arsimit të lartë. Përkundrazi, studenti duhet të ndodhet në qendër të vëmendjes në arsimin e lartë dhe formimi i tij në aspektin akademik dhe profesional duhet të jetë një element jetik jo vetëm për personin e tij, por me funksionimin drejtpërsëdrejti si dhe me misionin e universiteteve.

Një universitet që ka në qendër studentin duhet të thellohet në realizimin cilësor të programeve mësimore bashkëkohore, të cilat formojnë një lidhje direkt midis teorisë dhe praktikës, duke bërë të mundur përgatitjen e studentëve me dijet, aftësitë, profesionalizmin dhe kompetencat e duhura për të qenë të aftë në përmbushjen e kërkesave të tregut të punës brenda dhe jashtë vendit, që synon të integrojë në BE.

REKOMANDIME.

- Qartësimi dhe përvetësimi i duhur i misionit dhe vizionit të universiteve jopublike nga igjithë stafi i universitetit do kishte një ndikim shumë të madh në përformancën epërgjithshme të këtyre universiteve në Shqipëri.
- Nxitja e kulturës së cilësisë totale, përmes konferencave, seminareve dhe workshopeve për të ndërgjegjësuar çdo punonjës të universitetit,mbi parimet e MCT do të përcaktojë të ardhmen e universitetit.
- Cilësia duhet të jetë në fokus të të gjitha aktiviteteve të Universitetit, por në veçanti duhet të fokusohet në ngritjen dhe promovimin e një kulture pozitive dhe bashkëpunuese institucionale ku cilësia të shikohet si një përgjegjësi personale dhe kolektive.
- Formimi i nje sistemi efikas për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies duke u mbeshtetur tek indikatorëte matjes së cilësisë së mësimdhënies.

Bibliografia

- A.Qefalia.&A.Koxhaj.(2010).*Menaxhimiicilësisëtotale:koncepte,metoda,strategji.*
- Çerri,S.(2012).AssessingthequalityofhighereducationservicesusingamodifiedSERVQUAL scale. *Annales Universitatis Apulensis Series Oeconomica, 14*(2), 664-679.
- APAAL.(2013,12,10). *Universitet Private*/ http://aaal.edu.al/sq/al/institucionet-ne-al/institucionet-private.html.
- APAAL.(2015,104).*Institucionetjopubliketëarsimittëlartë*.http://www.aaal.edu.al/sq/
- Arif,M.&.(2004).Baldrigetheoryintopractice:aworkingmodel.*InternationalJournalofEducationalManagement,18*(5), 324-328.
- Abdullah, A. (2010). Measuring TQM Implementation: A Case Study,*Measuring BusinessExcellence,14*(3),3-15.
- Amar,K.a.(2002).BarrierstoimplementingTQMinIndonesianmanufacturingorganizations.*TheTQMMagazine,4*(6),fv.367-372.

NDIKIMI I ARSIMIT NË DEMOKRATIZIMIN E SHOQËRISË NË BALLKANIN PERËNDIMOR.

Anila Tabaku,
Nëndrejtore në Shkollën 'Misto Mame' Tiranë.

Abstrakt.
Ky dokument ka si qëllim të evidentojë ndikimin e arsimit në demokratizimin e shoqërisë në vendet e Ballkanit Perëndimor, të cilat në faza të ndryshme të historisë së tyre kaluan nga qeverisje diktatoriale në sisteme demokratike të ekonomisë së tregut. Nga demokratizimi i shoqërisë përfitojnë të gjithë anëtarët e shoqërisë së këtyre vendeve, të cilët gëzojnë liritë themelore, barazi, zhvillim, që janë edhe bazat e një demokracie funksionale, aq e nevojshme për vendet e BP. Dokumenti del në përfundimin se shoqëritë që kanë nivel të zhvilluar arsimi kanë edhe nivele të larta demokracie. Arsimi ka një ndikim të jashtëzakonshëm në demokratizimin e Ballkanit Perëndimor, sepse pjesëtarët e arsimuar të shoqërisë mbrojnë dhe çojnë përpara vlerat themelore të demokracisë.

Demokracia është pranuar si filozofia e jetës moderne. Duke qenë se arsimi është instrument i rëndësishëm që mundëson ndryshimet e shoqërive drejt modernizimit, ai duhet t'i mbajë lidhjet e tij të pashkëputura nga kjo filozofi. Në këtë këndvështrim, demokracia bëhet e nevojshme për të mundësuar arsimin demokratik. Nga ana tjetër, për të kuptuar sa më mirë demokracinë dhe format e saj, është i nevojshëm arsimi.

Çdo shoqëri, përfshirë këtu edhe ato të Ballkanit Perëndimor, i transmeton normat shoqërore, kulturën, idealet, historinë nga një brez në tjetrin nëpërmjet arsimit, duke vendosur kështu një lidhje të drejtpërdrejtë mes këtij të fundit dhe vlerave demokratike. Në shoqëritë demokratike, thelbi i arsimit është pikërisht përçimi i vlerave të qeverisjes demokratike, përçim që ka rëndësi të jashtëzakonshme për demokracinë, sepse ndryshimet dinamike në këto shoqëri bëjnë të nevojshme që qytetarët të jenë të pajisur me aftësi të tilla si mendim kritik e analitik, kulturë debati konstruktiv, shkëmbim idesh e përvojash, etj. Mundësia për ndryshime pozitive shoqërore dhe politike është pikërisht në dorë të qytetarëve të arsimuar.

Fjalë kyçe: arsim, ndikim, demokraci, demokratizim, Ballkani Perëndimor, shoqëri.

Shoqëria e Ballkanit Perëndimor në 30- vitet e fundit: sukseset dhe sfidat.

Në dhjetëvjeçarin e fundit të shekullit të kaluar, vendet e Ballkanit Perëndimor (Shqipëria, Kosova, Mali i Zi, Serbia, Bosnje-Hercegovina, dhe Maqedonia e Veriut) përmbysën regjimet diktatoriale të modelit socialist bolshevik dhe rivendosën sistemet demokratike në themel të të cilit qëndrojnë respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, zgjedhjet e lira, ekonomia e hapur e tregut, shtypi dhe liria e fjalës, dhe rihapja ndaj botës perëndimore të zhvilluar dhe demokratike.

Në këto vendetë Ballkanit Perëndimor, përfshirë këtu edhe Shqipërinë, janë bërë përparime të jashtëzakonshme drejt demokratizimit të jetës së vendit. Në këto vende bëhen zgjedhje përgjithësisht të lira shumëpartiake, ndonëse shpesh me probleme të theksuara siç evidentohet nga raportet e vëzhguesve të ndryshëm, si OBSE, ODHIR, BE, ShBA, dhe organizata të tjera;Liria e fjalës dhe e shtypit është e garantuar me kushtetutë dhe njerëzit dhe mediat janë të lirë të shprehin mendimin e tyre, pavarësisht se në mjaft raste hasin edhe në pengesa serioze për ushtrimin e kësaj të drejte themelore; reformat për zhvillimin ekonomik të këtyre vendeve bazohet në modelin perëndimor të tregut të lirë dhe konkurrencës së ndershme, edhe pse varfëria, korrupsioni, dhe emigracioni kanë nxjerrë pengesa të mëdha në këtë rrugëtim; sistemi gjyqësor pas reformave të mëdha, si në Shqipëri dhe në disa vende të tjera të Ballkanit Perëndimor, ka prodhuar rezultate të prekshme në luftën kundër korrupsionit, krimit të organizuar, etj.; sistemi arsimor është modernizuar për t'iu përgjigjur zhvillimeve të reja politike dhe ekonomike të këtyre vendeve; Shqipëria, Mali i Zi, dhe Maqedonia e Veriut janë vende anëtare të Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) dhe synojnë të anëtarësohen edhe në Bashkimin Evropian.

Por jo çdo gjë që shkëlqen është ar. Elita politike e këtyre vendeve nuk kishte aspak përvojënë qeverisje demokratike. Pas rënies së sistemit komunist, këto vende u përballën me mungesë të theksuara të forcave të kualifikuara; u mungonin njohuritë bazë në të gjithë sektorët e administratës, sistemit të drejtësisë, fushës së biznesit, teknikës dhe mediave gjë që bëri mjaft të nevojshme nisjen nga e para të pothuajse çdo gjëje; elitat politike përdornin ende mendësinë e sistemit të vjetër ku kundërshtari politik konsiderohej armik dhe jo konkurrent; shkelja e të drejtave themelore të njeriut ishte praktikë e zakonshme në jetën politike dhe ekonomike të vendit; postet publike u konsideruan si pronë private dhe jo si detyrim për t'i shërbyer qytetarëve me dinjitet dhe drejtësi.

Me nisjen e reformave të çdo fushë të jetës publike lindën probleme të ndryshme për të cilat këto vende ishin të papërgatitura, jo sepse më parë nuk ekzistonin si problematika, por i mbaheshin të fshehura publikut. P.sh., varfëria e shoqëruar nga niveli mjaft i lartë i papunësisë në shumë vende, sidomos në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni e Veriut, kishte kapur çdo qelizë të jetës së vendit dhe solli si rezultat emigracioni i ligjshëm e i paligjshëm dhe lëvizjet e brendshme e të pakontrolluara të popullsisë. Rilindja e këtyre fenomeneve bënë që shumë fshatra e zona të tjera të vendit të zbrazeshin dhe qytetet kryesore të mbipopulloeshin duke sjellë kështu kaos dhe zhvillim urban të paplanifikuar dhe me probleme të rëndë sociale; zhvillimi industrial dhe bujqësor i këtyre vendeve u ndërpre ose bëri shumë hapa prapa dhe bëri që këto vende të vareshin nga produktet e importit dhe ndihmat ekonomike për mbijetesë; zgjedhjet në përgjithësi paraqesin probleme të theksuara, veçanërisht në lidhje me blerjen e votës, manipulimet, kontestimin e vazhdueshëm të rezultatit nga pala humbëse, probleme me listat e zgjedhësve, e shkuara

kriminale e kandidatëve për postet publike, etj.; korrupsioni dhe krimi i organizuar janë probleme madhore me të cilat këto vende janë në luftë të hapur në rrugën e tyre drejt integrimit evropian

Pak historik për arsimin në BP në 30 vitet e fundit.

Në 30 vitet e fundit në Shqipëri janë kryer një sërë reformashnë sistemin arsimor që kanë synuar të shndërrojnë të gjithë modelin e centralizuar të arsimit të përgjithshëm e profesional në vend. Të frymëzuar nga thënia e figurës emblematike të të drejtave të njeriut, NelsonMandela "Arsimi është arma më e fortë për të ndryshuar botën" dhe me synimin për t'u bërë dhe ndjerë pjesë e botës së përparuar perëndimore, vendet e Ballkanit Perëndimor ndërmorën reforma të jashtëzakonshme për modernizimin e arsimit me qëllim demokratizimin e shoqërisë së këtyre vendeve.

Kështu, në Shqipëri, p.sh., sistemi arsimor parauniversitar pësoi ndryshime rrënjësore, përfshirë këtu kalimin nga sistem tetëvjeçar në atë nëntëvjeçar për arsimin e mesëm të ulët apo nga katërvjeçar në trevjeçar për arsimin e mesëm të lartë për t'iu përafruar sistemit evropian, zbatimin e sistemit të Bolonjës në arsim, kurrikula u modernizua dhe mësimdhënia ka në qendër nxënësit duke synuar t'i përgatisë ata për jetën dhe jo thjesht t'u përçojë në mënyrë mekanike njohuri të paracaktuara. Përdorimi i metodave bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies synon t'i pajisënxënësit me kompetenca e aftësi jashtëzakonisht të nevojshme për një shoqëri demokratike, si mendimi analitik dhe kritik, nxjerrja dheanaliza e informacionit nga burime të ndryshme, përdorimi e strategjivetë shumta të mësimnxënies, përfshirë këtu edhe prezantimin, analizën zgjidhjen e problemeve.Kompetencat kyçe që janë baza e kurrikulës e re janë në përputhje me kompetencatkryesore të të mësuarit gjatë të gjithë jetës, që në thelb është karakteristikë e sistemit arsimor në të gjitha vendet e Bashkimin Evropian.Miratimi i një qasjeje të tillë në kurrikulën kombëtare në vendin tonë shihet si njëhap i rëndësishëm drejt modernizimittë kurrikulës dhe vetë sistemit arsimor shqiptar.

Në Shqipëri ashtu si edhe në vendet e tjera të rajonit modernizimi i arsimit kishte si pikësynim në radhë të parë demokratizimin e vendit, përafrimin e parimeve dhe strukturave arsimore me ato të vendeve të përparuara perëndimore, përgatitjen e qytetarëve me parimet themelore demokratike, si respektimi i të drejtave të njeriut, toleranca, harmonia, mirëkuptimi, respektimi i mendimit ndryshe,

Ndikim i arsimit në demokratizimin e shoqërisë.

Demokracia është pranuar si filozofia e jetës moderne. Duke qenë se arsimi është instrument i rëndësishëm që mundëson ndryshimet e shoqërive drejt modernizimit, ai duhet t'i mbajë lidhjet e tij të pashkëputura nga kjo filozofi. Në këtë këndvështrim, demokracia bëhet e nevojshme për të mundësuar arsimin demokratik. Nga ana tjetër, për të kuptuar sa më mirë demokracinë dhe format e saj, është i nevojshëm arsimi.

Arsimi është një e drejtë universale e çdo individi. Ai është mjet i përmbushjes së të drejtave të tjera të njeriut dhe instrument fuqizues social dhe ekonomik. Nëpërmjet Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, shtetet kanë rënë dakord se çdo shtetas ka të drejtë të arsimohet.

Çdo shoqëri, përfshirë këtu edhe ato të Ballkanit Perëndimor, i transmeton normat shoqërore, kulturën, idealet, historinë nga një brez në tjetrin nëpërmjet arsimit. Në këtë kuptim, ka një lidhje të drejtpërdrejtë

mes arsimit dhe vlerave demokratike. Në shoqëritë demokratike, thelbi i arsimit është pikërisht përçimi i vlerave të qeverisjes demokratike, përçim që ka rëndësi të jashtëzakonshme për demokracinë, sepse ndryshimet dinamike në këto shoqëri bëjnë të nevojshme që qytetarët të jenë të pajisur me aftësi të tilla si mendim kritik e analitik, kulturë debati konstruktiv, shkëmbim idesh e përvojash, etj. Mundësia për ndryshime pozitive shoqërore dhe politike është pikërisht në dorë të qytetarëve të arsimuar.

Studime të ndryshme (Acemoglu et al., 2005:44) argumentojnë se arsimi kontribuon në zhvillimin e kulturës së demokracisë, gjë që nga ana tjetër ndihmon në përmirësimin e mirëqenies së anëtarëve të shoqërisë. Në këtë këndvështrim, thënia e Mësueses së Popullit ParashqeviQiriazi se "Arsimi e mbron lirinë më mirë se një ushtri" plotëson pikërisht këtë binom të pandarë në kulturën politike të çdo vendi me demokraci të konsoliduar. Po ashtu, në shumë studime të kryera në pesëdhjetë vitet e fundit (Aleman, E., &Kim, Y., 2015; Murtin, F., &Wacziarg, R., 2014; Dahlum, S., &Knutsen, C. H., 2017, etj.)arrihet në përfundimin se rritja e nivelit të arsimit shoqërohet pazgjidhshmërisht me rritjen e nivelit të demokracisë. Arsimi bën të mundur që të kuptohet plotësisht demokracia, të drejtat dhe detyrimet e shtetasve, përfitimet e shoqërisë prej saj, zhvillimi i shoqërisë në sajë të demokracisë, rreziqet që i kanosen shoqërisë nga mungesa e demokracisë, etj. Nga ana tjetër, studimet konstatojnë se me rritjen e nivelit arsimor qytetarët janë në gjendje të marrin vendime në mbështetje të shoqërisë, të përmbushin detyrat e tyre si pjesëtarë të shoqërisë dhe të kontribuojnë në një shoqëri që jeton në harmoni dhe paqe duke respektuar të drejtat e çdo pjesëtari të shoqërisë, pavarësisht nivelit ekonomik apo kulturor, etnisë, besimit fetar, përkatësisë partiake, etj.

Në marrëdhënien mes arsimit dhe demokracisë, prania e qytetarëve të arsimuar bën të mundur tolerancën për pranimin e mendimit ndryshe (aq i nevojshëm për vendet e Ballkanit Perëndimor), për respektimin e të drejtave të qytetarëve që i përkasin grupeve kundërshtare, pakicave, etj. duke mbështetur kështu parimet bazë të demokracisë.

Në çdo nivel arsimor nxënësit e studentët mësojnë për demokracinë, parimet, të drejtat e njeriut, kulturën demokratike, format e ushtrimit të demokracisë si zgjedhjet e lira e të ndershme, pjesëmarrja qytetare, llogaridhënia, qeverisja sa më pranë qytetarit, etj. Le t'i shqyrtojmë shkurtimisht disa prej tyre.

Zgjedhjet e lira dhe të ndershme janë themeli i çdo demokracie. Në sistemin diktatorial, zgjedhjet nuk ishin të lira dhe qytetarët ishin të detyruar të votonin për vetëm një kandidat që ishte i caktuar nga pushteti monist. Falë arsimit, nxënësit e studentët tashmë e dinë se demokracia funksionon kur zgjedhjet janë të lira dhe të ndershme, të cilat prodhojnë një qeveri demokratike. Kur qeveria e zgjedhur nuk punon mirë, nuk përmbush zotimet që ka marrë para qytetarëve apo nuk punon për rritjen e mirëqenies së tyre, këta të fundit e rrëzojnë atë me anë të votës. Qytetarët e arsimuar janë të informuar, të ndërgjegjësuar dhe të vetëdijshëm se kanë të gjithë të drejtën t'i kërkojnë llogari pushtetarëve për mosmbajtjen e premtimeve, të propozojnë nisma që synojnë rritjen e transparencës në vendimmarrje, përfshirjen e qytetarëve në procese të rëndësishme të jetës politike, ekonomike e social-kulturore të vendit, etj. Mungesa apo manipulimi i zgjedhjeve dëmton demokracinë e një vendi, veçanërisht ato me demokraci të brishtë si në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe sjell pasoja të rrezikshme për liritë themelore të qytetarëve, ekonominë e vendit, etj. Mjafton të kujtojmë këtu raste të manipulimi të zgjedhjeve në Shqipëri (maj 1996, qershor 2001, zgjedhjet vendore 2011, etj.,), në Serbi, Mal të Zi, Maqedoni, Bosnje-Hercegovinë, etj.

Arsimi ka ndikuar edhe në zhvillimin ekonomik të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Futja e parimeve moderne të ekonomisë së tregut, si konkurrenca e lirë, nxitja e sipërmarrjes së lirë private, studimi i tregut duke u bazuar në kërkesë-ofertë, analiza e avantazheve konkurruese, etj. bëri që këto vende të kuptojnë se demokratizimi i tyre bazohet pikërisht në arsimin e qytetarëve dhe përgatitja e fuqisë punëtore të kualifikuar, përfshirë këtu ekspertë, specialistë, konsulentë, biznesmenë, etj.

Arsimi, veçanërisht ai në gjuhën amtare për pakicat, ka ndikim të drejtpërdrejtë në respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve. Mohimi i kësaj të drejte bazë në disa vende të Ballkanit Perëndimor bëri që të lindin konflikte etnike në shoqëritë e këtyre shteteve, si në Serbi (1980-2000), Mal të Zi (1990), Maqedoni e Veriut (2001). Si për krahasim, pakicat etnike dhe gjuhësore në Shqipëri e gëzojnë dhe e përmbushin plotësisht këtë të drejtë të garantuar në Kushtetutën dhe ligjet e tjera të vendit tonë. Falë kësaj të drejte, qytetarët e këtyre pakicave mësojnë në gjuhën e tyre, gjë që ka ndikuar në një marrëdhënie harmonike dhe paqësore me grupet e tjera të shoqërisë shqiptare, duke kontribuuar kështu në forcimin e demokracisë në vendin tonë.

Angazhimi dhe pjesëmarrja qytetare në vendet e Ballkanit Perëndimor është rritur dhe vazhdon të rritet falë arsimit. Qytetarët dhe shoqëria civile e këtyre vendeve janë të ndërgjegjësuar se me pjesëmarrjen e tyre të vazhdueshme në jetën politike, ekonomike, kulturore, e sociale të vendit, në vendimmarrjen, në kërkesën e llogarisë, në ushtrimin e të drejtave për protestë, për peticione, mosbindje civile, etj., mundësohet si rezultat logjik demokratizimi i shoqërisë.

Shoqëria civile në këto vende është plotësisht e ndërgjegjësuar se arsimi ka një ndikim të jashtëzakonshëm në demokratizimin e shoqërive të brishta të Ballkanit Perëndimor. Me ndihmë teknike dhe financiare nga donatorët dhe shtetet partnere, organizatat e shoqërisë civile punojnë me shkollat, me institucionet publike arsimore dhe me grupimet shoqërore për të përçuar mesazhin se pa arsim nuk ka të ardhme, nuk ka demokraci, nuk ka shtet.

Falë arsimit, qytetarët përçojnë brez pa brezi vlerat dhe parimet demokratike, si toleranca, mirëkuptimi, paqja, pranimi i mendimit ndryshe, vullnetarizmi, pjesëmarrja në zgjedhje, pagimi i taksave, respekti për pakicat, mbrojtja e mjedisit, etj.

Do të doja të përmbyllja këtë dokument duke përdorur fjalët e ish Presidentit të ShBA, Franklin D. Roosevelt: "Demokracia nuk funksionon nëse ata që votojnë dhe zgjedhin nuk e përdorin këtë armë të fuqishme me mençuri dhe maturi, të cilat fitohen vetëm me arsim. Rrjedhimisht, mbrojtësi më i mirë i demokracisëështëarsimi."

Bibliografia:

Acemoglu, D. J., Simon, R., James A., &Yared, P. (2005).From Education to Democracy? The American Economic Review, 95(2) (Nga arsimi në demokraci? Revista Ekonomike Amerikane);

Aleman, E., & Kim, Y. (2015). The Democratizing Effect of Education. Research and Politics, (Efekti demokratizues i arsimit. Hulumtime dhe politika) 1-7;

Dahlum, S., & Knutsen, C. H. (2017). Do Democracies Provide Better Education? Revisisting the Democracy-Human Capital Link. World Development, 94,186-199. (A ofrojnë arsim më të mirë demokracitë? Rishqyrtimi i lidhjes së kapitalit njerëzor me demokracinë);

Murtin, F., & Wacziarg, R. (2014). The Democratic Transition. Journal of Economic Growth, 19, 141-181. (Tranzicioni demokratik. Revista e Rritjes Ekonomike);

Sanborn, H., &Thyne, C. L. (2013). Learning Democracy: Education and the Fall of Authoritarian Regimes. British Journal of Political Science, 44, 773-797. (Të mësojmë për demokracinë: Arsimi dhe rënia e regjimeve totalitare. Revista Britanike e Shkencave Politike).

PSIKO – EKONOMIA NJË HORIZONT I RI PËR SHKENCËN EKONOMIKE.

Ariet Malaj
Kolegji Universitar i Biznesit,
Departamenti Ekonomiksit & Informatikës,
amalaj@kub.edu.al

Abstrakti:

Përpjekja për të bërë një përshtypje për konsumatorët duke stimuluar interesin e tij sigurisht që është një vlerë e shtuar e një aktiviteti ekonomik, dhe ka nga ata që kanë si moto në punë sloganin "reklama është shpirti i tregtisë". Ne mund të marrim këtë për mirë nëse kemi parasysh nivelin e fitimeve që kompanitë shumë kombëshe kanë bërë në vitet e fundit. Po të marrim për shembull kompanitë multinacionale, të cilat i shpjegon Naomi Klein (Montreal 8 Maj 1970 gazetare shkrimtare dhe aktiviste) në librin e saj "No Logo", publikuar në Janar 2000. Libri merret kryesisht me fenomenin e brading (marrja me teknikat e marketingut të markave apo produkte specifike) në lëvizjen anti globale.

Grupet e mëdha që kanë globalizuar një pjesë të ekonomisë botërore kanë krijuar strategji të tyre të biznesit për reklamimin e markave të tyre, duke ju dhënë të tretëve pjesë të madhe të aktiviteteve të prodhimit dhe investuar shumicën e nismave të saj në publicitetin e markës së saj të korporatave. Shumë kompani të tjera shumëkombëshe kanë kuptuar se puna e vazhdueshëme dhe këmbëngulëse dhe kushtet psikologjike çojnë në identifikimin e personit me një imazh të caktuar e të vetëm që është logo e kompanisë.

Psiko-ekonomike, është një disiplinë që mund të duket një emër të çuditshme, nuk është plotësisht i panjohur: zhvillimi i njohjes së psikologjisë aplikuar në fushën e sociologjisë e komunikimit ose në reklamat janë fushat e zbatimit të psiko-ekonomike, aty ku motivet ekonomike ndërthuren me shprehje të psikikës njerëzore.

1. Psiko-Ekonomia: horizontet e reja të shkencës ekonomike.

Sistemi ekonomik, sipas vizionit të ekonomisë së tregut të shoqërisë moderne perëndimore, është rrjeti i ndërvarësive dhe ndërlidhjeve ndërmjet operatorëve ose subjekteve ekonomike që kryejnë veprimtaritë e prodhimit, konsumit, shkëmbimit, punës, kursimeve dhe investimeve për të kënaqur nevojat individuale dhe të fitojnë maksimalisht, duke optimizuar përdorimin e burimeve, duke shmangur mbeturinat dhe duke rritur produktivitetin individual edhe duke ulur koston e punës.
P.R.Sarkar, filozof Indian, në ekspozitën e tij të Dimensionit të Katërt të Ekonomise, hodhi themelet për një dege të re të studimeve ekonomike të vendosur në rraporte, marrdhënie reciproke dhe të drejtëpërdrejta me shkencat shoqërore , **psiko-ekonomia**.
Psiko-ekonomia, një disiplinë që mund të duket me një emër të çuditshëm, nuk është plotësisht e panjohur. Kjo degë e re ndihmon në zhvillimin e më tejshëm të njohjes së psikologjisë aplikuar në fushën e sociologjisë , komunikimit ose në reklamat të cilat janë fushat e zbatimit të psiko-ekonomis. Qartësisht ndikon në mënyrë progresive aty ku motivet ekonomike thuren me shprehje të psikikës njerëzore. Kur përgatitet një produkt komercial departamenti i ekspertëve të komunikimit, të sociologjisë, të psikologjisë, drejtorët e filmimeve, etj kujdesen për të paraqitur produktin (reklamuar) në një mënyrë që të bëjë atë sa më të pëlqyeshëm për konsumatorët. Për të arritur këtë rrezultat, ata stimulojnë, shprehin, manipulonjë ndjenjat e njerëzve të tërhequr nga kureshtja dhe në të përgjithëshmen jo vetëm vëmendjen vizuale por edhe atë mendore. Kjo është arritur duke përdorur imazhe, tinguj, ndjesi që hedhin kujtesën tonë në të kaluarën, në të ardhmen dhe në të tashmen. "Inputet e kujtesës" të shkaktuara nga reklama, do të mbetet në çdo rast, gjithmonë të lidhura me një produkt i cili ka për qëllim për tu shitur ose në rastin më të mirë, për tu blerë nga njerëzit. Pra, edhe në qoftë se një spot apo reklamë është konceptuar ndonjëherë si një vepër arti, diferenca me të është se qëllimi është thjesht ekonomik , pra për të rritur shitjet e këtij produkti apo atij shërbimi.

Përpjekja për të bërë një përshtypje për konsumatorët duke stimuluar interesin e tij sigurisht që është një vlerë e shtuar e një aktiviteti ekonomik, dhe ka nga ata që në emër të parasë thonë sloganin "reklama është shpirti i tregtisë". Ne mund të marrim këtë për të mirë nëqoftëse kemi parasysh nivelin e fitimeve që kompanitë shumë kombëshe kanë bërë në vitet e fundit. Po ti referohemi kompanive shqipëtare na tërheq reklama imponuese gati e dhunshme e tendencave monopoliste në treg. Por reklama ndryshon nga reklama. Po ti referohemi kompanive multinacionale, të shpjeguara nga gazetarja kanadeze Naomi Klein në librin e saj "No Logo", vëmë re se grupet e mëdha ekonomike të globalizuara kanë krijuar në një pjesë të madhe të strategjisë së tyre të biznesit, reklamimin e markës së tyre. Duke transformuar një pjesë të madhe të aktiviteteve të prodhimit dhe investuar shumicën e nismave të saj në publicitetin e markës së korporatave, çdo kompani shumëkombëshe ka kuptuar se sa i vazhdueshëm dhe këmbëngulës duhet të jetë kushtëzimi psikologjik. Është ky kushtëzim që çon në identifikimin e produktit apo shërbimit, nga ana e personit me një imazh të caktuar dhe të vetëm, logon e kompanisë.

Kjo ide nuk është aq e re apo e avancuar për shkak se në shumë filozofi lindore ekziston praktika e përqëndruar në forma gjeometrike apo simboleve (këto janë quajtur Yantra dhe janë përdorur në shumë praktika e meditimit dhe Buddhist dhe Tantra Yoga) për të ndërtuar brënda vetes një botë të mirëqënies shpirtërore. Por në mes të strategjisë dhe praktikave të murgjve nga njëra anë dhe kompanive

shumëkombëshe ka një "ndryshim semantik" thelbësor.

Priftërinjtë kanë vendosur, duke mbyllur sytë sa herë që bëjnë meditim, me pak fjalë bëjnë një zgjidhje midis vetes dhe ajërit ndërmjetësuar nga ndërgjegjja.

Në rastin e logos tregtare të një kompanie shumëkombëshe (psh. coca cola), ne jemi ballafaquar me një "bombë" të vazhdueshme dhe masive jashtë personit i cili me kalimin e kohës bëhet imazh i natyrshëm dhe i njohur, pra ne jemi të ballafaquar me një ajër të imponuar nga jashtë. Kur personazhet e portretizuar në tabela, gjithmonë të shkojnë në një varkë me vela, jetojnë në shtëpi super luksoze, drejtojnë makinat nga 100.000 euro si dhe të produkteve që reklamojnë në mënyrë bindëse dhe të nevojshme për suksesin e tyre, si dhe ky mesazh është përsëritur ose të riprodhohet mijëra herë , atëherë maturohet ideja tek njerëzit se "unë blej, sepse unë jam".

Por kjo "Mantra" pra kjo energji, e cila përsëritet në mënyrë të pandërgjegjshme nga miliona e miliona njerëz, nuk është zgjedhur nga konsumatori individual, por erdhi në shtëpitë tona nëpërmjet televizionit, ne gjejmë atë në radio të makinës tonë, kur ne udhëtojmë, në rrugë ose në stadium në postera reklamash, në supermarkete, objektet argëtuese dhe madje edhe në rrobat që ne veshim. Duhet të theksohet se është e vështirë për të shpëtuar nga një gjë, kur ky vullnet është një mënyrë e vazhdueshme tërheqëse e propozuar.

Kur reklamat janë plot me mesazhe të padukshme që shkojnë përtej syrit të njeriut mëndja e konfirmon atë imazh. Kur një akullore të bëhet një objekt seksual ose kur një çokollatë ndryshon jetën tuaj, kur një shampo ju lejon për të pushuar në Palasë dhe një pjatë makarona ju sjell qetësi në shtëpi, ne duhet të pranojmë se edhe pse këto mesazhe duan të interpretojnë jetën e përditshme, nga realiteti kanë pak, sepse realiteti e dimë të gjithë dhe është krejt një gjë tjetër.

Është gjithashtu e vërtetë se gjithkush mund të jetë në dijeni të manipulimit të cilit i është nënshtruar, por promovimi i produkteve të caktuara është aq këmbëngulës dhe konkurrenca e dobët në mënyrë që njerëzit janë të detyruar të konsumojnë atë produkt të veçantë edhe pse nuk është jetësisht e nevojshme.

2. Psiko-ekonomia dhe dinamikat e reja të shfrytëzimit.

Ka një linjë ndarje delikate në mes të vullnetit të lirë dhe manipulimeve në grup; në mes të tregut të lirë dhe monopolit. Nëpërmjet psiko-ekonomisë së punës nxirret në pah atë që është përtej dhe në këtë anë të kësaj linje. Në këtë drejtim filozofi indian Prabhat Ranjan Sarkar ka teorizuar dy degë të aplikimit të psiko-ekonomisë: E para është përqëndruar në zbulimin dhe zhdukjen e të gjitha këtyre praktikave, strukturave të padrejta ekonomike dhe sjelljeve që çojnë në shfrytëzimin dhe që pengojnë zhvillimin e qenieve njerëzore. Sarkar koncepton njeriun në tërësinë e shprehjes së tij, si në nivelin e nevojave fizike dhe niveli i nevojave psikologjike e shpirtërore. Në marrëdhënien midis nevojave materiale dhe mendore nuk duhet lënë pas dore progresi njerëzor. Progresi njerëzor nuk është vetëm material, por është një ekuilibër mes nevojave fizike, psikologjike dhe shpirtërore.

Po ti referohemi librit "No Logo" të Naomi Klein (gazetare kanadeze) shikojmë se ajo i jep një formë të qartë llojeve të reja të shfrytëzimit. Ajo shpjegon se ndërsa në qendra shkëlqejnë këpucë me logon e Nike

dhe të korporatave të tjera shumëkombëshe, pak e dinë se çfarë forma të shfrytëzimit i janë nënshtruar gratë punëtore që punojnë në fabrikat prodhuese të dislokuara në Indonezi ose Filipine.

Pak konsumatorë të cilët veshin, duke shfaqur me krenari logot e këtyre këpucëve, i dinë kushtet ç'njerëzore të cilave ju janë dorëzuar punëtorët që kanë prodhuar këpucët që ata mbajnë në këmbë dhe me të cilat mburen.

Bota e qytetëruar ka hyrë dhe hyn në grevë duke sakrifikuar orët e punës, luftoi shumë për të marrë të drejtat që punëtorët kanë. Por po kjo popullsi nuk janë në dijeni të prejardhjes së këtyre produkteve që konsumojnë. Këto produkte janë të njëjta fruta të shfrytëzimit, vetëm për shkak se bombardimet reklamat ka krijuar një imazh pozitiv që frymëzon besimin dhe besueshmërinë në mendjen tonë edhe pse realiteti nuk lexohet. Nëse shfrytëzimi i punëtorëve është i lirë, në rastin e konsumatorit perëndimor është shfrytëzimi psiko-ekonomik dhe kjo është ide e manipuluar, e cila është një produkt i psikikës, për qëllime ekonomike : shitja e produktit.

Ky është një koncept i ri i shfrytëzimit që është studimi i veçantë i psiko-ekonomike. Ngacmimi, reklamat mashtruese, teorizimi i asimetrive të informacionit, efektet psiko-sociologjike të lëvizshmërisë dhe të fleksibilitetit në tregun e punës dhe në përgjithësi të gjitha format e marrëdhënieve ekonomike që prodhojnë degjenerim dhe tendencat depersonalizuese në shoqëri janë pjesë e kësaj dege të parë të zhvillimit të psiko-ekonomisë.

3. Psiko-ekonomia dhe përmirësimi i cilësisë së jetës.

Ndërsa deri tani u shpjegua shqetësimi mbi praktikat shfrytëzuese nga këndëvështrimi i psiko-ekonomisë, tani do të trajtojmë shqetësimin për të përmirësuar cilësinë e jetës së njerëzve duke rritur siguri materiale dhe mendore të popullsisë. Aktualisht, ky drejtim i studimit është praktikisht e pashkelur por ka ekonomi në Europë, Amerikë, Azi etj. që kanë zgjidhur tashmë problemet e lidhura me minimumin e nevojshëm dhe se kanë arritur një shkallë të lartë të zhvillimit teknologjik. Këto vënde mund të aplikojnë potencialin e madhe të kësaj çështjeje.

Sot të gjithë jemi duke folur në lidhje me nevojën për cilësinë më të madhe të jetës dhe të kombinuar kjo nevojë me më shumë konsumim e mallra dhe pasurish materiale. Në sajë të këtij koncepti të kufizuar të "mënyrës së jetës", vërtetë vrapojmë të gjithë për të bërë jetët tona më të rehatshme në kuadrin e ekzistencializmit material, për të mos kthyer jetët tona në një "stres të përjetshëm".

Kjo, në nivel kolektiv, i ka dhënë formë të llojeve të ndryshme të pafavorshme sociale, të tilla si format e depresionit për shkak të ritmit të punës, shkëputjes dhe personalitetit, çrregullimeve për shkak të modeleve ekzistenciale të diktuara nga konsumi i tepërt i të mirave materiale,etj. Psiko-ekonomia mund të jetë një mjet i shkëlqyer për përballjen problemet e ambjentaliste në bashkëpunim me nevojat njerëzore dhe zgjedhjet e politikave ekonomike.Deri më tani, ekonomia e bazuar mbi fitimin ka konceptuar marrëdhëniet me mjedisin dhe burimet natyrore në vendet e shfrytëzimit të këtyre potencialeve natyrore duke krijuar nivele të paqëndrueshme ndotjesh. Ne jetojmë në qytete ku ajri është rënduar për shkak të emetimit të hidrokarbureve dhe pluhurit dëmshme nga makina. Zgjedhjet urbanistike irracionale dhe

trafiku i mbingarkuar e bëjnë jetën tonë të përditëshme nervoze duke na u shfaqur edhe stresi fizik edhe ai psiqik.

Edhe ajo që ne hamë nuk është më e sigurt për shkak të zgjedhjeve, industrisë ushqimore, të cilët parapëlqejnë për të rritur fitimet përpara shëndetit të njeriut.Nëse në vendet e varfra, njerëzit janë duke vdekur nga uria, në vendet e pasura konsumojnë tragjedi çdo ditë të errët dhe të heshtur: çdo vit miliona njerëz vdesin nga kanceri, tumoret, kardiovaskulare dhe sëmundjet e frymëmarrjes të shkaktuara nga ndotja e ajrit, ushqim dhe ujë.

Konkluzione.

1. Në fakt, nevojat e sotme në vendet e pasura, janë se zgjedhjet ekonomike duhet të marrin parasysh ndikimin e mjedisit dhe pasojat, si fizike dhe mendore të qënieve njerëzore, në vend të përfitimeve që rezultojnë. Në këtë koncept konsumohet dallimi thelbësor ndërmjet shfrytëzimit maksimal dhe shfrytëzimit. Ekonomia në bazë të maksimizimit të fitimit shfrytëzon çdo burim për të arritur këtë qëllim duke sjellë njerëzimin në zgjedhje irracionale dhe të rrezikshme edhe për ekzistencën e tij sepse në përzgjedhjen e politikave ekonomike po paraprin politika e naftës dhe sigurimit të saj megjithatë shkenca ka krijuar tashmë për sistemet e konvertimit. Përgjigja qëndron pikërisht në fitimet e atyre që kontrollojnë tregun e energjisë, përkatësisht kompanitë e shumëkombëshe të naftës që s'janë të gatshëm të heqin dorë nga situata e tyre e privilegjuar ekonomike, duke krijuar një gjendje të shfrytëzimit që e gjithë shoqëria vuan.

2. Psiko-ekonomia është mjet që do të lejojë në të ardhmen arritjen e shfrytëzimit maksimal të burimeve natyrore. Ky mjet do të drejtojë në zgjedhjen e prodhimit të tyre, tregtimit dhe konsumit në pajtueshmërinë maksimale me qenie njerëzore dhe nevojat e mjedisit. Këtu konsiston shfrytëzimi maksimal i burimeve.

3. Nevoja sot është se zgjedhjet ekonomike duhet të marrin parasysh ndikimin e mjedisit dhe pasojat, si fizike dhe mendore të qenieve njerëzore. Psiko-ekonomia, gjatë vlerësimit të një investimi, tregtie ose biznesi, të një produkti, parashikon efektet anësore. Për të arritur këtë ai përdor tregues të ndryshëm. Psiko – Ekonomia propozon një tregues të ri, indeksi i përgjithshëm i cilësisë së jetës (IGQV).

   Ky indeks përfshin vlerësimin e treguesve në vijim:

   1.Ndikimi mjedisor
   2. Ndikimi në shëndetin e njeriut:
   3. Ndikimi psikologjik:
   4. Ndikimi socio-kulturore
   5. Ndikimi në format jo-njerëzore të jetës

   Kjo lidhje midis ekonomisë dhe nevojën e personit psiko-fizik, kjo është një kërkesë e natyrshme e qytetërimit njerëzor dhe si i tillë duhet të jenë të kënaqur.

4. Sot shoqëritë shumë të industrializuara vuajnë nga forma të ndryshme të kësaj pafuqie kolektive të cilat çojnë në rrëzimin e të gjitha marrëdhënieve shoqërore. Administratorët publikë dhe politikanët kanë tendencë për të zgjidhur probleme të tilla si trafiku, huliganizmit, krime të vogla, etj caktimin e fondeve për të krijuar infrastrukturë të përshtatshme për të përmbushur ato. Duke pasur parasysh këto përpjekje financiare, të cilat për më tepër e rënduar xhepat e taksapaguesve, krimin, ndotjen dhe trazirë të përgjithshme sociale, e cila rritet gjithnjë e më shumë duke përdorur mjete të tilla si:

• Reduktimi i orarit të punës.
• Sistemi i rritjes sinkronizuar mes rritjes së produktivitetit dhe pagave.
• Përdorimi i formave të reja të pjesëmarrjes së punëtorëve në pronësinë e mjeteve të prodhimit.
• Krijimi i një mjedisi të pëlqyeshëm të punës në shëndetin fizik dhe mendor për punëtorët.
• Menaxhimi i prodhimit dhe aktivitete tregtare bazuar në parimin e "të koordinuar bashkëpunimin" dhe jo "bashkëpunimit të kushtëzuar".
• Rritja e cilësisë dhe sigurisë së produkteve dhe shërbimeve sjellë në treg,

Dëshiron të bëjë një kontribut të rëndësishëm në krijimin e një mjedisi të pëlqyeshëm në zhvillimin integral të individit dhe në harmoni me ligjet që qeverisin shoqërinë njerëzore. Vetëm në këtë mënyrë të gjitha ndikimet negative të zhvillimit shkencor dhe intelektual në lidhje me ekonominë mund të mbahet nën kontroll, dhe njerëzimi do të jetë në gjendje për të lëvizur në harmoni me natyrën e universit.

Sigurisht rruga e jetës ka ndryshuar rrënjësisht, por ju nuk mund të argumentojnë se e gjithë kjo është përparim real, në fakt, të gjitha zbulimet shkencore dhe teknologjike kanë krijuar probleme të kolateralit që nuk ka ekzistuar më parë. Aksidentet më të shpejtë të transportit janë shumëfishuar, industrializimi ka shkaktuar dëme të pathëna për mjedisin dhe shëndetin e njerëzve. Shumë ilaçe trajtimin e sëmundjeve, por të gjenerojnë efekte anësore në të njëjtat pacientëve të cilët e përdorin atë, duke krijuar shtetet e varësisë ndonjëherë kronike, si të njëjtat sëmundje shërohet.

Kur të kemi arritur një nivel të caktuar të sigurisë ekonomike, të matur me garantimin e nevojave minimale dhe me rritje të vazhdueshme dhe jo të tepruar në fuqisë blerëse, ne duhet të lëvizin interesat kolektive në nivelin e nevojave psiko-shpirtërore.

Literatura:

1. Maltz, L., Deblois, P. & The EDUCAUSE Current Issues Committee. (2005). Top Ten IT Issues. EDUCAUSE Review, 40.

2. Abdullah, F. M., Mohammed, A. A., Maatuk, A. M. and Elberkawi, E. K.: Application of electronic management system in governmental institutions: An empirical study on the Libyan civil registration. Dubai, UAE—December 2019. https:// doi. org/ 10. 1145/ 33686 91. 33687 10.

3. Tham, C. M., & Werner, J. M. (2005). Designing and evaluating e-learning in higher education: A review and recommendations. Journal of leadership & organizational studies, 11(2).

4. Gaebel, M., Kupriyanova, V., Morais, R. and Colucci, E. 2014. E-learning in European Higher Education.

5. Osamwonyi. E &Akpata. T (2016) "In-Service Education of Teachers: Overview, Problems and the Way Forward", *Journal of Education and Practice*Vol.7, No.26.

ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM EKONOMIK NJË SFIDE E SË TASHMES.

Dr. Mimoza Zeneli

mzeneli2017@gmail.com

ABSTRACT

The concept of Sustainable Development (SD) based on people, planet and prosperity, with the aim of achieving the Sustainable Development Goals (SDGs) is ambitious and creates a new development paradigm[198]. This new concept is based on the multidimensional structure of objectives as well as the inclusion of individual-centered actors. How possible is this in the current conditions of economic, social and institutional development of Albania.

What is the work done by Albanian institutions in this field knowing that since 2015 Albania has become part of this process? Despite the efforts made in this direction, an intensive and quality work is required to make possible what the policymakers have written in the strategic documents to be realized in fact.

Key words: Sustainable, SGG , Goals, multidisciplinary, objectives

1.Shqipëria në këndvështrimin e Agjendës 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm (SDG[199]).

Në vitin 2015 Shqipëria dhe shtete e tjera anëtare të Kombeve të Bashkuara, miratuan Agjendën 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm (SDG). Zhvillimi iqëndrueshëm i ekonomisë tashmë është njësfidë kryesore për Shqipërinë.Axhenda e vitit 2030 është përqëndruar në 17 Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG), 169 synime dhe mbi 230 tregues, të cilat mbulojnë të gjitha aspketet kryesore të zhvillimit (i) Ekonomik (ii) Social dhe (iii) Mjedisor.

Axhenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm[200], ofron një plan të përbashkët për paqen dhe prosperitetin për njerëzit dhe planetin, tani dhe në të ardhmen.17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG), janë një thirrje urgjente për veprim nga të gjitha vendet - të zhvilluara dhe në zhvillim - në një partneritet global.Ata pranojnë se dhënia fund e varfërisë dhe privimeve të tjera duhet të shkojë paralelisht me strategjitë që përmirësojnë shëndetin dhe arsimin, zvogëlojnë pabarazinë dhe nxisin rritjen ekonomike – të gjitha duke trajtuar ndryshimet klimatike dhe duke punuar për të ruajtur oqeanet dhe pyjet tona.

Përmbushja e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm ka për bazë zhvilliminglobal dhe përballimin e problemeve gjithmonë në rritje, si thellimi ihendekut të varferise, diferenca ekonomike dhe sociale e familjeve rurale me ato urbane, aksesi në shërbimet shëndetësore dhe sociale, menjanimi i shtresave në pozitë të pafavorshme për shkak të gjinisë, vendodhjes, përkatësisë etnike, paaftësisë fizike etj.

Para së gjithash përmbushja e këtyre objektivave, kërkon një kuptim të qartë nga të gjithë palët e interesuara për rëndësinë e objektivave si dhe kontributin e drejtpërdrejtë të tyre për një mirëqenije shoqërore të përmirësuar.

[198]Literature Review on Sustainable Development The spirit and the critics of SD and SDGs, Pedro Neves . January 2018

[199] Sustainable Development Goal , agenda 2030

[200]https://sdgs.un.org/goals

2. Ekonomia e Shqipërisë, ndryshimi i PBB-së 2008-2020.

Rritja ekonomike vitet e fundit ka pësuar ndryshime të crregullta në mungesë të plote të një trendi të qartë, duke reflektuar në këtë mënyrë specifikat dhe natyrën e evolimit socio ekonomik të Shqipërisë.

Vërejmë një rritje deri në 3.75% në vitin 2010 për të rënë më pas në vitin 2013 në 1%, e cila pasohet me një rritje graduale duke arritur deri në 4% në vitin 2018 e cila mëpas vijon me një rënie në vitin 2020 me -3.48% e cila përkon dhe me periudhën pandemike të COVID 19.



Burimi : INSTAT

Ky ndyshim i PBB në nivel Kombëtar thellohet më shumë kur analizojmë atë në këndvështrimin rajonal. Grafiku I mëposhtëm tregon më së miri ndryshimin në vlerat negative të PBB ndërmjet rajoneve.

Më poshtë paraqitet rritja e PBB 2008-2022 në nivel Kombëtar si dhe për tre rajonet Rajonin Qendror,



Rajonin Verior dhe atëJugor



Burimi: INSTAT

Njihet fakti se rritja ekonomike sjell rezultate positive në rritjen e shkallës sëpunësimit dhe uljen e varferisë.Të dhënat e INSTAT për vitet 2008-2020 tregojnëse niveli i punësimit nuk ka ndjekur tendencën e ndryshimit të zhvillimit të ekonomisë ndërkohë niveli i varfërisë është ulur me rritjen e PBB.



Burimi; INSTAT

Siç vërehet edhe nga grafiku, niveli i varfërisë në % në vitin 2012 është më e ulët në të gjitha rajonet se në vitin 2002.

Ka ardhur koha të jemi më të qartë në objektivat themelore të zhvillimit dhe modelit të rritjes ekonomike për dy dekadat në vazhdim. Duhet të ndërtojmë "profilin" apo "portretin" e ekonomisë shqiptare të së

nesërmes[201] shprehet A. Civici në Forumin Modeli ekonomik dhe Sfidat, por cështja qëndron se a është e gatshme politika dhe institucionet për të adresuar këto problem dhe në orjentimin e politikave të qarta për të krijuar një strategji të qartë dhe të kostueshme për të krijuar premisatpër një zhvillim të qëndrueshëm.
Pavarësisht përpjekjeve të politikbërësve për të rishikuar modelin ekonomik të zhvillimit të Shqipërisë, është koha që ky ndryshim të bëhet nga kontribuesit më të rëndësishëm tëekonomisë në nivel qëndrore dhe lokal qëështë individi.

3. Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm si një domosdoshmëri e kohës.

SDG 2030 Agenda është një marrëveshje ndërmjet shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara për të përmirësuar në tërësi ekonominë. Kjo do të arrihet duke bashkuar qeveritë e tyre përkatëse, bizneset, mediat, institucionet e arsimit të lartë dhe OJQ-të lokale për të përmirësuar jetën e njerëzve në vendin e tyre deri në vitin 2030.
Është një sfidë e rëndësishme e cila kërkon një ndërgjegjësim të të gjithë aktorëve në zhvillimin e një vendi. Ndërgjegjësimi nuk duhet kuptuar vetëm sinjë informim tëqytetarëve, oraganizatave, institucioneve por ka të bëjë me fuqizimin e tyre për të qënë të aftë të marrin pjesë në realizimin e këtyre objektivave në cdo aspekt të jetës duke filluar nga përditshmëria.
Nuk mund të kemi zhvillimim të qëndrueshëm kur rrisim prodhimin e energjisë dhe nuk kujdesemi për mjedisin, kur rriten investimet dhe nuk punohet për reduktimin e varfërisë, përmirësojmë infrastrukturën rrugore apo të edukimit pa u kujdesur që të mos kemi individë të margjinalizuara.
Megjithatë, edhe pse Shqipëria ka integruar SDG-të në kuadrin e politikave kombëtare dhe ka krijuar mekanizma për vendimmarrje të rëndësishme strategjikë - si Komiteti Ndërministror dhe Grupi i Punës Ndërinstitucional për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, shpesh, përpjekjet për të vlerësuar koston e përmbushjes së këtyre objektivave të zhvillimit. dhe për të identifikuar opsionet e financimit janë të pamjaftueshme[202].
Vendi ende përjeton sfida socio-ekonomike dhe pabarazi (në rritje), të cilat përkeqësohen më tej nga pandemia e paprecedentë e COVID-19, si dhe nga fatkeqësitë natyrore, si tërmeti i nëntorit 2019 dhe ndryshimet klimatike. Këto jo vetëm kanë nxjerrë në pah urgjencën e Axhendës së Zhvillimit të Qëndrueshëm, por edhe nevojën për qasje tërësore për financimin e zhvillimit të qëndrueshëm që i përgjigjen pasigurisë së shtuar, goditjeve të ndërlidhura dhe shkëmbimeve ndërmjet zgjedhjeve të politikave.
Pavarësisht se Shqipëria tashmë ka përqafuar Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe sic është theksuar mësipër ka integruar SDG-të në kuadrin e politikave kombëtare, sfida kryesore tashmë konsiston në punën e përbashkët institucionale te te gjithe aktoreve ku në qëndër duhet të jetë zhdukja e varfërisë, pabarazisë dhe konsolidimit të dinjitetit njerëzor.

4. Rekomandime dhe konkluzione.

- Rritja e ndërgjegjësimit të të gjithë aktorëve në realizmin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm është një factor për garantimin e suksesit në këtë proces.
- Angazhimi i komunitetit në këtë proces qëndron duhet të konsiderohet prioritare. Nëse objektivat për një zhvillim të qëndrueshëm synojnë uljen e varfërisë apo konsolidimin e dinjitetit njerezore,

[201]Ardian Civici, Forumi –Modeli Ekonomik dhe Sfidat , Shkurt 2020
[202]https://albania.un.org/en/114509-strategic-policy-options-sdg-financing-joint-programme

kjo gjë mund të arrrihet vetëm me angazhimin e aktorëvë të interest të cilët adresojnë saktë problemet. Pavarësisht përpjekjeve të institucionalistëve për integrimin e SDG në strtategjitë apo në planet e veprimit, zbatueshmëria e tyre kondicionohet nga Individi i cili duhet të kuptojë rëndësinë e tyre dhe të identifikojë alternativa zbatimi. Vetëm në këtë mënyrë mundet që këto strategji plane apo dokumenta startegjik të realizohen me sukses.

- Forcimi ikapaciteteve institucionale (qëndrore dhe locale) të nevojshëm për përgatitjen dhe realizimin e objektivave të mirëpërshtatur me kushtet e Shqipërisë.
- Rritja e angazhimi të Njësisve të Qeverisjes Vendore si një element kyç në këtë proces për të mundësuar përshtatjen e planeve të qeverisjes vendore me atë të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm.
- Forcimi i kapaciteteve të shoqatave apo organizatave përfaqësuese të shoqërisë civile për të vepruar dhe për të shtyrë përpara realizimin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm si një nga faktorët kryesorë ndikues.

Bibliografia

1. Literature Review on Sustainable Development The spirit and the critics of SD and SDGs, Pedro Neves . January 2018,
2. Accelerating the implementation of the SDGs: How multilevel governance supportsthe implementation of SDG 12 in the EU, Melle Potter , Universität Münster,2020
3. Sustainable development goals and uncertainty visualization,JESSICA GOSLING-GOLDSMITH Enschede, The Netherlands, September 2018
4. Raporti i vlerësimit mbi situatën aktuale në realizimin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm në nivel kombëtar dhe local, Mars 2019
5. Support to SDG Financing Programme, Qershor 2020
6. How the UN is supporting The Sustainable Development Goals in Albania
7. Albania launches Sustainable Development Goal 4-Education 2030 and the Education Policy Review report
8. Forumi –Modeli Ekonomik dhe Sfidat , Shkurt 2020
9. Literature Review on Sustainable Development
10. The spirit and the critics of SD and SDGs
11. Literature Review onSustainable Development
12. The spirit and the critics of SD and SDGs

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Kolegji Universitar i Biznesit
Integration of the higher education system, security and progress towards the EU! : 8th international conference of UCB / University College of Business. - Tiranë : Erik, 2023.
343 f. ; 21 x 29.7 cm.
ISBN 9789928380173
1.Arsimi i lartë 2.Studimi dhe mësimdhënia 3.Bashkimi Evropian 4.Konferenca
378 (062)